

DEMOKRACIA SOCIALE BOTIMI 2

Simon Vaut (e të tjerë)

Ekonomia dhe Demokracia Sociale



AKADEMIA
PËR DEMOKRACI
SOCIALE

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG



Botimi i tretë i përditësuar

Botuar nga



Friedrich-Ebert-Stiftung

Botimi në gjermanisht: Akademia politike, Bon, dhjetor 2009

Botimi në anglisht: Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Berlin, maj 2011

Botimi në shqip: Fondacioni Friedrich-Ebert, Tiranë, dhjetor 2020

Redaktuar nga: Jochen Dahm, Tobias Gombert, Christian Krell, Simon Vaut

Përgjegjës: Dr. Christian Krell / Drejtues projekti: Jochen Dahm

Shtypur nga: Design & Print "AP" Studio

Përkthyer nga anglishtja: Enrieta Hasanaaj

Redaktoi në shqip: Martin Blushi

Fotoja e kopertinës: Frédéric Cilon; Nyul/Hans12/Chesse, fotolia

Autorët e rubrikave individuale janë vetë përgjegjës për përmbajtjen e tyre.

Mendimet e shprehura këtu nuk janë domosdoshmërisht ato të Fondacionit "Friedrich Ebert".

DEMOKRACIA SOCIALE BOTIMI 2

Simon Vaut (e të tjerë)

Ekonomia dhe Demokracia Sociale

PËRMBAJTJE

Parathënie	4
1. Hyrje	12
2. Teoritë themelore ekonomike	15
2.1. Adam Smith – Themeluesi i liberalizmit ekonomik	18
2.2. Kritika e kapitalizmit e Karl Marx-it	23
2.3. John Maynard Keynes: Menaxhimi i kapitalizmit	29
2.4. Modelet ideale të teorisë ekonomike	34
2.5. Ekonomia sot	36
3. Sistemet ekonomike dhe rendet ekonomike	48
3.1. Kapitalizmi dhe demokracia	48
3.2. Kapitalizmi i koordinuar dhe i pakoordinuar	52
3.3. Kuadri i ri si rezultat i globalizimit	57
4. Orientimet e politikave ekonomike të demokracisë sociale	61
4.1. Vlerat bazë	61
4.2. Të drejtat themelore	64
4.3. Parimet e politikës ekonomike	70
4.4. Excursus: Matja e rritjes cilësore	79
5. Krahasimi i programeve ekonomike të partive politike	81
5.1. Programi i Hamburgut – Programi bazë i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë	82
5.2. Parimet për Gjermaninë – Programi i CDU-së	86

5.3. "E ardhmja është e gjelbër" – Programi bazë i Bündnis 90/Die Grünen	88
5.4. "Parimet e Visbadenit" të FDP-së	90
5.5. "Pikat kryesore të programit" të "Die Linke-s"	93
5.6. Vlerësimi i programeve në përputhje me synimet e demokracisë sociale	95
6. Rendet ekonomike: Modelet e vendeve të caktuara	98
6.1. ShBA-ja	101
6.2. Britania e Madhe	105
6.3. Gjermania	108
6.4. Japonia	116
6.5. Suedia	122
7. Politikat ekonomike: shembuj praktikë	128
7.1. Politika industriale mjedisore: Politika e rritjes për një të ardhme të qëndrueshme	129
7.2. Politika Buxhetore: Çfarë i detyrohem Gjermanisë	133
7.3. Rreziqet dhe mundësitë e privatizimit	138
7.4. Puna e denjë dhe vendimmarrja e përbashkët: Politika e punës së denjë	143
7.5. Debati mbi pagën minimale	151
8. Vazhdo të mendosh	158
Bibliografia	159
Reagime ndaj botimit të parë në gjuhën gjermane	162
Rreth autorëve	164

PARATHËNIE e Botimit të 3-të në Gjermanisht

Kriza ekonomike dhe financiare solli një pikë kthese. Problemet që hasim shkojnë përtej thjesht përballimit të pasojave specifike të krizës dhe prekin vetë themelet e shoqërisë sonë. Sot, ne duhet të vendosim sesi duam të jetojmë e punojmë, jo vetëm për disa vite më pas, po për dekadat që do të vijnë. Si do të dukej një rend ekonomik i drejtë mbështetur në solidaritet? Ç'ekuilibër duhet gjetur midis shtetit dhe tregut? Si mund të triumfojë një politikë moderne ekonomike socialdemokrate, që drejtohet kah vlerat?

Këto janë pyetje kyçe për të gjithë ata që duan të japin mendimin e tyre dhe të marrin pjesë në politikë në mënyrë aktive. Besimi te tregu i pakontrolluar është lënë mënjanë. Tashmë, është shfaqur mundësia për të ndjekur një drejtim të ri, por vetëm ata që e dinë se ku po shkojnë do të mund të frymëzojnë të tjerët të përqafojnë idetë e tyre dhe të arrijnë objektivat. Kjo është një arsye më shumë për të qenë të sigurt për drejtimin e zgjedhur. Qëllimi i këtij libri është të ndihmojë për ta arritur këtë siguri. Pas shpjegimit të teorive të rëndësishme ekonomike, përshkrimit të rrethave ekonomike, cilësimit të vlerave dhe drejtimeve kryesore, ngrihet pyetja se çfarë nënkuptojnë këto vlera për një politikë konkrete socialdemokrate. Natyrisht, nuk ka përgjigje absolute për këtë. Ajo çka e bën të suksesshme një politikë ekonomike socialdemokrate duhet të vlerësohet mirë në mënyrë të vazhdueshme dhe të përshtatet çdo herë nga e para. Kësisoj, ky vëllim nuk ka për qëllim të japë përgjigje përfundimtare, por është një ftesë për të lexuar e reflektuar më thellë.

Ky është vëllimi i dytë i serisë "Botime për demokracinë sociale" dhe është shkruar mbështetur mbi botimin '*Bazat e demokracisë sociale*'. Ky i fundit shpjegon vlerat themelore të demokracisë sociale, krahason modelet sociale të liberalëve, konservatorëve dhe socialdemokratëve, si dhe paraqet dallimet midis demokracisë libertariene dhe asaj sociale. Vëllimi i tretë i kësaj serie titullohet "Shteti i mirëqenies dhe demokracia sociale".

Asnjë diskutim rreth ekonomisë së shekullit të njëzetentjetë nuk mund të rrijë pa marrë parasysh ndryshimet rrënjësore që ka sjellë globalizimi. Në vazhden e këtyre librave do të vijë edhe një tjetër vëllim i titulluar '*Globalizimi dhe demokracia sociale*', ku do të shqyrtohet globalizmi në raport me ndikimin që ka në formësimin e kuadrit të rendit ekonomik. Po kështu, analiza do të përqendrohet

edhe te konteksti i globalizimit dhe mundësitë për ta formësuar politikisht atë.

Dëshirojmë të falënderojmë Simon Vaut dhe Tobias Gombert. Simon Vaut shkroi pjesën më të madhe të librit. Tobias Gombert ka treguar kompetencë të jashtëzakonshme e përkushtim të konsiderueshëm me ndihmën që ka dhënë në punën botuese dhe edukative. Po ashtu, falënderojmë edhe Thomas Meyer dhe Michael Dauderstädt për këshillat mbi konceptimin e librit, Wilhelm Nölling për komentet me vlerë dhe të gjithë ata që morën pjesë për bashkëpunimin e shkëlqyer. Pa kontributin e tyre, ky libër nuk do të ishte i mundur; për çdo mangësi jemi ne përgjegjës.

Akademia për Demokraci Sociale ka si simbol busullën. Qëllimi i Akademisë së Fondacionit "Friedrich Ebert" është të ofrojë një kuadër ku mund të qartësohen pikëpamje dhe orientime. Ne do të ishim të lumtur, nëse do të përfitonit nga kjo kur të zgjidhni rrugëtimin tuaj politik. Demokracia sociale varet pozitivisht nga një debat e angazhim konstant publik.



Dr. Christian Krell

Drejtues i

Akademisë për Demokraci Sociale

Bon, Dhjetor 2009



Jochen Dahm

Drejtues i projektit

"Botimet për demokracinë sociale"

PARATHËNIE e Botimit Ndërkombëtar

Shpërthimi i krizës financiare dhe ekonomike e ktheu qartë vëmendjen te ndërvarësitë dhe ndërlidhjet globale të ditëve të sotme. Për rrjedhojë, situata në të cilën gjendemi ndryshon kryekëput nga goditjet ekonomike të dekadave të mëparshme. Kjo ndodh jo vetëm për shkak të vetë shkallës së krizës ekonomike, por, mbi të gjitha, në sajë të një morie dukurish të krizës që bëhen bashkë. Kriza financiare dhe ekonomike nuk duhet parë më vete. Në të kundërt, ajo është e lidhur me krizën shqetësuese mjedisore dhe klimaterike, një krizë strukturore të drejtësisë dhe, në shumë rajone, me dobësimin e modelit mbizotërues të zhvillimit që orientohet nga eksporti. Është me rëndësi që këto simptoma që i mbi-vendosen njëra-tjetrës të shihen si një e tërë.

Në të njëjtën kohë, kjo është një krizë e shkencës së ekonomisë, e cila prej vitesh është murosur brenda ngrehinës së saj ideologjike, pa qenë e aftë t'i përgjigjet spektrit kompleks të krizës. E mbizotëruar nga rryma e përgjithshme neoklasike dhe e tërhequr larg nga pluralizmi produktiv ekonomik, ajo nuk mund të formulojë zgjidhje praktike, që do t'i përshtateshin këndvështrimit botëror të teorisë ekonomike standarde.

Të merresh me teorinë nuk është thjesht një përmbushje akademike. Pikëpamjet botërore të teorisë ekonomike ngërthejnë brenda tyre debatet politike dhe strategjitë konkrete, ku mbështeten alternativat praktike. Për këtë arsye, paraqitja e gjallë e qasjeve kryesore teorike në ekonomi që nis nga Adam Smith-i e deri në ditët e sotme është një tipar i rëndësishëm i botimit të dytë për demokracinë sociale (i pari, 'Bazat e demokracisë sociale', ka dalë tashmë në gjuhën angleze).

Sidoqoftë, pavarësia në interpretim përcaktohet para së gjithash në praktikën e politikës ekonomike. Veçanërisht, gjatë këtyre muajve të fundit, është zhvilluar gjerë e gjatë debati rreth modeleve të qëndrueshme ekonomike e sociale. Pas vitesh amullie, po rishqyrtohen konceptet e zhvillimit dhe marrëdhënieve midis tregut e shtetit, ekonomisë e shoqërisë. Megjithatë, edhe këto debate vazhdojnë të përshkohen nga një shkallë e lartë pasigurie kur vjen fjala për bazat rregullatore dhe të politikës sociale të koncepteve "të mira" ose "të qëndrueshme" zhvillimore.

Për këtë arsye, jam i kënaqur që ky vëllim rreket po ashtu të krahasojë programet e ndryshme të politikës ekonomike të partive politike gjermane, politikat konkrete ekonomike dhe, aq më tepër, orientimet bazë të politikave ekonomike të demokracisë sociale.

Botimet për demokracinë sociale e kanë zanafillën te aktivitetet që ka ndërmarrë Fondacioni “Friedrich Ebert” për edukimin politik në Gjermani. Shumë nga shembujt e marrë në këto botime pasqyrojnë politikat e shoqërinë në Gjermani ose vendet të tjera të OECD-së. Pavarësisht kësaj, ato ilustrjnë modele e rrjedha veprimi politike ideale, të cilat kanë vlerë edhe në kontekste të tjera sociale e politike. Në themel të punës ndërkombëtare që Fondacioni “Friedrich Ebert” zhvillon në më shumë se 100 vende qëndron bindja se vlerat dhe idealet bazë të demokracisë nuk njohin kufij.

Kështu, unë uroj që botimi ndërkombëtar i përmbledhjeve për demokracinë sociale të ketë lexues të përkushtuar e të shumtë në numër



Christiane Kesper

Drejtor

Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar

PARATHËNIE e Botimit në Shqip

Zhvillimi ekonomik, modelet dhe tiparet kryesore të tij kanë qënë dhe mbeten historikisht në një simbiozë të ngushtë me zhvillimet politike, nivelin e demokracisë dhe mirëqënien sociale. Raportet dhe ekuilibri i brishtë ndërmjet tyre, veçanërisht në epokën moderne, kanë përcaktuar themelet, ekuilibrat dhe strukturën e vetë shoqërisë njerëzore. Ekuilibrat ndërmjet shtetit dhe tregut, eficientës ekonomike dhe politikave sociale, liberalizmit dhe etatizmit, fitimit dhe interesave individuale dhe mirëqënies sociale, prodhimit të brendshëm bruto dhe kënaqësisë së brendshme bruto, ekonomisë e shërbimeve private dhe ekonomisë e shërbimeve publike, Shtetit të madh dhe Shtetit të vogël, globalizmit dhe lokalizmit, lirisë ekonomike e tregëtare e proteksionizmit, etj., kanë qënë vazhdimisht në fokus të dilemave, debateve dhe zgjidhjeve alternative politike, ekonomike e sociale për shoqëritë dhe vende të ndryshme të botës.

Pozicionimi teorik, institucional, politik, ekonomik e social ndaj këtyre dilemave apo zgjidhjeve të mundshme i ka dhënë jetë sistemeve politike, ekonomike, sociale e qeverisëse kudo ku ato janë debatuar e aplikuar. Natyrisht, jo pa debate e dilema të forta në emër të përcaktimit të versionit më të mirë të modelit të kapitalizmit, thelbit të demokracisë sociale, strukturës së rritjes ekonomike, shkallës së mirëqënies sociale, politikave e shërbimeve publike, barazisë sociale, pasurimit dhe varfërisë së shtresave të ndryshme sociale, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit, sistemet fiskale dhe modelet e rrishtëpërndarjes, etj. Këto pikëpyetje thelbësore janë tashmë në vëmendjen e analizave, debateve dhe zgjidhjeve konkrete në shumë vende të botës, në programet e partive politike, botën akademike e shoqërinë civile, aktivitetin dhe politikat kryesore të qeverive, strategjitë e institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare.

Libri “Ekonomia dhe Demokracia Sociale” është një lloj enciklopedie por dhe manual i shkëlqyer në trajtimin e këtyre dilemave, pikëpyetjeve, debateve e zgjidhjeve të propozuara, si nga këndvështrimi historik e politik i tyre, ashtu dhe nga këndvështrimi ekonomik, social dhe praktik i tyre. Janë të rrallë librat dhe botimet me trajtime kaq komplekse të një problematike të tillë kaq jetike për shoqërinë dhe të ardhmen e saj, veçanërisht në këto dy dekadat e para të shek.XXI-të, të mbushura me ngjarje, zhvillime, dilema, kriza, paqartësi, rreziqe e oportunitete të të gjitha llojeve, veçanërisht pesë fenomene madhore me të cilat është ndeshur e po ndeshet cdo vend apo kontinent i botës sonë : kriza financiare globale e

vitit 2008, kriza e pandemisë së covid-19, thellimi i pabarazive ekonomike e sociale në nivel global, globalizimi dhe e ardhmja e tij, kriza mjedisore e klimatike.

Në këtë mjedis plot sfida, problem nuk është vetëm dhënia e një përgjigjeje se si mund të përballohen këto problematika që prekin themelet e shoqërisë sonë, por mbi të gjitha, dhënia e përgjigjeve fundamentale për disa pyetje po kaq fundamentale : si duam të jetojmë e punojmë në dekadat e ardhshme? Cili është rendi ekonomik që garanton shkallën më të lartë të solidaritetit? Si duhet ti përcaktojmë raportet themelore ndërmjet Shtetit dhe tregut?, Shoqërisë dhe individit?, Liberalizmit dhe Socialdemokracisë?, etj.

Libri “Ekonomia dhe Demokracia Sociale” synon pikërisht rrugën dhe përpjekjet që duhen bërë për dhënien e këtyre përgjigjeve jetike për themelet dhe të ardhmen e shoqërisë sonë, duke vendosur në qendër të analizave, argumenteve dhe rekomandimeve të tij, Shtetin e mirëqënies, Demokracinë sociale dhe politikat ekonomike socialdemokrate, si zgjidhja më e mirë për të tashmen dhe për të ardhmen. “Tashmë, është shfaqur mundësia për të ndjekur një drejtim të ri, por vetëm ata që e dinë se ku po shkojnë do të mund të frymëzojnë të tjerët të përqafojnë idetë e tyre dhe të arrijnë objektivat. Kjo është një arsye më shumë për të qenë të sigurt për drejtimin e zgjedhur. Qëllimi i këtij libri është të ndihmojë për ta arritur këtë siguri është një ftesë për të lexuar e reflektuar më thellë.”

Natyrshtëm, libri fillon me një analizë të thellë historike të teorive themelore ekonomike dhe ekonomistëve të shquar - Adam Smithi, Karl Marksi, Xhon Maynard Keynesi - që kanë analizuar e trajtuar teorikisht e historikisht kapitalizmin, socializmin, komunizmin dhe socialdemokracinë, që kanë debatuar modelet e teorisë ekonomike e janë “ndeshur” për vlerat e kapitalizmit dhe liberalizmit ekonomik, socializmit apo ekonomisë sociale të tregut, menaxhimin e kapitalizmit dhe demokracisë sociale, tregun e lirë, fitimin individual e rishpërndarjen sociale, kapitalizmi dhe demokracia apo socializmi dhe demokracia sociale, etj.

Autorët, pasi reflektojnë mbi vlerat që këto teori kanë për demokracinë sociale, si “miniera idesh” nga të cilat mund të përfitohet shumë për të shqyrtuar thelbin e argumenteve të politikave ekonomike, duke u siguruar që të mos “verbohemi” nga ideologjia, arrijnë në përfundimin se “... edhe pse demokracia sociale nuk është tërësisht e ngërthyer prej njëres nga këto teori ekonomike, por përbën një kuadër të përgjithshëm normativ, ajo merr nga të tria teoritë e përmendura,

edhe pse anon qartazi nga kapitalizmi i menaxhuar që përshkruan Kejnsi ... Askush që merret seriozisht me ekonominë nuk mund të shpërfillë idetë e Smithit, Marksit dhe Kejnsit”.


Konkluzioni i tyre është i qartë : Demokracia sociale nuk përdor vetëm një, por një mori qasjesh të ndryshme teorike, në thelb të të cilave qëndron kapitalizmi i menaxhuar, i llojit që kërkonte Kejnsi. Socialdemokratët mbështeten edhe te kritika e kapitalizmit e Marksit, si dhe te efikasiteti dhe produktiviteti i tregut, i përshkruar nga Smithi. Sipas tyre, “një sistem ekonomik duhet të mbështetet te konkurrenca dhe prona private. Megjithatë, tregjet duhen rregulluar, krizat ekonomike duhen luftuar në mënyrë aktive nga shteti dhe duhet siguruar bashkëvendosja dhe pjesëmarrja”.

Një vend të veçantë e të gjerë në këtë libër gjejnë dhe “programet ekonomike e politike të partive socialdemokrate, kristian-demokrate, etj., vecanërisht programi bazë i Partisë Social Demokrate të Gjermanisë, që është një nga partitë kryesore socialdemokrate në botë. Me mjaft interes janë analizat dhe komentet për vlerësimin e programeve socialdemokrate në përputhje me synimet strategjike e historike të demokracisë sociale dhe ekonomisë sociale të tregut. Trajtimi historik dhe konkret i tyre, veçanërisht i modelit dhe përvojës gjermane, është një vlerë e shtuar orientuese e formuese për partitë dhe lëvizjet me natyrë dhe frymë socialdemokrate për të gjithë vendet apo grupimet politike të interesuara dhe të atashuara me këto vlera.

Me mjaft interes janë dhe trajtimet e hollësishme që i bëhen modeleve ekonomiko-politike e sociale, të përfshira në konceptin e modeleve të kapitalizmit, të zbatuara në vende si SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Japonia, Suedia, etj. Specifikat historike, kulturore, politike, ekonomike e sociale të çdo vendi, formësojnë modele të ndryshme kapitalizmi. Cili prej tyre është më i mirë, më i përshatshëm, më eficient, më social, më i qëndrueshëm, më reagues ndaj krizave?

Në libër gjenden mjaft prej përgjigjeve që kërkojnë pyetjet dhe pikëpyetjet e mësipërme, vecanërisht për vlerat e modelit ekonomik e social socialdemokrat gjerman dhe specifikave të tij për politikën industriale, rritjen ekonomike cilësore e gjithëpërfshirëse, qëndrueshmërinë buxhetore, punësimin cilësor e papunësinë mjaft të ulët, pagat dhe politikën e punës, shkallën e lartë të shërbimeve publike, harmoninë sociale, etj.

Botimi në shqip i librit “Ekonomia dhe Demokracia Sociale” është një kontribut i vyer për politikanët, ekonomistët, juristët, akademikët, shoqërinë civile, studentët dhe gjithë shoqërinë shqiptare për të njohur bazat dhe historinë dhe zhvillimet moderne të socialdemokracisë si model politik, ekonomik e social, për të njohur më në thellësi “modelin gjerman të socialdemokracisë”, dhe mbi të gjitha, për ti “përkthyer” këto njohuri e eksperiencia të vyera në objektiva e veprime konkrete politike, institucionale, ekonomike e sociale në Shqipëri.



Prof. Dr. Adrian Civici

Rektor i Universitetit “Mesdhetar i Shqipërisë”



1. HYRJE

Ç'politikë ekonomike i shkon për shtat demokracisë sociale?

Në vitin 1988, në fjalimin e tij përshëndetës kur mori detyrën, ish-kancelari gjerman, Gerhard Schröder, deklaroi se politika ekonomike e koalicionit të tij nuk ishte as e djathë e as e majtë, por një politikë ekonomike moderne.

Po, në të vërtetë, a kanë dallim politikat ekonomike të liberalëve, konservatorëve dhe socialdemokratëve? A ka një teori ekonomike që i përket qartësisht socialdemokracisë apo, aktualisht, ka vetëm teori ekonomike reja ose të dala mode? ¹

Po kush do të pranonte se përfaqëson një teori të vjetruar dhe çfarë do të thotë realisht “moderne” në këtë kontekst? Dikur, trajneri i futbollit, Otto Rehhagel, thoshte: “Çdokush që fiton është ‘modern’”. Në kontekstin politik, kjo do të thotë se politikë ekonomike moderne është çdo politikë që ka sukses.

Po si duhet matur ky sukses? Disa thonë se ai përbëhet nga mirëqenia dhe zhvillimi më i madh i mundshëm. Të tjerë e vënë theksin te barazia e drejtësia: një rend ekonomik nuk duhet të çojë për pasojë në pabarazi, shfrytëzim e padrejtësi. Terren po fitojnë ata që bëjnë thirrje për qëndrueshmëri, ruajtje të burimeve dhe të mjedisit, si piketa të suksesit ekonomik: zhvillimi nuk duhet të sjellë si rezultat mbishfrytëzimin.

Vlerat bazë të socialdemokracisë janë liria, drejtësia dhe solidariteti. Për rrjedhojë, një platformë partiake mund të ketë vetëm një përgjigje nga këndvështrimi i demokracisë sociale. Të tria parimet – që do të thotë, së pari rritja, së dyti, barazia sociale, së treti, qëndrueshmëria – duhen sjellë në harmoni me njëra-tjetrën.

Megjithatë, nuk ka një hartë të gatshme për të arritur deri aty. Një politikë ekonomike moderne e drejtuar për nga vlerat, po t’u referoheshim fjalëve të Gerhard Schröder, nuk përdor vetëm dhe instinktivisht as instrumentet e politikës ekonomike klasike të krahut të majtë e as të krahut të djathë. Një politikë moderne ekonomike socialdemokrate që ecën drejt vlerave drejtohet mbi të gjitha nga rezultatet. Ajo synon të krijojë një shoqëri ku liria, drejtësia, solidariteti dhe të drejtat e gjera themelore shoqërore, ekonomike e kulturore zbatohen për të gjithë.

¹ Në tekst përdoren të dyja format, mashkullore dhe femërore. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të gjuhës, nënkuptohen të dyja sekset.

Si matet suksesi në politikën ekonomike?

Ekuilibri midis rritjes ekonomike, barazisë shoqërore dhe qëndrueshmërisë mjedisore?

Ky libër do të ofrojë një orientim bazë për pyetjet se mbi cilat themele teorike mund të mbështetet demokracia sociale; cilat sisteme dhe rende ekonomike favorizojnë realizimin e ambicieve të saj; si qëndrojnë gjërat me rendet ekonomike në vende të tjera dhe çfarë mund të nënkuptojnë këto probleme teorike për politikëbërjen.

Objektivi dhe strukturat e përmbledhjes

Struktura tematike e lexuesit		Orientimi i politikës ekonomike të demokracisë sociale Kapitulli 4				
		Demokracia liberale		Demokracia libertariane		
Objekti i botimit "Bazat e demokracisë sociale"						
Objekti i botimit "Ekonomia dhe demokracia sociale"						
Kapitulli 2	Teoria	Marx		Keynes		Smith
Kapitulli 3.1	Sistemi			Kapitalizmi		
Kapitulli 3.2	Rendet	Autoritar		I koordinuar		I pakoordinuar
Kapitulli 6	Vendet			Suedia	Japonia	Gjermania
Kapitulli 5	Krahësimi i programeve partiake				Mbretëria e Bashkuar	ShBA
Kapitulli 7	Shembuj praktikë					

Së pari, në nivelin e **teorisë ekonomike** do të jepen analiza dhe përfundime nga ekonomistët më me ndikim në histori: Adam Smith, Karl Marx dhe John Maynard Keynes. Llojet ideale të liberalizmit ekonomik, antikapitalizmit dhe kapitalizmit të menaxhuar që burojnë prej këtej do të shqyrtohen më tej nga këndvështrimi i sotëm dhe duke mbajtur parasysh objektivat e demokracisë sociale (Kapitulli 2).

*Kapitulli 2:
Teoria ekonomike*

Në nivelin e **sistemeve dhe rendeve ekonomike**, do të studiohet lidhja midis kapitalizmit dhe demokracisë dhe do të prezantohen dy rendet ekonomike që mbizotërojnë në vendet e industrializuara perëndimore: kapitalizmi i koordinuar dhe i pakoordinuar (Kapitulli 3).

*Kapitulli 3:
Sistemet dhe rendet ekonomike*

Në nivelin e programeve të politikës ekonomike, nga njëra anë, **orientimi i politikës ekonomike në demokracinë sociale** zhvillohet mbi bazën e vlerave bazë, të drejtave themelore dhe parimeve të politikës ekonomike (Kapitulli 4).

Kapitulli 4: Orientimi i politikës ekonomike në demokracinë sociale

Nga ana tjetër, mbështetur në kriteret e rendeve të koordinuara dhe të pakoordinuara ekonomike dhe orientimit të politikës ekonomike të demokracisë sociale që përshkruhet më lart, do të bëjmë një krahasim të **programeve të politikave ekonomike** të partive që përfaqësohen në Bundestag mbi bazën e platformave të tyre politike (Kapitulli 5).

Vëllimin e përmbyll një krahasim midis modeleve të ndryshme ekonomike në **ShBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Japoni dhe Suedi** (Kapitulli 6) dhe shembuj konkretë të propozimeve për politika në fushat e politikës ekonomike, si **privatizimi, politika industriale mjedisore, puna e denjë dhe bashkëvendimmarrja** (Kapitulli 7).

Çështja e politikës ekonomike socialdemokrate cek një sërë nivelesh të ndryshme që do të trajtohen në këtë vëllim, veçanërisht, kur bëhet fjalë për atë çka e dallon në vetvete demokracinë sociale.

Një përgjigje të parë për këtë pikëpyetje e ofron PSD-ja në programin e vet bazë:

“Socialdemokratët nuk garantojnë vetëm të drejtat themelore civile, politike e kulturore për të gjithë, por edhe të drejtat ekonomike e shoqërore. Kjo garanton pjesëmarrje shoqërore të barabartë për të gjithë me anë të demokratizimit të shoqërisë, veçanërisht, përmes bashkëvendimmarrjes, shtetit parandalues të mirëqenies sociale bazuar në të drejtat civile dhe ekonomisë së koordinuar të tregut, që siguron epërsinë e demokracisë mbi tregjet.” (Programi i Hamburgut 2007: 19)

2. TEORITË THEMELORE EKONOMIKE

Në këtë kapitull

- paraqiten teoritë ekonomike me ndikimin më të madh historik;
- shqyrtohet vlera e tyre në kohët e sotme;
- vihet në dukje rëndësia që kanë për demokracinë sociale.

“Njerëzit praktikë, të cilët e mendojnë veten krejt jashtë çdo ndikimi intelektual, zakonisht janë robër të ndonjë ekonomisti të vdekur”, shkruante John Maynard Keynes (Keynes 1966: 323), i cili ishte vetë një prej ekonomistëve më të rëndësishëm të historisë. Në këtë kapitull, paraqiten dhe krahasohen elementet thelbësore të teorive të tij e të dy ekonomistëve të tjerë mjaft të rëndësishëm e me ndikim, Adam Smith-it dhe Karl Marx-it. Kjo përvijon tri polet e teorive më të rëndësishme ekonomike në histori.

Po a ia vlen të merresh me idetë e ekonomistëve që kanë jetuar kaq kohë më parë? A kanë ende vlerë shpjegimet e tyre në një botë të globalizuar përherë në ndryshim apo janë demode, pa kuptim dhe të hedhura poshtë nga historia?

Pse dhe në ç’mënyra i vlejné këto teori demokracisë sociale? Ato mund të jenë të dobishme në dy mënyra.

Pikësëpari, ato përbëjnë “miniera idesh” nga të cilat politikat mund të përfitojnë. Njohja me këto burime ndihmon për të shqyrtuar thelbin e argumenteve të politikave ekonomike, duke u siguruar që të mos “verbohemi” nga ideologjia.

Së dyti, edhe pse demokracia sociale nuk është tërësisht e ngërthyer prej njëres nga të tria teoritë ekonomike, por përbën një kuadër të përgjithshëm normativ, ajo merr nga të tria teoritë e përmendura, edhe pse anon qartazi nga kapitalizmi i menaxhuar që përshkruan Keynes.

Ato kanë qenë objekt kritikash të ashpra. Ka pasur përpjekje të panumërta për t’i përgënjeshtuar. Janë shpallur madje të vdekura, por e kanë vërtetuar sistematikisht se “qeni plak ende merr frymë”. Askush që merret seriozisht me ekonominë nuk mund të shpërfillë idetë e Smith-it, Marx-it dhe Keynes-it.

Tre ekonomistë të mëdhenj: Smith, Marx dhe Keynes

A kanë ende vlerë klasikët?

“Miniera idesh”

Demokracia sociale: Huazime nga të tria

*Konteksti historik:
Smith: Mesi i
shekullit të 18-të*

Çdo studim që u bëhet këtyre klasikëve duhet të marrë në konsideratë kontekstin e epokave të tyre përkatëse. Adam Smith-i i formuloi idetë e veta në mes të shekullit të tetëmbëdhjetë, në kohën e merkantilizmit, që u mësoi monarkëve se duhej të financonin lukset e oborreve të tyre duke kontrolluar tregtinë e duke drejtuar ekonominë. Për pasojë, Smith-i e ngriti skepticizmin kundrejt shtetit mbështetur në përvojat e tij me monarkitë ekstravagante në kërkim të pasurimit të vetvetes, përkundër, le të themi, një shteti modern të mirëqenies.

*Marx: Mesi i
shekullit të
nëntëmbëdhjetë*

Kritika elokumente e Marx-it kundër kapitalizmit në messhekullin e nëntëmbëdhjetë u rrek të jepte një përgjigje për varfërimin e masave gjatë industrializimit të hershëm dhe valës së parë të globalizimit. Sot, perceptimi i ideve të tij merr formë nga socializmi shtetëror i shekullit të njëzetë, i cili, ndonjëherë, ofron një panoramë të shtrembëruar.

Keynes: Vitet '30

Së fundi, në vitet '30, Keynes-i analizoi liberalizmin ekonomik, i cili, në dritën e krizës ekonomike globale, u duk qartë që po shpërbëhej me rrënjë. Teoria e tij e përgjithshme e Punësimit, Interesit dhe Parasë ishte jo më pak, por një përpjekje për të bërë propozime për stabilizimin e sistemit ekonomik, me qëllim që të parandaloheshin hyrja e demokracive të tjera në diktatura radikale. Me krizën financiare globale të vitit 2007, idetë e Keynes-it kanë përjetuar një rilindje. Si konstatimet e tij rreth rregullimit të tregut financiar global, ashtu edhe programet shtetërore të investimeve po diskutohen sërish intensivisht.

*Ide dhe modele
ekonomike të
përjetshme*

Përveç orientimit bazë, marrja në konsideratë e tre ekonomistëve të mëdhenj, Smith-it, Marx-it dhe Keynes-it, ka edhe një tjetër avantazh mjaft praktik. Shumë modele dhe argumente ekonomike që njohim sot e që i përdorim shpesh pa ua ditur prejardhjen, u formuluan prej tyre.

*Smith: "Dora e
padukshme e tre-
gut"*

Koncepti i "dorës së padukshme të tregut", për shembull, u prezantua nga Adam Smith-i. Ai ka për qëllim të shpjegojë efikasitetin e tregut. Sot, ai përdoret ndonjëherë në formën e një përfytyrimi mitologjik, sipas të cilit tregjet mund të ndreqin gjithçka.

	Smith	Marx	Keynes
Kur	Mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë.	Mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë	Vitet '30
Rasti	Merkantilizmi, absolutizmi	Industrializimi dhe varfërimi i punëtorëve	Kriza ekonomike globale dhe lindja e diktaturave
Synimi kryesor	Çlirimi nga shteti merkantilist	Përmirësimi i situatës së punëtorëve dhe çlirimi i tyre prej shfrytëzimit	Garantimi i demokracisë duke stabilizuar ekonominë dhe tregun e punës
Lidhjet me demokracinë sociale	Liria dhe modeli i bashkëpunimit	Modeli i "punës së denjë" dhe çështja e ekuilibrit midis punës dhe kapitalit	Modeli i ekonomisë së koordinuar dhe politikës ekonomike aktive

Nga ana tjetër, të gjithë ata që janë në kërkim të një politike e cila mund të sigurojë "punën e denjë" nuk e shpërfillin dot Marx-in. Ishte ai që formuloi konceptin kyç të "tjetërsimit të punës".

Së fundi, Keynes-i doli me thënien e tij të cituar shpesh, "në fund, të gjithë do të vdesim". Ai i bënte thirrje shtetit të merrte përgjegjësi për të kundërvepruar ndaj dështimeve të tregut. Komenti i tij u drejtohet kryesisht atyre që mbështeten te aftësia afatgjatë e tregut – që, shpesh, nënkupton një periudhë vërtet të gjatë – për t'u shëruar vetë, në vend të përgjegjësisë së shtetit për politikën ekonomike.

Marx:
"Puna e denjë"

Keynes: "Në fund, të gjithë do të vdesim"

Lexime të mëtejshme:
Nikolaus Piper (ed.) (1996), Die großen Ökonomen: Leben und Werk der wirtschaftswissenschaftlichen Vordenker, Stuttgart.

2.1. Adam Smith – themeluesi i liberalizmit ekonomik

Smith: “Pasuria e kombeve”

Konteksti historik:
Merkantilizmi në mes të shekullit të tetëmbëdhjetë

Vepra bazë e liberalizmit ekonomik është, “Pasuria e kombeve”, e botuar në vitin 1776 nga Adam Smith.

Asokohe, Britania e Madhe gjendej në një periudhë kalimi nga merkantilizmi në kapitalizëm (Gerstenberger 2006: 40, 57–65 dhe Conert 2002: 64).

Në epokën merkantiliste, që zgjati nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë në shekullin e tetëmbëdhjetë, Princërit dhe mbretërit e matnin suksesin e politikës së tyre ekonomike me sasinë e arit dhe argjendit që ishin të aftë të grumbullonin. Tregtia shihej si lojë me vlerë zero: çfarëdo përftonte një vend ishte në kurriz të një vendi tjetër. Importet e mallrave, për rrjedhojë, u nënshtroheshin tarifave të larta proteksioniste dhe nxitej importi i artikujve për përdorim të gjerë. Oborret mbretërore përpiqeshin të drejtonin ekonominë. Shoqatat e tregtarëve përcaktonin me hollësi se kush mund të zhvillonte aktivitete të caktuara dhe në ç’sasi mund të prodhoheshin mallrat.

Qëllimi i Smith-it:
tejkalimi i merkantilizmit

Smith-i shkruante atë që dikush mund ta quajë “manifestin kapitalist” të tij, me qëllim që të shkatërrojë këtë rend të ngurtë ekonomik. Idetë e tij gjetën një terren pjellor dhe ai kontribuoi për liberalizimin e ekonomisë dhe tregtisë.

Smith-i transformoi rrënjësisht teorinë e asaj çka ishte pasuria e një ekonomie kombëtare. Ai e maste pasurinë vetëm si puna e kryer dhe jo, siç bënte merkantilizmi, me rezervat e arit.

Adam Smith (1723–1790) konsiderohet si babai i liberalizmit ekonomik dhe jetoi si filozof moral dhe punoi si punonjës i doganave në Skoci.

Ai nxori tezën se, duke supozuar se forcat e tregut veprojnë lirisht, mirëqenia do të rritet në maksimum, nëse gjithkush ndjek interesin e vet. Në vitin 1776, Smith-i botoi librin, “Hulumtim mbi natyrën dhe shkaqet e pasurisë së kombeve” (*shpesh, i përmendur thjesht si ‘Pasuria e Kombeve’*), që mund të konsiderohet si baza e ekonomisë moderne. Idetë e tij themelore vazhdojnë të mësohen edhe sot në librat e ekonomisë.

Më pak i njohur është fakti se, Smith-i si filozof moral, në *‘Teorinë e ndjenjave morale’*, deklaroi se drejtësia, besimi dhe ndershmëria janë thelbësore për aktivitetin ekonomik dhe se mirëkuptimi i ndërsjellë është forca më e rëndësishme motivuese në themel të bashkëjetesës shoqërore.

Sipas Smith-it, ka tri burime prej të cilave mund të arrihet mirëqenia e përgjithshme:

- puna në ndjekje të interesit dhe pasurisë vetjake
- ndarja e punës dhe specializimi
- tregtia e lirë dhe konkurrenca

Ai përshkroi përmes një shembulli sesi ndjekja e interesit dhe pasurisë vetjake mund të jetë produktive dhe, në fund t'i shërbejë qëllimit të përbashkët.

“Ne nuk e presim darkën tonë nga kasapi, prodhuesi i birrës apo bukëpjekësi, se ata janë dashamirës, por ngaqë ata i shërbejnë interesit të tyre vetjak. Ne nuk i drejtohemi humanizmit të tyre, por dashurisë që ata kanë për veten dhe nuk u flasim kurrë për nevojat që kemi ne, por për avantazhet që kanë ata”.
(Smith 1974: 17).

Që në fjalinë e parë të ‘Pasurisë së Kombeve’, Smith e përshkroi ndarjen e punës si forcë themelore shtytëse e zhvillimit ekonomik:

“Përmirësimi më i madh i fuqive prodhuese të punës dhe pjesa më e madhe e aftësisë, zotësia dhe gjykimi me të cilat drejtohet apo zbatohet duket se janë rrjedhojë e ndarjes së punës”.(Smith 1974: 9).

Ai i shpjegoi avantazhet e ndarjes së punës duke përdorur shembullin e një fabrike gjilpërash. Një individ që bën gjilpëra mund të prodhojë vetëm një grusht të tilla në ditë. Megjithatë, nëse prodhimi ndahet në disa faza, secila prej të cilave kryhet nga një punonjës i specializuar që përqendrohet te një “veprim i caktuar”, në një ditë mund të prodhohen disa mijëra gjilpëra.

Së fundi, Smith ishte avokat i tregtisë dhe konkurrencës së lirë. Ashtu si në rastin e ndarjes së punës midis punonjësve të ndryshëm, palët që mund të tregtojnë lirisht me njëra-tjetrën mund të specializohen për atë që dinë të bëjnë më mirë. Në këtë mënyrë, prodhimi i përgjithshëm mund të rritet. Shpërndarja përmes “dorës së padukshme të tregut”, sipas Smith-it, është më efikase dhe krijon më shumë stimuj sesa çdo lloj forme tjetër e planifikimit qendror ekonomik. Për këtë, Smith-i mori shembullin e tregtisë midis Skocisë dhe Portugalisë.

Tri burimet e pasurisë

Ndjekja e interesave vetjake

Prodhimtaria përmes ndarjes së punës

Mirëqenia përmes tregtisë dhe konkurrencës së lirë

Përfitimi nga “avantazhi krahasues” përmes tregtisë

Edhe pse Skocia ishte veçanërisht e aftë në prodhimin e leshit, Portugalia ishte mirë me prodhimin e verës. Smith e quante këtë avantazh krahasues. Nëse të dyja vendet do të përqendroheshin te prodhimet e tyre specifike dhe do t’i tregtonin ato, në vend që të përpiqeshin të prodhonin edhe verë, edhe lesh me shpenzime të mëdha, të dyja do të kishin përfituar.

Ky vlerësim devijoi nga ideja e kohës se tregtia është një lojë me rezultat zero. Është ironike që, si punonjës dogane, Smith-i ishte përgjegjës për respektimin e rregullave të tregtisë merkantiliste për mbi një dekadë.

Çfarë është “Laissez-faire”?

Për t’i lënë burimet e mirëqenies, që janë kërkimi i fitimit, ndarja e punës, tregtia dhe konkurrenca, të bëjnë punën e tyre, shteti, sipas Smith-it, duhet të ndikojë vetëm tërthorazi mbi tregun, duke i lënë atij sa më shumë liri të jetë e mundur. Kjo çoi te doktrina e ashtuquajtur “laissez-faire”². Sipas saj, shteti duhet të shkojë deri te garantimi i sigurisë publike, mbrojtjes kombëtare, sigurisë ligjore, infrastrukturës dhe arsimit dhe, përtej këtyre, nuk duhet të ndërhyjë në treg. Kjo do të sjellë si rezultat produktivitetin më të madh të mundshëm.

Çlirimi i fuqive prodhuese

Smith-i hodhi themelet teorike të liberalizimit të ekonomisë, që, në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kryesisht me industrializimin, çliruan fuqi prodhuese të pashembullta deri më tani. Smith e mori si të mirëqenë që ekonomia e lirë e tregut do ta gjente automatikisht ekuilibrin dhe nuk parashikoi kriza apo rënie ekonomike.

Problemet me ndarjen e punës

Ashtu si Marx-i, i cili analizoi shfrytëzimin e punëtorëve dhe tjetërsimin e punës, edhe Smith-i ishte i vetëdijshëm për anën e errët të kapitalizmit. Ai trembej se sofistikimi i vazhdueshëm i ndarjes së punës do të çonte në “gjymtimin mendor” të punëtorëve dhe, për ta kompensuar këtë, bëri thirrje për mundësi më të mëdha arsimimi.

Smith: Teoria e ndjenjave morale

Në veprën e tij më pak të njohur, ‘Teoria e ndjenjave morale’ (1759), Smith përshkruan nevojën e njerëzve për t’u sjellë në mënyrë të denjë dhe të ndershme e për t’u ngritur mbi egoizmin e tyre si qenie me nevoja kolektive. Në këtë mënyrë, ai përgënjeshtroi ata që duan ta futin në kurth si mbrojtësin kryesor të pikëpamjes se njerëzimi është thjesht një *homo oeconomicus* (njeriu ekonomik – shën. i përkthyesit), që vetëm shfrytëzon në maksimum dobinë.

Smith-i e konsideronte veten, mbi të gjitha, si filozof moral sesa si ekonomist, duke theksuar rëndësinë e drejtësisë, besimit dhe ndershmërisë në marrëdhëniet e biznesit.

2 Laissez faire (frëngjisht) do të thotë “t’i lësh [njerëzit] të lirë të bëjnë ç’të duan”.

Interesat individuale → E mira e përbashkët

Shteti si kuadër rregullator




Figura 1: Smith: Nxitja e së mirës së përbashkët përmes interesit vetjak

Teoria klasike e liberalizmit ekonomik, që u mbështetet te Smith, mbizotëroi deri në krizën globale të vitit 1929. Vetëm pas goditjes së kësaj të fundit nisën të përhapeshin mëdyshjet nëse tregjet që drejtoheshin nga 'dora e padukshme' arrinin gjithnjë ekuilibrin. Kriza e rëndë dhe papunësia e lartë me ritme të qëndrueshme që erdhi si pasojë nuk mund të shpjegoheshin me qasjen 'laissez faire'. Liberalizmi klasik ekonomik u tund kësisoj nga themelet. Duke kthyer kokën pas, fituesi i çmimit "Nobel", Joseph Stiglitz, është shprehur se "arsyeja se pse shpesh 'dora e padukshme' ngjan e padukshme është se ajo nuk ekziston" (Stiglitz 2002).

Dekadat që vijuan përfshinë epokën e keynes-ianizmit, që përshkruhet në rubrikën tjetër. Vetëm pas shumë vitesh në hije, rreth viteve '80, liberalizmi ekonomik përjetoi një rilindje, falë neoliberalëve.

Shkolla e Çikagos

Ekonomistët më të famshëm që ringjallën, zhvilluan e përhapën idetë e Smith-it ishin August von Hayek dhe Milton Friedman. Këta të fundit formuluan një ideologji ekonomike liberale që u njoh edhe si “Shkolla e Çikagos” (Friedman ishte profesor në Çikago). Megjithatë, neoliberalët i kufizuan idetë e Smith-it te kritika kundrejt shtetit dhe përkrahja nga ai e tregut të lirë. Hayek dhe Friedman e shpërfillën “teorinë e tij të ndjenjave morale”.

Riinterpretimi në kohën e Thatcher-it dhe Regan-it

Riinterpretimi i veprës së Smith-it pati ndikim të jashtëzakonshëm, sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nën drejtimin e Presidentit Ronald Reagan dhe në Mbretërinë e Bashkuar gjatë mandatit të kryeministres Margaret Thatcher. Parimet udhëheqëse të politikave të ndjekura nga të dyja këto figura ishin se shteti nuk është pjesë e zgjidhjes së problemit; ai është vetë problemi. Kjo nënkuptonte liberalizimin, privatizimin dhe shkurtimin e përfitimeve të shtetit..

Konsensusi i Uashingtonit

Ithtarët e tregut ushtruan ndikim të madh edhe mbi politikën e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në kuadrin e të ashtuquajturit Konsensusi i Uashingtonit, këto institucione përhapën ideologjinë ekonomike liberale, për shembull, në Amerikën Latine, në vendet e dala nga komunizmi dhe, pas krizës aziatike të vitit 1997, në Azinë Juglindore. Liberalizimi i tregjeve financiare u ndikua po ashtu në mënyrë vendimtare nga kjo ideologji. Ndër pasojat që u shkaktuan ishin krizat më e rënda të arkitekturës financiare globale në dekada dhe një rënie ekonomike globale, që prej vitit 2008. Rrezja dhe magnituda e krizës kanë sjellë një ndryshim të mendimit ekonomik e politik. Në vend të liberalizmit ekonomik që ka besim të verbër te tregu, tashmë po fitojnë terren ata që kërkojnë një ekuilibër të ri midis shtetit dhe tregut dhe që theksojnë epërsinë e politikës mbi ekonominë.

Lexime të

mëtejshme:

Helen Winter dhe Thomas Rommel (1999), Adam Smith für Anfänger. Der "ohlstand der Nationen: eine Leseintroduction, Munich.

2.2. Kritika e kapitalizmit nga Karl Marx

*Marxi: Lidhja me
Smith-in*

Karl Heinrich Marx (1818–1883) ishte një filozof e gazetar politik gjerman.

Atë çfarë ekonomistët liberalë e panë si stabilitet dhe rritje që buron prej zhvillimit të tregut të lirë, Marx e përshkroi si luftë klasash, shfrytëzim, varfërim dhe sistem të prirur për të krijuar kriza, që mund të çonte në një revolucion proletar.

Vepra më e rëndësishme ekonomike e botuar (pjesërisht pas vdekjes) ishte, “Das Kapital” (Kapitali), tri vëllimet e së cilës panë dritën midis viteve 1867 dhe 1894. “Manifesti komunist”, botuar në vitin 1848, pati një ndikim të jashtëzakonshëm politik.

Kritika ndaj kapitalizmit e filozofit gjerman, Karl Marx, shihet shpesh si kundërvënia teorike ndaj ideve të Smith-it. Kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë: Marx-i e studioi nga afër veprën e Smith-it dhe doli në përfundime të ngjashme. Të paktën, forcat prodhuese dhe novatore të kapitalizmit theksohen edhe më fort nga Marx-i sesa nga Smith-i. Megjithatë, Marx-i nxori përfundime krejt të ndryshme. Ndryshe nga Smith-i, ai e pa kapitalizmin si qenësisht të paqëndrueshëm dhe

shkatërrues, që nuk sillte “pasurinë e kombeve” por varfërimin e shumicës dërrmuese të punëtorëve.

Që të arrijmë të kuptojmë idetë e Marx-it, duhet ta vëmë veten në rrethanat e pasigurta në të cilat gjendeshin punëtorët gjatë periudhës së parë të industrializimit në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Një nga dokumentet e Muzeut të Kulturës Industriale në Duisburg e përcjell këtë me ngjyra mjaft të gjalla: (Baier u. a. 2002: 18):

*Konteksti
historik: Industri-
alizimi i hershëm
dhe messhekulli i
nëntëmbëdhjetë*

“Ndërsa të pasurit ndërtuan një zonë ekskluzive banimi në të dalë të qytetit, për punëtorët u ndërtuan vargje të zymta apartamentesh të shëmtuara, që ishin të mbipopulluara, johigjenike dhe të kushtueshme ... Shpesh, për shembull, e gjithë familja dhe qiraxhiu flinin në një dhomë, ku shtratin e ndanin disa njerëz me radhë: oraret e gjumit përkonin me turnet e punës. Kushtet e punës në fabrika ishin përqendruar krejt te makineritë me të cilat, punëtorët që u shërbenin, duhej të përshateshin. Si rregull, java e punës ishte shtatëdhjetë orë, madje, edhe 80 orë në rastin e industrisë tekstile. Puna e fëmijëve ishte e përhapur gjerësisht, sigurimet shoqërore pothuaj nuk njiheshin dhe kujdesi shëndetësor ishte i pakët”.

Përshkrimi paraqet pak a shumë kushtet e punës dhe të jetesës në shumë prej vendeve më të varfra sot.

Marx nuk i konsideronte këto kushte çnjerëzore pune e jetese si një rastësi fatkeqe, por si pasojë e pashmangshme e kapitalizmit. Sipas analizës së tij, nuk ka rrugë tjetër për tregun e lirë përveçse të çojë në varfëri e shfrytëzim, duke qenë se fitimet e kapitalistëve vijnë nga shfrytëzimi i punëtorëve.

Thelbësore është edhe teoria e Marx-it për "mbivlerën", që ai e paraqiti në vëllimin e parë të Kapitalit në vitin 1867 dhe u shtjellua në vëllimet e botuara pas vdekjes. Mbivlera është vlera që merr sipërmarrësi në këmbim të kapitalit të investuar, e cila është shumë herë më e lartë se ky i fundit.

Për shembull, nëse ai investon 100 euro në prodhim (që do të ishte një shpërbllim në raport të drejtë me mallrat dhe të gjitha mjetet e prodhimit), por fiton 110 euro në treg. Sipas Marx-it, mbivlera mund të përftohet sistematikisht vetëm nga puna që krijon vlerë. Me fjalë të tjera, nëse punonjësi krijon më shumë vlerë sesa ajo që merr në formën e pagës.

Marx-i përshkroi se si punonjësit merrnin vetëm pagat e nevojshme për të siguruar jetesën. Në të kundërt, kapitalistët pasuroheshin nga diferenca midis kësaj page dhe mbivlerës që krijojnë punonjësit.

Ai supozoi se kapitalisti, i nxitur nga konkurrenca përherë në rritje, rreket ta shtojë këtë mbivlerë. Pagat ulen më tej, zgjatet orari i punës dhe shtohet përdorimi i makinerive. Kjo sjell për pasojë rritjen e papunësisë. Në të njëjtën kohë, konkurrentët nxirren jashtë tregut gradualisht. Së fundi, shoqëria është gjithnjë e më e ndarë midis atyre pa pasuri dhe një grupi të vogël në duart e të cilit është përqendruar kapitali.

Mbivlera, sipas teorisë së Marx-it për vlerën e punës, përftohet nga fitimi që merr sipërmarrësi nga produkti i punonjësve, pas zbritjes së kostove të pagës, vlerës së punës dhe shpenzimeve për mjetet e prodhimit. Për rrjedhojë, mbivlera është sinonim me shfrytëzimin e punonjësve. Marx-i bën dallimin midis mbivlerës absolute, që vjen thjesht si rrjedhim i punës pas orarit (orë më të gjata pune) dhe mbivlerës relative që përftohet përmes rritjes së prodhimit (Wirtschaftslexikon 2009).

3 Dëshirojmë të falënderojmë botuesin J.H.W. Dietz Nachf., Bon, për mundësinë që na dha për të përdorur përkufizimet nga Fjalori i tij Ekonomik në këtë vëllim.

Lexime të mëtejshme:

Volker Happe, Gustav Horn dhe Kim Otto (2009), *Das Wirtschafts-lexikon. Begriffe. Zahlen. Zusammen- hänge. Bonn.*³

Në të ashtuquajturat 'Dorëshkrime ekonomike dhe filozofike', të shkruara në vitin 1884, përveç konceptit të "mbivlerës", Marx identifikoi edhe konceptin e "tjetërsimit të punës". Këtu, Marx-i (ashtu siç kishte bërë edhe Adam Smith) kuptoi anën e errët të ndarjes së punës në prodhim. Në rastin e prodhimit masiv, punëtori është i përfshirë vetëm në faza tejet të kufizuara dhe monotone të prodhimit. Atij i privohet kontakti me produktin përfundimtar dhe kënaqësia që shoqëron prodhimin e tij.




Figura 2: Struktura bazë e argumentit të Marx-it

Për Adam Smith-in, konkurrenca dhe ndarja e punës ishin burimet e përparimit. Në kundërshtim me të, Marx e shihte konkurrencën dhe ndarjen e punës si e keqja themelore e kapitalizmit dhe shkak për shfrytëzimin e tjetërsimin. Siç e perceptonte ai, zhvillimet në prodhim në kohën e tij u sillnin fitime vetëm pronarëve kapitalistë, ndërkohë që varfëronin punëtorët.

Një rend ekonomik që orientohet nga fitimi, sipas Marx-it, është i paqëndrueshëm e i prirur për kriza. Sipas tij, në fund, ai mund të shkaktojte revolucionin e të shfrytëzuarve.⁴

"Centralizimi i mjeteve të prodhimit dhe socializimi i punës mbërrijnë në fund në një pikë ku bëhen të papajtueshme me membranën kapitaliste. Kjo membranë është çarë tanimë. Po bie kambana e vdekjes së pronës private kapitaliste." (Marx 1991: 684 f.)

Një koncept përfundimtar kyç në arsenalin teorik të Marx-it, që ai e trajton kryesisht në Manifestin komunist të vitit 1848, është "prona" ose "pronësia", veçanërisht në kuptimin e pronësisë private të mjeteve të prodhimit.

Për Marx-in, pronësia private mbi mjetet e prodhimit është tipar veçues i shoqërisë klasore kapitaliste. Pas revolucionit proletar të parashikuar nga Marx-i në shkrimet e hershme, prona private, sipas mendimit të tij, do të hiqej. Për shkak të pagave të ulëta, që nuk mjaftojnë për të jetuar, klasa punëtore nuk ka asnjë mundësi për të blerë pasuri të konsiderueshme. Në të kundërt, kapitalistët i përvetësuan pasuritë e tyre nëpërmjet shfrytëzimit.

Për rrjedhojë, në 'Manifestin komunist' Marx kërkoi mes të tjerash:

- centralizimin e huasë në duart e shtetit përmes bankës kombëtare me kapital shtetëror dhe monopol të vetëm
- centralizimin e transportit në duart e shtetit
- shtimin e ndërmarrjeve shtetërore, mjeteve të prodhimit, kultivimit dhe

⁴ Në literaturën për Marx-in, ofrohen përgjigje të ndryshme për pyetjen nëse ai e konsideronte revolucionin si nevojë apo vetëm si një zhvillim të mundshëm historik. Vendimtare në këtë drejtim është pyetja, nëse duhen bërë dallime midis fazave të ndryshme të veprës së Marx-it a nëse ajo duhet marrë në tërësi. Për lexime të mëtejshme, shih: Heinrich (2004: 169–78).

përmirësimin e të gjitha pronave, në përputhje me një plan të përbashkët (shih Marx/Engels 1987: 54).

Interpretuesi më i rëndësishëm i Marx-it, Friedrich Engels, pa që një shtetëzim i tillë kishte probleme: “sa më shumë që [shteti] të vazhdojë të marrë forcat prodhuese, aq më shumë shndërrohet ai në një kapitalist kombëtar, aq më shumë qytetarë shfrytëzon ai [...] marrëdhënia kapitaliste nuk zhduket. Më shumë, vjen në pikën ku duhet marrë një vendim”(Engels 1988: 553f).

Citimi në vijim i atribuohet ekonomistit John Kenneth Galbraith :“Në kapitalizëm, njeriu shfrytëzon njeriun. Në komunizëm, është thjesht e kundërta.” Vende si Bashkimi Sovjetik dhe ish-Gjermania Lindore (DDR), që përmbushën kërkesat e ‘Manifestit komunist’ për centralizimin dhe shtetëzimin e bankave, të sistemit të transportit dhe mjeteve të prodhimit, dështuan.

Marx-i e interpretonte historinë si rrjedhojë e luftës së klasave, që e arrinte kulmin e saj në përballjen e borgjezisë me proletariatin dhe mund të përfundonte me një revolucion proletar. Ai krijoi utopinë e një shoqërie pa klasa, pa konkurrencë e pa pronësi private të mjeteve të prodhimit.

Sidoqoftë, historia ka treguar se varfërimi i punëtorëve që përshkruan Marx dhe rritja e përqendrimit të pasurisë te pronarët kapitalistë nuk është e pashmangshme. Fitimet gjatë periudhës së mirëqenies u bë e mundur të shpërndaheshin në mënyrë më të drejtë, edhe falë organizimit e solidaritetit të punonjësve në sindikata dhe krijimit e konsolidimit të shtetit të mirëqenies.

Termet **“Borgjezi”** dhe **“Proletariat”** Marx-i i përdorte për t’iu referuar klasave kundërshtare. Fjala “proletar” rrjedh nga latinishtja “proletarius” (“që i përket shtresës së ulët shoqërore”). Fjala “borgjezi” vjen nga frëngjishtja dhe i referohet “gjithë shtresës që zotëron prona” (sipërmarrësit, kapitalistët, menaxherët, qiradhënësit).

Përqendrimi i kapitalit ra poshtë nga “shkatërrimi krijues”, i përshkruar nga ekonomisti austriak, Joseph Schumpeter. Ai tregon sesi shoqëritë tregtare riorganizohen në mënyrë të vazhdueshme, si rezultat i novacioneve, konkurrencës, krizave dhe tregjeve të reja.

Problemet e shtetëzimit

Historia si rezultat i luftërave klasore

Varfërimi nuk është i pashmangshëm

Schumpeter: “shkatërrimi krijues”

"Hapja e tregjeve të reja, qofshin të huaja apo vendase, si dhe zhvillimi organizativ nga dyqanet artizanale dhe fabrikat në shoqëri tregtare të tilla si "U.S. Steel" ilustrojnë të njëjtin proces ... që revolucionarizon pareshtur strukturën ekonomike së brendshmi, që shkatërron pareshtur të vjetrën, që krijon pareshtur një të re. Ky proces shkatërrimi krijues është thelbi i kapitalizmit".
(Schumpeter1942: f.137).

Industria automobilistike zëvendësoi karrocierët, farkëtarët dhe stallierët. Prodhuetit të makinave të shkrimit iu desh t'i hapte rrugë prodhuesit të kompjuterit. Këta janë shembuj të shkatërrimit krijues, që, nga njëra anë, nxit novacionin, por, nga ana tjetër, krijon pasiguri të reja dhe kërkon nga njerëzit një elasticitet të jashtëzakonshëm.

Eksperimenti me socializmin shtetëror, që bazohej te Marx-i, ka dështuar dhe teoricienët e tij janë diskredituar. Po a është hedhur poshtë teoria, si rrjedhim i kësaj? Fakti është se, deri tani, nuk është gjetur asnjë alternativë funksionale për një rend ekonomik që mbështetet te efikasiteti i tregut dhe prona private, dhe që ka rezistuar në praktikë.

Marx-i ishte më shumë analist sesa udhëheqës. Nga doktrinat e tij nuk mund të nxirren zgjidhje praktike dhe parashikimet e tij nuk janë vërtetuar. Megjithatë, analizat e tij ende tërheqin vëmendje. Më shumë se çdokush tjetër, Marx-i rrit vetëdijesimin për rreziqet dhe krizat e kapitalizmit të pakufizuar.

Po si duhet klasifikuar atëherë Marx-i? Ndoshta, në mënyrën që rekomandoi Willy Brandt kur shkoi për vizitë në shtëpinë e Karl Marx-it në Trier në vitin 1997: "Marx-it i jepet haku më mirë duke e rrëzuar nga piedestali i tij, qoftë kjo në kuptimin pozitiv apo negativ. Sido që ta paraqesin apo të duan njerëzit të jetë Marx-i, kërkimi i lirisë, çlirimi i njeriut nga robëria dhe varësia e skajshme ishte motivi kryesor i mendimit dhe veprimit të tij".

*Dështimi i socializmit
shtetëror*

*Vlerat e qëndru-
eshme të analizave
të Marx-it*

*Si duhet klasifikuar
Marx-i? Willy Brandt:
"në kërkim të lirisë"*

**Lexime të
mëtejshme:**

*Francis Wheen (2008),
Marx's "Das Kapital":
A Biography*

2.3. John Maynard Keynes: Menaxhimi i kapitalizmit

John Maynard Keynes {1883–1946} ishte një ekonomist britanik, i cili pati ndikim të rëndësishëm në teorinë ekonomike të shekullit të njëzetë.

Në veprën e tij me ndikim, “Teoria e përgjithshme e punësimit, interesit dhe parasë” (1936), ai vendosi në pikëpyetje aftësinë e tregjeve për t’u shëruar vetë dhe hodhi themelet e atij që, më tej, do të njihje si “kejsianizmi”, qëllimi i të cilit ishte të drejtonte kapitalizmin.

Po kështu, Keynes punoi për zhvillimin e sistemit të Bretton Woods-it, që përcaktoi rregullat për ekonominë dhe tregjet financiare globale në periudhën e pasluftës.

Si doktrina e Adam Smith-it për kapitalizmin e lirë me sa më pak ndërhyrje të mundshme, ashtu edhe refuzimi i konkurrencës dhe pronësisë private mbi mjetet e prodhimit nga Karl Marx, janë problematike. A ka një rrugë të mesme të kapitalizmit të koordinuar, që shfrytëzon forcat prodhuese të tregut, por kundërvepron dhe amortizon forcat e tij shkatërruese?

Ekonomisti britanik John Maynard Keynes analizoi natyrën janusiane⁵ e të kapitalizmit: po aq sa është pro-

duktiv, është edhe i paqëndrueshëm nga pikëpamja strukturore. Edhe pse i besonte rendit të tregut bazuar në pronë e konkurrencë, ai ishte kritik i shkollës neoklasike, që i referohej doktrinë së Smith-it.

Për shembull, ai kritikonte faktin se “supozimet e saj vërtetohen rrallë ose kurrë e, për këtë arsye, nuk mund të zgjidhin problemet ekonomike të botës së sotme” (Keynes 1966: 319).

Përballë krizës së thellë ekonomike botërore në vitin 1929, Keynes e vendosi në pikëpyetje “dorën e padukshme”. Tregu nuk e kishte gjetur sërish ekuilibrin, siç do priste gjithkush nisur nga supozimi i Smith-it, por papunësia kishte mbetur në një shkallë të lartë dhe stanjacioni ekonomik ishte ulur këmbëkryq.

Keynes identifikoi një spirale në rënie: nëse prodhohen më pak mallra dhe punonjësit janë konsumatorë të pushuar nga puna dhe prodhuesit kanë fituar pasiguri dhe shpenzojnë më pak para (“kursime paniku”). Kërkesa vazhdon të bjerë, kompanitë prodhojnë më pak dhe shkurtojnë më shumë vende pune, njerëzit kursejnë edhe më shume e kështu me radhë. Kësisoj kriza rëndohet keq e më keq dhe ekonomia rrezikon të bjerë në një depresion afatgjatë. Me ardhjen e krizës ekonomike

*Keynes –
Një rrugë e mesme?*

*Kritika e Keynes ndaj
Shkollës Neoklasike*

*Dyshime rreth
“dorës së
padukshme”*

*Rreziku i një spiraleje
ekonomike në rënie*

⁵ Perëndia romake, Janus kishte dy fytyra, një që sheh përpara dhe tjetra pas.

botërore, gjatë së cilës ndodhi pikërisht kështu, ajo gjeti terren pjellor. Keynes jo vetëm njohu situatat në të cilat tregu i lirë nuk funksionon, por, në formën e menaxhimit kundërciklik ekonomik, krijoi edhe ide sesi duhej kundërvepruar.

Në rastin e rënies ekonomike, shteti duhet të ndërhyjë në treg dhe të kompensojë kërkesën private, huamarrijen dhe të emetojë më shumë para. Ai mund t'u japë njerëzve para drejtpërdrejt, për shembull, duke ulur taksat. Megjithatë, kjo qasje mund të shkojë huq nëse njerëzit vazhdojnë të kursejnë si kundërreagim ndaj pasigurisë. Më efektive për shtetin është që të shpenzojë drejtpërdrejt, për shembull, duke ndërtuar rrugë ose shkolla. Si rezultat i kësaj do të punësoheshin më shumë njerëz, të cilët, për pasojë, do të konsumonin më shumë dhe do të vinin në lëvizje një spirale pozitive. Keynes e shprehu këtë si më poshtë:

»Nëse shpenzojmë më shumë sesa 150 milionë sterlina, gjithkush do të ketë të ardhura më të larta dhe ata që janë të papunë nuk do të kenë nevojë më për përfitimin e papunësisë. Përveç kësaj, ky shpenzim do të sjellë punësim për shumë njerëz të tjerë. Paratë në ekonomi do të qarkullojnë e do të shpenzohen për të gjitha llojet e mallrave dhe nuk do të përqendrohen vetëm në pak industri.« (Keynes 1939, cituar në Weinert 2008)

Ky ishte justifikimi i tij për braktisjen e bindjes se tregu gjithnjë e gjen ekuilibrin, siç kishte supozuar Smith-i. Komenti i tij, i përmendur më lart, se “në fund, të gjithë do të vdesim”, është i mirënjohur. Kjo u shndërrua në një thirrje për shtetin që të marrë përgjegjësi: është shumë më e rëndësishme të krijohen vende pune dhe rritje sot, sesa të besohet në mënyrë të vakët në një të ardhme më të mirë dhe treg që vetërregullohet.

Megjithatë, Keynes pranoi se ndërhyrja në treg ishte me rrezik: është e vështirë të dish kur duhet ndërhyrë e në çfarë mase. Ai shkroi:

“Fakti kryesor është pasiguria e skajshme e bazës së njohurive mbi të cilën duhen bërë vlerësimet e fitimeve të ardhshme. Njohja nga ana jonë e faktorëve që do të përcaktojnë fitimin nga një investim pas disa vjetësh, për pasojë, është zakonisht mjaft e pakët, në mos, shpesh e papërfillshme.” (Keynes 1966: 126)

Është e nevojshme ndërhyrja aktive nga shteti

Menaxhimi ekonomik nga shteti

“Në fund, të gjithë do të vdesim”




Figura 3: Struktura bazë e argumentit të Keynes-it

Analizat dhe rekomandimet e Keynes-it, sipas të cilave shteti duhet të ndërhyjë në treg, patën një ndikim kaq të madh formues, sa që kundërshtia e tij ndaj Smith-it dhe Marx-it përshkruhet shpesh si "revolucioni keynesian". Kjo është pasqyruar edhe në reagimet ndaj idesë së tij. (Ekonomistët) liberalë dhe konservatorë e kanë përshkruar Keynes-in si socialist të padeklaruar, ndërsa marksistët e kanë qortuar

I ashtuquajturi revolucion keynesian

për besimin e tepruar te tregu. E sigurt është që Keynes, në përpjekje për t'iu kundërvënë diktaturave që po lindnin, jo vetëm në Gjermani, u përpoq të ruante demokracinë.

“Sistemet e sotme autoritare shtetërore duket se e zgjidhin problemin e papunësisë në kurriz të efikasitetit dhe lirisë. Është e sigurt që bota nuk do ta tolerojë shumë gjatë papunësinë, që, me përjashtim të intervaleve të shkurtra të entuziazmit, shoqërohet në mënyrë të pashmangshme, sipas mendimit tim, me individualizmin kapitalist të ditëve të sotme. Sidoqoftë, me një analizë të duhur të problemit, sëmundja mund të kurohet duke ruajtur njëkohësisht efikasitetin dhe lirinë.” (Keynes 1966: 321)

Ligji themelor psikologjik

Më tej, me “Ligjin themelor psikologjik”, Keynes parashtrori arsyen se përse rishpërndarja mund të jetë jo vetëm e dëshirueshme nga pikëpamja shoqërore, por edhe ekonomikisht racionale. Një ekonomie dinamike i duhet kërkesë e mjaftueshme. Ata që fitojnë më shumë priren të kursejnë një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre. Për të nxitur kërkesën, për rrjedhojë, është e logjikshme që atyre të cilëve fitojnë më pak, kursimet e të cilëve janë në masë më të vogël, t’u jepen më shumë të ardhura.

Ndikimi i Keynes-it në shekullin e njëzetë

Së fundi, Keynes luajti rol vendimtar në ndërtimin e të ashtuquajturit sistemi Bretton Woods.

Ndikimi i Keynes është i pakrahasueshëm me asnjë ekonomist tjetër të shekullit të njëzetë. Rekomandimet e Keynes-it u vunë në zbatim fillimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga viti 1933, si pjesë e Kursit të ri të Presidentit Roosevelt (Ruzvelt – shën. i përkthyesit). Së pari, investimet publike, për shembull, në infrastrukturë, u rritën në mënyrë të konsiderueshme. Së dyti, konsumi u nxit duke nxitur rritjen e përfitimeve të sigurimeve shoqërore, duke qenë se personat me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura kanë një nivel të ulët kur-

Sistemi Bretton Woods: Në vitin 1944, në një konferencë në Bretton Woods, ShBA, u ra dakord për arkitekturën financiare ndërkombëtare të pasluftës. Në thelb të saj ishte një sistem monedhe ndërkombëtare, sipas të cilit, luhatjet në kursin e këmbimit frenoheshin përmes lidhjes me dollarin amerikan. Prej asaj kohe, u ngritën Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore si institucione për huadhënien ndërkombëtare dhe rregullatorë të tregjeve financiare. Sistemi Bretton Woods qëndroi në fuqi deri në vitin 1973. Pas trazirave në tregun e këmbimit, u desh të hiqej dorë nga norma fikse e kursit të këmbimit në dollar.

simesh. Doktrinat e Keynes-it mbetën kredoja ekonomike deri në vitet '70. Në Gjermani, ato përfaqësoheshin sidomos nga ekonomisti Karl Schiller, i cili ishte Ministri për Çështjet Ekonomike dhe Ministër Financash i SPD-së (Partia Social-demokrate) në periudhën 1966-1972. Gjatë kësaj kohe, madje, edhe presidenti konservator amerikan, Richard Nixon deklaroi: "Tani, jemi të gjithë kejnianë".

Megjithatë, kejnianizmi përjetoi krizë në mes të viteve '70. Nga njëra anë, politika kundërciklike buxhetore nuk funksionoi në mënyrën e parashikuar nga Keynes. Edhe pse shpenzimet gjatë periudhave të krizës u rritën, borxhi i qeverisë nuk u shlye kur ekonomia mori kthesën e përmirësimit. Si rezultat, pati një grumbullim të borxhit publik dhe u zvogëluar gjithnjë e më shumë hapësira e shpenzimeve për deficitin, ndërkohë që krizat ndoqën njëra-tjetrën. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, ndodhën edhe dy kriza naftë. Ngritjet marramendëse të çmimit të naftës shkaktuan

një rreth vicioz: pagat u rritën, por të ardhurat shtesë u përpinë nga çmimet më të larta të energjisë, në kundërpërgjigje të së cilës pagat u

Stagflacioni: Kur bëhen bashkë stanjacioni ekonomik dhe inflacioni (Wirtschaftslexikon 2009).

ngritën sërish, duke sjellë rritje të inflacionit, që, nga ana tjetër, shtoi trysinë mbi pagat. Paketat nxitëse ekonomike nuk qenë efektive. Pati stanjacion ekonomik kombinuar me inflacion të lartë ("stagflacion"). Ekonomistët neoliberalë dhe klasikët e rinj u ngritën duke e vënë theksin te një politikë miqësore për ndërmarrjet nga pikëpamja e ofertës: përpjekjet për nxitjen e avantazheve të vendndodhjes përmes uljes së kostos, konsolidimi i buxhetit dhe masat shtrënguese ishin në rend të ditës.

Pas viteve të liberalizmit ekonomik, thirrjet për ndërhyrje nga shteti në një treg kryesisht të liberalizuar – mes të tjerave, si rezultat i krizës së tregut financiar, që nisi në vitin 2007 – po bëhen gjithnjë e më të forta. Po kështu, është i dukshëm një kthim te Keynes. Në të vërtetë, kjo nuk përbën çudi, duke qenë se ajo çka Keynes shkroi rreth tregjeve ndërkombëtare financiare është më me vend se asnjëherë:

"Spekulatorët mund të mos bëjnë dëm, ashtu si flluskat në një ndërmarrjeje me rrjedhë të qëndrueshme. Por, situata bëhet serioze kur ndërmarrja shndërrohet në flluskën e një vorbulle spekulimi. Kur zhvillimi i kapitalit të një vendi bëhet nënprodukt i veprimtarive të një kazinoje, ka gjasë që puna të jetë bërë keq."
(Keynes 1966: 134)

Lexim i mëtejshëm:

Reinhard Blomert (2007), John Maynard Keynes, Reinbek.

Heinz-J. Bontrup (2006), Keynes wollte den Kapitalismus retten. Zum 60. Todestag von Sir John Maynard Keynes, Bonn.

2.4. Modelet ideale të teorisë ekonomike

Në debatin politik të ditës, idetë e Smith-it, Marx-it dhe Keynes-it janë të kudogjendura. Nëse një politikan liberal (në kuptimin e “liberalizmit ekonomik”) kërkon ta zhveshë shtetin nga funksionet e veta themelore dhe deklaron se shteti nuk është pjesë e zgjidhjes, por vetë problemi, kjo është në përputhje me mendimin e Adam Smith-it. Në periudhat e kapitalizmit të shfrenuar globalist, gjatë të cilave tregjet tronditen me themel, zgjidhjet e Keynes-it sa i takon menaxhimit të ekonomisë së tregut marrin sërish vlerë dhe përballë pamjes së fabrikave në vendet në zhvillim, ku punonjësit qepin rroba për 14 orë në ditë në këmbim të pagave shfrytëzuese, ai që vjen lehtë ndërmend është Marx-i.

Kjo nuk është e habitshme, pasi, sipas modelit ideal⁶, Smith-i, Marx-i dhe Keynes-i përfaqësojnë tri botëkuptime shumë të ndryshme ekonomike dhe që shpërfaqen kur dalin në pah çështjet e shpërndarjes, marrëdhënieve midis tregut dhe shtetit dhe probleme të tjera të politikave ekonomike. Tri modelet ideale mund të përshkruhen si vijon:

1. Kapitalizmi i pastër

1. Shteti duhet të qëndrojë jashtë proceseve ekonomike. Puna në kërkim të pasurisë është forca shtytëse e aktivitetit ekonomik dhe, për rrjedhojë, nuk duhet penguar (pikëpamja libertariane, sipas Smith-it).

2. Antikapitalizmi

2. Sistemi ekonomik kapitalist, i cili bazohet te pronësia private mbi mjetet e prodhimit dhe konkurrenca, çon në shfrytëzimin dhe varfërimin e masave. Për këtë arsye, ajo duhet shfuqizuar (pikëpamja komuniste sipas Marx-it).

3. Kapitalizmi i menaxhuar

3. Rendi ekonomik mbështetet mbi pronën dhe ekonominë e tregut, por shteti, përmes rregullimit, rishpërndarjes dhe menaxhimit makroekonomik – me fjalë të tjera, me anë të menaxhimit të qëllimshëm të kërkesës – ndërhyt në ekonomi. Prona garantohet, por është e ngulitur në shoqëri dhe ka detyrime kundrejt saj (demokracia sociale, sipas Keynes-it).

Nga teoria ekonomike, del qartë se tregu i shfrenuar shkatërrohet në të njëjtën mënyrë si përpjekjet për të ecur pa një sistem tregu. Historia na tregon se si radikalizmi i tregut, ashtu edhe zhdukja tërësore e tij kanë dështuar. Për të arritur

⁶ “Modeli ideal” përmendet në kuptimin e sociologut Max Weber, konkretisht, ekzagjerimi i qëllimshëm i realitetit për të renditur ose ngërthyer teorikisht segmentet e realitetit shoqëror. Megjithatë, “sipas modelit ideal” do të thotë edhe që në këtë vëllim hyrës, është i mundur vetëm një vështrim i shpejtë mbi idetë përkatëse

objektivat e demokracisë sociale, kapitalizmi duhet orientuar dhe menaxhuar. Programi i Godesburgut i SPD-së, në vitin 1959, që erdhi falë përpjekjeve të ekonomistit Karl Schiller, i cili asokohe ushtronte një ndikim të konsiderueshëm mbi SPD-në, e shprehu këtë në mënyrë të përmbledhur: “Sa më shumë treg të jetë e mundur dhe sa më shumë planifikim që të jetë e nevojshme” .

Siç e përmendëm më lart, teoritë e parashtruara këtu duhen vlerësuar në kontekstin e tyre historik. Është e qartë që kapitalizmi nuk është shembur si rezultat i kontradiktave të brendshme, siç e parashikoi Marx-i. Megjithatë, ai nuk bie vetë në ekuilibër harmonik, siç priste Smith-i. Shekulli i njëzetë u karakterizua nga një mirëqenie e pashembullt e segmenteve të mëdha të popullsisë, por edhe nga trazira sociale e kriza të panumërta. Si mund të vlerësohen këto zhvillime nga pikëpamja socialdemokrate? Matthias Platzeck, Peer Steinbrück dhe Frank-Walter Steinmeier rreken të japin një përgjigje të mundshme në librin e tyre në vitin 2007, “Auf der Höhe der Zeit” (Në hapin e kohës):

“Përkundrejt mendimit të ngushtë ekonomik të marksistëve besnikë, nga njëra anë, dhe liberalëve nga ana tjetër, socialdemokratët ‘revizionistë’ rreth Eduard Bernstein supozuan si të mirëqenë epërsinë e politikës dhe parimeve të reformës dhe përparimit, kompromisit dhe pajtimit e interesave përgjatë vijave klasore. Kur të tjerët besonin në zhvillimin spontan të forcave ekonomike dhe historike, forcat socialdemokrate e vunë theksin te menaxhimi aktiv dhe pragmatik i transformimit. Ato donin të kombinonin në mënyrë proaktive dinamizmin e tregut me reformat sociale dhe përtëritjen e shoqërisë, me qëllim që të gjitha segmentet e popullsisë të kishin mundësi të përfitonin sistematikisht nga rritja dhe mirëqenia. Çështja ishte jo vetëm të pajtohej ekonomia e tregut, demokracia dhe kohezioni social me njëri-tjetrin, por, me anë të mjeteve politike, të sigurohet edhe ndërveprimi pozitiv midis tyre: ky ishte plani i ri e i pashembullt historik për të ecur përpara, që u parashtrua nga socialdemokratët në fillim të shekullit të njëzetë. Për herë të parë, ata ia dolën mbanë të pajtonin në praktikë dhe me një sukses të padëgjuar ato çka më parë shiheshin gjithnjë si të papajtueshme dhe në armiqësi të ndërsjellë: një ekonomi dinamike tregu, një demokraci të gjallë dhe kohezion social. Koncepti i “shekullit të njëzetë socialdemokrat” i sociologut Ralf Dahrendorf është përmbushur plotësisht. ... është me rëndësi të kujtojmë edhe njëherë qartë sesa e vështirë ishte fitorja e socialdemokracisë ndaj kundërshtarëve të saj dhe sa të brishta janë frytet e këtij suksesi në shekullin e njëzetë. ... Kësisoj, një parti socialdemokrate

“Sa më shumë treg të jetë e mundur dhe sa më shumë planifikim, që të jetë e nevojshme”

Çfarë përgjigjesh mund t’u ofrojë politikanët socialdemokratë këtyre pyetjeve?

e vetëdijshme duhet të reflektojë menjëherë rreth faktit sesa të rëndësishme dhe evoluese vazhdojnë të jenë këto ide për botën e shekullit të njëzetentjetë, që u ngjizën fillimisht nga përballjet e saj me klasicizmin marksist dhe rrugën liberale "laisser-faire", pasi në epokën e globalizimit, asgjë nuk ka ndryshuar në drejtim tensionit të brendshëm të ndërsjellë në thelb midis tregjeve, demokracisë dhe shoqërisë." (Platzeck, Steinbrück and Steinmeier 2007: 19–21)

2.5. Ekonomia sot

*Ku qëndron
ekonomia sot?*

Pasi prezantuar ekonomistët më të rëndësishëm në histori, lind pyetja se ku është ekonomia sot. Sa e vështirë është t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje e ilustron ngjarja në vijim.

*Një pyetje e vështirë:
Një shembull*

Me rastin e hyrjes së Mbretërisë së Bashkuar në Komunitetin Evropian në vitin 1973, gazeta The Times botoi një letër të firmosur nga 154 ekonomistë, të cilët deklarorin se anëtarësimi i Britanisë në KE do të sillte me gjasë më shumë dizavantazhe sesa përfitime. Të nesërmen, u botua një deklaratë e 142 ekonomistëve (të tjerë), e cila thoshte se hyrja e Britanisë kishte të ngjarë të sillte më shumë përfitime ekonomike sesa dizavantazhe. Kjo u pasua nga letra e një lexuesi, i cili ngriti hipotezën se ekonomistët do t'i shkaktonin Mbretërisë së Bashkuar më shumë dizavantazhe sesa avantazhe ekonomike (cituar në Wagner dhe Wiegard 2002: 773).

*Asnjë pikëpamje
mbizotëruese:
dy arsye*

Kjo anekdotë tregon se nuk ka një pikëpamje mbizotëruese në ekonomi. Për këtë ka dy arsye:

*Së pari: nuk ka
shkencë të
gdhendur në "gur"*

Së pari, ekonomia, si të gjitha shkencat, nuk është, siç thotë filozofi Karl Popper, diçka e gdhendur në gur por në rërë. Me fjalë të tjera, të dhënat, faktet dhe vërtetimet nga të cilat ekonomistët nxjerrin përfundimet e tyre kushtëzohen nga pasaktësitë ose thjesht mund të jenë të gabuara.

*Së dyti, shprehjet
ekonomike janë të
mbushura me vlera*

Së dyti, ekonomia në veçanti është e mbarsur me vlera. Ndryshe nga shkencat natyrore, hipotezat dhe teoritë e saj përcaktohen nga pikëpamjet humaniste dhe shoqërore. Një ekonomist i cili beson se njeriu është një *homo oeconomicus* që

rrit dobinë në maksimum do të dalë me përfundime të ndryshme nga një ekonomist që e sheh njeriun si qenie shoqërore komplekse.

Një kujtesë kthjelltësuese që ekonomia, e cila presupozohet se ndërtohet mbi fakte të forta, përfshin po ashtu një masë të madhe ideologjie dhe që, për rrjedhojë, rekomandimet e ekonomistëve duhen parë përherë me një sy kritik, u botua nga gazetari i ekonomisë Andreas Hoffmann:

“Unë nuk mund të hipi në avion, pa më shkuar mendja te subvencionet. Ekonomistët i urrejnë subvencionet. Subvencionet janë pjesa e errët, ato e paralizojnë ekonominë. Megjithatë, pa subvencione, nuk do të kishte asnjë avion “Airbus” në qiell. Ne fluturojmë me Airbus vetëm sepse disa krerë qeverish donin të ndërtonin avionë. Në të kundërt, Boeing-u do të sundonte qiejt ashtu si Bill Gate sundon botën e kompjuterëve. ... Ose le të marrim fuqinë e sindikatave. Thuhet se sindikatat i pengojnë ndërmarrjet në përpjekjen për të krijuar fitime. Atëherë, pse prodhuesit gjermanë të makinave dhe ndërtuesit e makinerive, firmat metalpunuese dhe elektrike kanë qenë kaq të suksesshme në botë? Në fakt, ato duhej të kishin dështuar, pasi sindikatat e tyre janë më të fortat. ... Nuk ka shumë vlerë ti referohemi botës reale nëpërmjet ekspertëve të mirëfilltë ekonomikë. Ka të ngjarë që kjo të shkaktojë reagime kundërshtuese, të pasuara nga deklarata se nuk është realiteti problemi, por qasja e politikës ekonomike. ... Po pse ndodh që harta të gabojë kaq shumë dhe kaq shpesh? Lufta e Parë Botërore nuk duhet të kishte shpërthyer kurrë, pasi ekonomistët e konsideruan jofitimprurëse. Tetë ditë përpara së enjtes së zezë, në tetor të vitit 1929, ekonomisti i famshëm Irving Fisher deklaroi se rëzimi i bursës nuk do të ndodhte kurrë. Asnjëra prej pesë krizave ekonomike që kanë ndodhur në Gjermani nuk është parashikuar shkencërisht; as shpërthimi i internetit në vitet 90. Në vjeshtën e vitit 2002, Instituti parashikoi se rritja për vitin 2003 do të ishte 1,3 për qind: ndërkohë, ekonomia u turr me 0,2 për qind. Aktualisht, askush nuk po e lodh trurin të mendojë pse po krijohen vende pune në Gjermani dhe pse po rritet

ekonomia sërish. Nafta është shumë e shtrenjtë dhe Angela Merkel po i keqmenaxhon reformat.”
(Süddeutsche Zeitung, 16 shtator 2006)

Ekonomia nuk është shkencë ekzakte

Natyrisht, ekonomia nuk është shkencë ekzakte, që të mund të bëjë parashikime precize, por, mbështetur mbi supozime, ajo parashtron teza që janë pak a shumë të pranueshme mbi baza empirike.

Përfundimi: të bësh të qartë qëndrimin tënd specifik

Çfarë konkluzionesh mund të nxirren nga ky përfundim. Padyshim, jo që ekonomia duhet të konsiderohet si joshkencore apo pohimet e saj mund të interpretohen në mënyrë tërësisht arbitrare. Megjithatë, është e rëndësishme që ekonomistët të jenë të hapur për supozimet dhe pikëpamjet të tyre, duke u i lejuar lexuesit e tyre t’i kategorizojnë dhe interpretojnë kundrejt këtij sfondi.

Dy kampe: politika e ofertës dhe politika e kërkesës

Po të flasim në përgjithësi, ekonomistët e sotëm mund të ndahen në kampin e ofertës dhe të kërkesës, të cilët, për të qenë të sigurt, i ndan një kufi tejet i lëvizshëm, që ka shumë mbivendosje.

Politika e ofertës

Politika nga ana e ofertës: Adam Smith, David Ricardo, John Stuart Mill

Politika ekonomike që favorizon ofertën i qëndron traditës së teorisë klasike të Adam Smith-it, e hartuar nga David Ricardo, John Stuart Mill dhe të tjerë. Kërkesat politike që lindin nga kjo teori liberale e tregut dhe armiqësia e saj me shtetin përfshijnë krijimin e kushteve sa më të favorshme për ndërmarrjet, duke u dhënë mundësi të nxjerrin fitime të mira. Ndaj është edhe termi “politika e ofertës”: duhet optimizuar ofrimi i mallrave dhe shërbimeve. Nga kjo, sipas teorisë, do të lindë automatikisht kërkesa. Shteti duhet të ndërhyjë në treg sa më pak të jetë e mundur. Subvencionet dhe pronësia publike dhe rregullimi i tregut duhen ulur në minimum dhe tatimet e kontributet e sigurimeve shoqërore duhen mbajtur në nivele sa më të ulëta të mundshme. Banka Qendrore duhet të sigurojë stabilitetin e monedhës, por pa cenuar ciklin ekonomik.

Politika e kërkesës

Politika e kërkesës: John Maynard Keynes

Politika ekonomike e orientuar nga kërkesa u themelua nga John Maynard Keynes dhe mbështetet te roli aktiv që luan shteti në nxitjen e punësimit dhe menaxhimin e ciklit ekonomik. Kyç për këtë është ruajtja e kërkesës konstante në ekonomi. Për këtë qëllim, pagat duhet të rriten së paku në përputhje me prodhimtarinë. Henry

Ford, i cili futi prodhimin në masë në fabrikat e tij, duke nxitur kështu prodhimtarinë, përkrahu paga më të larta në dobi të kërkesës. Mendohet se në lidhje me këtë ai ka thënë se, “makinat nuk blejnë makina”. Në rast se ka rënie të konsumit privat dhe investimeve, shteti duhet të ndërhyjë me programe investimesh dhe masa intensive punësimi. Si rrjedhojë e kësaj kërkesë shtesë, ndërmarrjet do të fillojnë të investojnë sërish, punësimi do të rritet dhe do të shtohet konsumi privat. Banka Qendrore duhet të luajë rolin e saj në rimëkëmbjen ekonomike duke ulur normat e interesit dhe duke zgjeruar ofertën në para.

Tiparet dalluese

Një tipar kryesor dallues i politikës ekonomike nga aspekti i ofertës kundrejt atij të kërkesës ka të bëjë me pagat. E para i sheh pagat si barrë – një lloj faktori kostoje që, sidomos gjatë krizave, duhet shkurtuar. Ndryshe nga e para, e dyta i interpreton pagat si faktor vendimtar i kërkesës në ekonomi, që duhet të rriten gjatë periudhave të rënies ekonomike, për t’u siguruar që të mos nisë spiralla rënëse, ashtu si ndodhi në krizën ekonomike botërore të viteve ‘20. Disa ekonomistë e konsiderojnë mungesën e kërkesës si shkakun e stanjacionit ekonomik që kaloi Gjermania në periudhën 2001-2005, duke qenë se për disa vite me radhë pagat u frenuan dhe kërkesa vendase për investime publike ra në mënyrë të konsiderueshme, duke sforcuar ekonominë gjermane. Për të dalë nga kriza, u pa nevoja për rritje të pagave dhe për paketa për stimulimin e ekonomisë (Horn 2005). Sidoqoftë, politika e kërkesës ka dy probleme. E para, në praktikë ka rezultuar e vështirë që, gjatë periudhave ekonomike më të favorshme, të paguhen borxhet publike: mes të tjerave, kjo është arsyeja se pse borxhi kombëtar është rritur pareshtur. Në fund, qëllimi i programeve të nxitjes ekonomike dhe veprimit politik ulet gjithnjë e më shumë. Së dyti, ndërthurja e stimullit të kërkesës me një politikë bankare të përmytjes së tregut me para ndonjëherë ka çuar në spirale inflacioniste të pagave. Në të njëjtën kohë, inflacioni ka nxitur “kursimin e panikut”, duke bërë që konsumi të rrijë në vend. Rrjedha logjike e këtij zhvillimi në fund të viteve ‘70 ishte kombinimi fatal i stanjacionit dhe inflacionit: i ashtuquajtur: *stagflacion*.

Cila nga dy teoritë ka ndikim më të madh? Siç u përmend më lart, nga kriza ekonomike globale në vitet ‘20 deri në vitet ‘70, politika keqnesiane e kërkesës mbizotëroi në arenën ndërkombëtare. Megjithatë, në fund të viteve ‘70, në kundërpërgjigje të një ekonomie botërore që kishte mbetur në vend dhe përhapjes së inflacionit (stagflacioni), politika neoklasike e ofertës përjetoi një ringjallje.

*Nga kejnësianizmi
në vitet '70 te Kon-
sensusi i Uashingto-
nit në vitet '90*

*Një pjesë e madhe e
ekonomistëve gjer-
manë orientohen
drejt ofertës*

*Përgjigjet kejnësiane
për krizën e tregut
financiar në vitin
2008*

Lexim i mëtejshëm:

*Një panoramë e
mirë e sfondit të
këtij debati mund të
gjendet në librin e
shkëlqyer e lehtësisht
të kuptueshëm nga
Peter Bofinger,
"Grundzüge der
Volkswirtschafts-
lehre" (2007).*

Politika që favorizon ofertën u përkrah në vitet '80 nga Ronald Reagan në ShBA dhe Margaret Thatcher në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe nga Helmut Kohl në Gjermani – edhe pse në formë më të butë. Në vitet '90, ky orientim që mori politika ekonomike u pasqyrua në të ashtuquajturin Konsensusi i Uashingtonit dhe u përhap vrullshëm në mbarë botën. Mbi të gjitha, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar propaganduan një politikë liberalizimi që kërkonte ulje të taksave, privatizim, liberalizim, tregti të lirë dhe shkurtim të subvencioneve. Ideja ishte që të nxitet tregu e të sprapset shteti. Ish-kryeekonomisti i Bankës Botërore dhe fituesi i çmimit "Nobel", Joseph E. Stiglitz u shndërrua, që prej asaj kohe, në një kritik të fortë të Konsensusit të Uashingtonit. Ai e shihte besimin e verbër në teorinë e ofertës si kryesisht ideologjik dhe pa bazë empirike. Fakti është se ka shtete që kanë ndjekur recetat e liberalizimit të tregut, ekonomitë e të cilave kanë mbetur në vend, ndërkohë që të tjera kanë ecur përpara, si nga ana shoqërore, ashtu edhe ajo ekonomike mbi bazën e një bashkërendimi dhe menaxhimi më të fortë të tregut (Stiglitz 2002).

Aktualisht, shumica e ekonomistëve gjermanë duket se anojnë nga aspekti i politikës së ofertës. Kur në vitin 2005, Koalicioni Kuqegjellbër mori hapur në konsideratë shpenzimet publike reflacioniste për të nxitur kërkesën – me fjalë të tjera, një politikë klasike kejnësiane – më shumë sesa 250 profesorë të ekonomisë bënë thirrje për politika ekonomike të orientuara drejt kërkesës në të ashtuquajturën "Thirrja e Hamburgut". Ekonomistët që përkrahën politikën e orientuar nga kërkesa, kanë qenë prej vitesh në pozita mbrojtëse, por, tashmë, zëri i tyre po dëgjohet gjithnjë e më shumë.

Teoria e kërkesës e Keynes-it mund të shpjegojë, për shembull, se pse kriza e tregut financiar e goditi ekonominë reale caq shpejt dhe thellë në vitin 2008, duke shkaktuar një rënie ekonomike globale. Po kështu, shumë vende janë përgjigjur me anë të politikave kejnësiane të nxitjes së kërkesës, duke rritur shpenzimet publike e duke shtuar fuqinë blerëse të familjeve.

Kriza financiare dhe ekonomike që nga viti 2008 ka sjellë një rishikim madhor idesh. Edhe kreu i Deutsche Bank, Josef Ackermann, tashmë shprehet se: "Nuk besoj më në aftësitë vetëshëruese të tregut" (Ackermann 2008) dhe bën thirrje për një mbikëqyrje financiare globale. Tashmë, radikalët e tregut janë tërhequr dhe doktrinat e Keynes-it kanë dalë sërish në dritë. Teoritë e tij e shpjegojnë këtë krizë të rëndë dhe piketojnë disa rrugë të mundshme për të dalë prej saj.

Fakti që Keynes ka ende vlerë nuk është thjesht rastësi. Në fund të fundit, vepra e tij më e madhe, *'Teoria e përgjithshme e punësimit, interesit dhe parasë'*, që produkt i krizës ekonomike globale të viteve '30, që, në shumë mënyra, ngjason me situatën aktuale. Atëherë, si tani, të dala nga çoroditja e tregut financiar, ekonomitë e mbarë botës kaluan njëkohësisht në krizë, duke vënë në lëvizje spiralen rënëse. Për shkak të mungesës së fuqisë blerëse dhe shqetësimeve për afrimin e një krize edhe më të rëndë, familjet konsumojnë më pak, ndërmarrjet shtyjnë investimet dhe bankat ende thuajse nuk japin hua. Prodhohet më pak, çka sjell si pasojë mbylljen e vendeve të punës dhe konsumi vazhdon të fundoset më tej. Krizës së viteve '30 iu dha fund, fillimisht, duke vënë në zbatim të gjerë rregullimin e tregut dhe programet e investimeve shtetërore, bazuar në idetë e Keynes-it

Si mund të shpjegohet zanafilla e krizës së tregjeve të pasurive të paluajtshme në vitin 2007 në ShBA? Ishte ngritur një flluskë gjigande spekulative, që e çoi sistemin kombëtar bankar në prag të kolapsit. Nxënësi i Keynes-it, Hyman Minsky kishte një shpjegim bindës për këtë, mbështetur në punën e mësuesit të tij (Minsky 1986) Gjatë periudhave të gjata të rritjes ekonomike shtohet lakmia dhe oreksi për të ndërmarrë rreziqe. Në kërkim të fitimeve më të larta, ndërmerren rreziqe më të mëdha. Konkurrenca midis bankave i tundon ato të anashkalojnë rregullat duke dalë me produkte të reja financiare, për të financuar investime me risk. Kur akumulohet shumë risk, e gjithë shtëpia prej letre shembet, siç e kemi parë. Zgjidhja e Minskit është rregullimi nga shteti për të mbrojtur tregun nga vetvetja dhe për të shmangur krizat financiare. Keynes-i kërkoi t'u jepej fund tregjeve globale financiare të parregulluara që në vitin 1926, në esenë e tij, "Fundi i Laisser-faire" (Keynes 1926). Po kështu, ai u përfshi në hartimin praktik të rregullave për tregun botëror. Mes të tjerash, ai mori pjesë në konferencën e Bretton Woods-it, në të cilën u hodh koncepti i një regjimi për tregjet financiare botërore, i cili solli disa dekada stabilitet. Tashmë, kjo temë është kthyer edhe njëherë në rendin e ditës në botë. Takimi i G20-ës në prill të vitit 2009 në Londër është përshkruar edhe si përpjekje për një Bretton Woods të dytë. Në këtë drejtim, janë hedhur hapa të vegjël, por të rëndësishëm: u ra dakord për rregullimin global të fondeve mbrojtëse dhe u krijua një forum për stabilitetin financiar në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Po çfarë rrugëdaljesh nga kriza aktuale mund të gjejmë te Keynes? Ciklet ekonomike zakonisht menaxhohen nëpërmjet politikës së normës së interesit. Sipas

kësaj, bankat qendrore në mbarë botën ulën normat e interesit si reagim ndaj krizës së vitit 2008. Megjithatë, për shkak të ashpërsisë së krizës, këto masa nuk patën efektin e zakonshëm. Njerëzit i hoqën mënjatë paratë me kapicë, siç e kishte parashikuar Keynes që do ndodhte në kriza veçanërisht serioze. Për të kompensuar mungesën e investimit dhe konsumit privat, Keynes-i bëri thirrje për një investim shtetëror të financuar nga borxhi. Shumë vende, gjatë viteve 2008 dhe 2009, reagueshan me një politikë klasike kejneshane të nxitjes së kërkesës, duke rritur shpenzimet publike dhe duke shtuar fuqinë blerëse të familjeve në një shkallë të padëgjuar më parë. Pas paketave të konsiderueshme të nxitjes ekonomike që u ndërmoren në ShBA, Kinë dhe Evropë, në takimin e G20-ës në prill të vitit 2009, ekonomitë më të mëdha të botës vendosën të injektonin 1.1 trilionë dollarë amerikanë në ekonomitë e mbarë globit. Ministri britanik i Financave asokohe, (socialdemokrati) Alistair Darling, iu referua shprehimisht Keynes-it kur shpalli paketën e nxitjes ekonomike të qeverisë së tij.

Institutet studimore ekonomike përfaqësojnë shpesh një shkollë bazë studimi (orientim nga kërkesa ose oferta) në teorinë ekonomike dhe e orientojnë veten në përputhje me këtë. Edhe pesë institutet kryesore të studimeve ekonomike në Gjermani mund të klasifikohen kryesisht si të orientuar nga kërkesa apo nga oferta.

*Klasifikimi i
instituteve
gjermane të
studimeve
ekonomike*

Veprimtaria e tyre kërkimore ka jo pak ndikim në debatin për politikën ekonomike. Për rrjedhojë, është me rëndësi të njihen bindjet e tyre ekonomike bazë e të mbahen parasysh kur vlerësohen analizat dhe rekomandimet e tyre. Sidoqoftë, të pesta këto institute punojnë së bashku, veçanërisht për prognozën ekonomike, që përbëjnë bazën e buxheteve publike dhe ndikojnë në planifikimin e shumë firmave.

Lexim i mëtejshëm:

Michael Dauderstädt (2009), Krisenzeiten: Was Schulden vermögen und was Vermögen schulden, Friedrich-Ebert-Stiftung (ed.), Bonn. Volkswirtschaftslehre" (2007).

- *Deutsches Institut für Wirtschaftsforschung (DIW)* (Instituti gjerman i Studimeve Ekonomike) në Berlin, i drejtuar nga Profesor Gert G. Wagner (www.diw.de), është kryesisht i orientuar drejt kërkesës.
- *Institut für Wirtschaftsforschung Halle (IWH)* (Instituti i Studimeve Ekonomike i Halle) në Halle/Saale, i drejtuar nga Profesor Ulrich Blum (www.iwh-halle.de), është i orientuar kryesisht drejt ofertës.
- *Institut für Weltwirtschaft (IfW)* (Instituti i Kiel-it për Ekonominë Botërore) në Kiel, drejtuar nga Profesor Dennis J. Snower (www.ifw.de), është kryesisht i orientuar nga oferta.

- *Rheinisch-Westfälisches Institut für Wirtschaftsforschung (RWI)* (Instituti Studimeve Ekonomike i Rinit Verior-Vestfali) në Esen, drejtuar nga Profesor Christoph M. Schmidt (www.rwi-essen.de), është i orientuar nga oferta.
- *IFO Institut für Wirtschaftsforschung e. V. (IFO)* (Instituti i Studimeve Ekonomike IFO) në Mynih, i drejtuar nga Profesor Hans-Werner Sinn (www.ifo.de), është i orientuar nga oferta dhe dukshëm më liberal sa i takon tregut nga të pesta institutet.

Përveç atyre më sipër, të tjera institute të orientuar nga oferta janë Institut der deutschen Wirtschaft Köln (IW) (Instituti i Studimeve Ekonomike i Këlnit, i drejtuar nga Profesor Michael Hüther: www.iwkoeln.de), që ka lidhje të ngushta me punëdhënësit; Wirtschafts und Sozialwissenschaftliches Institut (WSI) (Instituti Ekonomik dhe i Shkencave Shoqërore, i orientuar nga kërkesa, drejtuar nga Profesor Heide Pfarr: www.wsi.de), që është pranë sindikatave dhe instituti i lidhur me të, Institut für Makroökonomie und Konjunkturforschung (IMK) (Instituti i Studimeve Makroekonomike dhe Lulatjeve të Biznesit, drejtuar nga Profesor Gustav Horn).

	Politika e ofertës	Politika e kërkesës
Ideja bazë	Krijimi i kushteve më të favorshme të mundshme për ndërmarrjet, duke iu dhënë atyre mundësi sigurojnë fitime të mira	Sigurimi i kërkesës, përmes mbështetjes nga shteti të punësimin dhe menaxhimit të ekonomisë
Shkolla e mendimit	Adam Smith, David Ricardo, John Stuart Mill	John Maynard Keynes
Koncepti i shtetit	Shtet pasiv	Shtet aktiv
Këndvështrimi për pagat	Pagat janë faktor kyç i kostos	Pagat janë faktor i kërkesës dhe duhet të rriten në përputhje me rendimentin
Roli bankës qendrore	Duhet të sigurojë stabilitet monetar	Duhet të sigurojë stabilitet monetar dhe të ndihmojë në ruajtjen e punësimin dhe rritjen konstante
Ndikimi mbizotërues	Nga vitet '80	Midis viteve '30 dhe '70 dhe në rritje që nga viti 2008
Institute	Institut für Wirtschaftsforschung Halle (IWH) Institut für Weltwirtschaft (IfW) Rheinisch-Westfälisches Institut für Wirtschaftsforschung (RWI) ifo Institut für Wirtschaftsforschung e. V. (ifo) Institut der deutschen Wirtschaft Köln (IW)	Deutsches Institut für Wirtschaftsforschung (DIW) Wirtschafts- und Sozialwissenschaftliches Institut (WSI) Institut für Makroökonomie und Konjunkturforschung (IMK)

Tensionet midis tregut, bashkëvendimmarrjes, politikave rregullatore dhe qeverisjes politike

Pas vështrimit mbi teoritë ekonomike bazë, pyetja që lind është sesi socialdemokratët mund të ndërtojnë një politikë moderne mbështetur në vlera mbi themelet e tyre. Për këtë qëllim shërbejnë si busull orientimet e socialdemokracisë, që shpjegohen në dy kapitujt e ardhshëm. Megjithatë, në këtë pikë, duhen paraqitur njëherë kundërshtitë që duhen pajtuar në përputhje me doktrinat socialdemokrate (shih Meyer 2005b: 67).

1. Prodhimtaria dhe zhvillimi përballë drejtësisë sociale dhe sigurisë sociale

Rendja pas interesit dhe pasurisë vetjake çliron forca të jashtëzakonshme, sikurse e përshkruajnë Smith-i dhe Marx-i. Tregu dhe konkurrenca bëjnë që burimet e pakta të shkojnë aty ku mund të shfrytëzohen në mënyrë më produktive. Kjo ka vërtetuar se mund të jetë shumë më efikase, sesa do të ishte ekonomia e planifikuar.

Nga ana tjetër, tregu çon në shpërndarje të pabarabartë dhe, me luhatjet e ndjeshmërinë ciklike që ka ndaj krizave, bëhet i paqëndrueshëm në strukturë, sipas përshkrimit të Keynes-it. Si rrjedhojë, tregjet duhet të jenë subjekt i një kuadri politik, që t'i mbajë këto kriza nën kontroll. Shteti i mirëqenies duhet t'i ruajë njerëzit nga rreziqet e tregut. Përmes tatimeve progresive mbi të ardhurat, që do të thotë tatim që rritet bashkë me të ardhurat, si dhe tatimeve mbi trashëgiminë dhe pronën, duhet arritur shpërndarja “e drejtë”. Më tej, shteti duhet të menaxhojë ciklet ekonomike me anë të politikës së shpenzimit, taksave dhe normës së interesit. Kjo do të thotë se gjatë krizave ekonomike duhen rritur shpenzimet publike, me qëllim që të ruhet qëndrueshmëria e konsumit dhe të nxitet dëshira e njerëzve për të investuar përmes huave të lira.

2. Elasticiteti dhe novatorizmi përballë mbrojtjes së punësimit të varur dhe sigurisë sociale gjithëpërfshirëse.

Konkurrenca doemos sjell novacion. Megjithatë, goditjet dhe krizat që i shoqërojnë duhen lehtësuar përmes garantimit të mbrojtjes së punësimit dhe përfitimeve sociale për punonjësit. Transformimet strukturore me ndi-

Ekulibri midis tregut, demokracisë dhe kohezionit shoqëror

Zhvillimi dhe ndershmëria

Elasticiteti dhe siguria

kim të thellë si, për shembull, rënia e industrisë së qymyrit dhe çelikut në Rur (Ruhr – rajon në Gjermani, shën. i përkthyesit), mund të orientohet drejt krijimit të vendeve të reja të punës vetëm duke zbatuar një politikë strukturore specifike.

Prona dhe konsolidimi sociale

3. Prona dhe konkurrenca përballë integritit social dhe vendosjes së rregullave

Sistemet ekonomike që janë përpjekur përgjithësisht t'i heqin qafe të drejtat e pronësisë mbi mjetet e prodhimit dhe konkurrencën kanë dështuar përherë. Çdo sistem i suksesshëm ekonomik mbështetet mbi pronën dhe konkurrencën. Pavarësisht kësaj, kjo nuk e çliron pronësinë nga përgjegjësia sociale. Për shembull, Neni 14 i Kushtetutës së Gjermanisë (*Grundgesetz*) përcakton se "Prona dhe e drejta e trashëgimisë janë të garantuara. ... [por] nga prona burojnë detyrime. Përdorimi i saj i shërben edhe së mirës publike". Për të siguruar një treg të drejtë dhe për të parandaluar mbizotërimin në treg të aktorëve individualë, konkurrenca duhet të ketë rregulla.

Vendimmarrja dhe bashkëvendimmarrja në ndërmarrje

4. Autonomia e ndërmarrjes përballë bashkëvendimmarrjes dhe imponimit të një kuadri politik

Nga e drejta e pronës buron e drejta për t'u marrë me veprimtari tregtare. Megjithatë, vendimmarrja tregtare nuk duhet të kufizohet vetëm te pronarët e kapitalit, por duhet të përfshijë edhe ata që, me anë të fuqisë punëtore, kontribuojnë për të krijuar vlerë. Për pasojë, vendimmarrja në shoqëritë tregtare duhet të kushtëzohet me bashkëvendimmarrje.

Katër dimensionet e ekonomisë politike

Nga kjo lindin katër dimensionet:

- imponimi i një kuadri politik
- shpalsja e logjikës së tregut
- të drejtat për përfshirjen e punëmarrësve dhe bashkëvendimmarrja
- rregullimi makroekonomik

Të marra së bashku, nënkuptojnë një sistem ekonomik socialdemokrat mbështetur në vlera, ku logjika e tregut mund të shpalojë brenda një kuadri politik. Nga prona "burojnë detyrime" dhe gjithashtu ajo i nënshtrohet "së mirës publike". Kjo, mes të tjerash, sigurohet me anë të pjesëmarrjes së punonjësve në vendim-

marrjen e ndërmarrjes, krahas aksionarëve. Stabiliteti i përgjithshëm ekonomik sigurohet vetëm nëpërmjet rregullimit makroekonomik: me fjalë të tjera, shteti, përmes politikës buxhetore dhe të normës së interesit, përpiqet të përftojë një rritje të qëndrueshme dhe punësim të lartë.

Çfarë nënkupton kjo për demokracinë sociale?

- Të gjithë ata që interesohen për çështjet ekonomike duhet të njihen me bazat e ndryshme teorike dhe të jenë të aftë të identifikojnë ideologji të ndryshme.
- Demokracia sociale nuk përdor vetëm një, por një mori qasjesh të ndryshme teorike.
- Sidoqoftë, në thelb qëndron kapitalizmi i menaxhuar, i llojit që kërkonte Keynes.
- Nga ana tjetër, socialdemokratët mbështeten edhe te kritika e kapitalizmit e Marx-it, përveçse te efikasiteti dhe produktiviteti i tregut, i përshkruar nga Smith-i.
- Një sistem ekonomik duhet po ashtu të mbështetet te konkurrenca dhe prona private. Megjithatë, tregjet duhen rregulluar, krizat ekonomike duhen luftuar në mënyrë aktive nga shteti dhe duhet siguruar bashkëvendimmarrja dhe pjesëmarrja.

3. SISTEMET EKONOMIKE DHE RENDET EKONOMIKE

Në këtë kapitull

- trajtohen marrëdhëniet midis kapitalizmit dhe demokracisë, që janë në të njëjtën kohë të tendosura dhe mbështetin njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë;
- përshkruhen variante të ndryshme të kapitalizmit, të cilat shquhen nga njëra-tjetra për nga shkalla e tyre e koordinimit;
- shpjegohet koncepti i “ekonomisë sociale të tregut” dhe
- parashtrihen si ndikimet pozitive, ashtu edhe mangësitë e globalizimit nga pikëpamja socialdemokrate

3.1. Kapitalizmi dhe demokracia

*A e shkatërron
“superkapitalizmi”
demokracinë?*



“A e shkatërron superkapitalizmi demokracinë?”, shtronte pyetjen botimi ekonomik, Manager Magazin, në kopertinën e tij në marsit të vitit 2008. Ky titull provokues shoqërohej nga fotoja e një karkaleci. Artikulli kryesor pohon se ekonomia e globalizuar e tregut⁷ mund të vendosë në pikëpyetje besueshmërinë e demokracisë. Ai vijon duke pohuar se shumë njerëz nuk kanë më besim se mund të përfitojnë nga ekonomia e globalizuar. Si rrjedhim, besimi te ekonomia dhe politika po bie.

*Të ndërthurur
historikisht:
demokracia dhe
kapitalizmi*

Historikisht, shfaqja e demokracisë dhe ajo e kapitalizmit kanë qenë të lidhura ngushtë. Demokracitë janë vendosur shpesh së bashku me zhvillimin e tregjeve të lira. Ishte Evropa e shekullit të tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë, ku u shfaqën

⁷ Ekonomi tregu apo kapitalizëm – a dallojnë në kuptim këto terma? Në thelb, të dyja konceptet i referohen një sistemi ekonomik që ngrihet mbi pronën private dhe konkurrencën. Në përdorimin e përditshëm, termi “ekonomi tregu” dëgjohet shpesh të përdoret nga avokatët e sistemit ekonomik liberal, ndërsa “kapitalizmi” përdoret më shpesh nga ata që janë kritikë të tregut. Sidoqoftë, në këtë libër, përdorimi i të dyja termave nuk duhet marrë si përfaqësues i asnjë ideologjie të veçantë.

thirrjet për liri individuale me një ekonomi që bazohej te konkurrenca e lirë dhe prona private (shih komentet për Adam Smith-in në Kapitullin 2). Kjo kërkesë u shoqërua me dëshirën për siguri juridike dhe të drejta themelore të detyrueshme, si dhe me kërkesën për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik të qytetarëve në shtet. Demokracisë së parë të epokës së re iu hap rrugë nga pavarësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me parullën “nuk ka taksim pa përfaqësim”. Me fjalë të tjera, kërkesat për pjesëmarrje politike dhe ekonomike qëndrojnë bashkë. Pas vitit 1989, liberalizimi ekonomik dhe demokratizimi shkuan krah për krah në shtetet paskomuniste të Evropës.

Për një kohë të gjatë, dukej e natyrshme që shtetet demokratike ishin në thelb më të suksesshme ekonomikisht sesa ato jodemokratike. Mirëqenia e Perëndimit dhe kolapsi ekonomik i Bllokut të Lindjes duket se e pohuan një gjë të tillë. Megjithatë, mund të shohim ndërkohë që ka edhe shtete që nuk janë demokratike, por, pavarësisht kësaj, përfytyrojnë rritje të madhe ekonomike duke zbatuar një sistem ekonomik kapitalist. Këtu, Kina është shembulli i parë që të vjen në mendje, pasi vendi është zhvilluar ekonomikisht qysh prej kalimit në një vend kapitalist në fund të viteve '70, por pa u demokratizuar gjatë këtij procesi. Në një sërë vendesh të tjera, po kështu, sinkronizimi i liberalizmit ekonomik dhe politik nuk ka ndodhur (ende?). Këtë e pohon edhe Indeksi i Lirisë Ekonomike në Botë, i cili botohet çdo vit e vlerëson lirinë ekonomike dhe politike. Në dy vendet e para të renditjes sa i takon lirisë ekonomike qëndron Hong Kongu dhe Singapori.

Është me rëndësi të theksohet se ka (ende?) shtete autoritare me ekonomi plani dhe të tjera me sisteme kapitaliste. Ndërkohë, të gjitha shtetet demokratike ekzistuese mbështeten në ekonominë e tregut.

Sidoqoftë, raporti midis demokracisë dhe kapitalizmit nuk është pa përplasje. Demokracia bazohet në barazi: “një njeri, një votë”. Çdo votë ka të njëjtën peshë. Nga ana tjetër, ekonomia e tregut mbështetet në pabarazi. Në një sistem ekonomik kapitalist, “torta” ndahet në disa pjesë të mëdha. Mund të ketë rishpërndarje, por, nëse kjo shkon larg deri aty sa pjesa e gjithkujt të ketë të njëjtën masë, atëherë nuk ka stimul, për shembull, për të punuar më shumë.

A janë shtetet demokratike vërtet më të suksesshme ekonomikisht?

Përplasjet midis kapitalizmit dhe demokracisë

*Pabarazia mund të
çojë në "demokraci
defektoze"*

Pabarazia mund të çojë, mes të tjerash, në një situatë ku aktorët me fuqi ekonomike arrijnë një pozitë kaq të fortë vetoje, saqë shfaqet një "demokraci defektoze". Studiuesi i shkencave politike, Wolfgang Merkel e përkufizon si më poshtë këtë lloj demokracie: "Demokracitë e gjymtuara janë sisteme qeverisëse që karakterizohen nga prania e regjimeve zgjedhore demokratike, të cilat përgjithësisht funksionojnë në rregullimin e marrjes së pushtetit, por që privohen për shkak të prishjes së funksionimit të një apo më shumë nënregjimeve, të shtyllave plotësuese, të cilat në një demokraci funksionale janë të domosdoshme për të garantuar lirinë, barazinë dhe kontrollin" (Merkel dhe të tjerët, 2003: 66).

*Burimet e pengimit
së demokracisë*

Kjo nënkupton se, edhe pse zhvillohen zgjedhje dhe ekzistojnë elemente të tjera të demokracisë, ato minohen nga faktorë të ndryshëm që pengojnë ushtrimin e drejtë të saj. Kështu ndodh, për shembull, kur një aktor i shoqërisë është kaq i fuqishëm ekonomikisht, sa mund të ushtrojë veto mbi vendimet e përbashkëta. Për të marrë një shembull: është e kuptueshme që një investuesi i cili është në pozitë t'i bëjë shantazh një shteti duke shfaqur mëdyshje nëse do ta vendosë prodhimin e vet aty, t'i bëhen lëshime politike, si ulja e standardeve mjedisore ose të punës. Kjo përbën shkelje të parimeve demokratike.

*Raporti midis demo-
kracisë dhe kapita-
lizmit të tregut sipas
Thomas Meyer*

Në vëllimin e parë të serisë së librave ku bën pjesë kjo përmbledhje, jepet një panoramë e përplasjeve midis demokracisë dhe kapitalizmit të tregut (f. 58-62 dhe 84ff), sipas librit të Thomas Meyer, 'Teoria e demokracisë sociale'.

*Paradoksi i
demokracisë*

Figura në faqen 51 paraqet paradoksin e demokracisë. Sipas saj, kapitalizmi, nga njëra anë, është parakushti i demokracisë. Nga ana tjetër, një treg i parregulluar sa duhet mund të krijojë kushte që nuk pajtohen me pjesëmarrjen e të gjithëve, duke çuar kështu në demokraci defektoze.

*Milton Friedman:
Ekonomia e tregut
çon në demokraci*

Është kjo, bashkë me ndërgjegjësimin për rreziqet e kapitalizmit në raport me demokracinë, që e dallon demokracinë sociale nga demokracia libertariane. Ekonomistë libertarianë, si Milton Friedman, pohojnë se ekonomia e tregut çon edhe në liri politike dhe demokraci.




Figura 4: Paradoksi i teorisë së demokracisë

Friedman-i dha kundërshebullin e tij. Ai skandalizoi shumë prej kolegëve të tij në vitet '70, me këshillimin e juntës brutale ushtarake në Kili. Diktatori Augusto Pinochet ndoqi udhëzimin e Friedmanit për liberalizimin e skajshëm të ekonomisë. Ndryshe nga ajo ç'priste ekonomisti libertarian, kjo nuk çoi as në liri më të madhe politike e aq më pak në demokraci. Në të kundërt, rritja ekonomike i dha qëndrueshmëri diktaturës. Me kalimin e kohës, Kili u bë sërish vend demokratik, por më vonë sesa vende të tjera të Amerikës Latine.

Ç'po ndodh që përplasjet midis kapitalizmit dhe demokracisë po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje, madje edhe në revistat ekonomike. Ekonomisti amerikan dhe ish-Sekretari i Shtetit për Punën në administratën e presidentit Bill Clinton, Robert Reich i jep një përgjigje kësaj në librin e tij të vitit 2008, *'Superkapitalizmi: Beteja për demokraci në epokën e biznesit të madh'* (nëntitulli në botimin gjerman është: 'Si po e minon ekonomia demokracinë tonë'). Ai përshkruan periudhën nga vitet e pasluftës deri në vitet '80 gati si epokën e artë të kapitalizmit të

Kundërshebulli:
Kili

Aktualiteti i çështjes
së "demokracisë dhe
kapitalizmit"

moderuar (gati, pasi periudha në fjalë nuk duhet parë pa një sy kritik: Reich, për shembull, përmend mungesën e mundësive ekonomike për gratë dhe pakicat) Në shoqëritë perëndimore të pasluftës, rritja e standardeve të jetesës dhe standardeve minimale shoqërore mundi të arrihej falë marrëveshjes midis sindikatave, punëdhënësve dhe qeverive. Krahasuar me ekonominë *'laisser-faire'*, që kishte paraparirë, kjo shënoi një përparim të jashtëzakonshëm. Megjithatë, në superkapitalizmin e ekonomisë së globalizuar, është shënuar sërish rritje e pabarazive në të ardhura.

Superkapitalizmi është një koncept i krijuar nga Robert Reich për të përshkruar zhvillimin e kapitalizmit në kushtet e globalizimit.

Të drejtat e punonjësve dhe standardet shoqërore janë vënë në rrezik dhe përgjegjësia sociale e biznesit po ulet. Përfundimet që nxori Robert Reich janë të ngjashme me ato të revistës *Manager Magazin*, përmendur më sipër dhe ato të Thomas Meyer: forcat centrifugale të tregut mund të sabotojnë demokracinë. Për këtë arsye, Reich bën thirrje për një konsolidim më të fortë të tregut me anë të rregullimit dhe zbatimit të të drejtave të punonjësve.

3.2. Kapitalizmi i koordinuar dhe i pakoordinuar

Në Kapitullin 2 të këtij vëllimi, u parashtruan një numër sistemesh ekonomike ideale, duke iu referuar ekonomistëve si Smith, Marx dhe Keynes. Megjithatë, në botën reale ka shumë modele të kombinuara. Peter A. Hall dhe David Soskice (2001) kanë identifikuar dy modele në vendet e industrializuara perëndimore, që, në librin e tyre, *'Varieties of Capitalism'* (Llojet e kapitalizmit – shën. i përkthyesit), i etiketojnë si kapitalizmi "i pakoordinuar" dhe "i koordinuar". Kjo qasje ka forcë të konsiderueshme shpjeguese në marrjen në analizë dhe vlerësimin e sistemeve ekonomike.

Në këtë kuadër, sistemet ekonomike dallohen sipas aspekteve në vijim:

- Sistemi financiar
- Marrëdhëniet e punës
- Sistemi i arsimit dhe formimit
- Marrëdhëniet mes ndërmarrjeve

Kapitalizmi i pakoordinuar

Kapitalizmi i pakoordinuar liberal ka karakteristikat e mëposhtme sipas këtyre aspekteve:

- Sistemi financiar: financimi i ndërmarrjeve bëhet kryesisht përmes tregut të kapitalit (aksioneve). Kjo nënkupton se ndërmarrjet veprojnë në përputhje me të ashtuquajturin “parim të vlerës së aksionarit”. Sipas sistemit në fjalë, pronarët janë të gatshëm të investojnë edhe në kompani me risk, duke spekuluar me mundësinë e marrjes së fitimeve të larta shumë shpejt.
- Marrëdhëniet e punësimit janë kryesisht afatshkurtra (“punëso dhe pusho”) dhe mbrojtja e punësimit është e dobët. Pagat negociohen mbi baza individuale ose në nivel ndërmarrjeje. Shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat janë relativisht të dobëta.
- Sistemi i arsimit dhe formimit: Theksi mbetet te formimi i njerëzve me aftësi të përgjithshme. Kjo nënkupton se arsimit është kryesisht i përgjithshëm dhe nuk ka prirje të ofrojë kualifikime profesionale. Kjo e bën më të lehtë lëvizjen midis profesioneve të ndryshme në tregun e punës, por, po ashtu, çon në mungesën e njohurive të specializuara, sipas profesioneve të caktuara.
- Marrëdhëniet midis ndërmarrjeve: Ndërlidhjet midis kompanive janë të pakta (për shembull, kur ndërmarrjet janë pjesë e bordeve mbikëqyrëse të njëra-tjetrës) dhe bashkëpunimi brenda industrisë është i vogël (për shembull, në fushën kërkimore). Shoqatat industriale më shumë bëjnë lobistin për kompanitë anëtare, sesa janë aktorë që mbajnë përgjegjësi për shoqërinë në tërësi.

Sistemi mund t’u përshtatet shpejt e me elasticitet ndryshimeve në treg. Kjo nënkupton se ky model prodhimi favorizon industrinë e orientuar nga novacioni, por, po ashtu, është edhe më i paqëndrueshëm dhe më i pasigurt për punonjësit.

Kapitalizmi i koordinuar

Kapitalizmi i koordinuar ka karakteristikat në vijim:

- Sistemi financiar: Zakonisht, financimi ndodh në formën e huave bankare. Ky është një kapital më “i duruar” sesa në rastin e modelit të vlerës së aksio-

Sistemi financiar

Marrëdhëniet e punës

Sistemi i arsimit dhe formimit

Marrëdhëniet midis ndërmarrjeve

Sistemi financiar

narit dhe favorizon investime më afatgjata. Sigurisht që kjo formë financimi e ndërmarrjeve nuk i ndalon aktorët e konsoliduar të tregut, si sipërmarrësit, të përftojnë qasje në kapital. Menaxhimi kontrollohet dhe gjykohet jo vetëm nga tregu, por edhe nga aktorë të tjerë, si bankat, punëmarrësit, aktorët shtetërorë (modeli aksionarëve).

Marrëdhëniet e punës

- Marrëdhëniet e punës: Pagat negocohen në mënyrë të koordinuar midis firmave individuale në nivel sektori (marrëveshjet kolektive). Mbizotërojnë marrëdhëniet afatgjata të punësimit. Stabiliteti dhe drejtësia sociale janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ka shoqata punëdhënësish dhe sindikata të mir-organizuara, si dhe pjesëmarrje nga punonjësit.

Sistemi i arsimit dhe formimit

- Sistemi i arsimit dhe formimit. Modeli i formimit kombinon kualifikimet specifike për kompanitë me ato të përgjithshme për fushën dhe drejtohet nga organizatat kryesore të punëmarrësve dhe punëdhënësve (sistemi i formimit të dyfishtë). Në këtë mënyrë, përçohen njohuritë specifike për kompaninë dhe fushën e caktuar.

Marrëdhëniet midis ndërmarrjeve

- Marrëdhëniet midis ndërmarrjeve: ndërlidhjet midis kompanive janë të përhapura përmes pronësisë së kryqëzuar. Shoqatat e sektorit luajnë rol të rëndësishëm në sistemin politik.

Kapitalizmi i koordinuar karakterizohet nga një nivel i lartë stabiliteti dhe dinamizëm dhe elasticitet më i ulët sesa kapitalizmi i pakoordinuar. Në këtë sistem, linjat dhe proceset ekzistuese të prodhimit modifikohen vazhdimisht dhe në detaj. Novatorizmi priret të hyjë me hapa të vegjël. Sistemi mund t'u përshtatet vetëm ngadalë situatave të reja problematike.

Dobia e identifikimit të dallimeve

Dy sistemet kanë avantazhe dhe dizavantazhe të caktuara. Sa i takon rendimentit dhe konkurrueshmërisë, asnjë prej modeleve nuk ka epërsi të dukshme ndaj tjetrit. Identifikimi i dallimeve midis këtyre të dyjave është qartësues për dy arsye:

Niveli analitik

1. Nga pikëpamja analitike: Modeli bën të mundur të shpjegohet pse zhvillohen modele të ndryshme prodhimi. Vendet "anglosaksone" (në terma ekonomike), me tregjet e tyre elastike të punës dhe qasjen e lehtë në kapitalin me risk, favorizojnë industrinë e orientuara nga novacioni, siç është, për shembull, teknologjia e informacionit. Për rrjedhojë, nuk është rastësi që firma të

teknologjisë së informacionit, si Google, Microsoft dhe një mori biznesesh të reja e kanë origjinën në SHBA. Vendet me kapitalizëm të koordinuar, si Suedia dhe Gjermania, kanë industri shumë konkurruese, për shembull, në sektorin automobilistik ose të ndërtimit të makinerive. Të mirat e prodhuara janë më konkurruese aty ku ka periudha shumë të gjata planifikimi, për shkak të investimit të lartë kapital që përfshihet. Këto industri nuk kanë novacione rrënjësore, por më tepër përmirësime të vazhdueshme. Këta faktorë favorizojnë vendet ku ka punonjës të mirarsimuar dhe të formuar, të cilët priren të qëndrojnë për një kohë të gjatë në firmat e tyre dhe ku gjendet kapitali “i duruar”.

2. Dy modelet kanë dallim edhe nga këndvështrimi normativ. Vlerat socialdemokrate janë më të realizuara në vendet me kapitalizëm të koordinuar. Marrëdhëniet afatgjata të punësimit u ofrojnë punëmarrësve më shumë siguri sesa një treg pune “punëso dhe pusho”. Po ashtu, ndërmarrjet që bëjnë investime afatgjata dhe nuk kanë si shtysë kryesore fitimin e shpejtë nxitin një treg pune më të qëndrueshëm.

Niveli normativ

Ekonomia sociale e tregut: Për variantin gjerman të kapitalizmit të koordinuar, që nga periudha e pasluftës, është konsoliduar termi “ekonomia sociale e tregut” ose, duke iu referuar ish-selisë së qeverisë së Republikës Federale Gjermane (Bon), “kapitalizmi i Rinit”. Ekonomia sociale e tregut erdhi si reagim ndaj trazirave shoqërore të industrializimit, nga njëra anë, dhe tmerreve të diktaturës naziste nga ana tjetër. Ajo ishte një përpjekje për të gjetur një rrugë të mesme midis kapitalizmit të shfrenuar dhe rendit ekonomik social. Tërheqja që u shfaq ndaj këtij të fundit në periudhën e pasluftës nuk është për t’u nënvlerësuar. Kushtetuta gjermane (Grundgesetz), e cila sapo ishte miratuar nuk zotohej ndaj asnjë rendi ekonomik të posaçëm. Neni 15 bën të mundur shtetëzimin e mjeteve të prodhimit. Po ashtu, partitë politike qenë deri diku kritike kundrejt kapitalizmit: dega e CDU-së në Landin e Vestfalisë së Rinit Verior, në programin e Ahlen të vitit 1947, u deklarua në përkrahje të socialkristianizmit dhe SPD-ja kërkoi shtetëzimin e industrive kryesore. Ekonomia sociale e tregut ishte edhe një përpjekje për të fituar besimin e popullit gjerman te ekonomia e tregut dhe demokracia.

Ekonomisti Alfred Müller-Armack pati një ndikim vendimtar mbi konceptin, duke shpjeguar në librin e tij të vitit 1947, *Wirtschaftslenkung und Marktwirtschaft* (Menaxhimi ekonomik dhe ekonomia e tregut):

“Ne flasim për një ekonomi sociale tregu, për të cilësuar këtë formë të tretë të politikës ekonomike. Kjo nënkupton ... se ekonomia e tregut na duket e nevojshme si kuadër mbështetës i rendit të ardhshëm ekonomik, edhe pse kjo nuk duhet të jetë një ekonomi liberale tregu që lihet të bëjë ç’ të dojë, por

një ekonomi tregu e menaxhuar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe, patjetër, e menaxhuar në pikëpamjen sociale” (Müller-Armack 1947: 88).

Kjo përfshinte, nga njëra anë, konkurrencë reale, vendosje të çmimeve lirish dhe pronësi private mbi mjetet e prodhimit dhe, nga ana tjetër, drejtësinë sociale përmes sigurimeve shoqërore dhe tatimit progresiv. Roli i shtetit nuk u përcaktua me saktësi.

Në vitet e para të Republikës Federale, ndërhyrjet në treg ishin të kufizuara, për shembull, për të parandaluar monopolet. Nga vitet '70, ndikimi në ekonomi u zgjerua, mes të tjerash, përmes menaxhimit ekonomik.

Kapitalizmi i Rini-t u respektua në mbarë botën, duke qenë se arriti të pajtonte rritjen ekonomike dhe të punësimit me një shtet të zgjeruar të mirëqenies. Po ashtu, edhe vende të tjera evropiane u rrekën ta imitonin këtë model. Edhe Traktati i Lisbonës e përcakton ekonominë sociale të tregut si objektivi të Bashkimit Evropian.

Premtimi i Ludwig Erhard për “mirëqenie për të gjithë” natyrisht që nuk u mbajt për të gjithë, pasi, mes të tjerave, krizat e naftës të viteve '70 dhe ribashkimi shfaqën probleme të reja sociale, veçanërisht në tregun e punës. Megjithatë, u arrit të krijohet një klasë e mesme e gjerë, e cila që vendimtare për stabilizimin e demokracisë së re.

Ndërkohë, popullariteti i idesë çoi në një lloj arbitrariteti. Ashtu si në një test të Rorschach, aty mund të projektohet gati çdo ide.

Programi bazë i DGB-së (Deutscher Gewerkschaftsbund – Konfederata e Unionit të Tregtisë së Gjermanisë) e cilëson ekonominë sociale të tregut si një “përparim të madh historik”. Një nga organizatat e themeluara nga shoqata e punëdhënësve, “Gesamtmetall”, quhet “Nisma e re e ekonomisë sociale të tregut”. Gati çdo prirje politike, për pasojë, anon drejt ekonomisë sociale të tregut, edhe pse, duhet pranuar, me shumë variacione në ekuilibrin midis politikës sociale, rregullimit dhe ekonomisë së tregut.

3.3. Kuadër i ri si pasojë e globalizimit

“Bota është e sheshtë” është titulli i një libri, që u shfaq në vitin 2006. Po çfarë kuptimi ka kjo metaforë? Autori Thomas Friedmann doli me postulatën se, për shkak të globalizimit, ekonomia botërore kishte hyrë në një epokë të re në të cilën konkurrenca globale ishte rritur jashtë mase. Ekonomitë kombëtare mund të vetizolohen vetëm në një shkallë minimale. Fusha e lojës e konkurrencës globale është niveluar – është e sheshtë. Friedmann identifikon një numër faktorësh shtytës të globalizimit:

- Qysh prej viteve ‘50, pengesat tregtare janë rrëzuar me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Përmes marrëveshjeve të Organizatës Botërore Tregtare (OBT) apo paraardhëses së saj GATT (*Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat – shën. i përkthyesit*), janë ulur detyrimet doganore dhe janë hequr kufizimet. Që prej viteve ‘70, kurset e këmbimit midis monedhave kombëtare kanë qenë kryesisht të lira. Brenda zonave rajonale të tregtisë së lirë të Bashkimit Evropian dhe NAFTA-s (ShBA, Kanada dhe Meksikë) janë hequr praktikisht të gjitha kufizimet tregtare. Mercosur në Amerikën Latine dhe ASEAN në Azinë Juglindore aspiron të njëjtën gjë.
- Deri më tani, Evropa, ShBA-ja dhe Japonia kanë qenë forcat mbizotëruese në tregjet botërore, por, aktualisht, me to po konkurrojnë gjithnjë e më shumë vende. Që nga vitet ‘70, Kina ka hapur në mënyrë graduale ekonominë e saj, të izoluar më parë kundrejt tregut botëror dhe ekonomisë së tregut, duke shënuar, për pasojë, një rritje të lartë. Tani, ajo është eksportuesja më e madhe në botë, duke ia kaluar Gjermanisë. Pas pikës së kthesës të vitit 1989, republikat ish-Sovjetike dhe Evropa Lindore përjetuan kalimin e tyre në ekonomi tregu dhe konkurrojnë në tregtinë botërore. Rreth asaj kohe, edhe India nisi të liberalizonte ekonominë e saj që ishte proteksioniste dhe me shumë rregulla të forta dhe është tashmë drejt rrugës për të rivalizuar Kinën sa i takon rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë, në konkurrencën globale kanë hyrë rishtazi më shumë sesa dy miliardë njerëz.
- Novacionet teknike i kanë përshpejtuar këto dy procese të nxitura politikisht. Kostoja e telefonatave ndërkombëtare është ulur në një fraksion të asaj që ishte falë teknologjisë së fibrave optike, duke bërë që qendrat e thirrjeve në Indi të kenë mundësi të marrin thirrje nga ShBA-ja. Falë internetit, poro-

*Globalizimi –
“Bota është e
sheshtë”*

Nxitesit e globalizimit

*1. Shpërbërja e
pengesave tregtare*

*2. Shfaqja e
ekonomive në
zhvillim*

3. Novacioni teknik

sitë mund të përcillen me sekonda nga Hamburgu në Shangai. Programet kompjuterike për një firmë që gjendet në Paris mund të krijohen në Bangalor, Indi. Kontabiliteti mund të zhvendoset në Pragë nga Londra. Logjistika moderne mundëson zinxhirë kompleksë prodhimi, në mënyrë që çdo pjesë individuale të mund të prodhohet dhe montohet në vendndodhje të ndryshme dhe, në përfundim, të shitet në mbarë botën. Kostot e transportit për dërgesat janë ulur dhe udhëtimi me avion nuk është më luks.

Fitimtarët e globalizimit: ekonomitë e dijes

Cilët janë fitimtarët e këtij globalizimi? Ekonomitë e dijes janë ato që përfitojnë më shumë. Me fjalë të tjera, janë vendet me industri që merren me kërkime intensive, për të cilat tregu botëror ofron mundësi të jashtëzakonshme shitjeje. Arsyeja për këtë është se, le të themi, iPod-i që dikur dizenohej – me kosto të lartë – tani mund të prodhohet me njësi relativisht të ulët kostosh dhe shitet me miliona në tregun botëror. Në një treg të kufizuar lokal, kostot e zhvillimit mund të tejkalojnë fitimet e mundshme. Fitimi nga një program kompjuterik, një këngë a film pas prodhimit rritet, sa më i madh të jetë tregu i shitjeve.

Efektet e mallrave industriale me vlerë të lartë

E njëjta gjë vlen edhe për mallrat industriale të nivelit të lartë. Një model i ri automobili, për shembull, mund të ndërtohet për një periudhë afatgjatë nga pesë deri në dhjetë vjet dhe me kosto të lartë. Teknologjitë e reja, si sistemi hibrid i shtytjes, kanë fitime vetëm nëse ka një treg të madh për makinat e prodhuara. Industritë automobilistike në Japoni e Gjermani, të cilat investojnë vlera të mëdha në prodhim, kanë fituar në mënyrë të jashtëzakonshme nga globalizimi. Në përgjithësi, vendet me nivel të lartë arsimit dhe formimit, që janë tërheqëse për studiuesit dhe punonjësit me njohuri krijuese, kanë qenë ato që kanë fituar nga globalizimi.

Efektet mbi mallrat rifuxho

Lidhur me mallrat rifuxho, situata është ndryshe. Le të marrim një fabrikë e cila prodhon bluza, për shembull: kostoja rritet thuhet në të njëjtën masë me numrin e prodhuar. Avantazhet konkurruese që burojnë nga nivelet më të larta të arsimimit/formimit dhe infrastrukturës kanë ndikim më të vogël te mallrat që janë të thjeshta për t'u prodhuar, për të cilat kërkimi dhe zhvillimi luajnë rol të vogël. Si rrjedhojë, prodhimi i mallrave rifuxho gati po zhduket në vendet me paga të larta. Prodhimi i tyre po migron në vende me kosto më të ulëta të prodhimit. Edhe industria tekstile, që dikur ishte nga degët më të mëdha të industrisë në Evropë, është tkurrur tashmë në një numër firmash specifike, si për shembull, veshje stilistësh. Prodhimi në masë është zhvendosur në Indi, Bangladesh dhe Kinë.

Kjo nënkupton që si ekonomitë e dijes, që ofrojnë produkte me kosto të larta zhvillimi apo kontribute krijuese, ashtu edhe ato që prodhojnë mallra rifuxho me çmim të mirë mund të përfitojnë nga globalizmi. Aktualisht, kjo është ajo që ka ndodhur: Gjermania, një “kampion e eksportit botëror” për një kohë të gjatë, eksporton makina të cilësisë së lartë dhe mallra kapitale në mbarë botën. Stilistët italianë dhe francezë dizenojnë veshje luksi për të gjithë botën. Firmat informatike amerikane, Google dhe Microsoft janë po aq të njohura në Kinë e Rusi, sa në vendin e origjinës. Nga ana tjetër, ekonomitë e dijes përfitojnë nga importimi i mallrave më të lira rifuxho: thekëse, geta, mobilje IKEA – me fjalë të tjera, gjithçka që mund të prodhohet në Kinë, Evropën Lindore dhe ekonomitë e tjera me paga të ulëta, janë bërë më të lira në raport me fuqinë blerëse gjatë këtyre dy dekadave të fundit.

Megjithatë, këto zhvillime kanë edhe anën e tyre të errët.

1. Jo të gjithë kanë përfituar njësoj nga globalizmi: shumë nuk kanë përfituar aspak dhe disa thjesht janë lënë jashtë. Punonjësit e një fabrike tekstilësh në Evropë pak i ngushëllon fakti se firma informatike ngjitur ka një regjistër porosish të mbushur përplot, në rast se firma e tyre mbyllet për ta transferuar prodhimin në vende me pagë të ulët. Mirëqenia në përgjithësi është rritur, qoftë në vendet e pasura apo ato në zhvillim. Rritja ekonomike në dy dhjetëvjeçarët e fundit pas viteve '90 në mbarë botën ka qenë më e lartë se kurrë. Vetëm në Kinë, që prej viteve '70, 400 milionë njerëz kanë kapërcyer mbi kufirin e varfërisë absolute, sipas përcaktimit nga OKB-ja, edhe pse një pjesë jo e papërfillshme e gjejnë veten me një punësim të pasigurt. Në të njëjtën kohë, sidoqoftë, shpërndarja e mirëqenies është më e pabarabartë se kurrë. Në vendet në zhvillim, sidomos, por edhe ato të pasura, hendeku i të ardhurave vijon të rritet.
2. Liberalizimi i tregtisë botërore ishte një proces i vështirë, për të cilin u deshën disa dekada. Megjithatë, ky i ashtuquajtur i globalizim “negativ” që çoi në eliminimin e rregullimeve, ndodhi më shpejt sesa proceset e globalizimit “pozitiv”, që përqendrohej te vendosja e standardeve të reja për të cilat kishte lindur nevoja, çka po ecën ngadalë. Për shembull, Protokollin e Kiotos për mbrojtjen e klimës ende nuk është ratifikuar nga të gjitha shtetet, edhe 15 vjet më pas e nuk po respektohet nga të gjitha shtetet që janë zotuar për zbatimin e tij. Standardet sociale globale, si normat e ILO-s (*Standardet Ndërkombëtare të Punës – shën i përkthyesit*) për mbrojtjen e punonjësve,

nuk janë të detyrueshme. Konventat e OKB-së për të drejtat themelore ekonomike e sociale janë të detyrueshme në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare, por nuk kanë asnjë efekt real. Ka ende një rrugë të gjatë përpara që këto të drejta të zbatohen.

A kërkon trysnia e konkurrencës që të ulen standardet shoqërore dhe mjedisore?

Kundërshembulli: Skandinavia

Shqetësimi më i shpeshtë është se globalizimi është “garë për të arritur fundin” kur vjen fjala për standardet më të ulëta shoqërore e mjedisore. Po kjo tezë kundërshtohet nga fakti se vendet me standardet më të larta shoqërore dhe mjedisore janë edhe më konkurrueset. Këtu përfshihen veçanërisht vendet skandinave, me rregullat e tyre shembullore për mjedisin dhe sistemin më të zgjeruar të mirëqenies në botë, që financohet nga taksat e larta. Kështu, kostot e larta nuk janë domosdoshmërisht një dizavantazh konkurrues kur, ashtu si në Finlandë, Suedi, Norvegji dhe Danimarkë, ato çojnë në sisteme të shkëlqyera arsimit dhe formimit dhe kërkimit, në infrastrukturë të shkëlqyer, një administratë efikase të pakorruptuar dhe paqe sociale. Një shtet mirëqenieje me zhvillim të lartë mund të nxitë, mes të tjerash, konkurrueshmërinë e mirëqenien edhe në kontekstin e tregjeve të hapura. E kotë të thuhet që kjo kushtëzohet fort nga një numër faktorësh: nëse vendet nuk ofrojnë më shumë sa i përket cilësisë, krahasuar me kostot që kanë, ato do të jenë të humbura në globalizëm. Së fundi, nuk do të thotë se, ngaqë vendet me standardet më të larta përfitojnë më shumë nga globalizimi, këto standarde do të përhapen automatikisht.

Çfarë do të thotë kjo për socialdemokracinë?

- Kapitalizmi dhe demokracia janë të ndërthurura ngushtë që në zanafillë.
- Kapitalizmi mund të çojë në pabarazi, që minojnë demokracinë. Demokracia sociale duhet të gjejë një përgjigje për këtë.
- Nga këndvështrimi socialdemokrat, kapitalizmi i koordinuar është modeli më i mirë. Ai siguron një rend më të qëndrueshëm ekonomik, me më tepër drejtësi sociale dhe marrëdhënie më afatgjata punësimi, sesa kapitalizmi i pakoordinuar.
- Globalizimi ka sjellë përparim dhe nivel të lartë të dinamizmit ekonomik në mbarë botën, por, po ashtu, ka krijuar çështje të reja sociale.

4. ORIENTIMET E POLITIKËS EKONOMIKE TË DEMOKRACISË SOCIALE

Christian Krell dhe Simon Vaut

Në këtë kapitull

- paraqiten orientimet e politikës ekonomike të demokracisë sociale;
- identifikohen vlerat bazë: liria, drejtësia dhe solidariteti;
- përshkruhen të drejtat themelore për njohjen dhe zbatimin e plotë të të cilave lufton demokracia sociale;
- së fundi, paraqiten parimet e qëndrueshmërisë, barazisë sociale dhe rritjes, që duhet të karakterizojnë politikën ekonomike të socialdemokracisë, nëse është e orientuar drejt vlerave bazë dhe të drejtave themelore.

Me qëllim që të qartësojmë orientimin e politikës ekonomike të demokracisë sociale, do të dalim për një moment nga korniza e ngushtë e politikës ekonomike e do të shqyrtojmë në thellësi vlerat në bazë të të cilave i qaset demokracia sociale shoqërisë në tërësi. Kjo vjen pasi hartimi i politikave, edhe kur ato kanë të bëjnë me fusha të caktuara, si politika ekonomike apo sociale, e mbajnë të gjithë shoqërinë në fushëpamjen e tyre.

4.1. Vlerat bazë

Liria, drejtësia dhe solidariteti këto janë vlerat kryesore bazë të demokracisë sociale. Demokracia sociale përpiqet për një shoqëri ku realizohen këto vlera. Vlerat bazë të demokracisë sociale kanë të njëjtën rëndësi dhe janë të ndërvarura, duke e mbështetur, por edhe duke e kufizuar njëra-tjetrën.

Vlerat bazë të demokracisë sociale dhe zanafilla e tyre përshkruhen dhe shpjegohen me hollësi në botimin, "Bazat e demokracisë sociale". Për këtë arsye, në këtë vëllim do të japim vetëm një përkufizim të shkurtër.

*Liria, drejtësia dhe
solidariteti*

*Liria: një jetë me
vetëvendosje*

- Liria është të jetosh një jetë për të cilën vendos vetë. Kjo, së pari, nënkupton liri nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit ose shoqërisë. Megjithatë, liria reale arrihet vetëm kur janë të pranishme kushtet ekonomike dhe shoqërore që krijojnë mundësinë për ushtrimin e saj.

*Drejtësia:
pjesëmarrje dhe
siguri*

- Drejtësia bazohet në dinjitetin e barabartë të të gjithë njerëzve dhe kërkon jo vetëm barazi përpara ligjit, por edhe mundësi të barabarta sa i takon pjesëmarrjes dhe sigurisë sociale, pavarësisht nga prejardhja familjare, origjina shoqërore, pasuria apo gjinia.

*Solidariteti: të
qëndrosh përkrah
njëri-tjetrit*

- Solidariteti është vullneti i njerëzve për të qëndruar përkrah e për ta ndihmuar njëri-tjetrin. Socialdemokrati Johannes Rau e përshkroi dikur solidaritetin si vinovilin që e mban shoqërinë së bashku.

Rrënjët historike

Historia e këtyre tri vlerave është e jashtëzakonshme. Rrënjët e tyre historike shtrihen tek Iluminizmi dhe kanë lindur si parullë revolucionare. Thirrja për “liri, barazi dhe vëllazëri” karakterizoi revolucionin francez në vitin 1789. Lëvizja punëtore i përsërit këto kërkesa që nga mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë. Në fillimet e themelimit të SPD-së nga Ferdinand Lassalle në vitin 1863, punëtorët e qëndisën në flamujt e tyre “liri, barazi dhe vëllazëri”.

Më në fund, SPD-ja ishte partia e parë që ngrihej mbi vlerat bazë të lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit në programin e saj themelor, Programi i Godesbergut, në vitin 1959. Thuajse dy dekada më vonë (1978), edhe CDU-ja iu drejtua këtyre tri vlerave në programin e saj të parë të themelimit, edhe pse mbështetur në një tjetër kuptim.

Sot, këto vlera bazë nuk janë më kërkesë e një lëvizjeje revolucionare, por janë të pranuar në thelb nga të gjitha rrymat e rëndësishme politike. Pavarësisht kësaj, do të ishte e gabuar po të hamendësonim se ka një konsensus gjithëpartiak mbi këto vlera bazë të “lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit”.

Ende ekzistojnë dallime të rëndësishme në dy nivele midis rrymave politike kur vjen fjala për vlerat bazë.

Lexim i mëtejshëm:

*Tobias Gombert
(2009), Bazat e
Demokracisë Soci-
ale, Librat mbi
Demokracinë Soci-
ale, Vëllimi 1, Berlin,
f. 11–37*

1. Kuptimi i vlerave individuale bazë

Është e qartë që vlerat individuale bazë mund të interpretohen në mënyra të ndryshme. Për shembull, liria nuk nënkupton të njëjtën gjë për të gjithë. Rymat liberale, për shembull, e vendosin theksin te të ashtuquajturat të drejta dhe liri civile, kryesisht të drejtat për mbrojtje nga arbitrariteti i shtetit dhe mbrojtjen e pronës private. Megjithatë, demokracia sociale shkon përtej kësaj, duke theksuar se liria reale varet gjithashtu nga nxitja pozitive e të drejtave dhe lirive civile. Liria reale në këndvështrimin social demokrat, për shembull në raport me lirinë e fjalës, do të thotë se nuk mjafton të përcaktosh të drejtën e lirisë së shprehjes së mendimeve; po kaq rëndësi ka që njerëzit të vendosen në pozitë të tillë – nëpërmjet edukimit e me radhë – që ta shfrytëzojnë efektivisht lirinë e tyre të fjalës.




Figura 5: Të drejtat dhe liritë civile negative e pozitive

2. Marrëdhëniet e ndërsjella të vlerave bazë
Përveç interpretimit të vlerave individuale bazë, është po qaq me rëndësi të merren në konsideratë marrëdhëniet e ndërsjella midis tyre. Ka një dallim të madh nëse vlerat bazë renditen në të njëjtin nivel apo një vlerë e caktuar konsiderohet më domethënëse sesa një tjetër. Kjo mund të ilustruhet me liberalizmin politik (në kuptimin e tij tradicional, jo atë bashkëkohor të ShBA-së): sipas kuptimit liberal të vlerave bazë, liria është në majë. Liria, si ajo e konkurrencës apo liria e pronësisë, priret të marrë më shumë rëndësi sesa vlera e drejtësisë (ose “paanësia”), që mund të kufizojë lirinë e pronësisë. Megjithatë, demokracia sociale nuk i rendit vlerat bazë ndryshe: ajo thekson se ato janë të gjitha në nivel të barabartë.

Është e qartë se, edhe pse të gjithë rrymat e rëndësishme politike në Gjermani u referohen vlerave bazë të lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit, ato shpesh i interpretojnë ato në mënyra shumë të ndryshme.

4.2. Të drejtat themelore

Shqyrtimi se çfarë nënkuptojnë vlerat e përshkruara bazë për orientimin e politikës ekonomike të demokracisë sociale çon në një problem të dyfishtë:

Para së gjithash, vlerat bazë nuk janë të pakundërshtueshme. Rryma të ndryshme politike, por edhe kultura të ndryshme, i lidhin ato me gjëra të ndryshme. Për pasojë, ato nuk përbëjnë një bazë të gjerë e të gjithëpranuar për orientimin e politikës ekonomike.

Së dyti, vlerat bazë funksionojnë në nivel shumë të lartë abstragimi. Nga ana tjetër, çdo përshkrim i orientimeve të politikës ekonomike duhet të jetë konkret. Të vetme, vlerat bazë nuk mjaftojnë për të shërbyer si udhëzime të sakta e konkrete për orientimin e politikës ekonomike.

Vlerat bazë të demokracisë sociale përfaqësojnë kështu një kuadër të rëndësishëm, kur vjen fjala për të përshkruar një politikë ekonomike socialdemokrate. Sidoqoftë, ky kuadër duhet ngritur mbi baza më të gjera e të besueshme dhe të plotësohet me kërkesa të sakta e konkrete.

*Vlerat bazë si themel
i orientimeve të poli-
tikës ekonomike: dy
probleme*

*1. Vlerat
bazë nuk janë të
pakundërshtueshme*

*2. Vlerat bazë janë
shumë abstrakte*

“Mentorët” e demokracisë sociale janë marrë me këtë sfidë tërë kohën. Studiuesi i shkencave politike, Thomas Meyer ka sugjeruar, mes të tjerash, në përgjigje të këtyre sfidave, se demokracia sociale nuk u referohet vetëm vlerave bazë apo elementare por edhe të drejtave themelore. Si pikë kryesore referimi për çdo teori të socialdemokracisë, Meyer përmend të drejtat themelore të sanksionuara në konventat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Kjo është shpjeguar me hollësi në librin ‘*Bazat e demokracisë sociale*’.

Një sërë argumentesh tregojnë se, po kështu, konventat e OKB-së duhen marrë si referim edhe për përcaktimin e orientimeve të politikës ekonomike të demokracisë sociale:

- Konventat e OKB-së janë, në nivel global, burimi më koherent, i detyrueshëm ligjërisht, ndërkulturore dhe ndërvendor për të drejtat themelore e, për rrjedhojë, për bashkëjetesën njerëzore.
- Konventat e OKB-së kanë formuluar të drejta ekonomike shumë konkrete dhe precize për çdo individ.

Kësisoj, këtu do të përshkruajmë të drejtat themelore të parashikuara në konventat e OKB-së dhe do të marrim në konsideratë se ç’kuptim kanë ato për politikën ekonomike në demokracinë sociale dhe sesi dallon demokracia sociale nga rrymat e tjera politike në këtë drejtim. .

Në vitin 1966, Kombet e Bashkuara hartuan dy pakte ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Pakti për të drejtat civile dhe politike (pakti civil) përmend kryesisht të ashtuquajturat të drejta dhe liri civile negative; me fjalë të tjera, të drejtat që mbrojnë nga ndërhyrja e shtetit apo shoqërisë në liritë personale. Këtu përfshihet, për shembull, e drejta për lirinë dhe sigurinë vetjake (Neni 9), e drejta për “të pasur opinione pa ndërhyrje” dhe e drejta për zgjedhje të lira me votim të fshehtë (Neni 29).

Pakti për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (pakti social) përmend kryesisht të drejtat dhe liritë civile pozitive; me fjalë të tjera, duke mundësuar të drejta që kanë për synim të lehtësojnë dhe nxitin lirinë e individit përmes masave që ndërmerren nga shteti dhe shoqëria. Këtu përfshihet, për shembull, e drejta

Pika e referimit: konventat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut

Ndërkulturore dhe ndërvendore

1966: dy pakte të OKB-së

1. Pakti e OKB-së për të drejtat civile dhe politike

2. Pakti i OKB-së për të drejtat sociale

për të punuar (Neni 6), e drejta për kushte pune “të drejta”, të sigurta dhe të shëndetshme (Neni 7), e drejta për formuar lirisht sindikata (Neni 8), e drejta për sigurime shoqërore (Neni 9) dhe e drejta për arsim falas dhe arsim të lartë të hapur në mënyrë të barabartë për të gjithë (Neni 13).

Të drejtat që përmban pakti i OKB-së për të drejtat sociale dhe zbatimin e tyre janë shpesh vite dritë larg

Pakti civil është nënshkruar aktualisht nga 151 shtete dhe pakti social nga 148 shtete. Megjithatë, fakti që paktet janë nënshkruar edhe nga shtete që i shkelin sistematikisht të drejtat dhe liritë civile duhet të na bëjë të ndalemi e të mendojmë. Është e qartë se vlefshmëria formale e pakteve të OKB-së e vetme është e pamjaftueshme për arritjen e “idealit të njerëzve të lirë që gëzojnë lirinë nga frika dhe skamja”, siç përshkruhet në pakte. Shpesh, të drejtat dhe zbatimin e tyre janë vite dritë larg.

Për më tepër, të drejtat e paktit social nuk i detyrojnë shtetet për zbatimin e menjëhershëm të të drejtave themelore, por vetëm të përpiqen për realizimin gradual të këtyre të drejtave. Pakti përshkruan detyrimin që kanë shtetet për të vepruar në mënyrë të tillë që të përmbushen dhe të nxiten të drejtat formale që janë dhënë.

Demokracia sociale: zbatimin e konventave të OKB-së

Socialdemokracia ka si synim zbatimin e të drejtave themelore politike, civile, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të sanksionuara kudo në konventat e OKB-së, në mënyrë të tillë që të mos mbeten vetëm të vlefshme zyrtarisht, por të kenë efekt në praktikë. Demokracia sociale është, në thelb, një program për zbatimin në vazhdimësi të të drejtave e lirive civile pozitive e negative në mbarë botën.

A mund të krahasohen sipas peshës që kanë të drejtat dhe liritë me njëra-tjetrën?

Po a mund të vihen në peshore të drejtat dhe liritë? A kanë ato realisht të njëjtën peshë apo disa janë më të rëndësishme se të tjera? Oskar Lafontaine, për shembull, shkaktoi debat mbi këtë çështje kur gjatë një interviste ngriti pyetjen se sa rëndësi kishte liria e fjalës për viktimat e AIDS-it në Afrikë (Der Tagesspiegel, 15 gusht 2008). Mos do të thotë kjo se të drejtat dhe liritë civile u vijnë në ndihmë vetëm të pasurve të cilët janë në gjendje të shprehen nëpërmjet medias? A përfiton njeri nga liria e shtypit, nëse është aq i varfër saqë nuk mund të përballojë të blejë as edhe një gazetë? Ekonomisti indian, fitues i çmimit “Nobel”, Amartya Sen, ka pohuar se “kurrë nuk ka pasur uri në një vend demokratik me media të lirë” (Sen 1999). Me fjalë të tjera, uria shkaktohet zakonisht nga problemet e shpërndarjes, që do të thotë, nga qasja e pamjaftueshme ndaj artikujve ushqimorë në dispozicion. Një qeveri e cila duhet t’u përgjigjet qytetarëve dhe dëshiron të rizgjidhet nuk mund ta përballojë të shpërfillë abuzimet shoqërore për një kohë

të gjatë, sidomos kur ato janë bërë publike nga media e lirë. Liria, sipas Sen-it, çon, rrjedhimisht, në barazi shoqërore. Ai beson se shteti dhe shoqëria duhet të krijojnë bazën për veprim autonom dhe liri. Kjo do të thotë se liria ekziston vetëm kur ka një nivel minimal të sigurisë shoqërore dhe të ashtuquajtura shërbime me interes të përgjithshëm (për shembull, për shëndetësinë dhe arsimin).

Të drejtat dhe liritë themelore civile dhe shoqërore, pozitive dhe negative janë të ndërvarura dhe nuk mund të vihen përkundër njëra-tjetrës. Willy Brandt e theksoi këtë lidhje edhe në fjalimin e vet të lamtumirës si kryetar i partisë:

“Nëse do të më duhet të them se çfarë ka më shumë rëndësi për mua se gjithçka tjetër përpos paqes, nuk ka “sikur” apo “por”: liria, liria për shumicën jo për një grusht njerëzish; liria e ndërgjegjes dhe mendimit. Po ashtu, liria nga nevoja dhe frika” (Brandt 1987: 32). Ajo çka kishte peshë për Willy Brandt, si rrjedhim, ishte, nga njëra anë, liria nga arbitrariteti dhe shtypja – me fjalë të tjera, të drejtat dhe liritë civile negative – dhe, nga ana tjetër, liria që të fal një jetë materialisht e sigurt – me fjalë të tjera, të drejtat dhe liritë civile pozitive. Demokracia sociale dallon qartë nga demokracia libertariane sa i takon përkrahjes së hapur të zbatimit real të të drejtave themelore në shkallë globale.

Demokracia sociale dhe demokracia libertariane

Demokracia sociale dhe ajo libertariane janë pikësëpari, modele ideale teorike: ato janë të vështira për t’u gjetur në botën reale. Megjithatë, është me rëndësi të përpiqemi të formojmë një panoramë të këtyre modeleve të ndryshme të demokracisë, që gjithsecili të krijojë qëndrimin e vet.

Si demokracia libertariane, ashtu edhe ajo sociale mbështeten në modelin e demokracisë liberale dhe, kësaj, kanë rrënjë të përbashkëta:

- demokraci pluraliste, ku ka shtet të së drejtës;
- pushtet politik që i bindet kushtetutës;
- sovranitet popullor i organizuar mbi bazën e parimit të shumicës demokratike.

Sidoqoftë, ato dallojnë qartë kur vjen fjala te marrëdhënie midis të drejtave dhe lirive pozitive dhe negative. Demokracia libertariane është e mendimit se dhënia e të drejtave dhe lirive pozitive tkurr dhe mundet edhe të shkatërrojë të drejtat dhe liritë civile negative. Nga ana tjetër, demokracia sociale mbështetet mbi supozimin se të drejtat dhe liritë civile pozitive dhe negative duhen konsideruar si të barabarta, nëse duam që të zbatohen formalisht gjithkund dhe të sjellin ndryshim real.

Të drejtat themelore negative dhe pozitive janë të ndërvarura

*Willy Brandt:
“Liri nga frika dhe nga nevoja, gjithashtu”*

Modele të ndryshme të demokracisë...

... me rrënjë të përbashkëta

Vlefshmëria thjesht formale e të drejtave dhe lirive civile nuk është e mjaftueshme

Vlefshmëria thjesht formale e të drejtave dhe lirive civile, siç propozon demokracia libertariane, nuk është e mjaftueshme nga pikëpamja socialdemokrate, pasi pabarazitë ekonomike mund të çojnë në (shih Meyer 2005b: 15):

- marrëdhënie varësie dhe nënshtrimi;
- kushte pune çnjerëzore;
- mundësi të pabarabarta për të ushtruar të drejtat politike qytetare.

Shembulli i lirisë së fjalës

Le të marrim shembullin e shprehjes së mendimit. Nga pikëpamja libertariane, mjafton që shteti të mos bëjë asgjë për të kufizuar lirinë e fjalës: për shembull, frenimi për të mos censuruar shtypin. Nga pikëpamja e demokracisë sociale, sidoqoftë, shteti duhet të hedhë hapa vendimtare të mëtejshme dhe të nxitë në mënyrë aktive mundësitë reale dhe të barabarta për shprehjen e opinionëve. Këtu përfshihet qasja e barabartë në informacion dhe marrja e një arsimimi që të jep mbi të gjitha mundësinë të krijosh opinionë. Më tej, të drejtat e pronësisë së atyre që drejtojnë mediat masive duhet të jenë të formuara në mënyrë të tillë, që ata të mos e përdorin pushtetin e mediave të tyre për t'u imponuar këndvështrimet e tyre të tjerëve. Ky keqpërdorim shkel detyrimet sociale që lidhen me pronësinë private, e cila është karakteristikë e rëndësishme e demokracisë sociale. Nga pikëpamja libertariane, kjo ndërhyrje në pronësi është e pakonceptueshme.

Objektivat e ndryshme të demokracisë sociale dhe demokracisë libertariane

Pavarësisht rrënjëve të përbashkëta, demokracia sociale dhe demokracia libertariane mbështeten mbi supozime të ndryshme që çojnë në objektiva shumë të ndryshme në raport me rendin ekonomik.

Konsolidimi shoqëror i tregjeve është i nevojshëm

Dallime themelore ka, për shembull, në mënyrën si e kuptojnë tregun. Demokracia libertariane e kupton tregun si shprehje të lirisë dhe, për rrjedhojë, lufton për një treg që vetërregullohet. Demokracia sociale, në të kundërt, e vendos theksin te fakti se tregjet që janë plotësisht të lira mund të çojnë në rezultate që janë të padëshiruara për shoqërinë në tërësi. Kriza e tregut financiar e vitit 2008 është një prej shembujve të kësaj. Për këtë arsye, demokracia sociale bën thirrje për konsolidimin shoqëror të tregjeve me anë të kuadreve të imponuara politikisht dhe politikave rregullatore të shtetit.

Qartësisht, demokracia sociale dhe ajo libertariane, edhe pse në historikun e tyre kanë pika të ngjashme referimi te demokracia liberale, kanë dallime të dukshme nga njëra-tjetra, sidomos sa i takon politikës ekonomike.




Figura 6: Krahasimi i demokracisë liberale, libertariane dhe sociale (përfshi në aspektin ekonomik)

Ideja socialdemokrate e tregut shprehet edhe në Programin e Hamburgut të SPD-së:

“Sipas nesh, tregjet janë një formë e nevojshme e bashkërendimit ekonomik që ka epërsi ndaj çdo alternative. Megjithatë, tregjeve që u lihet liri e plotë janë të verbra në aspektin shoqëror e mjedisor. Ato nuk janë në gjendje që, të vetme, t’i ofrojnë publikut mallra me sasi të mjaftueshme. Që tregjet të përmbushin potencialin e tyre, ato kanë nevojë për rregullim nga shteti, i cili është në gjendje të zbatojë sanksione, ligje efektive dhe çmime të drejta.” (Programi i Hamburgut 2007: 17)

4.3. Parimet e ekonomisë politike

Tri parime

Konkretisht, çfarë nënkuptojnë vlerat bazë dhe të drejtat themelore për politikën ekonomike socialdemokrate?

Pikëpamja e parashtruar këtu është se një politikë socialdemokrate që dëshiron të përmbushë vlerat e saj bazë dhe të zbatojë të drejtat themelore në botën reale, duhet t'u referohet këtyre tri parimeve:

- rritja
- drejtësia sociale
- qëndrueshmëria

Rritja, drejtësia sociale dhe qëndrueshmëria

Nga këndvështrimi demokracisë sociale, këto tri parime duhet të vlerësohen në të njëjtën mënyrë kur bëhet fjalë për politikën ekonomike. Kjo është ajo çka e dallon demokracinë sociale nga konservatorët, libertarianët dhe populistët e krahut të majtë, të cilët përqendrohen vetëm te njëri prej këtyre parimeve. Vetëm nëse këtyre parimeve u jepet i njëjti vend, do të ketë rritje cilësore e, për pasojë, përparim të qëndrueshëm, i cili sheh nga e mira e përbashkët.

Të gjitha masat e politikës ekonomike mund vlerësohen në bazë të faktit nëse u kanë dhënë hakun njësoj këtyre parimeve. Kështu, këto parime përbëjnë kriteret e një politike ekonomike socialdemokrate.




Figura 7: Trekëndëshi i parimeve të politikës ekonomike socialdemokrate

Rritja

Sipas formulimit të pakteve të OKB-së, njerëzit duhet të jetojnë “të lirë nga nevoja dhe frika”. Konkretisht, kjo nënkupton “zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor dhe punësim të plotë e produktiv”. Liria nga nevoja nënkupton mbështetjen materiale bazë. Për këtë qëllim, vendi ka nevojë për një Prodhim Kombëtar Bruto (PKB), i cili siguron nivelin minimal të mirëqenies, duke i dhënë gjithkujt mundësinë të ushtrijë të drejtat e tij. Nga njëra anë, kjo ka të bëjë me pasurinë individuale dhe, nga ana tjetër, me mirëqenien e shoqërisë së tërë, pasi duhet të ketë burime të mjaftueshme në dispozicion për detyrat e përcaktuara publike.

Për një shoqëri të lirë dhe të drejtë, bazuar në solidaritet duhet mirëqenie. Kjo mirëqenie duhet arritur dhe siguruar para së gjithash nga rritja ekonomike. Vetëm duke pasur prodhimtari të lartë dhe krijim vlere, mund të krijohet hapësira për mirëqenie individuale dhe shoqërore. Historikisht, është e qartë se, kur ekonomitë kombëtare rriten në mënyrë të qëndrueshme, shpërndarja e produktit kombëtar priret të jetë më e drejtë sesa gjatë periudhave të krizës ekonomike. Kështu, rritja është kusht për realizimin e vlerave dhe synimeve të demokracisë sociale të paraqitura në këtë vëllim.

Rritja ekonomike : Një rritje e produktit të brendshëm bruto (PBB); me fjalë të tjera, rritja e vlerës së tregut të të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një ekonomi kombëtare. Supozimi i përgjithshëm është se ka përherë rritje, qoftë ajo e një lloji apo një tjetri. Për shembull, stanjacioni njihet si “rritja zero”, ndërsa, nëse bie prodhimi, kjo konsiderohet si rritje negative. Megjithatë, nëse çmimet rriten, të paktën në rastin e rritjes nominale ekonomike, kjo shihet si pozitive. Në kundërshtim me këtë, në rastin e rritjes reale, përjashtohet rritja e çmimeve. (Wirtschaftslexikon 2009)

*Pakti social i OKB-së,
“Liria nga frika dhe
nevoja»*

*Një nivel minimal
rritjeje është para-
kusht për një shoqëri
të drejtë e të lirë,
bazuar në solidaritet*

Çfarë nënkupton
"rritja"?

1967, Ligji për stabilitetin dhe rritjen:
"rritje konstante dhe
e mjaftueshme"

1972, "Kufizimet e
Rritjes": kritika e përqendrimit tek rritja

Po çfarë do të thotë "rritje"? Mënyra sesi socialdemokratët e konceptojnë llojin e duhur të rritjes ka ndryshuar gjatë dekadave të fundit.

Në vitin 1967, nën patronazhin e ministrit socialdemokrat për Çështjet Ekonomike dhe, më vonë, ministër i Financave, Karl Schiller, "rritja e vazhdueshme dhe e mjaftueshme ekonomike" u përcaktua si objektivi themelor politik në ligjin "Për stabilitetin dhe rritjen". Politika ekonomike pati si objektiva edhe papunësinë e ulët, inflacionin e ulët dhe ekuilibrin e tregtisë së jashtme, duke formuar të ashtuquajturin "katërkëndëshi magjik". Po ashtu, detyra e shtetit është të ekuilibrojë luhatjet ekonomike dhe të parandalojnë krizat, në përputhje me teorinë kejnësiane.

Mes të tjerave, studimi me ndikim, The Limits of Growth (Kufizimet e rritjes), që doli në vitin 1972, shtoi ndërgjegjësimin se rritja përfshin edhe konsumin e lëndëve të para dhe dëmtimin e mjedisit. Si rezultat, pati debate intensive mbi çështjen nëse rritja është e dëshirueshme ose e mundur në një periudhë afatgjatë.

"Rritja" në Programin e Hamburgut:

"Pasuria dhe cilësia e lartë e jetës kanë qenë përherë përparësi në politikën ekonomike socialdemokrate. Në të shkuarën, progresi kuptohej kryesisht si rritje sasiore. Në ditët e sotme, ndryshimi i shpejtë i klimës, mbingarkesa e ekosistemeve dhe rritja e popullsisë botërore na detyron t'i japim zhvillimit një drejtim të ri, që sheh nga e ardhmja. Nga kjo varet nëse zhvillimi do të jetë edhe përparim. Ne duam përparim të qëndrueshëm, një ekonomi dinamike, drejtësi sociale dhe përgjegjësi mjedisore në unison. Kjo kërkon rritje cilësore kombinuar me shfrytëzim të ulët të burimeve. Njerëzit duhet të kenë mundësinë ta fitojnë jetesën me anë të punës së denjë, pa shfrytëzim. Çdo njeri duhet të marrë pjesën që i takon nga pasuria e krijuar".
(Programi i Hamburgut 2007: 42)

Ndërkohë, u miratua një koncept më kompleks rritjeje, që kërkon të kombinojë novacionin teknologjik, përtëritjen mjedisore dhe kohezionin social. Në këtë kontekst, në vitin 2000, nën udhëheqjen e drejtuesve të qeverive socialdemokrate, u miratua Strategjia e Lisbonës, objektivi i së cilës ishte që, brenda 10 viteve, ta bënte Evropën zonën ekonomike më konkurruese dhe dinamike në botë.

Për rrjedhojë, përkufizimi i rritjes ka qenë vazhdimisht në ndryshim. Euforia e rritjes në vitet '60 u ndoq nga qëndrimi kritik i viteve '70. Ndërkohë, një këndvështrim më i nënkuptuar është shfaqur, bazuar mbi konceptin cilësor të rritjes, i cili ka të bëjë me nxitjen e përparimit shoqëror, mes të tjerave, përmes konsumit të ulët të burimeve. Kjo pikëpamje më komplekse bën të mundur vendosjen në ekuilibër të rritjes, qëndrueshmërisë dhe barazisë sociale

Barazia sociale

Barazia sociale, sipas socialdemokratëve, është domosdoshmëri si parim i politikës ekonomike. Po kështu, kjo ka logjikë edhe ekonomikisht.

Nëse vlerat bazë dhe të drejtat themelore të socialdemokracisë merren seriozisht, duhet ndjekur një politikë ekonomike që karakterizohet nga barazia sociale. Nuk janë vetëm vlerat bazë të drejtësisë, lirisë dhe solidaritetit që e kërkojnë këtë, por edhe të drejtat themelore të hartuara në paktet e OKB-së. Për shembull, kërkohet një "standard i mjaftueshëm jetese", por edhe që grave t'u "garantohen kushte pune që nuk janë më poshtë sesa ato që gëzojnë burrat, me pagë të barabartë për punë të barabartë"; që të sigurohen "ushqim, veshmbathje dhe strehim i mjaftueshëm"; që të ketë "të drejtë për t'u arsimuar" dhe që, për rrjedhojë, të garantohet "zhvillimi i plotë i personalitetit njerëzor".

Demokracia sociale lufton për një shoqëri që bazohet në qytetarinë sociale, në të cilën çdo personi i garantohet një jetë që përmbush dinjitetin e tij/saj njerëzor, siguruar nga mbështetja e nevojshme materiale, me qëllim që t'u jepet mundësia të marrin pjesë në jetën sociale dhe demokratike, pavarësisht suksesit në kuptimin e tregut. Rritja ekonomike, kështu, është kusht i nevojshëm nga këndvështrimi socialdemokrat, por jo qëllim në vetvete dhe duhet të marrë në konsideratë barazinë dhe drejtësinë sociale. Të ardhurat

*2000, Strategjia e
Lisbonës: Koncepti
kompleks i rritjes*

*Koncepti i rritjes
cilësore që merr
parasysh konsumin e
burimeve dhe përparimin social*

*Pakti social i OKB-
së: "standardi i mjaftueshëm i jetesës"*

nga ekonomia dinamike dhe produktive duhet të shpërndahen në mënyrë të drejtë. Kjo do t'u siguronte njerëzve mundësinë për të jetuar me punë të denjë, pa u shqetësuar për të ardhmen e tyre dhe për të marrë pjesën që u takon nga rritja e prodhimit kombëtar.

Barazia sociale e sanksionuar në Kushtetutën gjermane

Në Gjermani, barazia sociale në rendin ekonomik sanksionohet edhe në Nenin 19 të Kushtetutës, që e përcakton Republikën Federale të Gjermanisë si "shtet federal social". Më tej, Neni 14 parashikon detyrimet sociale që burojnë nga prona private: "Nga prona burojnë detyrime. Shfrytëzimi i saj i shërben edhe së mirës publike."

Detyrimet sociale të pronës private: shembuj

Pronarët e ndërtesave të banimit, për shembull, nuk mund të abuzojnë me to si objekte për të spekuluar, por duhet t'i mirëmbajnë dhe t'i japin me qira. Menaxherët kanë përgjegjësi jo vetëm për dividendët e aksionarëve, por edhe për shoqërinë në tërësi, për shembull, duke ruajtur vendet e punës dhe duke mbrojtur mjedisin. Çdokush që përfton një pjesë veçanërisht të madhe nga pasuria e shoqërisë duhet, nga ana tjetër, të bëjë shumë për shoqërinë. Detyrimet sociale të pronës përbëjnë një tipar thelbësor të demokracisë sociale.

A ka kundërshti midis barazisë sociale dhe parimit të meritës?

Po a nuk bie barazia sociale ndesh me parimin e meritës së ekonomisë së tregut? A nuk e pengon barazia sociale funksionimin e stimujve, që janë të rëndësishëm për një ekonomi dhe rritje dinamike? Këto pyetje trajtojnë përplasjet reale midis orientimit të rritjes dhe barazisë sociale.

Rodrik: Krijimi i vlerës kërkon barazi sociale!

Sidoqoftë, është e kundërta: zhvillimi i produktivitetit dhe rritjes ka gjithnjë nevojë për një bazë sociale. Për të krijuar vlerë, duhet një minimum barazie sociale. Ekonomisti amerikan Rodrik, për shembull, ka vërtetuar se shtetet që arrijnë një nivel të lartë sigurie sociale janë edhe shtetet e suksesshme ekonomikisht. Mes të tjerave, kjo është rezultat i faktit që siguria sociale rrit motivimin personal. Njerëzit që përfitojnë nga mbrojtja sociale janë më të gatshëm të përballen me ndryshimin, të ndërmarrin rreziqe dhe të sjellin risi (shih Rodrik 1997: p.178).

Edhe kritikët e pranojnë se shteti i mirëqenies nxit produktivitetin

Kjo është një lidhje që zor se ha diskutim. Edhe Hans-Werner Sinn, sot president i Institutit për Studime Ekonomike (ISE) në Mynih, theksoi në vitin 1985, në leksionin e tij përurues në Ludwig-Maximilian-Universität, se: "[solidari-

teti] u jep të rinjve sigurinë dhe vetëbesimin që iu duhet për të përfituar nga mundësitë e rrezikshme, por premtuese. Në këtë pikë, nuk jam i bindur që pikëpamja e përhapur se shteti i mirëqenies është shumë i kushtueshëm për ne, është e saktë. Përkundrazi, unë e konsideroj jashtëzakonisht të mundshme, pasi ishte vetëm shteti i mirëqenies ai që e bëri të mundur çlirimin e fuqive prodhuese në nivel të tillë sa të çonin në ngritjen ekonomike gjatë periudhës së pasluftës” (Sinn 1986: 566–77).

Për rrjedhojë, demokracia sociale lufton për të arritur ekuilibrin midis orientimit drejt rritjes dhe barazisë sociale. Një shembull konkret është modeli suedez. Në studimin e vendeve të caktuara në Kapitullin 6, është e qartë se një nga arsyt e suksesit të konsiderueshëm ekonomik të Suedisë ka qenë shkalla e lartë e barazisë sociale atje.

“Barazia sociale” në Programin e Hamburgut:

“Të ardhurat dhe prona nuk janë të shpërndara në mënyrë të drejtë në Gjermani. Synimi i politikës tati-more socialdemokrate është të ulë pabarazinë dhe të nxitë shanset e barabarta. Ne mbështesim rritjen e pagave, që lidhet me rritjen e prodhimtarisë dhe inflacionin. Ne duam të shohim më shumë prona në duart e punëtorëve. Pjesëmarrja e punëtorëve në kapitalin e ndërmarrjes, si burim të shtesë të ardhurash, siguron që punonjësit të kenë një pjesë më të drejtë në suksesin e firmës. Ajo nxit edhe novacionin dhe produktivitetin.”
(Programi i Hamburgut 2007: 43f)

Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria është parimi i tretë kyç i politikës ekonomike socialdemokrate. Qëndrueshmëria përfshin një dimension mjedisor, ekonomik dhe shoqëror.

Çështjet mjedisore janë shpesh të lidhura me qëndrueshmërinë. Në fakt, reflektimet e para rreth qëndrueshmërisë lindën nga vlerësimet mjedisore. Koncepti i “qëndrueshmërisë” e ka zanafillën nga shkencat e pylltarisë: nuk duhen prerë nga pylli më shumë pemë sesa mund të rriten, deklaroi në she-

Ekilibri midis orientimit të rritjes dhe barazisë sociale

Koncepti i “qëndrueshmërisë” e ka zanafillën nga pylltaria

kullin e tetëmbëdhjetë specialisti i bujqësisë dhe autori i shkrimeve mbi pyjet, Georg Ludwig Hartig. Sot, qëndrueshmëria mjedisore nënkupton që, për aq sa është e mundur, mjedisi të ruhet i paprekur, si një bazë e domosdoshme jetese për brezat e ardhshëm. Konservimi i burimeve, mbrojtja e klimës, mbrojtja e specieve dhe kufizimi i ndotjes mjedisore janë, për rrjedhojë, aspekte kyçe. Të drejtat themelore të parashikuara në paktin social të Kombeve të Bashkuara theksojnë gjithashtu, duke iu referuar përmirësimit të të gjitha "aspekteve të higjienës ... mjedisore« (Neni 12), që, para së gjithash, duhen ruajtur burimet natyrore të jetesës për të gjithë, jo vetëm sepse, në të kundërt, brezat që vijnë do të jenë të privuar nga kushtet bazë të ekzistencës, por edhe sepse aktualisht njerëzit kanë nevojë për ujë të pijshëm të pastër dhe ajër të shëndetshëm.

Socialdemokratët theksuan rëndësinë e qëndrueshmërisë qysh në një fazë të hershme.

1983, Komisioni
Brundtland

Në vitin 1983, ideja e qëndrueshmërisë u rimor nga Komisioni Brundtland (i quajtur kështu sipas emrit të ish-Kryeministrit norvegjez), që u ngrit nga Kombet e Bashkuara. Ai deklaroi se:

"Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që përmbush nevojat e së tashmes, pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshme për të përmbushur nevojat e tyre" (cituar në Hauff 1987: 46).

Përmasa ekonomike
e qëndrueshmërisë

Përveç përmasës mjedisore, koncepti i "qëndrueshmërisë" ka edhe një përmasë ekonomike. Raporti përfundimtar i paraqitur nga një komision hetimor i Bundestagut gjerman për "Konceptin e qëndrueshmërisë - nga modeli në zbatim" në vitin 1998, deklaronte se qëndrueshmëri ekonomike do të thotë që krijimi i pasurisë të jetë i mundur edhe për brezat e ardhshëm, me qëllim që të ruhet ekonomia sociale e tregut. Për këtë qëllim, shpenzimet publike – veçanërisht, në shtetin e mirëqenies– duhet të financohen fuqimisht dhe duhet të ketë një investim afatgjatë në arsim, kërkim dhe infrastrukturë.

Shembull
paralajmërues

Rëndësia e qëndrueshmërisë ekonomike është e dukshme, sidomos përballë krizës financiare globale. Kërkimi i fitimit afatshkurtër, që nuk merr parasysh qëndrueshmërinë, jo vetëm rrezikon kompanitë individuale, por edhe mund të destabilizojë ekonomi të tëra.

“Qëndrueshmëria” në Programin e Hamburgut të SPD-së::

“Parimi i qëndrueshmërisë nënkupton: të mendosh duke parë nga e ardhmja, duke i rezistuar qoftë mbizotërimin të gjërave afatshkurtra, ashtu edhe dominimit të motiveve ekonomike dhe logjikës së biznesit. Kjo do të thotë ta konceptosh politikën në këndvështrimin e shoqërisë dhe t’i kuptosh larminë demokratike, qëndrueshmërinë mjedisore, integrimin shoqëror dhe pjesëmarrjen kulturore si parime udhëheqëse të politikës socialdemokrate”.

(Programi i Hamburgut 2007: 17f).

Sidoqoftë, qëndrueshmëria ka edhe një përmasë sociale: qëndrueshmëri sociale do të thotë pjesëmarrje e përhershme e të gjithë anëtarëve të shoqërisë dhe pajtimi i tensioneve sociale që zgjat në kohë. Me fjalë të tjera, sigurimi i qëndrueshëm i nevojave bazë dhe pjesëmarrja sociale.

Programi i Hamburgut: „Qëndrueshmëri do të thotë: të mendosh duke parë nga e ardhmja”

Rritja cilësore – zbatimi i tri parimeve në të njëjtën shkallë

Rritja, barazia sociale dhe qëndrueshmëria: synimi i politikës ekonomike socialdemokrate është t’i zbatojë këto tri parime mbi baza të barabarta. Po a është e mundur kjo? A nuk i kufizon barazia sociale mundësitë e rritjes në një shoqëri? A nuk ka nevojë rritja në fund të fundit për lëndë të para, duke sjellë kështu uljen e qëndrueshmërisë? Duket sikur midis tri parimeve ka kundërshti. Si mund të zbatohen ato mbi baza të barabarta?

Willy Brandt e trajtoi këtë çështje qysh në vitin 1973, kur foli për parimet e rritjes dhe qëndrueshmërisë:

“As individi, as shoqëria nuk mund të jetojnë në kurriz të natyrës. Në këtë mënyrë, zhvillimi i mjedisit tonë do të bjerë ndesh me mirëqenien e njeriut. ... Ndotja e zhurmës, ajrit dhe ujit aktualisht vënë në pikëpyetje përfitimet e rritjes ekonomike. Megjithatë, do t’ju paralajmëroja të mos zgjidhni rrugën e shkurtër intelektuale në kërkim të rrugëdaljes, për shembull, me një ulje e përgjithshme e rritjes dhe prodhimit. Kjo është shumë më tepër çështje se ku, si dhe për çfarë qëllimi shërben rritja ekonomike dhe të kuptosh se rritja dhe parimet ekonomike duhet të jenë në shërbim të njerëzimit. Që “rrethanat” të mos na dre-

A ka fërkime midis këtyre tri parimeve?

Willy Brandt mbi marrëdhënien midis rritjes dhe qëndrueshmërisë

jtojnë, por t'i drejtojmë ne ato, duhet ta mendojmë më thellë këtë çështje dhe, së paku, hera herës, të punojmë ca më fort «

(Willy Brandt, fjalimi me rastin e marrjes së detyrës, 18 janar 1973).

*Pyetjet kryesore:
rritje ku, si dhe për
çfarë qëllimi?*

Ajo çka thoshte Brandt ishte se nuk mund të ketë një përkrahje pa kushte të parimit të rritjes. Ne duhet të marrim gjithnjë në konsideratë me kujdes se ku, si dhe për çfarë qëllimi do të prodhohet rritja. Interesave të kujt do t'u shërbejë dhe kush do të përfitojë prej saj? Për këtë arsye, socialdemokratët duhet të heqin dorë solemnisht nga çdo koncept i rritjes së verbër në funksion të rritjes cilësore, e cila merr në konsideratë në kushte të barabarta si barazinë sociale ashtu edhe qëndrueshmërinë.

Nëse, në frymën e Willy Brandt, e shohim më nga afër çështjen, duket qartë se, edhe pse ka disa kundërshtimi midis tri parimeve, ato janë edhe të ndërvarura dhe mbështetin njëra-tjetrën. Tashmë është bërë e qartë se barazia sociale është kusht për një ekonomi dinamike. Po ashtu, qëndrueshmëria mjedisore mund të nxitë rritjen. Në Gjermani, degët e industrisë që u kushtohen energjive të ripërtëritshme janë nga motorët më të rëndësishëm të rritjes ekonomike dhe garantojnë një numër të madh vendesh pune. Në Kapitullin 7 në shembullin praktik të politikës industriale mjedisore përshkruhet një lidhje e ngjashme.

Për rrjedhojë, duket se, edhe pse kërkesa për të trajtuar tri parimet e rritjes, barazisë sociale dhe qëndrueshmërisë në nivel të barabartë është një sfidë e madhe, ajo paraqet një mundësi po aq të madhe.

Pasojat që rrjedhin nga tri parimet duhet të rishikohen dhe rinegociohen në mënyrë të vazhdueshme. Këtu, nuk ka të vërteta absolute, por, nëse këto parime trajtohen njësoj, ato çojnë në një rritje ekonomike nga e cila përfiton e gjithë shoqëria.

*Qëndrueshmëria
mund të nxitë rritjen.*

*Shembull: politika
industriale mjedisore
(Kapitulli 7)*

Nga kombinimi i rritjes me barazinë sociale dhe qëndrueshmërinë buron rritja cilësore

“Rritja cilësore” në Programin e Hamburgut të SPD-së :

“Ne po punojmë drejt përparimit të qëndrueshëm, duke bërë bashkë dinamizmin ekonomik, drejtësinë sociale dhe logjikën mjedisore. Me anë të rritjes cilësore, duam të mundim varfërinë dhe shfrytëzimin, të krijojmë mundësi për mirëqenie e punë të denjë për të gjithë dhe të bëjmë diçka për ndryshimin e klimës që na kanoset. Po ashtu, është me rëndësi të garantojmë bazat natyrore të jetës për brezat e ardhshëm dhe të përmirësojmë cilësinë e jetës. Për këtë qëllim, ne duam të vëmë në shërbim të njerëzimit mundësitë që krijon përparimi në shkencë e teknologji “
(Programi i Hamburgut 2007: 5).

4.4. Excursus: matja e rritjes cilësore

Si mund të shprehet numerikisht përparimi ekonomik? Treguesi që përdoret më shpesh për të cilësuar zhvillimin ekonomik është Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB). PBB-ja është vlera e përgjithshme e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend brenda një viti të dhënë. Nëse PBB-ja rritet, njerëzit flasin për rritje ekonomike; kur mbetet në vend apo edhe tkurret, flitet për krizë. Rëndësia e PBB-së nuk ka sesi të mohohet: buxhetet publike, ulja e papunësisë dhe mirëqenia e shoqërisë varen të gjitha nga rritja ekonomike.

Megjithatë, PBB-ja ka edhe një numër anësh të padukshme, kur vjen fjala për matjen e përparimit ekonomik. Nga pikëpamja socialdemokrate, sidomos, panorama që krijohet nga përqendrimi vetëm te PBB-ja është e paplotë, pasi vetëm sa arrin të përshkruajë sa është prodhuar gjithsej, por nuk thotë asgjë lidhur me çështjet në vijim:

- Si shpërndahet PBB-ja? A është e drejtë shpërndarja? A i merr shumicën e burimeve një pakicë njerëzish? Cilat janë kriteret e shpërndarjes? Nevoja, rendimenti apo klasa shoqërore?
- Sa i qëndrueshëm është prodhimi nga ana mjedisore? A ka burime të investuara për mbrojtjen e mjedisit apo rritja përftohet në kurriz të shfrytëzimit të tepruar të natyrës?
- Si prodhohet rritja dhe ku shkojnë të ardhurat? A ndodh ajo duke rritur për një kohë të shkurtër borxhin familjar dhe publik apo ka investime në infrastrukturë, arsim dhe kërkim, në mënyrë që të krijohet mundësia për rritje afatgjatë?
- Si vlerësohen aktivitetet jomonetare? A rritet PBB-ja vetëm se bëhet më shumë punë? Nëse puna vullnetare apo në familje konvertohet në punësim fitimprurës, pse rritet PBB-ja, kur, në fakt, prodhohet e njëjta gjë?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet zhvilluar një koncept më kompleks i përparimit ekonomik dhe një koncept më i diferencuar i rritjes, që shkon përtej pyetjes sesa prodhon ekonomia gjithsej.

*Përparimi ekonomik
= PBB-në?*

*Anët e padukshme
të PBB-së*

1. Shpërndarja

2. Mjedisi

3. Qëndrueshmëria

4. Puna e papaguar

*Koncepti i rritjes së
diferencuar.*

Lexime të

mëtejshme :

Michael Dauderstädt (2007), Soziale Produktivität oder Umverteilung? Herausforderungen für eine Politik der neuen Wertschöpfung, Berliner Republik 3/2007. Hagen Krämer (2009), Wen beglückt das BIP?, Wiso direkt, Friedrich-Ebert-Stiftung (ed.), Bon.

Koncepti tradicional i rritjes

- Performanca e përgjithshme ekonomike

Koncepti i zgjeruar i rritjes

- Performanca e përgjithshme ekonomike
- Barazia sociale
- Zhvillimi i qëndrueshëm

Ka një numër qasjesh që rreken ta shprehin rritjen në mënyrë më gjithëpërfshirëse. Një prej tyre është ajo e ekonomistit të Bankës Botërore dhe fitues i çmimit alternativ “Nobel”, Herman E. Daly (Daly/Cobb 1989; Daly 1996), i cili ka luajtur rol në hartimin e një metode përlllogaritjeje të progresit real, që është Treguesi i Progresit Real (GPI). Kjo metodë e furnizon PBB-në me faktorë që synojnë të përshkruajnë kostot dhe përfitimet reale të veprimtarisë ekonomike (Lawn 2003). Faktorët që e përbëjnë këtë tregues përfshijnë, përveç PBB-së, shpërndarjen sociale të të ardhurave, punën e papaguar dhe vullnetare, rritjet në arsim, krim, kohën për argëtim, konsumin e burimeve, dëmtimin e mjedisit dhe investime në infrastrukturën publike. Sigurisht që përlllogaritja e GPI-së dhe e treguesve të ngjashëm është mjaft e ndërlikuar dhe detajet specifike të përbërjes dhe vlerësimit hanë debat. Megjithatë, pavarësisht kritikave të justifikuara, kjo përlllogaritje jep një kontribut të rëndësishëm në gjetjen e dobësive të metodave të zakonshme përlllogaritëse, përfshi atë të PBB-së.

OJQ-ja “Redefining Progress” (Ripërkufizimi i progresit – shën. i përkthyesit) boton rregullisht në adresën www.progress.org GPI-në për vendet e OECD-së. Nga kjo është e qartë se përparimi i matur nga GPI-ja mund të jetë shumë më i vogël seç mund të na bëjë të besojmë rritja e PBB-së. Mbi të gjitha, përfshirja e dëmit mjedisor dhe padrejtësisë sociale tregon madje se, në disa vende, GPI-ja po shënon rënie.

Përpjekjet për gjetjen e alternativave ndaj PBB-së vazhdojnë. Presidenti francez, Nicolas Sarkozy krijoi një komitet ekspertësh të nivelit të lartë për hartimin e treguesve që marrin parasysh vlerësime të cilat lidhen me cilësinë e jetesës, përparimin shoqëror e mjedisor. Qëllimi është që qeveria të marrë parasysh rezultatet e komitetit në fjalë në veprimtaritë e saj në të ardhmen.

5. KRAHASIMI I PROGRAMEVE EKONOMIKE TË PARTIVE POLITIKE

Tobias Gombert

Në këtë kapitull

- paraqiten dhe krahasohen programet e pesë partive politike të përfaqësuar në Bundestag;
- analizohen objektivat e tyre, mbështetur në modelin e ekonomive të koordinuara dhe të pakoordinuara;
- kategorizohen partitë sipas qëndrimit të tyre ndaj rritjes cilësore, siç parashikohet nga socialdemokratët.

Cila parti konsiderohet përgjithësisht më kompetente sa i takon politikës ekonomike? Cila parti mund të zgjidhë më mirë problemet e tregut të punës? Cila parti ka idetë më të mira për politikën sociale? Këto janë pyetje që ngrihen në çdo analizë që zhvillon media natën e zgjedhjeve (të përgjithshme). Po të flasim në përgjithësi, besohet se partitë e qendrës së djathtë zotërojnë aftësi më të mëdha për ekonominë, ndërsa e majta përgjithësisht mendohet se është më e aftë në raport me politikën sociale. Ky identifikim themelor i partive mbetet relativisht i pandryshuar dhe dokumenton një orientim të përgjithshëm në vlerësimin e partive politike. Po a është i saktë? Përgjigjja është, edhe po, edhe jo.

Klasifikimi pasqyron deri diku parimet udhëheqëse përkatëse ose fokusin kryesor të partive. Natyrisht, pyetjet janë edhe disi çorientuese: ato nuk përcaktojnë kompetencën për politikën ekonomisë dhe sociale, as nuk i ndërlidhin këto dy kompetenca. Megjithatë, një model politike ekonomike nuk kufizohet te zbatimi i kësaj politike në kuptimin e ngushtë, por duhet të merret shumë më gjerësisht me integrimin e saj me politikën sociale dhe fushat e tjera të politikave. Politika ekonomike është politikë sociale – një ekonomi funksionale është gjithnjë e ngulitur në sistemin shoqëror dhe kjo nuk duhet harruar. Për këtë arsye, kur shqyrtojmë programin e politikës ekonomike të një partie, duhet doemos të shohim programin e saj të përgjithshëm e, më pas, të shpjegojmë rolin që do të luajë ekonomia në kuadrin e sistemit ekonomik të synuar.

Në këtë kuptim, na vjen sërish në ndihmë pamja e busullës: duhet përshkruar jo vetëm ekonomia e synuar, por edhe pikënisja e një drejtimit të caktuar (ashtu si në kapitujt paraardhës).

Vërtet, palët kanë dallime të qarta sa u përket analizave të tyre për çështjet e ditës dhe ideve sesi duhet të jenë gjërat, siç mund të kuptohet prej programeve të tyre përkatëse. Në vijim do të paraqesim aspektet e politikës ekonomike të programeve partiake sipas kategorive të përdorura për të përshkruar ekonomitë e koordinuara dhe të pakoordinuara⁸.

5.1. Programi i Hamburgut - Programi bazë i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë

Në vitin 2007, Partia Socialdemokrate e Gjermanisë (SPD) miratoi të ashtuquajturin Program i Hamburgut, që është më i fundit në radhën e gjatë të programeve politike. Thelbi i ideve të politikës së tij ekonomike ka mbetur i njëjtë, me ndryshime të pakta qysh nga Programi i Godesberg-ut në vitin 1959: “Motoja jonë është: konkurrencë sa më shumë të jetë e mundur dhe rregullim nga shteti aq sa të jetë e nevojshme” (f. 43).

Në këtë mënyrë, ideja në themel të tij është para së gjithash një ekonomi tregu e koordinuar, edhe pse nuk i sheh shtetin dhe tregun në të njëjtin nivel: politika ka epërsi. Sidoqoftë, kjo politikë ekonomike hedh qartësisht supozimin se “rregullimi nga shteti” duhet të jetë aq sa është “i nevojshëm”: me fjalë të tjera, ndërhyrja politike duhet të jetë “e domosdoshme”. Po a është i nevojshëm një “shtet rregullator”?

Nevoja dhe kufizimet e një shteti rregullator bazohen mbi dy konsiderata kyçe: së pari, shqyrtohen mangësitë e një shteti të parregulluar ose të rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme; së dyti, objektivat për të cilat punon socialdemokra-

⁸ Kategoritë e paraqitura më lart do të jepen të përmbledhura në këtë kontekst: kategoria “marrëdhëniet midis ndërmarrjeve” është rrallë e pranishme në programet e partive e, për pasojë, nuk do të trajtohet këtu.

cia (f. 16), që mund të garantohen vetëm nga një shoqëri aktive dhe demokratike me një shtet rregullator. Defektet dhe objektivat, që ofrojnë një vështrim të përgjithshëm, përvijojnë hendeqet dhe detyrën e politikës sociale që SPD-ja i ka ngarkuar vetes me programin e saj.

Programi i Hamburgut rendit në mënyrë koncize jo vetëm vlerat, por edhe mangësitë e tregut: “Për ne, tregu është një mjet i nevojshëm i cili ka epërsi ndaj formave të tjera të bashkërendimit ekonomik. Megjithatë, nëse lihet i lirë, ai është i verbër qoftë nga pikëpamja shoqërore, ashtu edhe ajo mjedisore. Ai nuk është i aftë të ofrojë vetvetiu të mira publike në nivel të mjaftueshëm” (f. 17). Në këtë mënyrë përgjegjësia shoqërore, ekonomike e mjedisore nuk arrin të përmbushet përmes tregut, por vetëm nëpërmjet orientimit shoqëror e politik. Veçanërisht, tregu nuk i zgjidh pasojat e tregut të globalizuar, hendekut global midis varfërisë dhe pasurisë dhe krizës, por më shumë i përkeqëson. Rregullimi dhe dialogu social e kontrolli janë kërkesa urgjente që vlera ekonomike e krijuar të jetë në dobi të të gjithëve.

“Socialdemokracia mbetet për ne vizioni i një shoqërie të mbështetur në solidaritet, realizimi i së cilës është detyra jonë e përhershme. Parimi i veprimit tonë është demokracia sociale” (f. 16f). Kështu, çështjeve aktuale u shtohet një objektivi, që orientohet për nga vlerat bazë dhe vlefshmëria e tyre si dhe dobia e tyre absolute për të gjithë njerëzit, jo vetëm në Gjermani, por në mbarë botën. Ky objektivi mbështetet nga idetë mbi zhvillimin: objektivi nuk mund të arrihet me vendim nga shteti, por vetëm nëse aktorët shtetërorë dhe të shoqërisë civile punojnë së bashku: “Duke qenë mbështetës të këtij objektivi, këmbëngulim te epërsia e politikës demokratike dhe refuzojmë nënshkrimin e politikës, që nuk duhet të kufizohet te shteti, por të përfshijë edhe aleancat e rrjetet e shoqërisë civile, si dhe aksionin e lirë dhe të pavarur të njerëzve” (f. 17).

Objektivi: “Barazia”

“Ne duam një pjesëmarrje të drejtë dhe të barabartë të grave dhe burrave në punësimin fitimprurës, që përmbush nevojat e tyre. Puna që bëhet kryesisht nga gratë shpesh është më e keqpaguar. Për punë me vlerë të barabartë duhet të ketë pagë të barabartë. ... Për këtë duhen masa ligjore për pjesëmarrjen e barabartë të grave në pozicionet drejtuese në ndërmarrje, administratë, shkencë dhe fushën kërkimore, si edhe në bordet mbi-këqyrëse”

(Programi i Hamburgut 2007: 41).

Në veçanti, globalizmi, barazia gjinore dhe rëndësia në rritje e BE-së përmenden si sfidat e politikës ekonomike moderne. Në dritën e mangësive të lartpërmendura të tregut dhe objektivave të partisë, duhet zhvilluar më tej forma e koordinuar e tregut.

Sistemi financiar: Një kapitull më vete në Programin e Hamburgut i kushtohet ndikimit të kapitalit dhe tregjeve financiare. Ai pasqyron rëndësinë në rritje që ka për shoqërinë financimi dhe kontrolli i ndërmarrjeve (edhe në Gjermani): “Ne duam të shfrytëzojmë potencialin e tregjeve kapitale për rritje cilësore” (f. 46–47). Megjithatë, këtu merren parasysh edhe dizavantazhed dhe rreziqet në rritje që sjellin krizat: “Kur tregjet financiare rreken të krijojnë vetëm fitime afatshkurtra, ato vënë në rrezik strategjitë e rritjes afatgjatë të ndërmarrjeve dhe, kështu, shkatërrojnë vendet e punës. Me anë të ligjit për shoqëritë tregtare, ne duam të forcojmë pozitën e investuesve që synojnë ndërmarrjen e një angazhimi afatgjatë, në vend të fitimeve të shpejta. Na duhen rregulla për investuesit dhe fonde që nuk do të lejojnë ndjekjen e fitimit të njëanshëm në kurriz të funksionimit afatgjatë të ndërmarrjeve. Me rritjen e integritimit ndërkombëtar të tregjeve financiare dhe të artikujve, rregullimi i tyre ndërkombëtar është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm” (f. 47). Përveç kësaj, për shkak të orientimit të tyre afatgjatë drejt qëndrueshmërisë, duhen ruajtur bankat e kursimeve dhe bankat kooperative: ato luajnë rol thelbësor për ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe, po ashtu, mund të jenë faktor kyç në ekonominë lokale.

Marrëdhëniet e punës: SPD-ja e konsideron veten pjesë të traditës së lëvizjes punëtore. Për rrjedhojë, ajo përqendrohet te zbatimi dhe përmirësimi i të drejtave të punëtorëve. Për këtë qëllim, duhen ruajtur normat rregullatore aktuale të rendit ekonomik bazë: negociatat e lira dhe kontratat e përgjithshme kolektive duhet të mbeten të tilla. Nuk duhet të ketë një zhvendosje të vendimmarrjes

Objektivi : “Bashkëvendimmarrja”

“Në rast se nja nga shtetet nuk është më i aftë t’u ofrojë tregjeve kuadre rregullative të përshtatshme sociale dhe mjedisore, atëherë, këtë duhet ta bëjë Bashkimi Evropian. ... Kur veprimtaria ekonomike i kapërcen kufijtë, të drejtat e punonjësve nuk duhet të pushojnë së zbatuari në ata kufij. Për rrjedhojë, ne duam të garantojmë e rritim bashkëvendimmarrjen në kompanitë evropiane. Që marrëveshjet kolektive të forcohen e zbatohen lirish, ne përkrahim një bazë ligjore evropiane për negociimet dhe kontratat kolektive ndërkufitare” (Programi i Hamburgut 2007: 26, 28 f.

nga partnerët në marrëveshje të ndërmarrjet. Pagat minimale duhet të jenë në themel të marrëveshjeve të lira kolektive. Ndërmarrjet duhet të zbatojnë parimin e “demokracisë së brendshme të kompanisë”: bashkëvendimmarrja përmes këshillave të punës dhe pjesëmarrja në bordet mbikëqyrëse duhen forcuar. Në programin e Hamburgut u përfshinë dy aspekte të reja që ka të ngjarë të ndikojnë në favor të punëmarrësve në marrëdhëniet e punës, drejtpërdrejt dhe tërthorazi: pjesëmarrja financiare e punonjësve duhet rritur përmes fondeve të industrisë. Po ashtu, përfitimi i papunësisë duhet këmbyer në sigurim punësimi, që do të mbështeste financiarisht formimin/arsimimin dhe periudhat që u kushtohen përgjegjësive familjare, duke kontribuar kështu në forcimin e pozitës së punëmarrësve kundrejt punëdhënësve në marrëdhëniet e punës.

Formimi profesional dhe sistemi i formimit të vazhduar: Sistemi i dyfishtë i formimit, që ka, nga njëra anë, komponentin e vet në klasë për të cilin është përgjegjës shteti, dhe, nga ana tjetër, komponentin e vendit të punës, duhet ruajtur. Megjithatë, për formimin profesional duhet një sistem financimi bazuar në solidaritet. Është e qartë që kjo shkon përtej aleancës ekzistuese që synon krijimin e më shumë hapësirave për formim. Niveli i parë duhet të mbetet ose të kthehet sërish falas. Arsimit dhe formimit të mëtejshëm, si shtyllë e tretë e formimit profesional, duhet t’i jepet përparësi e lartë.

Politika industriale: Sektorët që si shteti, ashtu edhe shoqëria duhet t’i promovojnë me përparësi janë tregjet e reja pararojë (për shembull, sektorët e energjisë së ripërtëritshme, shërbimeve dhe shëndetësisë, por edhe artizanati lokal). Investimi në infrastrukturën publike qëndron në krye si detyrë thelbësore.

Në përgjithësi, Programi i Hamburgut bën thirrje për një politikë ekonomike që orientohet kah rritja cilësore: barazia sociale, qëndrueshmëria mjedisore dhe rritja duhen nxitur njësoj të gjitha.

5.2. Parimet për Gjermaninë – Programi i CDU-së⁹

Edhe CDU-ja paraqiti një program të ri partiak në vitin 2007. Në thelb, ajo e sheh ekonominë sociale të tregut si model të suksesshëm edhe për të ardhmen: “CDU-ja është partia e ekonomisë sociale të tregut ... CDU-ja refuzon formën socialiste dhe çdo formë tjetër kolektivizmi. Kjo vlen gjithashtu edhe për kapitalizmin e shfrenuar, që mbështetet vetëm te tregu dhe nuk ka asnjë përgjigje për problemet sociale të kohës së sotme. Ekonomia sociale e tregut mbetet modeli ynë në Gjermaninë e ribashkuar dhe në epokën e globalizimit” (f. 46).

Refuzimi i “kolektivizmit” gjen vend edhe në modelin e “sipërmarrjes”, që është thelbi dhe baza e ekonomisë sociale të tregut: “CDU-ja është e përkushtuar ndaj sipërmarrjes liberale me përgjegjësi sociale. Ajo përfshin sipërmarrësit dhe drejtuesit e kompanive që janë të aftë të krijojnë vende pune që i rezistojnë së ardhmes, identiteti kulturor dhe emri i të cilëve ndihmon në përvijimin e pozitës së Gjermanisë një botë. Për të pasur sukses, sipërmarrësit kanë nevojë për liri dhe kushtet e stimulit e duhur” (f. 49).

Duket qartë tashmë se ideja qendrore është krejt ndryshe nga ajo e SPD-së, si në objektiva, ashtu edhe në metoda: sipërmarrje e lirë e me përgjegjësi sociale dhe thirrje për përgjegjësi morale dhe shoqërore nga CDU-ja – rregullim dhe bashkëpunim demokratik për realizimin e të drejtave themelore të njerëzve nga SPD-ja. CDU-ja ka prirjen të mbështetet te ndjenja e përgjegjësisë e sipërmarrësve individualë, për të parë përgjegjësinë sociale ndaj shoqërisë dhe punonjësve.

Kësisoj, për CDU-në, roli i politikës është dukshëm më i vogël: “Ekonomia sociale e tregut është rend konkurrues. Politika në ekonominë sociale të tregut është ‘*Ordnungspolitik*’¹⁰ (f. 49). Detyrat e shtetit, për rrjedhojë, janë të sigurojë lirinë e tregtisë dhe kontraktimit, mbrojtjen nga pengesat e tregut dhe mbrojtjen nga shpërdorimi i pushtetit nga kompanitë mbizotëruese, si dhe transparencën e tregut dhe hapjen ndërkombëtare të tregjeve në bazë të kushteve të ndershme të konkurrencës” (shih f. 49 dhe 52).

9 Christlich Demokratische Union Deutschlands – Unioni Kristiandemokrat

10 Parimi bazë i “*Ordnungspolitik*” është se “shteti supozohet të krijojë një kuadër rregullator brenda të cilit forcat e tregut duhet të ndërveprojnë dhe të shpalosin dinamizmin e tyre në kushte konkurruese” (Hans Tietmeyer, fjala me rastin e marrjes së Çmimit Special 1997 i Forumit gjermano-britanik në Londër, më 15/12/97).

Roli i shtetit në lidhje me ekonominë e tregut është i orientuar drejt tipareve kryesore të një koncepti liberal, edhe pse përmban disa komponentë rregullatorë.

Sistemi financiar: Rëndësia në rritje e tregjeve ndërkombëtare financiare dhe të kapitalit vlerësohet pozitivisht dhe theksi vendoset te mundësitë për investime në Gjermani: “Fondet në kërkim të mundësive të investimit, si fondet private të kapitalit, mund të ndihmojnë edhe kompanitë në Gjermani që të bëhen më konkurruese dhe novatore” (p. 52). Rreziku qëndron kryesisht te fuqia tregtare e grupeve private të investimit. Sipas CDU-së, mbështetja tek organizatat ekzistuese ndërkombëtare është e mjaftueshme për të ofruar një “kuadër rregullator të besueshëm” dhe transparencë (shih f. 52).

Marrëdhëniet e punës: Qasja e CDU-së ndaj marrëdhënieve të punës buron prej etikës sociale të krishterë (f. 50). Ajo i referohet potencialit individual për zhvillim: “Ndërmarrjet kanë nevojë për punonjës të mirarsimuar, krijues e të motivuar për të pasur sukses. Punëmarrësit kanë nevojë për mundësi pjesëmarrjeje, përgjegjësi e liri, që i bëjnë të aftë të zhvillojnë plotësisht e me sukses aftësitë e tyre. Arsimi dhe formimi sigurojnë cilësitë e punësimit dhe produktivitetin e tyre. Po ashtu, që të mund të planifikojnë jetët e tyre, punëmarrësve u duhen garanci bazë për punësim dhe sigurime shoqërore. Ata kanë të drejtë të marrin pjesën që u takon nga mirëqenia sociale” (f. 50). Mbrojtja kolektive dhe organizimi kolektiv i marrëdhënieve të punës konsiderohet me rëndësi kritike. Për shembull, edhe pse vazhdojnë negociimet kolektive, palëve negociuese u bëhet thirrje të lëvizin nga kontrata të ngurta kolektive të sektorit dhe “t’u lënë një pjesë të madhe të përgjegjësisë kompanive individuale” (f. 58). Nëpërmjet “aleancave të ndërmarrjeve për vende pune”, të mundësuar nga ligji, rregulloret e ndërmarrjeve duhet të vihen në zbatim në lidhje me këto kontrata kolektive. Kjo do të ishte thujse një revolucion në legjisllacionin e punës dhe është tashmë objekt i debateve të forta midis ekspertëve ligjorë. Bashkëvendimmarrja kërkohet, por më shumë për forcimin në nivel ndërmarrjeje në raport me kontratën kolektive.

Sistemi i formimit profesional dhe formimit të vazhduar: CDU-ja përkrah gjithashtu sistemin e dyfishtë të formimit profesional, pasi është “avantazh lokal në raport me konkurrencën ndërkombëtare dhe parandaluesi më i mirë ndaj papunësisë të rinjtë” (f. 38). Si punonjësit privatë, edhe ata publikë kanë kërkuar vënien në dispozicion të më shumë vendeve për formimin profesional, edhe pse mbështetur në një “ndjenjë përgjegjësie dhe te stimuj të synuar”, jo

si rezultat i detyrimit nga shteti (f. 39). Institucionet e arsimit të lartë duhet të vendosin “tarifat studimi të përgjegjshme nga pikëpamja sociale”.

5.3. “E ardhmja është e gjelbër” Programi themelor i Bündnis 90¹¹

Aleanca 90/Të gjelbrit e paraqitën programin e tyre të partisë që në vitin 2002. Deri më tani është programi më i gjatë partiak që krahasojmë këtu. Çështja kryesore është shndërrimi i shoqërisë në një ekonomi tregu sociale dhe mjedisore dhe ecja drejt epokës së burimeve diellore. Shfrytëzimi i tepruar i burimeve mjedisore konsiderohet problemi themelor për të ardhmen. Megjithatë, transformimi i kërkuar paraqitet si një projekt, që nuk përmban vetëm kushte dhe pasoja mjedisore, por edhe sociale.

Lidhur me politikën sociale, Aleanca 90/Të gjelbrit duan të dallohen nga partitë e tjera me idetë e tyre liberale, por jo liberale të tregut: “Ekonomia sociale ekzistuese e tregut, që është tejet e orientuar nga fitimi i ndërmarrjeve, nuk i ka përmbushur pritshmëritë dhe duhet transformuar në mënyrë urgjente. Shqetësimet sociale nuk mund të reduktohen thjesht si çështje që i takojnë vetëm shtetit. Pa liri për të gjitha grupet sociale, pa vetëvendosje për qytetarët, pa subvencionim, solidariteti social ngurtësohet në burokraci. Ajo që duhet, sipas nesh, është mbështetja e shoqërisë civile nga burimet e shtetit, duke e kufizuar njëkohësisht këtë të fundit. Kjo na dallon nga modelet politike shtetërore socialiste, konservatore dhe liberale të tregut” (f. 43). Për rrjedhojë, Aleanca 90/Të gjelbrit bëjnë thirrje për një “kuadër rregullator qeveritar”, që garanton interesat mjedisore, sociale dhe kulturore (f. 46).

Sistemi financiar: Aleanca 90/Të gjelbrit janë shumë kritikë ndaj sistemit financiar në formën e tij aktuale. Ajo çka duhet, sipas tyre, është të zhbëhet pushteti që kanë “aktorët dominues globalë”: “Nga njëra anë, për këtë duhet një kuadër i përgjegjshëm demokratik dhe, nga ana tjetër, informim dhe edukim mjedisor, stimuj ekonomikë për zhvillimin e teknologjive dhe produkteve miqë-

11 Aleanca 90/Të gjelbrit

sore për mjedisin, si dhe marrëveshje me industrinë” (f. 27). Për rrjedhojë, ata i dhanë rëndësi të posaçme konsolidimit të tregjeve: “Hendeku midis globalizimit ekonomik dhe kontrollit të mangët politik dhe konsolidimi të këtij procesi duhet mbyllur. Bashkimi Evropian është qasja më me ndikim, e konceptuar deri më sot, për krijimin e një përgjegjësie të përbashkët mes shteteve që, për këtë qëllim, kanë hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre. BE-ja duhet të heqë dorë nga fiksimi i saj neoliberal në politikën ekonomike dhe të luajë një rol më aktiv ndërkombëtar në formësimin social e mjedisor të globalizimit” (f. 17). Kjo shtrihet edhe tek ekonomia globale: është nevoja për zhvillim të mëtejshëm të institucioneve ndërkombëtare dhe miratimin e rregullave dhe standardeve minimale të detyrueshme për transaksionet financiare (f. 59). Roli i “bankave të brendshme” dhe bankave të kursimeve, që kanë rëndësi të veçantë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nuk përmenden nga Aleanca 90/Të gjelbrit – në kundërshtim me SPD-në – pavarësisht nga fakti se nxitja e ekonomive rajonale është një nga çështjet e tyre kryesore (f. 54).

Marrëdhëniet e punës: Pikënisja për Aleancën 90/Të gjelbrit në raport me marrëdhëniet e punës është që “sa më shumë njerëz të jetë e mundur duhet të jenë të aftë të funksionojnë si aktorë të ndërgjegjshëm në jetën ekonomike” (f. 47). Që kjo të mund të arrihet, theksi duhet vënë te negociimet e lira kolektive dhe partnerët e fortë negociues, si dhe te këshillat e fortë të punës. Njëkohësisht, “dallimi në rritje midis zhvillimit ekonomik dhe strukturës ekonomike [kërkon] zgjidhje për negociime kolektive rajonale dhe sektoriale” (f. 48), edhe pse kontratat e përgjithshme kolektive konsiderohen të rëndësishme. Është e qartë që kjo nënkupton kontrata kolektive kuadër dhe, në plotësim të tyre, kontrata kolektive më elastike dhe individuale rajonale e sipas sektorëve. Aleanca 90/Të gjelbrit janë po ashtu përkrahës të “pjesëmarrjes së popullit në pasurinë prodhuese” (f. 131). Ata e lënë qëllimisht të hapur nëse kjo përfshin marrëveshjet e kompanive apo fondet midis kompanive. Po ashtu, ata kërkojnë që bashkëpronësia dhe bashkëvendimmarrja të diskutohen së bashku dhe që bashkëvendimmarrja në fabrikë dhe kompani “t’u përshtatet kërkesave dhe nevojave shoqërore që ndryshojnë” (p. 131). Teksti nuk bën të ditur se cilat mund të jenë këto nevoja dhe kërkesa.

Formimi profesional dhe formimi i vazhduar: Lidhur me formimin profesional, sipas Aleancës 90/ Të gjelbërve, është jetike që çdo njeri të ketë mundësi, në një shoqëri të mësimit, t’i japë formë individualisht karrierën së tij/saj të arsimit/formimit (f. 99). Vëmendja këtu është te një periudhë më e shkurtër e arsi-

mit fillestar dhe shoqërimi me formim profesional të vazhduar: një lloj sistemi modular (f. 99). Për këtë arsye, që të jetë i qëndrueshëm, arsimi fillestar duhet të përqendrohet te “kualifikimet bazë (profesionale dhe ndërdisiplinore) (f. 100). Kompanitë do të jenë përgjegjëse për vënien në dispozicion të trajnimeve më specifike që lidhen me praktikën konkrete të përditshme në firmë. Krahasuar me SPD-në dhe CDU-në, këtyre ideve iu mungon formulimi preciz: diskutimi nëse sistemi i dyfishtë i formimit profesional duhet mbajtur dhe nëse firmat duhet të vazhdojnë të jenë përgjegjëse si financiarisht ashtu edhe, bashkë me shkollat profesionale, për përmbajtjen e programit të studimeve, mbetet i hapur. Një tjetër çështje e hapur është nëse duhen, dhe si duhen, organizuar financiarisht dhe nga ana organizative mundësitë e të nxëniet gjatë gjithë jetës: përmenden vetëm palët në kontratat kolektive dhe fakti se duhet të ketë një “ekuilibër midis burimeve private dhe publike” (f. 103).

Në përgjithësi, Aleanca 90/Të gjelbrit paraqesin një program të orientuar drejt qëndrueshmërisë. Sa u takon marrëdhënieve midis shtetit dhe ekonomisë, me fjalë të tjera, sa i takon pyetjes se si duhet të duket një ekonomi e koordinuar tregu, programi shfaqet si një hibrid i qasjeve liberale (për shembull, një kuadër rregullator, por edhe pjesëmarrja individuale në sistemin e formimit) dhe qasjeve socialdemokrate. Mbetet për t’u parë nëse ky është një model logjik shoqërie.

5.4. “Parimet e Visbadenit” të FDP-së¹²

Nga pesë partitë e përfaqësuara në Bundestag, programi i FDP-së është më i vjetri: “Parimet e Visbadenit”, të vitit 1997. FDP-ja vlerëson se “propozimi i saj unik për të fituar” është përkushtimi ndaj liberalizmit (ekonomik): “FDP-ja, si parti e liberalizmit të organizuar, dallon nga të gjitha partitë e tjera që rreken të sjellin përparim duke i besuar shtetit dhe ndërhyrjes nga shteti, falë orientimit të saj drejt arsyes, pluralizmit dhe konkurrencës” (f. 6). Kështu, roli i shtetit është kritika qendrore dhe pikënisja politike për FDP-në: “ekonomia shtetërore burokratike” (f. 14) pengon, si rrjedhojë e “kalcifikimeve burokratike”, shpalsjen

12 Freie Demokratische Partei – Partia e Lirë Demokratike

e lirë dhe në mënyrë elastike të ekonomisë dhe shoqërisë: “Liberalët, në vend të ekonomisë shtetërore me qëllimet më të mira sociale dhe mjedisore, duan një ekonomi tregu me rezultatet më të mira sociale dhe mjedisore” (f. 6). Rruga e vërtetë, sipas liberalëve, është, së pari, të sigurojë efikasitet ekonomik, duke hequr ndërhyrjen nga shteti dhe kartelet e grupeve të fuqishme të interesit, në mënyrë që të arrihet “efikasiteti social” (shih f. 14). Kjo pasqyrohet edhe në kërkesën për të përfshirë një dispozitë mbi privatizimin në Kushtetutë, që do të sanksiononte përparësinë e sektorit privat, së paku, për ato detyra që mund t’i përmbushë me të njëjtin efikasitet (f. 30). FDP-ja shpall si modelin e saj “ekonominë sociale dhe mjedisore të tregut”. Megjithatë, ajo e përkufizon këtë mjaft ndryshe nga CDU-ja dhe Aleanca 90/Të gjelbrit.

Sistemi financiar: Sistemi financiar dhe i kapitalit duhet të jetë i lirë. Kjo formulë e shkurtër përmbledh në mënyrë të përsosur qëndrimin e FDP-së. “Në përputhje me kërkesat e tregut” do të thotë se një Bashkim Evropian i fortë duhet të ruajë konkurrueshmërinë. Për liberalët, në vitin 1997, kjo nënkuptonte: “në vend të pronësisë nga njerëzit, liberalët duan një popull pronarësh. Mundësitë për të pasur pronë motivojnë punën, krijojnë siguri shoqërore dhe përhapin një ndjenjë përgjegjësie. Ky është parakushti i një kulture të re risku dhe një kulture të re pavarësie vetjake” (f. 15). Nga këtu dalim në përfundimin se duhen rritur sa më shumë të jetë e mundur kapacitetet vetëfinancuese të sipërmarrësve përmes pronës private, por edhe nëpërmjet tregut të kapitalit dhe heqjes të “pengesave për konkurrencë”. Shtetit ka vetëm detyrë rregullatore: “duhet një monedhë e përbashkët e qëndrueshme evropiane, që t’i bëjë ekonomitë gjermane dhe evropiane më konkurruese në nivel ndërkombëtar. Bashkimi monetar plotëson tregun e përbashkët” (f. 25). Pika kryesore ku përqendrohet FDP-ja është krijimi i kushteve të mira për investuesit dhe, rrjedhimisht, nxitja dëshirës së njerëzve për të investuar.

Marrëdhëniet e punës: FDP-ja përmbledh në formë lakonike idetë e saj për ndryshim në fushën e marrëdhënieve të punës, si vijon: “Punonjësit duhet të bëhen bashkësipërmarrës” (f. 14). Për këtë qëllim, duhet rritur në mënyrë të konsiderueshme niveli i pronësisë mbi pasuritë prodhuese. Nga ana tjetër, FDP-ja është kritike kur bëhet fjalë për “bashkëvendimmarrjen përmes zyrtarëve”. Programi i partisë nuk është i qartë nëse kjo pasqyron dëshirën për të hequr, kufizuar apo thjesht plotësuar bashkëvendimmarrjen kolektive përmes këshillave të punës dhe pjesëmarrjes së punëtorëve në bordet mbikëqyrëse. Edhe

lidhur me kërkesën për pjesëmarrjen e punëtorëve në pasuritë prodhuese, mbetet e hapur sesi do të organizohen mundësitë e punëmarrësve për të ushtruar ndikim mbi vendimmarrjen në ndërmarrje apo fabrikë. Megjithatë, koncepti i bashkësipërmarrësve të pavarur nënkupton përfshirjen e “kontratave individuale”. Kontratat e përgjithshme kolektive (f.14), nga ana tjetër, refuzohen qartësisht, ndërkohë që do të parashikohen dispozita të përgjithshme hyrëse (me ligj?), që i lënë kompanitë të lira ta organizojnë pjesëmarrjen e punonjësve në formën që dëshirojnë. Nuk mund të fshihet fakti që propozimet e FDP-së, edhe pse vetëm sa i kemi cekur, kërkojnë një revolucion në legjislacionin e punës në Gjermani. Dispozitat (ligjore) hyrëse rrezikojnë vetë themelet e negociatave të lira kolektive. Trajtimi me përparësi i marrëveshjeve me ndërmarrjet çon në përmbysjen e piramidës ekzistuese ligjore, e cila u jep përparësi ligjeve dhe kontratave kolektive kundrejt kontratave individuale dhe me kompanitë dhe të ashtuquajturit “parim i favorizimit” (“gjen zbatim rregull që favorizon më shumë punonjësit”). Ende mbetet e paqartë se si mund të kontrollohet një rritje kaq e madhe e pushtetit të ndërmarrjeve.

Formimi profesional dhe formimi i vazhduar: Pohimet e FDP-së lidhur me formimin profesional dhe formimin e vazhduar janë kryesisht me natyrë të përgjithshme. Edhe këtu, kryefjala janë “hapja dhe konkurrenca”. Duhet shmangur “ngurtësimet dhe kontrollet e rrepta” dhe duhet nxitur ose lejuar oferta private (shih f. 24). Për pjesën tjetër, theksohet vetëm se është e nevojshme “përshtatja në mënyrë elastike dhe zhvillimi i mëtejshëm i kualifikimeve profesionale në të gjitha fushat” (f. 14).

Përgjithësisht, programi i FDP-së përbën një thirrje për një ekonomi tregu të pakoordinuar. Gati të gjitha problemet i vishen shtetit dhe praktikave të ngurta burokratike; gati çdo problem mund të zgjidhet duke i dhënë më shumë liri tregut. Liria përkufizohet si çlirim nga “laku” (i shtetit). Në radikalizmin e vet liberal, ky program nuk lë shumë për të dëshiruar.

5.5. “Pikat kryesore programore” të “Die Linke”

Die Linke (E Majta), partia që u krijua nga bashkimi i PDS-së (Partei des Demokratischen Sozialismus – Partia e Socializmit Demokratik) dhe WAGS (Arbeit & soziale Gerechtigkeit-Die Wahlalternative – Punë dhe Drejtësi Sociale – Alternativa zgjedhore), ende nuk ka prodhuar një program të mirëfilltë partiak. Sidoqoftë, ekziston një “dokument programor themelimi”, që në mars të vitit 2007 u miratua nga kongresi i përbashkët i partisë së WASG-së dhe “Linkspartei.PDS” dhe, zyrtarisht (në përputhje me ligjin për partitë politike) përfaqëson programin e partisë. Duhet thënë se përmbajtja e këtij “dokumenti programor themelimi” nuk është koherente e përfshin thjesht një mori synimesh të përsëritura. Komiteti Programor i partisë e paraqiti projektprogramin e ri të partisë për herë të parë, në mars 2010.

Qëllimi kryesor i *Die Linke-s* është të zbatojë një alternativë ndaj “kapitalizmit të shfrenuar”, që është, konkretisht, një “përtëritje e mbështetur në parimet e solidaritetit dhe një strukturim i vazhdueshëm demokratik i shoqërisë” (f. 1): “demokracia, liria, barazia, drejtësia, ndërkombëtarizmi dhe solidariteti janë orientimet tona themelore në vlera ... Liria dhe siguria sociale, demokracia dhe socializmi kushtëzohen nga njëra-tjetra” (f. 2). Për këtë arsye, duhen shfrytëzuar dispozitat kushtetuese që parashikojnë mundësinë e shpronësimit nga shteti të fushave kryesore të ekonomisë, me qëllim që të krijohet një “ekonomi efikase dhe demokratike”, e cila ndërtohet mbi pronën private dhe publike (f. 3).

Die Linke pretendon se është për një ndryshim gjithëpërfshirës të politikave dhe pikëpamjeve. Sa larg duhet të shkojë ky “ndryshim” është e vështirë të kuptohet nga dokumenti themeltar dhe mbetet për t’u parë se në ç’krah politik do të pozicionohet.

Sistemi financiar: Funksionimi i tregjeve ndërkombëtare financiare dhe të kapitalit shihet nga Die Linke si faktori themelor që shkakton kriza dhe pabarazi në shoqërinë e sotme: “përmes tregjeve financiare globale, pritshmëritë për përfitime nga kapitali mund të përhapen në mbarë botën dhe pa asnjë kufizim ... Pasja e një prodhimi fleksibël dhe një treg pune i përshtatur me nevojat e kapitalit shkatërron familjen dhe jetën shoqërore. ... Kapitalizmi neoliberal nënkupton

zhdemokratizimin. Është përqendruar një pushtet i pamatë në fondet ndërkombëtare financiare, grupet transnacionale dhe organizatat mbikombëtare (supranational) të kapitalizmit global: Organizata Botërore e Tregtisë, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe kështu me radhë. Ato nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli demokratik” (f. 5). Sipas Die Linke-s, sistemi financiar duhet ristrukturuar. Për ta bërë këtë, ata kërkojnë, nga njëra anë, “kontroll demokratik mbi tregjet financiare” dhe, nga ana tjetër, “decentralizimin e pushtetit ekonomik privat”, duke forcuar, mes të tjerave, legjislacionin antitrust. Përpos kësaj, sistemi financiar duhet plotësuar me nxitjen e formave të një ekonomie solidare (për shembull, kooperativat) (f. 11) dhe zgjerimin e sektorit publik (f. 8), si dhe “programe investimi të orientuara nga e ardhmja që nxitin punësimin” (f. 9).

Marrëdhëniet e punës: Për Die Linke-n “puna” nuk është thjesht mjet për të fituar jetesën: “Ne punojnë për një shoqëri në të cilën çdo grua dhe çdo burrë është në gjendje të punojë në këmbim të pagës për të jetuar. Punësimi fitimprurës, puna në familje dhe partneritetet, puna për të ndihmuar në organizimin e shoqërisë dhe pjesëmarrjen në jetën kulturore e shoqërore duhet të jetë e mundur për të gjithë” (f. 7). Sa i takon punësimin të qëndrueshëm, Die Linke mbështet një rregullim shumë më të rreptë të marrëdhënieve të punës me anë të ligjit dhe kontratave kolektive. Për shembull, partia bën thirrje për vazhdimin e negociimeve të lira kolektive, një “pagë ligjore minimale e mjaftueshme me të cilën njerëzit të sigurojnë jetesën”, “shkallë më e lartë e mbrojtjes së punësimin”, “të drejta bashkëvendimmarrje për të gjithë punëmarrësit” dhe “zbatim të gjerë të kontratave kolektive”. Ajo kërkon bashkëvendimmarrje në kompani mbi baza të barabarta (f. 13). Po ashtu, duhet të ekzistojë e drejta për të hyrë në grevë për arsye politike, që deri më tash ka qenë e ndaluar, për shkak të detyrimit për shmangien e aksionit industrial gjatë bisedimeve për pagat (p. 13). Këta shembuj dëshmojnë se Die Linke beson në kontrollin e ekonomisë nga shteti dhe shoqëria.

Formimi profesional dhe formimi i vazhduar: Lidhur me këtë, Die Linke e vendos theksin te pabarazitë shoqërore dhe te detyra për të ristrukturuar sistemin arsimor, që të shkojë drejt pjesëmarrjes së plotë. Sa i takon formimin profesional, ai përfshin kërkesën për të “drejtën themelore për formim”: “Shmangia e përgjegjësisë për formimin profesional nga punëdhënësit duhet ndaluar. Ne përkrahim ofrimin e një numri të madh vendesh për formim. Kjo kërkon financim ligjor mbështetur në vlerësim” (f. 17). Formimi profesional dhe ai i vazhduar duhen nxitur nga shteti (f. 17).

Në përgjithësi, Die Linke beson shumë më tepër te shteti se çdo parti tjetër. Për aq sa mund të shihet, kjo do të vijojë të jetë në kuadrin e një ekonomie të koordinuar tregu. Sidoqoftë, nuk ka ende një angazhim të qartë ndaj kësaj. Ka dy gjëra në veçanti që e dallojnë Die Linke-n nga partitë e tjera. Së pari, sektorët kryesorë të ekonomisë duhen shtetëzuar. Sa larg do të shkonte ky shtetëzim e në ç'formë, ende nuk është e qartë. Së dyti, ka vetëm një përshkrim të shkurtër se si duhet të jenë të strukturuar financat publike, që të mund të ofrojnë pasuri të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat që i drejtohen shtetit. Sigurisht që programi i një partie nuk duhet doemos të përmbajë një plan financimi dhe zbatimi, por kjo është çështje vendimtare kur vjen fjala te zbatimi i propozimeve në realitet.

5.6. Vlerësimi i programeve në përputhje me objektivat e demokracisë sociale

Socialdemokracia, siç kuptohet në këtë vëllim, udhëhiqet nga fuqia ligjore formale dhe zbatimi në praktikë i konventave të të drejtave themelore, të miratuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 1966 dhe që janë ratifikuar nga një shumicë dërrmuese vendesh. Nga gjithçka që u tha, del qartë se sidomos ekonomitë e koordinuara të tregut, si ato të Skandinavisë, janë më pranë përmbushjes së kushteve normative të socialdemokracisë.

Sa u takon qëllimeve dhe objektivave të politikës ekonomike, Simon Vaut dhe Christian Krell kanë paraqitur tri objektivat, rritja, barazia sociale dhe qëndrueshmëria, si karakteristike të demokracisë sociale. Kjo ngre pyetjen mbi mënyrën sesi angazhohen partitë e ndryshme politike për ta vazhduar apo ndryshuar ekonominë e koordinuar të tregut.

Programet partiake të pesë partive të përfaqësuara në Bundestag arrijnë deri në një "deklaratë synimesh", që ofron informacion rreth kahut drejt të cilit partia dëshiron ta zhvillojë ekonominë dhe shoqërinë gjermane kur të vijë në pushtet. Është e pamundur që këtu të shqyrtojmë shkallën në të cilën partitë u qëndrojnë programeve të tyre. Megjithatë, reagimet dhe propozimet për politika nga CDU-ja dhe FDP-ja për krizën e tregjeve financiare në vjeshtë të vitit 2008 dëshmuar

se orientimet programore nuk përkojnë gjithnjë me veprimin politik konkret. Për shembull, kohët e fundit, FDP-ja bëri thirrje për një shtet të fortë dhe CDU-ja, duke shkuar kundër kahut të saj liberal ekonomik, deklaroi mbështetjen për garanci dhe hua të konsiderueshme.

Qëndrimet e partive mund të përmbliidhen si më poshtë (patjetër, nga një këndvështrim i pjesshëm):

- **CDU-ja**, në këtë kontekst, përfaqëson **një ekonomi tregu të koordinuar në nivel më të ulët nga sa është sot**. Rudimentet e liberalizmit ekonomik kombinohen me sipërmarrjen individuale si etikë. Ka prirje të refuzohen format kolektive të bashkëvendimmarrjes dhe kontrollit apo të reduktohen ose të bëhen më elastike.
- **Aleanca 90/Të gjelbrit** angazhohen për një ekonomi të koordinuar tregu, që duhet ristrukturuar për të shkuar drejt “shoqërisë me energji diellore”. Për ta realizuar këtë, ata huazojnë ide liberale, elemente nga shoqëria civile dhe elemente të kontrollit kolektiv. Në përgjithësi, programi partiak i grupimit Aleanca 90/Të gjelbrit është më i gjati edhe pse i varfër në detaje lidhur me ekonominë e koordinuar.
- **FDP-ja** përkrah në programin e saj **një ekonomi tregu të pakoordinuar dhe liberale**. Nuk kuptohet menjëherë se në ç’mënyrë modeli i tyre shoqëror duhet të jetë “ekonomi tregu mjedisore dhe sociale”.
- **Die Linke** përfaqëson me forcë rregullimin e ekonomisë dhe përkrah një shtet që mbron individin. Ajo dallon nga katër partitë e tjera, kryesisht në dy drejtime: nga njëra anë, ajo ka hartuar vetëm “pika programore” (edhe pse tashmë është paraqitur një variant i parë i programit të partisë) dhe, nga ana tjetër, mbetet ende pyetja nëse ajo e merr mirëfilli si modelin e saj “ekonominë e tregut”.
- **SPD** angazhohet në programin e saj për një **ekonomi të koordinuar** tregu dhe zgjerimin e saj. Ky zgjerim u referohet të drejtave e lirive gjithëpërfshirëse civile të parashikuara në konventat e Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, ajo trajton nevojën për ta përshtatur qeverisjen në mënyrën e duhur. Kjo ka të bëjë kryesisht me qëndrueshmërinë, ndërkombëtarizimin e tregjeve financiare, me elasticitetin e proceseve dhe mbrojtjen sociale.

CDU-ja dhe FDP-ja anojnë qartë drejt objektivit të rritjes, nën të cilin priren të vendosin objektivat e tjera. Ato janë skeptike ndaj konceptit të "barazisë sociale".

Aleanca 90/Të gjelbrit, me idenë e tyre të "ristrukturimit diellor" të ekonomisë sociale dhe mjedisore të tregut, mbështeten kryesisht te objektivi i qëndrueshmërisë mjedisore. Përkrahët "barazia sociale", ndërkohë që mund të hamendësohet një nënrenditje e qartë e objektivit të "ritjes cilësore".

Die Linke ka një orientim të qartë drejt objektivit të "barazisë sociale". SPD-ja, ndërkohë, ka një qasje të barabartë e të ekuilibruar ndaj tri objektivave




Figura 8: Paraqitja skematike e partive sipas objektivave të tyre të politikës ekonomike

Për t'iu kthyer pyetjes fillestare: përpjekjet për heqjen e vijave të qarta dalluese midis kompetencës ekonomike dhe sociale të partive rrezikojnë të jenë të mangëta dhe jo veçanërisht kuptimplota në vlerësimin e politikës. Megjithatë, analiza e programeve të partive tregon se edhe ato mund të kenë objektiva tejet të ndryshme në raport me mënyrën si duhet organizuar e ngulitur në shoqëri ekonomia. Vetëm po të shohim të gjithë kuadrin, do të jemi në gjendje të gjejmë ndikimet në spektrin e partive e të jemi në pozitën për të gjykuar.

6. RENDET EKONOMIKE: MODELET E VENDEVE TË CAKTUARA

Për çfarë bën fjalë ky kapitull:

- Bazuar në dallimin që bëme më sipër për llojet e koordinuara dhe të pakoordinuara të kapitalizmit, do të krahasohen një sërë sistemesh ekonomike, në përputhje me teorinë e David Soskice-s dhe Peter A. Hall-it.
- Do të marrim në shqyrtim sistemet financiare, marrëdhëniet e punës, sistemet e arsimit/formimit dhe marrëdhëniet e ndërsjella të kompanive.
- Në qendër të vëmendjes do të jenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Suedia dhe Japonia.
- Ato mbulojnë një gamë të gjerë, në të cilën ShBA-ja përkon më shumë me modelin ideal të pakoordinuar dhe Suedia me atë të koordinuar.
- Këto modele të ndryshme ekonomike mund të ekzistojnë së bashku edhe në periudhat e tregjeve të hapura. Ato karakterizohen nga një mori parakushtesh dhe vlerësohen shumë ndryshe nga pikëpamja socialdemokrate.

6.1. ShBA-ja¹³

Simon Vaut

Ekonomi tipike e pakoordinuar tregu

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë shembulli klasik i një ekonomie të pakoordinuar tregu (Meyer 2005a: f. 279.), që ka shfaqur tradicionalisht liberalizëm tregu, skepticizëm kundrejt ndërhyrjes së shtetit dhe individualizëm. Sistemi ekonomik amerikan është i orientuar kryesisht nga objektivat në shërbim të konsumizmit ("jepu konsumatorëve atë që duan!) dhe shtimi i pasurisë në kurriz të të drejtave themelore shoqërore (Gilpin 2001: 150).

Megjithatë, ky gjykim mund të shihet në dritën e periudhës së dhënë historike. Në vitet '30, për shembull, presidenti Frenklin D. Roosevelt, me "Kursin e ri", një program i jashtëzakonshëm i nxitjes ekonomike, besonte në koordinim më

¹³Prezantimi në këtë libër i ShBA-së dhe Gjermanisë ka në një masë të konsiderueshme pjesë të prezantimit të Meyer-it (2005a: 279–282). Do të donim të falënderonim autorin që na dha leje.

të madh të ekonomisë. Edhe politikat e presidentit Lyndon B. Johnson në vitet '60 ndoqën të njëjtin drejtim me "luftën kundër varfërisë". Po edhe gjatë këtyre periudhave, ekonomia e ShBA-së mbeti në përgjithësi kryesisht e pakoordinuar. Politikat e presidentit Ronald Reagan (1980) dhe presidentit George W. Bush, nga ana tjetër, kërkonin të ulnin në minimumin e mundshëm koordinimin ekonomik.

Sistemi financiar

Financimi i kompanive në ShBA ndodh kryesisht nga tregu i kapitalit. Kjo rrit transparencën e të dhënave financiare, duke qenë se kompanitë e regjistruara në bursë duhet të bëjnë rregullisht publike bilancet e tyre. Strategjitë e kompanive përcaktohen më së shumti nga dëshira e aksionarëve për një dividend sa më të lartë të jetë e mundur. Ky njihet si parimi i vlerës së aksionarit.

Qasja në kapital varet nga vlerësimi që i bëjnë aksionarët parashikimit të të ardhurave të kompanisë. Shkrirjet e kompanive dhe blerjet janë të rregulluara më pak se në çdo vend tjetër. Për këtë arsye, drejtuesit e kompanive në ShBA janë pa pushim nën trysni për të regjistruar fitimin më të lartë të mundshëm brenda kohës më të shkurtër të mundshme. Të ardhurat e pamjaftueshme mund të çojnë në shkarkimin e drejtuesve, tërheqjen e kapitalit përmes bursës ose marrjen nën kontroll të kompanisë.

Marrëdhëniet e punës

Organizatat e kapitalit dhe të punës në ShBA janë kryesisht organizata lobuese për degë të caktuara interesash, më shumë sesa aktorë me përgjegjësi kundrejt shoqërisë në tërësi. Krahasuar me ato që gjenden në ekonomitë e koordinuara të tregut, sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve janë të dobëta në përgjithësi dhe iu mungojnë organizata ombrellë me ndikim. Pavarësisht kësaj, në disa sektorë ka sindikata të forta, që përfaqësojnë interesa të veçanta në mënyrë efektive. Për shembull, në Kaliforni gjendet një sindikatë e mirorganizuar për rojet e burgut, që ushtron një ndikim jo të vogël mbi policinë, përfshi rregullimet në sistemin penal. Megjithatë, interesat individuale të anëtarëve të organizuar kanë përparësi mbi interesin publik. Mbrojtja e ligjshme e punësimit është thuajse e pazhvilluar në ShBA. Për këtë arsye, marrëdhëniet e punës karakterizohen nga marrëdhënie punësimi afatshkurtra dhe negociime paqe në nivel ndërmarrjeje. Kontratat e përgjithshme kolektive si ato që gjenden në ekonomitë e koordinuara të tregut janë përgjithësisht të panjohura, si rrjedhojë e dobësimit të vazhdueshëm të sindikatave gjatë dekadave të fundit në ShBA. Robert Reich ia atribuon rënien

Financimi përmes tregut të kapitalit

Trysni për fitime afatshkurtra

Veprimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit nuk orientohen nga shoqëria si e tërë

Thuajse asnjë mbrojtje e punësimit

Sindikata të dobëta si pasojë e politikave antisindikaliste

e organizimit të sindikatave nga 33 për qind në vitin 1955, në vetëm 8 për qind në vitin 2006, dy faktorëve: së pari, politikave të qëllimshme antisindikaliste të kompanive dhe, së dyti, politikës përherë e më të fortë kundër sindikatave nga qeveria. Në vitin 1981, Presidenti Ronald Reagan, për shembull, vendosi ndalimin përgjithmonë të punësimit në shërbimin civil të kontrollorëve të trafikut ajror që hynin në grevë. (Reich 2008: 108fv).

Sistemi i arsimit dhe formimit

Një treg punë që është përgjithësisht më elastik mbështetet edhe nga sistemi i arsimit dhe formimit profesional, i cili prirret të ofrojë kualifikime të përgjithshme, që mund të shfrytëzohen në të gjitha firmat dhe sektorët. Punonjësit mund të merren në punë apo të pushohen për një periudhë afatshkurtër (“punëso dhe pusho”) dhe me shumë lehtësi, në varësi të situatës ekonomike. Duke qenë se tregu i punës është relativisht i parregulluar dhe përjeton luhatje të mëdha, punonjësit amerikanë kanë prirjen të investojnë për kualifikime të përgjithshme, që mund t’i përdorin edhe në punën e ardhshme. Meqenëse shoqatat e punëdhënësve janë mjaft të dobëta, kompanitë nuk janë në gjendje të bashkëpunojnë për programe formimi sipas sektorit. Si rezultat, punonjësit në ShBA janë të formuar me aftësi të përgjithshme që i përshtaten veçanërisht sektorit të shërbimeve, i cili është mjaft i ndjeshëm ndaj ndryshimeve të situatës ekonomike. Për shumë firma dhe sektorë, kjo çon në mungesë punonjësish të kualifikuar.

Mungesat e financimeve publike në fushat e shkencës kompensohen pjesërisht nga subvencionimi i kryqëzuar. Shumë novacione që përdoren në sektorin civil e kanë zanafillën te zhvillimet ushtarake, për shembull, në ndërtimin e avionëve, teknologjinë satelitore dhe teknologjinë e informacionit (Reich 2008).

Marrëdhëniet midis kompanive

Kompanitë amerikane konkurrojnë me njëra-tjetrën shumë herë më tepër sesa kompanitë në ekonomitë e koordinuara të tregut, si Suedia ose Gjermania, që përqendrohen te bashkëpunimi me kompani të tjera, me shtetin dhe sindikatat (Hinchmann 2006: 350). Firmat janë të integruara në një shkallë minimale: as bankat, as firmat e tjera nuk marrin pjesë në këshillat e tyre mbikëqyrëse. Në ShBA, ka mbizotëruar gjithnjë koncepti i lirisë ekonomike, ndaj shteti ndërhyr në treg vetëm për ta mbajtur në funksionim dhe, për shembull, për të parandaluar krijimin e karteleve. Për shembull, legjisllacioni i fortë antitrust është konceptuar për të parandaluar kompanitë që të përfshihen në fiksimin e çmimit.

Kualifikime të përgjithshme

Subvencionimi i kryqëzuar i kërkimit nga industria e armëve

Niveli i ulët i integritimit të korporatës

ShBA

PBB-ja për frymë 2008	38.000 €	PBB-ja për frymë sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS); 1 PPS përkon me fuqinë blerëse me vlerë 1 euro (mesatare e BE27) (burimi: Eurostat)
Rritja mesatare ekonomike 1990–2007	2,0 %	Mesatarja e rritjes ekonomike vjetore për frymë me çmime konstante (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 195)
Borxhi kombëtar 2008	70,7 %	Borxhi kombëtar si përqindje e PBB-së (burimi: Ministria Federale Gjermane e Financave, Raporti mujor 12/2009, f. 99)
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	– 4,9 %	Bilanci i të gjithë import-eksportit të mallrave si përqindje e PBB-së (burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: Parashikimi Ekonomik Botëror 10/2009, f. 187)
Norma e punësimit 2008	70,9 % (65,5 %)	Numri i personave në moshë pune (shifra për gratë jepet në kllapa); të grupmoshës 1564 vjeçe në raport me popullsinë (burimi: Eurostat)
Norma e papunësisë 2008	5,8 %	Raporti i njerëzve të papunë në popullsinë me moshë pune: Eurostat)
Pabarazia në të ardhura, sipas koeficientit “Gini”	40,8 %	Raporti që tregon shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave; 100% = pabarazi maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, f. 195)
Të ardhurat e grave krahasuar me ato të burrave	62 %	Përqindja e të ardhurave të grave krahasuar me ato të burrave (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 186)
Indeksi i varfërisë 2009	15,2 %	Indeksi i varfërisë përbëhet nga tregues të ndryshëm (përfshi jetëgjatësinë, shkallën e shkrimleximit dhe qasjen në kujdesin shëndetësor); 0 = varfëri minimale, 100 = varfëri maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, p. 180)
Shkalla e pjesëmarrjes në sindikata 2007	11,6 %	Raporti i popullsisë në moshë pune që janë të organizuar në sindikata (burimi: OECD)

*Ekonomi tregu
gjerësisht e
pakoordinuar*

Përmbledhje: ShBA

Me një ekonomi tregu kryesisht të pakoordinuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës u ofrojnë kompanive mundësi të jenë elastike në përgjigje të zhvillimeve të tregut, por kjo rrit trysinë e përshtatjes me një treg që ndryshon brenda një kohe të shkurtër. Sistemi amerikan i marrëdhënieve të punës është po ashtu më pak efektiv në hartimin e strategjive për prodhimet e kushtueshme që do të kërkonin punësim afatgjatë të qëndrueshëm. Përkundrazi, ai favorizon sektorët novatorë, që varen nga kapitali i riskut, si dhe teknologjinë e informacionit e sektorët e mëdhenj të shërbimeve, që bazohen te profile të arsimit të përgjithshëm dhe paga më të ulëta.

*Pasuria private
përballë varfërisë
publike*

Sistemi ekonomik në ShBA ka arritur për një kohë të gjatë norma më të larta rritjeje sesa vendet evropiane: që nga vitet '90, ekonomia amerikane është rritur mesatarisht me 3 për qind në vit, ndërkohë që vendet e BE-së kanë arritur deri në 2,2 për qind. Sidoqoftë, mbetet për t'u parë se si do të jetë zhvillimi afatgjatë në vazhden e krizës. Po këto fitime nga mirëqenia shpërndahen gjithnjë e më shumë në mënyrë të pabarabartë. Ndërkohë që në vitet '50, pagat e drejtorëve i tejkalonin 25 fish ato të punonjësve të paguar më pak në të njëjtën kompani, sot kjo shifër arrin mesatarisht në 350 fish (Reich 2008: 144). Për shkak të nënfinancimit kronik të buxhetit të shtetit, kur vihen përballë pasuria private dhe ajo publike, e para mbizotëron. Mes të tjerave, kjo çon në një infrastrukturë të varfër publike krahasuar me vende të tjera (Hinchmann 2006: 352).

*Ndryshim i drejtimit
pas zgjedhjes së
Barak Obamës?*

Që me ardhjen në pushtet të administratës së re amerikane, në fillim të vitit 2009, ideologjia e shtetit të vogël, i cili rregullon dhe ndërhyr pak, tipik i epokës së Reganit dhe Bushit, është sprapsur. Reformat e kujdesit shëndetësor, paketat e nxitjes ekonomike dhe rritja e mbikëqyrjes financiare, të miratuara nën drejtimin e Obamës, po i çojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës drejt një rregullimi më të madh, një koordinimi më të madh dhe raporti më të lartë të shpenzimeve publike

6.2. Britania e Madhe

Christian Krell

Britania e Madhe përshkruhet shpesh si pioniere e kapitalizmit. Industrializimi, tregtia e lirë dhe liberalizmi u zhvilluan aty më parë se në shumë vende të tjera. Në të njëjtën kohë, ana e errët e kapitalizmit të shfrenuar u bë e qartë veçanërisht shumë herët. Friedrich Engels e bazoi përshkrimin e jetesës dhe kushteve çnjerëzore të punës të punëtorëve në varësi në messhekullin e nëntëmbëdhjetë të “kushtet e klasës punëtore në Angli”.

Që nga dalja e studimit të Engels-it, duhet pranuar se shumëçka ka ndryshuar në kapitalizmin britanik. Gjithsesi në disa aspekte janë shquar raste vijueshmërie. Rendi ekonomik britanik vijon të jetë ende dukshëm liberal. Studimet ndërkombëtare krahasimore për kapitalizmin e përshkruajnë Britaninë e Madhe si një ekonomi liberale tregu e pakoordinuar.

Në vijim përshkruhen tiparet kryesore të ekonomisë britanike.

Sistemi i financimit dhe struktura e pronësisë

Në kapitalizmin britanik, gjendja e fitimeve aktuale të kompanisë është kyçe për financimin e saj. Për investime, kompanitë britanike kanë nevojë për paratë “e paduruara”, pjesën dinamike dhe tregjet financiare. Po ashtu, fitimi i lartë është kushti kryesor për të përfutur kapital. Kjo e dallon Britaninë e Madhe nga sistemi ekonomik, për shembull, që ka karakterizuar Gjermaninë për një kohë të gjatë, ku bankat e brendshme punojnë së bashku me kompanitë për një periudhë afatgjatë dhe, kështu, arrijnë t’i kuptojnë mirë ato, përfshi strategjitë e strukturat e tyre. Në Mbretërinë e Bashkuar, investuesit dhe financierët marrin vendime në bazë të kriterëve të vlerësimit që janë publike. Në këtë drejtim, fitimi merr epërsi.

Strukturat e pronësisë në Britaninë e Madhe janë shumë ndryshe nga ato në ekonomitë e koordinuara të tregut. Edhe pse në këto të fundit, është karakteristike që pronësia të jetë në duart e investuesve me interesa strategjike dhe afatgjata – për shembull, kompanive të tjera, bankave ose sektorit publik – rreth 80 për qind e pronarëve të kompanive britanike janë investues financiarë dhe privatë, që kanë përgjithësisht përparësi fitimin më të lartë të mundshëm.

Pioniere e kapitalizmit ..

... dhe të anës së tij të errët

Ekonomi liberale tregu e pakoordinuar

Financimi përmes tregjeve financiare dhe bursës

Struktura e pronësisë: raport i lartë i investuesve financiarë dhe privatë

Të ashtuquajturat marrje agresive nën kontroll, që synojnë sigurimin e fitimit të shpejtë, ndodhin shumë më lehtë sesa në ekonomitë e koordinuara të tregut për shkak të mundësive të gjera të ofruara nga financimi i tregut dhe struktura e tregjeve financiare.

Orientimi drejt asaj që mund të përfitohet në një kohë të shkurtër

Orientimi i fortë drejt fitimit, së bashku me strukturën e brendshme mjaft hierarkike të kompanive britanike, i lejon ato të kryejnë një ristrukturim të shpejtë në drejtim të tregjeve të reja e më fitimprurëse; sektorët më pak produktivë të biznesit shkurtohen me shpejtësi. Megjithatë, nga ana tjetër, ky orientim përcakton karakteristikën “afatshkurtër” të ekonomisë britanike – orientimi drejt asaj që mund të arrihet shpejt

Sindikata të forta vetëm në dukje

Marrëdhëniet e punës

Ka pasur periudha në të cilat sindikatat britanike janë shfaqur shumë të forta. I ashtuquajtur i “dimri i pakënaqësisë” është shembull për këtë. Në vitin 1978–79, një grevë kombëtare paralizoi të gjithë sektorin publik në Britaninë e Madhe: plehurat nuk grumbulloheshin, transporti publik ngriu dhe të vdekurit nuk varroseshin. Megjithatë, periudhat e reagimit me greva intensive nuk tregojnë se ka sindikata të forta. Sindikatat e forta dhe të mirorganizuar, si rregull, janë në pozitë për të vendosur për interesat e punonjësve në bisedime, pa pasur nevojë të hyjnë në grevë. Po ashtu, “dimri i pakënaqësisë” ishte më shumë shprehje e fuqisë së pamjaftueshme negociuese. Sindikatat britanike janë të dobëta krahasuar në nivel ndërkombëtar. Kjo vjen kryesisht për shkak të faktit se peizazhi i sindikatave britanike është relativisht i copëzuar. Në vitet ‘90, kishte ende mbi 300 sindikata. Ato nuk janë të organizuara me degë industrie, por sipas grupeve profesionale, si rezultat i të cilave, në vendin e punës përfaqësohen shpesh një mori sindikatash. Arsyeja e dytë e dobësisë së sindikatave britanike është se në Britaninë e Madhe, ashtu siç është tipike për ekonomitë liberale të tregut, kompanitë nuk e kanë detyrim ngritjen e këshillave të punës apo formave të tjera të përfaqësimit të punonjësve. Bashkëvendimmarrja, e llojit që ekziston në industrinë e qymyrit dhe çelikut në Gjermani, për shembull, është mjaft e panjohur në Britaninë e Madhe. Së fundi, të drejtat e sindikatave u tkurrën sistematikisht nga qeveria konservatore e Thatcher-it (1979–1990). Po kështu, shkalla e organizimit në sindikatë sot është relativisht e ulët. Në Britaninë e Madhe, popullsia punonjëse e organizuar në sindikata përbën vetëm më pak sesa 30 për qind.

Fragmentim i dukshëm i sindikatave

Nuk ka përfaqësim të detyrueshëm të punonjësve

Përgjithësisht, një nivel i ulët i organizimit në sindikata

Ashtu si punëmarrësit, edhe punëdhënësit janë relativisht pak të organizuar. Organizatat ombrellë thuajse nuk ekzistojnë dhe rëndësia e shoqatave të punëdhënësve është në rënie.

Bazuar në këto struktura, niveli i pagave negociohet zakonisht në nivel ndërmarrjeje ose është rezultat i proceseve individuale negociuese midis punëmarrësve dhe punëdhënësve. Që nga viti 1999, është vendosur kufiri i pagës më të ulët, në formën e pagës minimale, që nuk mund të shkurtohet.

Marrëdhëniet midis kompanive dhe punonjësve individualë përcaktohen shumë më tepër nga forcat e tregut, sesa në ekonomitë e koordinuara të tregut. Punëmarrësit kanë prirjen të qëndrojnë në kompani për një periudhë relativisht të shkurtër dhe, si rezultat, janë pak besnikë ndaj kompanisë. Largimet nga puna janë relativisht të lehta për t'u bërë dhe sindikatat nuk arrijnë t'i parandalojnë ato efektivisht dhe mbrojtja e punësimit është e dobët. Në të njëjtën kohë, punonjësit e kualifikuar e kanë më të lehtë të gjejnë një punë të re në tregjet elastike të punës.

Kompanitë britanike janë në përgjithësi të organizuara në mënyrë më hierarkike sesa kompanitë në ekonomitë e koordinuara të tregut. Përveç dominimit të drejtorit ekzekutiv, kjo gjen vend edhe në organizimin e punës. Për shembull, puna në ekip mes punonjësve me kualifikim të lartë, siç haset shpesh në Gjermani, është e rrallë në Britaninë e Madhe, ku është karakteristike ndarja konvencionale dhe rigoroze e punës (Wood 2001: 250).

Sistemi i formimit dhe formimit të vazhduar

Në tregjet elastike të punës në Britaninë e Madhe, mungojnë kualifikimet specifike profesionale në terren. Arsyet për këtë kuptohen lehtësisht nga këndvështrimi i punëdhënësit:

Së pari, duke qenë se punëmarrësit prirjen të qëndrojnë relativisht shkurt në një kompani, ka gjithnjë rrezik që investimi në njerëz nuk do të shlyhet, madje mund të përfitojë një kompani rivale. Së dyti, për shkak të elasticitetit të skajshëm të tregjeve, punonjësit e kualifikuar mund të punësohen dhe, nëse është nevoja, të pushohen shumë shpejt.

Negociatat për pagat në nivel ndërmarrjeje, por me pagë minimale

Mbrojtje e vogël e punësimit

Hierarki e theksuar brenda kompanisë

Pajisja me aftësi të përgjithshme

Më tej, ka pak stimuj nga ana e punëmarrësit për të përfutur kualifikime që janë specifike për firmën, pasi periudha relativisht e shkurtër e shpenzuar në një punëmarrës jep idenë se përqendrimi në aftësitë e përgjithshme që mund të përdoren, edhe në firma apo sektorë të tjerë, ia vlen më shumë.

Rezultati gati i pashmangshëm i kësaj mungese theksi te kualifikimet profesionale është rendimenti relativisht i ulët i kompanive britanike, krahasuar, për shembull me kompanitë gjermane dhe se, në përgjithësi, ekonomitë liberale të tregut kanë prirjen të përqendrohen në produkte që janë të thjeshta për t'u përpunuar dhe me metoda të standardizuara prodhimi.

Marrëdhëniet midis kompanive

Marrëdhëniet midis kompanive bazohen te raportet e tregut dhe raportet formale të parashikuara në ligj. Kompanitë rrallë janë të integruara me njëra tjetrën. Transferimi i teknologjisë bëhet kryesisht përmes shkëmbimit të personelit shkencor ose teknologjik me kualifikim të lartë. Lëvizja e shkencëtarëve dhe inxhinierëve nga institutet kërkimore drejt sektorit privat dhe anasjelltas ndodh më shpesh sesa në ekonomitë tradicionale të koordinuara të tregut. Nga ana tjetër, projektet e përbashkëta kërkimore midis kompanive apo rrjetet afatgjata të bashkëpunimit janë edhe më të rralla.

Vlerësim dhe përmbledhje

Modeli britanik i kapitalizmit është shumë më pranë sistemit ekonomik të ShBA-së sesa të ekonomive të Evropës kontinentale. Avantazhet e kapitalizmit britanik, për rrjedhojë, janë një normë relativisht e lartë punësimi dhe shkallë e ulët papunësie. Dizavantazhet janë rendimenti vazhdimisht i ulët i kompanive britanike krahasuar me kompanitë amerikane ose gjermane dhe orientimi i tyre drejt fitimit afatshkurtër. Sikur të mos mjaftonin këto, në rënien ekonomike aktuale, të gjitha mangësitë e tregjeve shumë elastike të punës po dalin në sipërfaqe: punonjësit mund të pushohen lehtë dhe shifrat e papunësisë po rriten ndjeshëm.

Megjithatë, është me rëndësi të thuhet se këto kategorizime nuk janë kurrë përfundimtare. Sistemi politik britanik, me sistemin e saj mazhoritar të zgjedhjeve dhe strukturë të centralizuar shtetërore nënkupton se të gjitha qeveritë mund të ndërmarrin me shpejtësi ndryshime strukturore me ndikim të thellë.

Britania e Madhe

PBB-ja për frymë 2008	29.200 €	PBB-ja për frymë sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS); 1 PPS përkon me fuqinë blerëse me vlerë 1 euro (mesatare e BE27) (burimi: Eurostat)
Rritja ekonomike mesatare 1990–2007	2,4 %	Mesatarja e rritjes ekonomike vjetore për frymë me çmime konstante (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f.195)
Borxhi kombëtar 2008	52,0 %	Borxhi kombëtar si përqindje e PBB-së (burimi: Ministria Federale Gjermane e Financave, Raporti mujor 12/2009, f. 99)
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-1,7 %	Bilanci i të gjithë import-eksportit të mallrave si përqindje e PBB-së (burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: Parashikimi Ekonomik Botëror 10/2009, f. 187)
Norma e punësimit 2008	71,5 % (65,8 %)	Numri i personave në moshë pune (shifra për gratë jepet në kllapa), të grupmoshës 15–64 vjeçe në raport me popullsinë (burimi: Eurostat)
Norma e papunësisë 2008	5.6 %	Raporti i njerëzve të papunë në popullsinë me moshë pune: Eurostat)
Pabarazia në të ardhura, sipas koeficientit "Gini"	36 %	Raporti që tregon shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave; 100% = pabarazi maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, f. 195)
Të ardhurat e grave krahasuar me ato të burrave	67 %	Përqindja e të ardhurave të grave krahasuar me ato të burrave (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 186)
Indeksi i varfërisë 2009	14,6 %	Indeksi i varfërisë përbëhet nga tregues të ndryshëm (përfshi jetëgjatësinë, shkallën e shkrim-leximit dhe qasjen në kujdesin shëndetësor); 0 = varfëri minimale, 100 = varfëri maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, p. 180)
Shkalla e organizimit në sindikata 2007	28 %	Raporti i popullsisë në moshë pune që janë të organizuar në sindikata (burimi: OECD)

6.3. Gjermania

Simon Vaut

Gjermania është një ekonomi e koordinuar tregu

Gjermania është një ekonomi tipike e koordinuar tregu (Meyer 2005a: 280fv) dhe është parë gjatë si model i një kombinimi shembullor i dinamizmit ekonomik, stabilitetit politik dhe barazisë sociale (Egle 2006: 273–326). Megjithatë, me rritjen e papunësisë dhe stanjacionin ekonomik që ndodhi në vitet '90, modeli gjerman e humbi shkëlqimin e, madje, u përshkrua nga *The Economist* si "i sëmuri i Evropës". Rritja ekonomike e viteve të fundit duket se e ka hedhur poshtë këtë gjykim, por mbetet për t'u parë nëse edhe Gjermania do ta përballojë sfidën që paraqet kriza e tregut financiar.

Financimi i kompanive përmes bankave

Sistemi i financimit

Në Gjermani, financimi i kompanive me anë të tregut të kapitalit luan vetëm një rol të vogël. Për këtë arsye, menaxhimi i ndërmarrjeve vlerësohet jo vetëm nga tregu, por edhe nga bankat, dhe ndërmarrjet e tjera të ndërlidhura me kompaninë, si dhe përfaqësuesit e punëmarrësve dhe aktorët shtetërorë. Kjo mund të favorizojë shkëmbimin personal të informacionit dhe krijimin e besimit. Financimi i kompanive bëhet kryesisht me anë të huave bankare. Në marrjen e këtyre huave, përveç të dhënave financiare, luan rol emri dhe rrjeti i kompanisë. Investuesit, nga ana e tyre, marrin informacion rreth emrit dhe veprimtarive të firmës nga lidhjet e tyre në rrjete të mbyllura. Kjo qasje në "kapitalin e duruar", që nuk varet nga fitimet afatshkurtra, u jep mundësi kompanive të investojnë në projekte afatgjata dhe të ruajnë një forcë pune të mirëkualifikuar, edhe gjatë periudhave të krizës ekonomike. Kjo përputhet me vrojtimin se drejtuesit e kompanive në Gjermani ndiejnë më pak trysni për të maksimizuar fitimet e menjëhershme apo për të reaguar me shpejtësi ndaj çmimit të aksioneve të kompanisë. Rregullat tatimore, ligjet dhe rrejetet e gjera të kompanive të ndërlidhura kanë prirjen t'i shkurajojnë marrjet nën kontroll të kompanive në mënyrë agresive. Është e vërtetë se kjo ndërlidhje midis kompanive dhe bankave është kritikuar si "kartel bankar" (Bury dhe Schmidt 1996) pasi e bën qasjen ndaj kapitalit më të vështirë për ata që hyjnë rishtas në treg dhe favorizon ata që janë brenda. Sidoqoftë, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë se këto raporte industriale po shkëputen në Gjermani dhe po rriten përfshirjet në rrafsh ndërkombëtar, siç shpjegohet në rubrikën e mëposhtme.

Qasja ndaj kapitalit "të duruar"

Jashtë teme : Fundi i Plc-së së Gjermanisë ?

Fillimisht pa u përmendur më së shumti në debatin politik, Gjermania ka përjetuar me hapa të ngadaltë por të sigurt një ndryshim të jashtëzakonshëm që nga vitet '90, që është përshkruar si "shkrirja" e Plc-së së Gjermanisë. Shprehja "Plc-ja e Gjermanisë" i referohet ndërlidhjes tradicionale të bankave dhe industrisë në Gjermani. Zanafilla e këtyre lidhjeve shkon pas në kohë, që në epokën perandorake. Ky integrim shërbeu mes të tjerash si një mburojë e jashtme dhe ruajti stabilitetin së brendshmi. Megjithatë, nën tryshninë e globalizmit, sistemi i bankave të lidhura me kompanitë dhe firmat me pronësi të kryqëzuara ka treguar se përbën pengesë, sidomos kur firmat gjermane dëshirojnë të marrin pjesë në tregun kapital global (Egle 2006: 291).

Për rrjedhojë, gjatë viteve të fundit, këto shoqëri me kapital të ndërsjellë midis bankave dhe industrisë janë ulur shumë në numër. Kompanitë gjermane janë specializuar dhe ndërkombëtarizuar më shumë.

Ndërlidhja e kompanive, veçanërisht banka-industri, në Gjermani ka nisur të shplekset këto vitet e fundit. Kjo dëshmon sesa shumë e ka tjetërsuar globalizmi sistemin ekonomik të Gjermanisë.


Të dhënat e serisë kohore të Institutit "Max Planck" për Studimin e Shoqërive në Këln e vërtetojnë këtë. Ndryshe nga rrjeti i dendur i lidhjeve të kapitalit që ekzistonte në vitin 1996, tashmë ai është shumë më i rrallë.

Kompanitë gjermane janë hapur, si rezultat, shumë kundrejt kapitalit ndërkombëtar. Kështu, Gjermania i është larguar disi modelit të kapitalizmit të koordinuar, për të ecur drejt një modeli të pakoordinuar. Blerja e kompanisë së mirënjohur gjermane, Mannesmann, nga grupi britanik i telefonisë celulare, Vodafone, në vitin 2001, dukej e pakonceptueshme më parë dhe përfaqësoi një lloj plasaritjeje. Sot (në mes të viteve 2010), 10 nga 30 kompanitë DAX janë me pronësi shumice të huaj: në vitet 2000 kishte vetëm tri të tilla. Gjatë së njëjtës periudhë, fluksi në hyrje i investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) është trefishuar, ndërkohë që po kështu është rritur edhe pronësia gjermane në tregjet ndërkombëtare.


A po zhbëhet ndërlidhja midis bankave dhe kompanive?

Prirja drejt modelit të pakoordinuar

Shoqëri me kapital të kryqëzuar në Gjermani në vitin 1996



Shoqëri me kapital të kryqëzuar në Gjermani në vitin 2006



© 2008 Lothar Krempel, Max-Planck-Institut für Gesellschaftsforschung, gjendet në adresën, www.mpifg.de/people/lk/; të dhëna nga Komisioni i Monopolit (Monopolkommission), gjendet në: <http://www.monopolkommission.de>

Kjo shkëputje e lidhjes është nxitur nga heqja e tatimit që aplikohet mbi vlerën e shtuar nga shitja e pasurive të paluajtshme. Më parë, ky tatim ishte 53 për qind, çka e bënte tmerrësisht jotërheqëse shitjen e aksioneve dhe kontribuonte në natyrën e ngurtë të lidhjeve midis industrisë dhe bankave.

Prirja drejt ndërkombëtarizimit dhe rritja e IHD-ve vazhdon. Pavarësisht kësaj, ka nisur një debat nëse kjo hapje ndaj “fondeve sovrane të pasurisë” dhe fondeve të kapitalit privat duhet të jetë e kufizuar.

Vlerësimi i përgjithshëm i “shkrirjes” së Plc-së së Gjermanisë është i përzier. Nga njëra anë, hapja ndaj kapitalit ndërkombëtar me investime dhe njohuri ka ndihmuar që shumë kompani gjermane të ruajnë konkurrueshmërinë dhe i ka bërë ato të jenë në gjendje të përmirësojnë pozitën e tyre në tregjet botërore. Kostot e pagës për njësi janë ulur ndjeshëm, ndryshe nga të gjitha vendet e tjera evropiane. Eksportet u rritën me 50 për qind gjatë një dekade – shumë më tepër sesa në vendet fqinje (burimi: Economist Intelligence Unit, 2006). Nga ana tjetër, trysnia për fitime dhe orientimi afatshkurtër janë rritur, duke shtuar pasigurinë në marrëdhëniet e punës.

Rreziku i blerjes së më shumë kompanive gjermane nga fondet private të investimit në aksione dhe fonde investimi të angazhuar në transaksione komplekse po debatohet gjerësisht, duke iu referuar përgjithësisht si një ‘murtaje karkalecash’. Kritika kryesore është se këto kompani janë të interesuara vetëm për fitimet afatshkurtra.

Komiteti gjerman i Këshilltarëve Ekonomikë (Sachverständigenrat zur Begutachtung der gesamtwirtschaftlichen Entwicklung) u shpreh në raportin e tij vjetor të vitit 2005: “Në qendër të debatit në Gjermani ishte rreziku për kompanitë. Ekzistonte frika se investuesit financiarë me orientim afatshkurtër po blinin tituj të kompanive, duke iu hequr aktivet e duke zbrazur rezervat, për t’i shitur sërish titujt, duke e lënë kompaninë shumë të dobësuar”. Në përgjigje të situatës, në vitin 2006 u miratua Akti i Kufizimit të Riskut, që i detyron investuesit të zbulojnë origjinën e fondeve dhe synimet e tyre (Sachverständigenrat 2005: 35).

Marrëdhëniet e punës

Në Gjermani, shkalla e organizimit në sindikata është mesatare krahasuar në nivelin ndërkombëtar, me 20 për qind (Stand 2007: f. 111). Megjithatë, marrëveshjet

*Avantazhet dhe
dizavantazhet e
flukseve të kapitalit
ndërkombëtar*

*Marrëveshje të lira
kolektive*

e lira kolektive japin një ndikim të konsiderueshëm mbi caktimin e pagave dhe kushteve të punës (Egle 2006:290). Sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve janë specifike sipas sektorëve. Për shembull, për industrinë e metalit është IG Metall dhe Gesamtmetall. Kjo nënkupton se bashkërendimi i negociatave për pagat bëhet brenda sinorëve të sektorit, duke siguruar që punonjësit në të njëjtën industri të presin të njëjtat paga. Si rezultat i këtyre pagave të njehsuara, mungon konkurrenca në pagë midis kompanive për marrjen e punonjësve më të mirëkualifikuar (Hassel 2006: 14).

Pjesëmarrja e punonjësve në çështjet e organizimit të punës dhe vendimet e personelit është mjaft e zhvilluar në Gjermani, krahasuar me nivelin ndërkombëtar. Akti i Themelimit të Këshillit të Punës rregullon madhësinë, kompetencat dhe përfshirjet e këshillave të punës. Shoqëritë anonime i nënshtrohen me ligj bashkëvendimarrjes, në rast se kanë një numër më të madh sesa 500 punonjës. Kjo do të thotë, për shembull, se punonjësit kanë përfaqësuesit e tyre të deleguar në bordet mbikëqyrëse të kompanive.

Sistemi i formimit

Sistemet komplekse të prodhimit në shumë kompani gjermane kërkojnë shpesh punonjës të mirëkualifikuar. Për të arritur këtë, sistemi i dyfishtë i formimit, që kombinon vlerën e lartë praktike dhe thellimin teknik, ka provuar se është i paçmuar (Egle 2006: 287). Ai është një "institucion themelor i kapitalizmit gjerman" (Hassel 2006: 13). Ata që ndjekin kurset e formimit paguhen relativisht pak, por, në këmbim, të rinjve u garantohet përgjithësisht hyrja në tregun e punës, që i siguron Gjermanisë një nga normat më të ulëta të papunësisë të rinjtë (në raport me normën e papunësisë të rriturve) në OECD (Hassel 2006: 15).

Kualifikimet krahasimisht shumë të specializuara u japin punonjësve më shumë fuqi negociuese sesa në ato vende ku sistemet e formimit janë të përgjithshme dhe punonjësit janë më të ndërkëmbyeshëm. Prodhimi i orientuar nga cilësia përfshin një lloj varësie nga punonjësit e mirëkualifikuar. Për t'u mbrojtur nga kërkesat gjithnjë e në rritje të punonjësve të tyre dhe për të mos lejuar firmat e tjera që t'i tundojnë punonjësit e kualifikuar të largohen, firmat gjermane kanë organizuar negociata të koordinuara për pagat midis punëdhënësve dhe punëmarrësve në sistemin e marrëdhënive industriale. Rezultati është harmonizimi i pagave sipas aftësive përkatëse në të gjithë sektorët industrialë. Kjo e bën më të vështirë "vjedhjen" e punonjësve me kualifikime industriale të veçanta.

Megjithatë, sistemi i formimit të dyfishtë rrezikohet në tri drejtime. Në periudhat e rritjes ekonomike kompanitë janë të lumtura të marrin praktikantë, si punonjës me vlerë të mirë dhe elastikë. Ndërkohë, në periudha stanjacioni ekonomik, ka mungesë të pozicioneve për praktikantët. Nëse kjo mungesë vazhdon për periudha të gjata, nis të vetëpërsëritet, pasi ata që nuk janë në gjendje të marrin një pozicion praktike shtojnë radhët e atyre që janë në kërkim të kësaj praktike vitin e ardhshëm, duke rritur konkurrencën. Së dyti, kompanitë po i shmangen përgjegjësive të tyre për formimin profesional. Së treti, “gjysmë-jeta” e dijes dhe njohurive po bëhet gjithnjë e më e shkurtër. Thuajse asnjë trajnim nuk e sistemon punonjësën për gjithë jetën. Gjermanisë, me ofertat pak të zhvilluara për formimin dhe formimin e vazhduar, i duhet ende t’u gjejë përgjigje sfidave të një bote pune që ndryshon më shpejt.

Marrëdhëniet midis kompanive

Drejtimesit e kompanive të mëdha gjermane rrallë kanë mundësi të marrin vendime të rëndësishme në mënyrë të njëanshme. Përkundrazi, duhet marrë miratimi i bordeve mbikëqyrëse dhe rrjeteve ku, përveç bankave, përfaqësohen kompani të tjera, punëmarrësit dhe aktorët shtetërorë. Për rrjedhojë, nuk janë aq shumë interesat afatshkurtra të aksionarëve për fitime që përcaktojnë vendimmarrjen e kompanisë, sa janë interesat e një numri aktorësh të tjerë.

Roli i shtetit në politikën ekonomike të Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore mund të përshkruhet më mirë si rol ndërmjetësues ose mundësues. Edhe pse mundësitë për të ndërhyrë drejtpërdrejt në proceset ekonomike ishin të kufizuara nga strukturat federale dhe një numër institucionesh të pavarura, si Bundesbank dhe Zyra Federale e Kartelit, shteti zhvilloi aftësinë të nxiste vetorganizimin e grupeve shoqërore dhe aktorëve thuajse korporatistë dhe t’u ofronte mjetet e nevojshme, pjesërisht kushtetuese, me qëllim që fushat e ekonomisë të mund të vetërregulloheshin dhe të vetadministroheshin, ndërkohë që diku tjetër rregullohen nga shteti ose lihen në dorë të tregut. Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe pavarësia monetare, si dhe Komisioneri evropian për Konkurrencën ndjekin parimet politiko-ekonomike që zbatohen në Republikën Federale e, kësajori, nuk e çoroditin sistemin. Më tej, shteti i transferon një pjesë të konsiderueshme të PBB-së sistemit të sigurimeve shoqërore dhe zbaton dispozitën kushtetuese “kushte të barabarta jetese” në të gjitha shtetet federale nëpërmjet sistemit të rishpërndarjes rajonale (Streck 1995).

Vlerësimi

Sistemi ekonomik gjerman është midis ekonomisë anglosaksone të tregut dhe ekonomisë skandinave të shtetit të mirëqenies (Schmidt 2000).

Në Gjermani, marrëdhëniet e punës kanë prirjen të jenë më afatgjata: mesatarisht, punonjësit punojnë për të njëjtin punëdhënës më shumë se 10 vjet, krahasuar me tetë dhe shtatë vjet përkatësisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe ShBA (Streeck 1995). Marrëdhëniet e punës kooperative dhe një forcë pune me kualifikim të lartë kanë sjellë rritje të prodhimtarisë, që siguron mundësinë për të paguar mirë punonjësit e kualifikuar dhe për të shkurtuar kohën e punës (Hassel 2006).

Për pasojë, shpërndarja e pagave në Gjermani është relativisht e ngushtë dhe, ndryshe nga vendet e tjera, punonjësit e kualifikuar i përkasin klasës së mesme. Kjo është një klasë e konsiderueshme në Gjermani: 66 për qind e popullsisë llogariten si klasë e mesme, krahasuar me 26 për qind në Mbretërinë e Bashkuar dhe 44 për qind në ShBA (Rössel 2005).

Megjithatë, si rezultat i krizës ekonomike, modeli gjerman është përballur me kritika qysh në vitet '90. Veçanërisht, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2005, konservatorët nisën një debat rreth shkaqeve pse Gjermania po mbetet pas, duke pretenduar se vendi nuk ishte më konkurrues në nivel ndërkombëtar. Pavarësisht këtyre profecive apokaliptike, Gjermania, që për një kohë të gjatë ishte eksportuesja që mbante vendin e parë në botë (sërisht, është në vend të dytë, pas Kinës), e ka shfaqur përsëri e përsëri konkurrueshmërinë e saj të fortë. Kjo, mes të tje-rash, vjen falë cilësisë së lartë të mallrave të saj komplekse industriale, sidomos në industrinë automobilistike dhe inxhinierinë mekanike e ndërtim. Përqindja e punonjësve industrialë mbetet në nivel të qëndrueshëm, 10 për qind më e lartë sesa në vendet e tjera të OECD-së (Egle 2006: 292).

Gjermania		
PBB-ja për frymë 2008	29 100 €	PBB-ja për frymë sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS); 1 PPS përkon me fuqinë blerëse me vlerë 1 euro (mesatare e BE27) (burimi: Eurostat)
Rritja mesatare ekonomike 1990–2007	1,4 %	Mesatarja e rritjes ekonomike vjetore për frymë me çmime konstante (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 195)
Borxhi kombëtar 2008	65,9 %	Borxhi kombëtar si përqindje e PBB-së (burimi: Ministria Federale e Financave të Gjermanisë, Raporti mujor 12/2009, f. 99)
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	6,4 %	Bilanci i të gjithë import-eksportit të mallrave si përqindje e PBB-së (burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: Parashikimi Ekonomik Botëror 10/2009, f. 187)
Norma e punësimit 2008	70,7 % (65,4 %)	Numri i personave në moshë pune (shifra për gratë jepet në kllapa), të grupmoshës 15–64 vjeçe në raport me popullsinë (burimi: Eurostat)
Norma e papunësisë 2008	7,3 %	(shifra për gratë jepet në kllapa),
Pabarazia në të ardhura, sipas koeficientit "Gini"	28,3 %	të grupmoshës 15–64 vjeçe në raport me
Të ardhurat e grave krahasuar me burrat	59 %	popullsinë (burimi: Eurostat)
Indeksi i varfërisë 2009	10,1 %	Indeksi i varfërisë përbëhet nga tregues të ndryshëm (përfshi jetëgjatësinë, shkallën e shkrimleximit dhe qasjen në kujdesin shëndetësor); 0 = varfëri minimale, 100 = varfëri maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, p. 180)
Norma e organizimit në sindikatë 2007	19,9 %	Raporti i popullsisë në moshë pune që janë të organizuar në sindikata (burimi: OECD)

6.4. Japonia

Werner Pascha

Japonia konsiderohet si rasti tipik i ekonomisë së koordinuar të tregut. Në spektrin e ekonomive të koordinuara të tregut, Hall dhe Soskice (2001: 34) e kategorizojnë Japoninë sipas "koordinimit në bazë grupi" (industrial). Kjo do të thotë se bashkërendimi i veprimtarive ekonomike bëhet përmes konglomerateve të bizneseve ndërsektoriale. Në Japoni bëhet përmes të ashtuquajturave keiretsu.

Japonia: Model i mirëqenies dhe barazisë sociale për një kohë të gjatë

Ashtu si Gjermania, Japonia konsiderohej si model i mënyrës për të arritur mirëqenie ekonomike dhe barazi sociale njëkohësisht (Kevenhörster, Pascha dhe Shire 2003).

Megjithatë, në kohën kur erdhi kriza ekonomike e fillimviteve '90, kjo famë ishte zbehur. Ajo që shkaktoi krizën ekonomike ishte "ekonomia flluskë"; me fjalë të tjera, plasja e flluskës spekulative. Fillimisht, edhe pse me hezitim, u ndërmorën reformat e tregut liberal, veçanërisht gjatë qeverisjes së Kryeministrit Koizumi (2001–2006).

Sistemi i financimit

Financimi i kompanive nga bankat

Sistemi japonez i financimit në periudhën e pasluftës ka qenë i orientuar nga bankat. Për dekada të tëra, instrumenti financues për kompanitë kanë qenë huatë bankare.

Nga ana e tyre, bankat mbështeteshin në masë të madhe te banka qendrore gjatë periudhës së parë të pasluftës, për shkak të mungesës së kapitalit. Nëpërmjet bankës qendrore, shteti mori një rol më të madh, që ishte i drejtpërdrejtë në raport me bankat dhe i tërthortë në raport me kompanitë.

Në përgjithësi, ishin sipërmarrjet e mëdha ato që përfituan nga sistemi. Shteti iu vendosi në dispozicion norma interesi të favorshme, nëse përmbushnin objektivat strategjike. Rezultati ishte një nivel i lartë investimesh dhe rritja e fortë, nga e cila përfitoi edhe forca e punës (Aoki dhe Saxonhouse 2000).

Megjithatë, shumë gjëra kanë ndryshuar që nga vitet '70. Kompanitë dhe bankat, falë ndërkombëtarizimit ekonomik dhe liberalizimit, kanë arritur të çlirohen nga lidhja e ngushtë me shtetin. Veçanërisht, kompanitë e mëdha kanë mundur të sigurojnë financime nëpërmjet tregut të kapitalit.

Një nga pasojat e paqëllimshme të këtij ndryshimi ishte ajo që përmendëm më sipër, “ekonomia e flluskës” e fundviteve ‘80 (Amyx 2004). Në vitin 1997, u miratua një paketë masash e njohur si “big bang”. Ideja ishte që Japonia të bëhej më tërheqëse si qendër financiare. Po u desh deri në vitin 2003 që pasojat afatgjata të plasjes së flluskës në sistemin bankar të mund të zgjidheshin.

Marrëdhëniet e punës

Sistemi i punës në Japoni ka qenë i orientuar drejt punësimit afatgjatë kohë përpara Luftës së Dytë Botërore, edhe pse, realisht, lulëzoi vetëm pas luftës (Demes 1998). Rritja sistematike e pagave, shpërblimet gjashtëmujore në varësi të rendimentit të kompanisë, përfitimet sociale tërheqëse dhe mundësitë e mira për rritje në karrierë u konceptuan për të ruajtur besnikërinë e punonjësve të kualifikuar.

Ky sistem u siguroi kompanive punonjës fleksibël, të besueshëm, të cilët ishin të interesuar që firma të kishte sukses dhe punonin për ta promovuar atë. Megjithatë, përfituesit kryesorë ishin punonjësit e rregullt meshkuj në kompanitë e mëdha, me fjalë të tjera, vetëm një e treta e popullsisë punonjëse.

Një nga anët e errëta të saj ishte varësia e madhe edhe e punonjësve të privilegjuar nga kompania e tyre. Përvoja profesionale lidhej ngushtë me një firmë. Lëvizshmëria e ulët midis kompanive, shumë orare të zgjatura dhe transferime, që shpërfillnin nevojat e jetës familjare ishin pasoja gati të pashmangshme.

Një anë pozitive është se dallimet në të ardhura në Japoni mbetën të arsyeshme, edhe midis drejtuesve të lartë dhe punonjësve të zakonshëm.

Në Japoni, sindikatat u shndërruan në normë gjatë periudhës së pasluftës. Edhe kur konfliktet ishin të shpeshta, drejtuesit e kompanisë dhe sindikata e kompanisë gjenin marrëveshje. Përfaqësimi i interesave të punëmarrësve në kompanitë më të vogla apo atyre me punonjës jo të rregullt ishte i papërfillshëm. Në përgjithësi, roli i sindikatave sa vjen e ulët për shkak të rritjes së larmisë së marrëdhënieve të punës dhe të interesave të punëmarrësve.

Edhe sistemi i punësimit afatgjatë po pëson sprapsje (Haak 2006). Në vitet ‘90 kur goditi kriza, të parët u prekën punonjësit më të vjetër që merrnin pagat më të larta. Punësimi i përkohshëm – për shembull, puna me kohë të pjesshme ose e nënkontraktuar – kanë marrë shumë më tepër rëndësi. Që nga viti 2003, paga

Punësim afatgjatë...

...me një anë të errët

Sindikatat e kompanive

mesatare thuajse nuk është rritur, pavarësisht suksesit relativ ekonomik.

*Arsim i
përgjithshëm
shtetëror...*

Sistemi i arsimit dhe formimit

Që nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, shteti ka garantuar arsimin bazë përmes institucioneve shtetërore. Thuajse të gjithë të rinjtë kryejnë më shumë sesa vetëm arsimin e detyrueshëm nëntëvjeçar. Objektivi i arsimit ka qenë për një kohë të gjatë nxitja e zellit, këmbënguljes dhe integritit social dhe përcjellja e dijeve themelore, në vend të nxitjes së krijimtarisë apo kultivimit të personalitetit të pavarur (Münch dhe Eswein 1998). Kjo nënkuptonte që vetëm të diplomuarit përshtateshin në mënyrë optimale me kompanitë që donin nga ana e tyre t'i pajisnin me kualifikimet specifike për ta.

*... dhe specializim në
kompani*

Nëpër kompani, "qarkullimi në punë" dhe "trajnimi në punë" janë mënyra si veprohet, si rezultat i së cilës aftësitë e përfuara janë kaq specifike për firmën, sa është gati e pamundur të lëvizësh në një kompani të re. Një tjetër karakteristikë e sistemit të formimit profesional është se të rinjtë "renditen" në përputhje me aftësitë e tyre, siç përshkruhet më sipër. Me anë të këtij filtrimi, kompanitë e mëdha që paguajnë mirë mund të zgjedhin lehtësisht kandidatët më të mirë, ndërkohë që ata që janë më pak të mirëpozicionuar dhe kanë lënë shkollën duhet të përshtaten me pozicionet e tyre.

Ka disa kohë që janë rritur shqetësimet se mbizotërimi i punonjësve të zellshëm por pak krijues nuk përputhet me mbajtjen e majës së përparimit teknologjik e organizativ. Përpos kësaj, vëmendja vetëm në një aspekt e të rinjve që hyjnë në tregun e punës nuk është më e duhura duke pasur parasysh një shoqëri që po plakët me shpejtësi. Për rrjedhojë, shkollat dhe universitetet duhet të zhvillojnë krijimtarinë dhe individualitetin, po ashtu, të sigurojnë kushte më të përshtatshme për më të vjetrit. Sikur kjo të mos mjaftonte, firmat po përpiqen të shkëputen nga format tradicionale të punësimit dhe masat për trajnim brenda kompanisë. Megjithatë, punësimi i të diplomuarve jashtë, pranimi i grave të kualifikuara në drejtim e kështu me radhë paraqesin sfida të mëdha

Marrëdhëniet midis kompanive

Ka një gamë të tërë marrëdhëniesh midis kompanive japoneze: shumë vëzhgues flasin për një ekonomi rrjeti (Lincoln dhe Gerlach 2004). Konglomeratet horizontale, si Mitsubishi ose Sumitomo, përbëhen nga kompani në sektorë të ndryshëm që ndërlidhen përmes shkëmbimit të personelit, kapitalit dhe meka-

Ekonomia e rrjetit

nizmave të tjera. Në konkurrencë me konglomeratet e tjera, ato kanë kultivuar avantazhe konkurruese të konsiderueshme, pa ngecur te specializimet tradicionale sipas sektorëve.

Konglomeratet vertikale i krijojnë lidhjet përgjatë zinxhirit të vlerave. Ndërkohë që kompania përgjegjëse mëmë - për shembull, Toyota – mund të garantojë cilësinë e produktit përfundimtar dhe është përgjegjëse për çështjet strategjike, një grup i parë furnitorësh kujdeset për komponentët e sistemit. Nivelet në varësi, që përbëhen kryesisht nga furnitorë të vegjël, merren me komponentë individuale. Kjo piramidë furnitorësh bën të mundur një fleksibilitet dhe përshtatshmëri të madhe, edhe nëse nivelet më të ulëta duhet të përballojnë një barrë të konsiderueshme kur shfaqen vështirësi.

Sistemi i orientuar nga kreditimi financiar prodhon marrëdhënie të mëtejshme midis bankave dhe kompanive. Në periudhën pas luftës, bankat luajtën një rol mbikëqyrës si banka të brendshme të kompanisë dhe, kështu, ishin shpesh më të rëndësishme se aksionarët. Sistemi japonez i drejtimit të biznesit u formësua së brendshmi nga hierarkia e drejtimit dhe së jashtmi nga bankat (Dirks dhe Otto 1998). Nëse kompania hasej me vështirësi, pritej që bankat ta mbështetnin, për të parandaluar krizën sistemike. Nga ana tjetër, shteti mori përsipër të garantonte vazhdimësinë edhe të institucioneve bankare më të dobëta. Me lidhjet personale midis bankierëve dhe kompanive dhe, deri diku, edhe nëpunësve civilë, mundësoheshin strategji afatgjata. Nga ana tjetër, kjo mund të çonte edhe në marrëveshje problematike, pa përjashtuar korrupsionin.

Ndërkohë, sistemi është përballur me një trysni të konsiderueshme. Rritja e varësisë nga tregjet ndërkombëtare të kapitalit po i detyron kompanitë t'i bëjnë më transparente marrëdhëniet dhe drejtimin e tyre. Kjo rrezikon t'i detyrojë kompanitë japoneze të punojnë në mënyrë afatshkurtër si kompanitë perëndimore, duke humbur pikat e forta të bashkëpunimit afatgjatë mbështetur në besim.

Vlerësim

Kapitalizmi i planifikuar japonez “bazuar në grup” ishte më i përshtatshmi për të nxjerrë në pah pikat e forta të sektorit të saj industrial në periudhën e pasluftës. Ai që në gjendje të përmirësonte gradualisht prodhimet e standardizuara industriale dhe t'i hidhte ato në tregun botëror në sasi të mëdha, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë e mirë e duke rritur vazhdimisht prodhimin. Financimi dhe mbikëqyrja

Mbikëqyrja e kompanisë nga bankat

Optimizimi i prodhimit industrial...

bankare krijuan mundësi për hartimin e strategjive afatgjata. Konglomeratet e fuqishme organizuan burimet për realizimin e këtyre strategjive. Sistemi arsimor vuri në dispozicion punonjësit e nevojshëm.

*... por edhe
probleme sociale e
politike*

Edhe pse ky mekanizëm krijoi disa probleme sociale dhe politike – për shembull, dallime midis kompanive të mëdha e të vogla, mungesa e mundësive për zhvillim personal, një lloj prirjeje për korrupsion – shumica e japonezëve përfituan në përgjithësi nga suksesi ekonomik.

*E ardhmja e modelit
japonez?*

Me ardhjen e ndërkombëtarizimit dhe përparimeve teknologjike e organizative, sidoqoftë, sistemi ka arritur kufijtë e vet. Barazia sociale po minohet dhe po e përball qeverinë me trysni të konsiderueshme, që është një arsye kryesore për qeveritë e paqëndrueshme, që nga dorëheqja e reformatorit të tregut, Koizumi.

Ndërkohë, ka lindur pyetja sesa shumë po lëviz sistemi ekonomik japonez në kahun e modelit të pakoordinuar anglo-amerikan (Dore 2000; Pascha 2004; Streeck/Yamamura 2003). Sidoqoftë, nuk duket se Japonia do të zgjedhë kapitalizmin e pakoordinuar. Treguesi imë i fortë i kësaj janë zhvillimet në drejtimin e kompanive. Veçanërisht, kombinimi i orientimit të tregut të kapitalit, politikës së personelit të orientuar nga tregu dhe hapjes së drejtimit, që është tipike e modelit të pakoordinuar, është ende jo shumë i dukshëm. Më shumë, mbizotërojnë forma të ndërmjetme, për shembull, integrimi i një politike personeli më të hapur me një model tradicional të pasluftës (Aoki/Jackson/Miyajima 2007).

Ende nuk është shfaqur një sistem i ri dhe koherent në brendësi.

Japonia

PBB-ja për frymë 2008	27 800 €	PBB-ja për frymë sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS); 1 PPS përkon me fuqinë blerëse me vlerë 1 euro (mesatare e BE27) (burimi: Eurostat)
Rritja ekonomike mesatare 1990–2007	1,0 %	Mesatarja e rritjes ekonomike vjetore për frymë me çmime konstante (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 195)
Borxhi kombëtar 2008	173,1 %	Borxhi kombëtar si përqindje e PBB-së (burimi: Ministria Federale e Financave e Gjermanisë, Raporti mujor 12/2009, f. 99)
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	3,2 %	Bilanci i të gjithë import-eksportit të mallrave si përqindje e PBB-së (burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: Parashikimi Ekonomik Botëror 10/2009, f. 187)
Norma e punësimit 2008	70,7 % (59,7 %)	Numri i personave në moshë pune (shifra për gratë jepet në kllapa), të grupmoshës 15–64 vjeçe në raport me popullsinë (burimi: Eurostat)
Norma e papunësisë 2008	4,0 %	Raporti i njerëzve të papunë në popullsinë në moshë pune (burimi: Eurostat)
Pabarazia në të ardhura, sipas koeficientit Gini	24,9 %	Raporti që tregon shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave; 100% = pabarazi maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, f. 195)
Të ardhurat e grave krahasuar me ato të burrave	45 %	Përqindja e të ardhurave të grave krahasuar me ato të burrave (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 186)
Indeksi i varfërisë 2009	11,6 %	Indeksi i varfërisë përbëhet nga tregues të ndryshëm (përfshi jetëgjatësinë, normën e shkrim-leximit dhe qasjen në kujdesin shëndetësor); 0 = varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, p. 180)
Norma e organizimit në sindikatë 2007	18.3 %	Raporti i popullsisë në moshë pune që është të organizuar në sindikata (burimi: OECD)

6.5. Suedia

Erik Gurgsdies

*Punësim i plotë me
"politikë pagash
bazuar në solidari-
ritet"*

Modeli "Rehn-Meidner"

Politika ekonomike suedeze bazohet tek i ashtuquajhuri modeli "Rehn-Meidner", që e merr emrin nga dy ekonomistët sindikalistë Gösta Rehn dhe Rudolf Meidner. Në vitin 1951, ata hartuan një model të përgjithshëm ekonomik që synonte të pajtonte punësimin e plotë me "politikën e pagave të bazuar në solidaritet", por pa shkaktuar procese inflacioniste.

Idėja themelore ishte se punësimi i plotë nuk mund të arrihet përmes një kërkesë agregate përgjithësisht të lartë, qoftë kjo e krijuar nga zhvillimet e favorshme në ekonominë globale apo nga programe kombëtare të nxitjes ekonomike. Duke qenë se sektorët individualë ekonomikë rriten me ritme të ndryshme, kërkesa vazhdimisht e lartë agregate çon shumë shpejt në krijimin e pengesave. Që të ruhet rritja në dritën e kësaj situate, sektorët ku shfaqen pengesat rreken të tundojnë punonjësit që të lëvizin nga sektorë të tjerë. Me punësimin e plotë, kjo mund të arrihet vetëm duke rritur pagat, çka sjell rritje çmimesh në këta sektorë. Për pasojë, për të kompensuar humbjet në fuqinë blerëse, pagat rriten në fushat e tjera, çka çon në rritje të çmimeve në të gjithë sektorët e, rrjedhimisht, të inflacionit në ekonominë kombëtare.

Politika e pagave solidare

Ç'është më e keqja, nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, sindikatat suedeze ndoqën të ashtuquajturën "politikë të pagave solidare". Ajo kishte dy parime kryesore. Së pari, aspironte zbatimin e parimit të "pagës së barabartë për punë të barabartë" dhe bazohej në përcaktimin e rendimentit mesatar të punës. Së dyti, hendeku në pagë midis llojeve të ndryshme të punës duhej ulur. Kushti për arritjen e këtyre objektivave ishte vendosja si përparësi e negociimit për pagat në nivel qendror, në vend të niveleve më të ulëta.

*Avantazhet dhe
dizavantazhet e
modelit "Rehn-
Meidner"*

Për të parandaluar që përfitimet që rrjedhin nga "politika e pagave të solidaritetit" të humbasin nga inflacioni, modeli "Rehn-Meidner" rekomandoi një politikë të rreptë të financave publike, që e mban nën kontroll kërkesën agregate, plus tepërcat buxhetore.

Ky koncept i politikës ekonomike i vendos në pozita mbrojtëse kompanitë me produktivitet të ulët në dy mënyra: së pari, ato përballen me probleme në shitje

kur kërkesa është e moderuar, për shkak të strukturës së dobët të kostos dhe çmimit; së dyti, “politika e pagave të solidaritetit” e përkeqëson situatën e tyre tashmë të vështirë në raport me kostot dhe konkurrueshmërinë, pasi iu hap rrugë kërkesave në lidhje me pagat në të gjitha fushat dhe në të gjitha kompanitë, në përputhje me produktivitetin mesatar të punës.

Në kundërshtim me këtë, situata i jep përparësi kompanive me produktivitet të lartë në dy mënyra: së pari, ato përballen me një kërkesë të lartë mbështetur në një kosto të mirë dhe çmime të favorshme; së dyti, marrëveshjet për pagat i përshtaten qëllimisht produktivitetit mesatar, duke krijuar si rezultat një lloj hapësire për të manovruar, falë produktivitetit të lartë. Në këtë mënyrë, këto kompani përfutojnë rritje të kapitalit për krijimin e vendeve të punës me produktivitet të lartë.

Kompanitë me produktivitet të ulët dhe punëmarrësit e tyre humbin si rezultat i politikës së rreptë të financimit publik dhe “politikës së pagës së solidaritetit”. Papunësia që vjen si rezultat nuk shihet se është problem publik, por konsiderohet në mënyrë proaktive si çështje që kërkon veprim publik. Kështu, u zhvillua një “politikë selektive e tregut të punës”, që zgjerohet dhe përpunohet në mënyrë të vazhdueshme. Nëpërmjet veprimtarive të gjera trajnuese dhe lëvizshmërisë së asistencës, u bënë përpjekje të mëdha për të kualifikuar të papunët, si dhe personat që hynin rishtas apo ktheheshin pas një ndërprerjeje në tregun e punës, për të siguruar punë produktive dhe të mirëpaguara.

Atëherë, në bazë të modelit “Rehn-Meidner”, politikat e rrepta fiskale, “politika e pagës së solidaritetit” dhe “politika përzgjedhëse e tregut të punës” çojnë drejt përtëritjes së vazhdueshme dhe përshtatjeve strukturore të ekonomisë suedeze. Që nga vitet ‘60, ky model, herë më shumë e herë më pak, ka shërbyer si udhëzues për politikën ekonomike suedeze. Në përgjithësi, modeli ekonomik suedez ka qenë i karakterizuar nga një “koherencë konceptuale [unitet] dhe pranim politik, të cilit vendet e ngjashme me të zor se i janë afruar”, siç u shpreh Fritz W. Scharpf në vitin 1987, bazuar në krahasimin e politikës ekonomike socialdemokrate në Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Austri dhe Suedi (Scharpf 1987: 119). Ky gjykim vlen edhe sot. Me tregun e vogël të brendshëm prej më pak se 10 milionë banorësh, Suedia ia ka dalë mbanë, pavarësisht trazirave të globalizimit, jo vetëm të ruajë një ekonomi mjaft konkurruese në tregun global, por edhe të intensifikojë tregtinë e saj të mallrave dhe, më së fundi, ofrimin e shërbimeve. Aktualisht, eksportet përbëjnë gjysmën e PKB-së.

Trysnia mbi kompanitë me produktivitet të ulët

Kompanitë më produktive janë të favorizuara

Papunësia konsiderohet në mënyrë proaktive si detyrë që kërkon veprim publik

Shkallë e lartë pranimi i modelit suedez

Sistemi i financimit dhe struktura e pronësisë

Financimi i kompanive në Suedi përmban një sërë elementesh. Para së gjithash, ky financim bazohet në sistemin e veçantë të bankave të brendshme. Ka po kështu edhe elemente të financimit nga kapitali, por me specifikën që pronësia e kryqëzuar e aksioneve është e përhapur te kompanitë suedeze. Kështu, një karakteristikë kyçe e financimit të biznesit në Suedi, është edhe parashikimi afatgjatë. Sistemi suedez i financimit i ngjan atij të Gjermanisë, që njihej prej një kohe të gjatë si “kapitalizmi i Rinit”.

Sistemi i formimit profesional

Në Suedi, u kuptua që herët se në një ekonomi të globalizuar “lënda e parë” më e rëndësishme e një ekonomie konkurruese është arsimiti. Formimi profesional në Suedi zhvillohet në arsimin e mesëm të lartë (midis grupmoshës 16-20 vjeçe). Thuajse të gjithë studentët angazhohen vullnetarisht në të. Përveç rrugës akademike, ka 14 programe kombëtare që ofrojnë formim profesional specifik.

Një parim bazë i politikës arsimore suedeze është shmangia e situatave arsimore pa rrugëdalje sa më shumë të jetë e mundur. Për këtë arsye, formimi profesional specifik plotësohet në një nivel të konsiderueshëm me më shumë arsim të përgjithshëm dhe kualifikimet profesionale janë të kombinuara me kualifikimet hyrëse në arsimin e lartë. Në vitin 2006, shkalla e kalueshmërisë për dëftesën e pjekurisë, për shembull, ishte 94,6 për qind.

Gjithashtu, është karakteristike për sistemin suedez të arsimit dhe formimit numri i madh i mundësive të formimit të vazhduar përgjatë gjithë jetës në punë. Siç e kemi parë tashmë, objektivi i politikës suedeze ekonomike dhe të punësimit nuk është mbrojtja e vendeve ekzistuese të punës, por më tepër t’u japë njerëzve mundësi të nisin punë produktive dhe, kështu, më konkurruese në kuadrin e konkurrencës ndërkombëtare. Kështu, në sistemin e arsimit dhe formimit kombinohet formimi i përgjithshëm dhe i specializuar për të gjithë popullsinë.

Marrëdhëniet e punës

Kur u bë e dukshme se socialdemokratët nuk do të rrëzoheshin nga qeverisja për të ardhmen e afërt, punëdhënësit i pranuan sindikatat si partnerë me të drejta të plota në bisedime për të ashtuquajturën Marrëveshja e Saltsjöbaden-it të vitit 1938.

Marrëveshja nënkuptonte se shteti do të mbahej larg rregullimit të tregut sa më shumë të ishte e mundur. Për mbi 30 vitet e ardhshme vazhdoi të ishte kështu. Tregu i punës ishte i qetë dhe zhvillimi i pagave kontrollohej në rrugë qendrore me anë të marrëveshjes së pagave. Nuk kishte thuarje asnjë akt ligjor për tregun e punës.

Kjo periudhë bashkëpunimi u pasua nga një përballje që nisi prej fillimit të viteve '70, deri në vitin 1998. Sistemi qendror i negocimit të pagave u zhbë gjithnjë e më shumë. Veçanërisht, si rezultat i kufizimeve të vendosura nga Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes në kuadër të anëtarësimit në BE, u bë e qartë për të dyja palët se sistemi i negocimit të pagave duhej ngritur tanimë mbi baza të reja. Nxitur nga qeveria socialdemokrate, sindikata më e rëndësishme industriale dhe punëdhënësit arritën të ashtuquajturën “Marrëveshje të industrisë” (Industrins samarbetsavtal) në vitin 1998.

Marrëveshja e industrisë bazohej në shtyllat që vijojnë: së pari, një grup rregullash që synonin uljen në minimum të periudhave pa marrëveshje, që me gjasë do të çonin në konflikt. Për këtë arsye, bisedimet për marrëveshjen vijuese duhet të fillojnë përpara se afati i asaj ekzistuese të përfundojë. Së dyti, arbitrat jopartiakë të emëruar publikisht përfshihen në bisedime dhe ndikojnë në drejtim të marrëveshjes, në përputhje me normat e BE-së. Së fundi, u ringjall ideja që sektori privat i eksporteve duhet të ketë funksion orientues për pagat. Pjesë të konsiderueshme të Marrëveshjes së industrisë u miratuan më vonë edhe për sektorin publik.

Sindikatat në Suedi kanë një pozitë shumë të fortë dhe norma e organizimit është e lartë, në 70 për qind. Në këtë kontekst, është mëse e natyrshme që bashkëvendimmarrja në ndërmarrje duhet organizuar nga sindikatat. Dublimi gjerman në formën e këshillave autonome të punës nuk njihet në Suedi.

Bashkëvendimmarrja në nivel kompanie – sërish krahasuar me Gjermaninë - nuk është e institucionalizuar me ligj. Në Suedi, rruga e ndjekur ishte t'u jepeshin sindikatave të drejta për të negociuar të gjitha llojet e çështjeve lidhur me bashkëvendimmarrjen. Për konfliktet që lindin nga bashkëvendimmarrja, ato kanë të drejtë të hyjnë në grevë, edhe kur ka në fuqi kontrata kolektive (pagash

Marrëdhëniet midis kompanive

Jo vetëm sindikatat, por edhe shoqatat e punëdhënësve kanë një nivel të lartë organizimi në Suedi. Pasja e partnerëve të fortë nga të dyja palët ishte një prej arsyeve kryesore të suksesit të marrëveshjeve të lartpërmendura midis punëdhënësve dhe sindikatave. Karakteristikë e Suedisë është edhe pronësia e kryqëzuar e kompanive. Përveç marrëdhënies të tregut, së fundi, ka edhe shumë rrjete informacioni për bizneset, për shembull, në lidhje me sigurimin e kapitalit të kompanisë, por edhe për qëllime të transferimit të teknologjisë, në kuadrin e bashkëpunimit midis kompanive.

Vlerësim

Nga të gjitha vendet e shqyrtuara në këtë libër, Suedia i afrohet më shumë modelit ideal të ekonomisë së koordinuar të tregut. Ekonomia suedeze karakterizohet nga fakti që punëdhënësit dhe punëmarrësit bashkëpunojnë intensivisht për caktimin e pagave; të dyja palët e tregut të punës janë të përfshira në ofrimin publik të formimit profesional dhe financimi i kompanive përfshin një kombinim të bankave të brendshme, pronësisë së kryqëzuar në ndërmarrje dhe rrjeteve të informacionit të biznesit, për sigurimin e kapitalit të kompanisë. Këto rrjete informimi që kanë synim transferimin e teknologjisë përdoren edhe për vendosjen e bashkëpunimit midis firmave.

Suedia është e jashtëzakonshme, pasi sistemi i saj ekonomik i koordinuar dhe një shtet i fortë i mirëqenies kanë qenë të aftë të kombinojnë rritjen e lartë, shpërndarjen e drejtë të pasurisë dhe papunësinë e ulët. Krahasuar me ShBA-në, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë dhe Japoninë, Suedia u afrohet më shumë kërkesave të socialdemokracisë.

Suedia		
PBB-ja për frymë 2008	30 100 €	PBB-ja për frymë sipas standardeve të fuqisë blerëse (PPS); 1 PPS përkon me fuqinë blerëse me vlerë 1 euro (mesatare e BE27) (burimi: Eurostat)
Rritja ekonomike mesatare 1990–2007	2,3 %	Mesatarja e rritjes ekonomike vjetore për frymë me çmime konstante (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 195)
Borxhi kombëtar 2008	38,0 %	Borxhi kombëtar si përqindje e PBB-së (burimi: Ministria Federale e Financave e Gjermanisë, Raporti mujor 12/2009, f. 99)
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	7,8 %	Bilanci i të gjithë import-eksportit të mallrave si përqindje e PBB-së (burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: Parashikimi Ekonomik Botëror 10/2009, f. 187)
Norma e punësimit 2008	74,3 % (71,8 %)	Numri i personave në moshë pune (shifra për gratë jepet në kllapa), të grupmoshës 15–64 vjeçe në raport me popullsinë (burimi: Eurostat)
Norma e papunësisë 2008	6,2%	Raporti i njerëzve të papunë në popullsinë në moshë pune: Eurostat)
Pabarazia në të ardhura, sipas koeficientit “Gini”	25 %	Raporti që tregon shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave; 100% = pabarazi maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, f. 195)
Të ardhurat e grave krahasuar me ato të burrave	67 %	Përqindja e të ardhurave të grave krahasuar me ato të burrave (burimi: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2009, f. 186)
Indeksi i varfërisë 2009	6,0 %	Indeksi i varfërisë përbëhet nga tregues të ndryshëm (përfshi jetëgjatësinë, shkallën e shkrim-leximit dhe qasjen në kujdesin shëndetësor); 0 = varfëri minimale, 100 = varfëri maksimale (burimi: Raporti për Zhvillimin Njerëzor 2009, p. 180)
Norma e organizimit në sindikatë	70.8 %	Përqindja e popullsisë në moshë pune e organizuar në sindikata (burimi: OECD)

7. POLITIKAT EKONOMIKE: SHEMBUJ PRAKTIKË

Psikologu social Kurt Lewin mendohet se ka thënë, “asgjë nuk është më praktike (në kuptimin ‘e dobishme’) se një teori e mirë”. Për ta bërë më të qartë rëndësinë që kanë në praktikë teoritë e paraqitura në kapitujt e mësipërm mbi çështjet ekonomike dhe të demokracisë sociale, janë marrë raste praktike si referim.

Në këtë kapitull përmbyllës, këto referenca janë marrë nga shembuj praktikë prej një sërë fushash të debatueshme të politikave. Ideja është të bëhet e qartë se si pasqyrohen vlerat bazë të socialdemokracisë në politikën e përditshme ekonomike dhe si mund të vihen në zbatim parimet e tyre të politikës ekonomike.

Në këtë seri publikimesh nuk ka një vëllim të veçantë për politikën e tregut të punës, duke qenë se për demokracinë sociale kjo është një fushë politike kyçe e, si e tillë, trajtohet në çdo vëllim. Kështu, politika e tregut të punës ka rëndësi të posaçme në këtë vëllim për “ekonominë dhe demokracinë sociale”. Për këtë qëllim, janë marrë dy shembuj praktikë, “puna e denjë” dhe “pagat minimale”.

Kontributet e paraqitura këtu përfshijnë një larmi autorësh me pikëpamje të ndryshme. Shembujt nuk mund të ofrojnë përgjigje absolute për rrethana që janë në ndryshim të vazhdueshëm, por përbëjnë një përpjekje për të parashtruar ide e për ta bërë lexuesin të mendojë.

Shembujt praktikë në këtë kapitull trajtojnë

- Politika industriale mjedisore: si mund të krijohen, me ndihmën e qeverisë, tregje pararojë që nxitin novacionin, rritjen dhe punësimin;
- buxheti i shtetit: rrethanat në të cilat huamarrja e qeverisë është me vend në raport me politikën e investimeve;
- privatizimi: avantazhet e tij, si duhet organizuar në kuptimin e politikave dhe në cilat raste duhet shmangur;
- puna e denjë dhe bashkëvendimmarrja: ato janë të ndërthurura dhe çështje kyçe për socialdemokracinë;
- pagat minimale: të nevojshme për të ulur punësimin e pasigurt, por edhe si reagim ndaj çështjeve gjinore.

7.1. Politika industriale mjedisore: Politika e rritjes për një të ardhme të qëndrueshme¹⁴

Peter Franz, Florian Mayer dhe Stefan Tidow

Mjedisi do të jetë një shtysë kryesore në ekonomitë e shekullit të njëzetënjëtë. Kërkesa për energji dhe lëndë të para është rritur jashtë mase vitet e fundit dhe do të vazhdojë kështu. Gjatë katër dekadave të ardhshme, popullsia e Tokës, nga gjashtë miliardë, do të rritet në nëntë miliardë. Numri i atyre që jetojnë në shoqëritë e industrializuara do të trefishohet në të njëjtën periudhë me rreth katër miliardë njerëz. Si pasojë, kërkesa për mallra konsumi të prodhuara në mënyrë industriale do të rritet jashtë mase. Sipas vlerësimeve, vetëm në Brazil, Rusi, Indi dhe Kinë (të ashtuquajturat vendet BRIK), gjatë tri viteve që vijnë, klasa e mesme që ka para për të shpenzuar dhe është e gatshme të shpenzojë do të dyfishohet në numër. Megjithatë, lënda e parë e planetit tonë është po aq e kufizuar sa hapësirat që mund të ndërtohen ose kultivohen. Ajri dhe uji janë burime të çmuara. Edhe energjia nuk është e pashtershme – sigurisht, ajo që përftohet nga burimet konvencionale, e cila ende përbën shumicën e energjisë në përdorim.

Shkurt, sfidat ekonomike dhe mjedisore po bëhen gjithnjë e më të ndërthurura. Ka mbaruar koha kur mjedisi dhe ekonomia ende mund të shiheshin si krejt të ndara. Ajo çfarë dikton mjedisi do të bëhet gjithnjë e më shumë e nevojshme ekonomikisht dhe jo vetëm në pikëpamjen ekonomike kombëtare, por edhe në nivel ndërmarrjeje. Për shembull, Sër Nicholas Stern, ish-kryeekonomisti i Bankës Botërore, i llogarit kostot ekonomike të ndryshimeve të pakontrolluara klimaterike deri në 20 për qind të PBB-së globale.

Ky ndryshim në raportin midis ekonomisë dhe mjedisit ka pasoja të drejtpërdrejta mbi politikat. Për ta tepruar vetëm pak, dikush mund të thotë se politika mjedisore po bëhet gjithnjë e më tepër një politikë ekonomike. Kjo strategji e politikës industriale mjedisore merr parasysh këtë zhvillim dhe del në përfundimin se energjia dhe burimet janë bërë një problem kryesor ekonomik, mjedisor e social në nivel kombëtar e global.

¹⁴Informacion i mëtejshëm rreth lidhjeve të ngushta midis mjedisit dhe ekonomisë mund të gjendet në Raportin për Ekonominë e Gjelbër, botuar për herë të parë në vitin 2009 nga Ministria Gjermane e Mjedisit dhe Agjencia Federale e Mjedisit: www.umweltwirtschaftsbericht.de.

► Politika e rritjes së qëndrueshme po bëhet pjesë e agjendës së novacionit, rritjes dhe punësimit

Politikat industriale mjedisore krijojnë lidhjen ndërmjet strategjive modernizuese ekonomiko-mjedisore për më shumë qëndrueshmëri me strategjitë e specializuara ekonomiko-mjedisore. Kjo nuk është thjesht një përgjigje ideologjike për sfidat e kohës sonë, por më shumë përvijon një drejtim pragmatik që orientohet nga objektivat.

Në thelb, ajo ka të bëjë me dy gjëra. Së pari, na duhet të strukturojmë ekonominë mbi baza të qëndrueshme. Kjo ka të bëjë me strukturat e prodhimit dhe rrotullohet rreth efikasitetit të energjisë. Këtu përfshihet jo vetëm përdorimi më efikas, por dhe një ndryshim kursi drejt lëndëve të para të ripërtëritshme. Nga biomasat mund të prodhohet jo vetëm karburant, por edhe plastikë dhe materiale moderne. E kotë të thuhet se, në kuadrin e politikës energjetike, kjo përfshin edhe përdorimin më të mirë të burimeve të energjisë së ripërtëritshme, si dielli, era, uji, energjisë gjeotermike dhe biomasës, si dhe shfrytëzimin e plotë të potencialit të saj. Në periudhën afatgjatë, thjesht nuk ka tjetër alternativë. Vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të tejkalojmë dilemat strukturore të lëndëve të para të kufizuara dhe kërkesës në rritje dhe, si rrjedhojë, të shkëpusim zhvillimin nga konsumimi i burimeve. Megjithatë, qëllimi i politikës industriale mjedisore nuk kufizohet te ky ndryshim kursi, por po ashtu lidhet me përdorimin optimal në ekonomi të mundësive që vihen në dispozicion në këtë mënyrë. Vetëm fakti që energjia në mbarë botën po bëhet më e shtrenjtë dhe lëndët e para po bëhen më të rralla, u jep një potencial të jashtëzakonshëm teknologjive të gjelbra, duke i shndërruar mirëfilli në tregun udhëheqës të së ardhmes. Teknologjitë efikase dhe ato mjedisore po kthehen në teknologji kyçe.

Konsulentët e menaxhimit kanë vlerësuar se tregu global i teknologjisë mjedisore ka tashmë një vlerë prej 1 000 miliardë eurosh. Sipas parashikimeve, në vitin 2020, kjo vlerë do të jetë dyfishuar në 2 000 miliardë euro. Gjermania është tanimë eksportuesi kryesor global i mallrave mjedisore dhe udhëheqës botëror në treg në shumë fusha të teknologjisë. Kjo e vendos vendin në një pozitë të mirë për të krijuar fitime nga tregjet e gjelbra në të ardhmen, nëse supozojmë që do të arrijë të ruajë avantazhin teknologjik. Megjithatë, siç e ka treguar edhe përvoja, kjo varet shumë nga zbatimi i një politike ambicioze mjedisore, që po shndërrohet në një motor modernizimi me kërkesat rigoroze që ka vendosur për proceset e prodhimit dhe produktet.

Politika industriale mjedisore do të çojë gjithashtu në një ndërthurje të këtyre dy dimensioneve. Për këtë qëllim, shteti duhet të formulojë objektiva kërkuese dhe të hartojë kuadrin e duhur, që të funksionojë si pionier dhe të shohë nga e ardhmja, por edhe të vihet në krye kur është nevoja. Edhe pse tregu po u përgjigjet përherë e më shumë realiteteve që ndryshojnë, ai prapë është tejet i ngadaltë në shumë raste. Deri më tash, ai nuk ka arritur të parashikojë sfidat dhe mundësitë në mënyrë të kënaqshme. Nëse e marrim seriozisht atë që na thotë shkenca për ndryshimin e klimës, na kanë mbetur vetëm pak vjet për të hedhur hapin e rëndësishëm e për të ndryshuar drejtim, çka është kaq e nevojshme. Kohë ka shumë pak, natyrisht, për ta humbur në debate boshe rreth rregullave e parimeve të përgjithshme. Ajo çfarë duhet është një kombinim praktik i instrumenteve dhe qasjeve të ndryshme të politikave dhe ndërthurja inteligjente e politikës mjedisore e novacionit në kuadrin e shtetëror me dështimin e tregut. Për ta bërë këtë, qeveria duhet të shfrytëzojë një gamë të gjerë instrumentesh politike dhe ekonomike në mënyrë të tillë që të nxitë fillimin e novacioneve, zbatimin e teknologjive efikase ekologjike, t'i japë hov ristrukturimit të ekonomisë dhe shoqërisë me efikasitet energjetik dhe të burimeve dhe, në të njëjtën kohë, të stimulojë rritjen dhe punësimin.

► Parimet e politikës industriale mjedisore

Tipari karakteristik i qasjes së politikës industriale mjedisore është kombinimi i një sërë aspekteve:

1. Instrumentet e kërkesës dhe ofertës duhet të jenë të kombinuara në mënyrë inteligjente. Shpesh, politikat e kërkesës dhe ofertës paraqiten si dy të skaje kundërta që nuk pajtohen. Megjithatë, kërkimi rreth novacionit tregon se mënyra më e mirë për të ushqyer dhe sjellë në treg teknologji novatore është të sigurohet ndërveprimi i një kuadri të mirë politik të ofertës me aktivizimin e kërkesës. Megjithatë, kjo ndodh vetëm nëse politika merr parasysh si aspektin e ofertës, ashtu edhe atë të kërkesës.

2. Kushtet e një kuadri rregullator të përlogaritur janë po aq të rëndësishme sa objektivat ambicioze. Kompanitë duhet ta dinë se ku janë. Për këtë arsye, politika nuk duhet të jetë arbitrare. Sidoqoftë, siguritë në planifikim nuk duhet t'i bëjnë kompanitë të flenë mbi dafina apo të mos përballen me "sfidat e së ardhmes". Konkurrenca nuk fle kurrë. Veçanërisht, ekonomitë aziatike në rritje po popullojnë tregjet botërore. Objektivat ambicioze afatgjata dhe të parashikueshme përbëjnë një element të rëndësishëm për një politikë që ekuilibron planifikimin

dhe dinamizmin. Një shembull tjetër është e ashtuquajtura qasje e “të parit në garë”, që orientohet drejt teknologjisë më të fundit. Për rrjedhojë, kompanive mund t’u kërkohet të bëjnë vetëm atë çka është praktike edhe e realizueshme, por vetëkënaqësia nuk është alternativë.

3. Çmimet duhet “të tregojnë të vërtetën” pa minuar konkurrueshmërinë. Çmimet janë njësi të rëndësishme për matjen e mungesave, që nuk duhet të na bëjnë të mbyllim sytë përballë së vërtetës mjedisore. Kryerja brenda për brenda kompanisë e kostove të jashtme dhe tregjet funksionale janë shtyllat kryesore të një politike industriale mjedisore. Faktoringu i “kostove të vërteta” mbetet i vështirë në praktikë, për shembull, kur nuk merren në konsideratë në konkurrencën ndërkombëtare apo vështirësia që ka përlllogaritja e kostove që do të lindin në të ardhmen.

4. Kërkimi nuk duhet të jetë vetëm teknologjik dhe, në të njëjtën kohë, ai duhet qëllimisht të nxitë përparimin dhe të ‘shtrojë shinat’. Asnjë nuk mund ta dijë sot se cilat teknologji do të fitojë në të ardhmen. Kjo është arsyeja përse politikat duhet të mos jenë specifike për teknologjinë e t’i kushtohen vetëm një gjëje. Një politikë “*technology forcing*¹⁵” vendos objektiva ambicioze, por nuk ofron strategjitë për gjetjen e zgjidhjeve teknologjike për përmbushjen e tyre. Nga ana tjetër, ka linja të veçanta teknologjike që tregu i vetëm nuk i zhvillon dot, por që premtojnë shumë lidhur me potencialin për të zgjidhur problemet. Politika kërkimore dhe teknologjike e qeverisë, po ashtu, duhet t’i ketë parasysh këto duke nxitur projekte eksperimentale pilot dhe projekte fanar me rëndësi simbolike.

5. Qasjet horizontale dhe politikat sektoriale duhet të plotësojnë njëra-tjetrën. Kuadri rregullator duhet hartuar në mënyrë të tillë që ta drejtojë krejt ekonominë në një kurs novatorizmi mjedisor. Kjo nuk është thjesht çështje e politikave rregullative mjedisore, por është edhe çështje konkurrence, taksash dhe politikave ekonomike. Për këtë duhet, gjithashtu, një infrastrukturë efikase, bashkëkohore dhe miqësore me mjedisin, si dhe punonjës të kualifikuar. Ky dimension horizontal është thelbësor. Sidoqoftë, do të ketë përherë fusha në të cilat ndryshimet strukturore duhen përshpejtuar mbi baza sektoriale. Këtu përfshihet nxitja e teknologjive dhe industrive kryesore duke pasur pikësynime të qarta, pasi, në

15 “Technology forcing” është një strategji, në të cilën një institucion rregullator përcakton një objektivi, për të ardhmen, i cili nuk mund të realizohet duke zbatuar teknologjitë aktuale. (shën. i redaktorit)

të kundërt, do të jetë e pamundur të dalim nga strukturat e vjetruara e të konsoliduara të tregut apo të sigurojmë që interesat strategjike afatgjata të luajnë një rol në konkurrencën ndërkombëtare. Për më tepër, teknologjia nuk mund të hedhë hapa përpara vetëm me anë të menaxhimit të kujdesshëm të kushteve të kuadrit të përcaktuar.

Për një ristrukturim të shoqërisë industriale që orientohet nga burimet nuk duhen vetëm sipërmarrës novatorë dhe një shtet pararojë. Duhet edhe punonjës me punë të denja, të cilët “e bëjnë punën mirë”, si dhe konsumatorë aktivë, të cilët vënë në lëvizje stimuj të rëndësishëm modernizimi “nga poshtë lart” me anë të kërkesave të tyre. Së fundi, ajo çka duhet është jo pak, por një “Kurs i ri” për të gjithë të interesuarit, për t’u përballur me sfidat e një bote që ndryshon dhe për të ndjekur një strategji modernizuese ekonomiko-mjedisore.

Skena politike dhe ekonomike ka ndryshuar ndjeshëm. Është e qartë se ekonomia dhe mjedisi janë më të ndërlidhura se kurrë dhe se Gjermania, e cila dëshiron të pozicionohet si një vend biznesi i qëndrueshëm, ka nevojë për prodhim miqësor me mjedisin e shoqërinë, me produkte e shërbime të qëndrueshme, punonjës të mirëkualifikuar dhe trajnim të mirë. Shtegun për këtë do ta hapë politika industriale mjedisore.

7.2. Politika buxhetore: Çfarë i detyrohem Gjermanisë

Michael Dauderstädt¹⁶

Borxhi kombëtar i Gjermanisë aktualisht po shkon në mbi 1,5 miliardë euro. Shlyerja e tij do të përpinte një masë të konsiderueshme të të ardhurave nga tatimet ose do të kërkonte hyrjen më thellë në borxh. Kësisoj, ai vendos një barrë mbi brezat e ardhshëm, që do të duhet t’i paguajnë këto borxhe. E ashtuquajtura “frena e borxhit” është paraqitur si mënyrë për të ndaluar këtë rritje të borxhit kombëtar. Ideja përkon me parashikimin bazë që qëndron në themel të Paktit Evropian për Stabilitet dhe Zhvillim,

¹⁶Ky është një variant i shkurtuar i botimit WISODirekt në gusht 2007, “Was wir Deutschland schulden” (Çfarë i detyrohem Gjermanisë), rishikuar në dritën e krisës së tregut financiar të vitit 2008.

që supozon se në një periudhë afatgjatë – domethënë, gjatë ciklit ekonomik – nuk do të ketë borxh të ri të konsiderueshëm. Megjithatë, një politikë e mençur financiare, përveç shlyerjes së borxhit, duhet të përfshijë si alternativë, një politikë ekonomike aktive që synon përtëritjen dhe investimin. Kjo nuk duhet të përbëjë pengesë për të.

Politikisht dhe ekonomikisht, dy dimensionet e borxhit kombëtar duhen dalluar nga njëri-tjetri: deficitin që rrjedh si pasojë e faktorëve ekonomikë dhe borxhi afatgjatë që buron nga financimi i investimeve që nxisin zhvillimin. Për shumicën e ekonomistëve, të dy këto dimensione janë themelore, edhe pse shkalla e tyre është e diskutueshme.

➤ Zhvillim përmes borxhit?

Gjatë rënies ekonomike, të ardhurat e shtetit tkurren, ndërsa shpenzimet, sidomos për përfitimet e papunësisë, rriten. Deficiti që vjen si rrjedhojë e kësaj, stabilizon kërkesën, që, në të kundërt, do të pësonte rënie. Shumë qasje moderne ndaj konsolidimit i vlerësojnë këta stabilizatorë automatikë si shumë të dobishëm. Në Gjermani, ligji i vitit 1967 për stabilitetin dhe rritjen e parashikon një politikë të tillë kundërciklike, edhe pse në rastin e atëhershëm u vu në zbatim një politikë prociklike.¹⁷ Kur ndodhin kriza, politika financiare ka reaguar shpesh ndaj rritjes së deficitit, duke zbatuar masa shtrënguese paniku, që vetëm sa kanë shërbyer për të thelluar e zgjatur vuajtjen. Në kundërshtim me këtë, gjatë periudhave të rritjes ekonomike, nuk janë bërë aspak përpjekje konsoliduese, duke sjellë si pasojë rritjen e borxhit të përgjithshëm.

Një politikë ekonomike aktive duhet të administrojë shpenzimet publike në mënyrë të tillë që të ketë një efekt kundërciklik. Në rastin ideal, në krizë shpenzimet do të rriteshin, edhe nëse rritet deficitin dhe borxhi kombëtar, me qëllim që të kompensojë kërkesën e sektorit privat që është më e dobët. Nga një pikëpamje ciklike, nuk ka rëndësi nëse kjo përfshin investimet apo konsumin shtetëror, edhe pse efekti i rritjes është më i qëndrueshëm në rastin e investimeve. Në periudha lulëzimi ekonomik, shpenzimet duhet të ulen që të kundërveprojnë ndaj “mbinxehjes” së kërkesës dhe të konsolidojnë buxhetin.

Në Gjermani, përpara se të zbatohet koncepti i ‘frenave’ të borxhit, Kushtetuta parashikonte se huamarrja nga qeveria duhej përdorur vetëm për financimin e investimeve. Kjo ishte shprehje e pikëpamjes se barra e shpenzimeve financuese,

¹⁷ Të paktën, ky është gjykimi përfundimtar i Solow/Wyplosz (2007).

përfitimet e të cilave do të shtriheshin për një periudhë të gjatë, nuk duhej t'i ngarkohej një viti të vetëm buxhetor. Më gjerësisht, ajo çfarë është e dobishme për brezat e ardhshëm nuk duhet financuar vetëm nga popullsia aktuale. Kjo transferon te buxheti i shtetit logjikën e një familjeje apo kompanie, që marrin borxh për të financuar investimet, për të marrë të ardhura në të ardhmen apo për të ulur koston (për shembull, ndërtimi apo blerja e një shtëpie që në të ardhmen siguron të ardhura nga qiraja apo kursime nga kostoja e qirasë).

Megjithatë, në rastin e shteteve, logjika është më e ndërlikuar. Çfarë i rrit të ardhurat e ardhshme ose ul shpenzimet? Së fundi, të gjitha masat që nxitin zhvillimin kontribuojnë në rritjen e të ardhurave. Kjo përfshin shumë më tepër sesa ajo çka mbulon "investimi kapital". Shpenzimi për të shmangur shpenzimet e ardhshme llogaritet si investim (për shembull, programet e vaksinimit).

Po në cilat rrethana është me vend huamarrja? Të gjitha proceset e zhvillimit janë të financuara nga huatë, që do të thotë, nga borxhi; nëse jo nga shteti, atëherë nga sektori privat. Të ardhurat aktuale mjaftojnë vetëm për blerjen e prodhimit aktual. Prodhimi shtesë kërkon huamarrje për të financuar investimet e nevojshme shtesë, të ardhurat e të cilave, në rastin ideal – me fjalë të tjera, pa mbajtur para ose kursyer nga të ardhurat e mbledhura–bëjnë të mundur shitjen e prodhimit shtesë. Nëse familjet dhe kompanitë – për shembull, për shkak të pesimizmit të shkaktuar nga kriza – nuk marrin hua, nevoja për zhvillim i dikton shtetit të ndërhyjë. Nga ana tjetër, gjatë periudhave të optimizimit ekspansiv – si në rastin e ShBA-së deri në vitin 2007 – huadhënia mund ta tejkalojë rritjen e mundshme të ekonomisë reale.

Në këtë sistem, politika monetare ngarkohet me kufizimin e huamarrjes në nivele realiste. Borxhi i tepërt, pavarësisht nëse është grumbulluar nga shteti, kompanitë apo familjet, çon në flluska çmimi të pasurive apo në kërkesa inflacioniste që nuk paraqesin vëllimin real të zhvillimit, por më shumë rritjet e çmimit përballë ofertës që është në gjendje amullie.

➤ Sa borxh është shumë borxh?

Sa i lartë duhet të jetë "mali" i borxhit? Shumë periudha zhvillimi që ka përjetuar ekonomia botërore, përfshi atë aktuale, përfundojnë në kriza borxhi, edhe pse zakonisht nuk është shteti ai që e shkakton, por tregjet financiare që shkojnë përtej mundësive të tyre. Nuk ka qenë përherë e qartë nëse çmimet e aktiveve,

që zakonisht rriten në të njëjtën kohë – pasuritë e paluajtshme, aksionet e kështu me radhë – u rritën nga pritshmëritë realiste për fitime apo teprica spekulative. Së fundi, ekonomia reale, përmes fitimeve të saj nga prodhimi dhe faktorët e tjerë të prodhimit, përcakton sa hapësirë mbetet për të manovruar në sistem. Inflacioni dhe bilanci i pagesave janë faktorë të rëndësishëm në këtë drejtim. Përgjithësisht, njerëzit janë të mençur pasi ndodh ngjarja (për shembull, Kriza Aziatike e vitit 1997, filluska e dot.com [e kompanive të internetit – shën. i përkthyesit] në vitin 2000 dhe kriza financiare në vjeshtë të vitit 2008), po kush do ta ndalte një lulëzim ekonomik të mrekullueshëm, që krijon vende pune e të ardhura, vetëm sepse çmimet po rriten paksa dhe bilanci i pagesave është në minus?

Pavarësisht shkallës së huamarrjes aktuale neto, qoftë për arsye të nxitjes ekonomike ose për të financuar investimet publike, shumë shqetësohen nga vlera absolute e borxhit të grumbulluar. Kjo kufizon hapësirën e shtetit për të manovruar, duke qenë se i duhet të shpenzojë një masë të konsiderueshme të të ardhurave për të shlyer borxhin, i cili mund të fryhet në mënyrë të dhimbshme me rritjen e normave të interesit. Përtej kësaj, borxhi publik përfaqëson rishpërndarjen në favor të pronarëve të kapitalit, të cilët i kanë dhënë shtetit para hua dhe të ardhurat e interesit të të cilëve paguhen kryesisht nga taksat që u vendosen punonjësve me pagë. Së fundi – për të cituar argumentin e përmendur më shpesh – kjo u ngarkon një barrë fëmijëve tanë, brezave të ardhshme.

► Një e ardhme e varfër kundrejt një të tashmeje të pasur?

Po a i dëmton realisht ky borxh brezat e ardhshëm? Edhe pse është shtruar shpesh, kjo tezë është shumë gjithëpërfshirëse. Brezi i ardhshëm trashëgon si titujt, ashtu edhe borxhet. Borxhi publik nuk prek ndarjen e përgjithshme të kësaj barre midis brezave, por shpërndarjen e saj brenda brezit të ardhshëm. Përballë tatimpaguesve, të cilët do të jenë përgjegjës për shlyerjen e borxhit, janë kreditorët, me fjalë të tjera, ata që i kanë dhënë para hua shtetit.

Barra që do të duhet të mbajë shteti dhe tatimpaguesit në periudhën afatgjatë, si rezultat i nivelit të dhënë të borxhit, varet kryesisht nga raporti midis normave të interesit dhe rritja nominale. Nëse ekonomia rritet më shpejt sesa normat e interesit, pesha relative e borxhit publik, në raport me PBB-në, do të bjerë. Këto periudha lehtësimi ishin sistematike në fazën e gjatë të rritjes midis vitit 1950 dhe 1975, por, që nga ajo kohë, shpeshësia e tyre është ulur. Megjithatë, rrethanat tregojnë gjithashtu se një politikë me norma të larta interesi u sjell përfitime

kryesisht pronarëve të kapitalit. Normat e larta të interesit rrisin ose stabilizojnë, të paktën, vlerën relative të kërkesave për shlyerje.

Nëse brezi aktual dëshiron të bëjë diçka lidhur me mirëqenien e tjetrit, ai nuk duhet të grumbullojë detyrime aktivesh financiare, kthimi real i të cilave duhet të gjenerohet nga brezi i ardhshëm për trashëguesin e borxheve. Ai duhet të marrë masa që rritin prodhimtarinë e brezit tjetër. Këtu përfshihen investimet në infrastrukturë dhe arsim, kërkim e zhvillim. Nëse moskonsumi është i volitshëm, ai duhet të vijë në formën e ruajtjes së burimeve, duke qenë se rritja e kostove të burimeve, përfshi, për shembull, mbrojtjen nga përmbytja, ul prodhimtarinë. Duke pasur parasysh shpërndarjen e pabarabartë, nëse familjet më të pasura kursejnë, pa u bërë investim real, kjo mund të çojë në flluska të paqëndrueshme dhe të rrezikshme pasurish.

Si vend, Gjermania nuk mund ta trashëgojë mirëqenien tek e ardhmja brenda ekonomisë së saj duke i bërë përgjigje të tejtutjeve të borxhit – aktiveve – , po aq sa nuk mund ta shtyjë varfërinë në të ardhmen duke grumbulluar borxh mbi borxh. Kjo mund të bëhet vetëm nëse borxhet krijohen jashtë vendit apo nëse titujt grumbullohen në raport me vendet e huaja. Borxhet e huaja mund të na shtyjnë drejt një të ardhmeje në eksport më shumë sesa në import, me qëllim që të shlyejmë kreditorët. Titujt e huaj të borxhit, siç i ka grumbulluar Gjermania vitet e fundit, mund të zhduken në tym apo të ulen ndjeshëm në një krizë të tregut financiar, ashtu siç e mësuam në kurriz shumë investues në vitin 2008. Sidoqoftë, në Gjermani, tepricat e eksportit konsiderohen jo si barrë, por si objektiv (edhe i politikës ekonomike).

➤ Kursim publik, por bollëk privat?

Në fund të fundit, për të gjithë këtë që thamë nuk ka dallim nëse borxhet i përkasin qeverisë ose kompanive dhe familjeve. Edhe pse vetëm borxhi publik është ai që përbën barrën (ose vesin), në Gjermani, grumbullimi i borxhit privat, kryesisht nga kompanitë, shihet si virtut. Në këtë mënyrë, brezi i ardhshëm trashëgon jo vetëm 1,5 trilionë euro në borxh publik me risk të ulët, por edhe 2,5 trilionë euro borxh të mundshëm të pasiguruar të kompanive.

Fakti që borxhet private për një kohë të gjatë shiheshin si më pak problematike, kontribuoi jo pak në valën e privatizimeve të ish-sektorëve publikë, si posta, telekomunikacionet, hekurudhat dhe rrugët. Huamarrja e tyre sot nuk konsiderohet

aq alarmuese sa borxhi publik, por si një investim i mirëpritur publik. Edhe në këtë aspekt, rishpërndarja do të bëhet brenda brezit tjetër. Po këtë herë, nuk janë taksapaguesit që duhet të shlyejnë interesat mbi borxhin publik, por konsumatorët dhe – duhet përsëritur – punonjësit që supozohet të rritin fitimin përmes çmimeve (për shembull, qirasë) dhe kontrollit të pagave. Sidoqoftë, edhe për sektorin privat, mirëqenia reale vjen nga rritja e produktivitetit real.

Kësisoj, Gjermanisë i detyrohem kurajën për krijimin e borxhit të nevojshëm për rritjen e qëndrueshme afatgjatë. Shlyerja e tij vjen përmes investimeve në aktive të trupëzuara, shëndetësi, arsim, kërkim dhe kapital njerëzor. Akumulimi i titujve të huaj të borxhit, i lënduar aq shumë, përmes tepricave të eksportit ose kundrejt brezave të ardhshme të gjermanëve përmes “provigjoneve” të financuara ka vetëm vlerën e asaj çka brezat e ardhshëm në vend dhe jashtë do të jenë në gjendje të përftojnë falë investimit të sotëm. Përveç rishpërndarjes “josoci-ale” të përfitimit të investuesve, fitimet e tyre nuk mund të jenë më të larta se normat e rritjes së vetë ekonomisë racionale.

7.3. Rreziqet dhe mundësitë e privatizimit

Simon Vaut

Privatizimi i pronës publike është një çështje e debatueshme e politikës ekonomike, që vërtitet rreth problemit të raportit midis shtetit dhe ekonomisë private. Debati i nxehtë që ndezi privatizimi i hekurudhave gjermane është një ilustrim i qartë se ka shumë më tepër në lojë sesa thjesht vendime individuale politike, përfshi idetë themelore mbi mirëqenien publike, të ashtuquajturat “shërbime me interes të përgjithshëm” dhe detyrat e shtetit. Fakti që mendimet pro dhe kundër ndërthuren te SPD-ja tregon se për socialdemokratët nuk ka përgjigje të thjeshta për çështjen e raportit midis ekonomisë private dhe shtetit; përkundrazi, kjo kërkon një vlerësim kompleks.

Një paraqitje e hollësishme e privatizimeve në mbarë botën u ndërmor si pjesë e një hulumtimi të kryesuar nga akademiku dhe politikani, Ernst Ulrich von Weizsä-

cker), i Klubit të Romës¹⁸ në librin *'Limitet e privatizimit'*. Komentet e mëposhtme mbështeten kryesisht te ky raport.

Klubi i Romës sjell në raportin e tij argumente kundër qëndrimeve të skajshme që përkrahin, pa qenë kritike, ideologjinë e privatizimit, nga njëra anë, dhe besimit jokritik te shteti, i cili do të donte të shihte sa më shumë pronësi publike, nga ana tjetër. Një rrugë e mesme, shumë pak e dukshme, që, në përputhje me nevojat e një sektori të dhënë, mbështetet te aktorët privatë, partneritetet publike-private ose furnizimin nga shteti, që gjithsesi është e mbushur përplot me hendeqe. Privatizimi ka forma të ndryshme dhe një plejadë aktorësh:

- Kompanitë shtetërore janë në konkurrencë me kompanitë private, por mbeten në pronësi publike: për shembull, *Deutsche Bahn*, që ishte një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar nën pronësinë federale që nga viti 1994 deri në privatizimin e pjesshëm, është eksponuar përherë e më shumë ndaj konkurrencës me ofrues të tjerë.
- Kontraktimi i palëve të treta (outsourcing) për detyra të caktuara: kjo nënkupton se shteti ua kalon detyra të caktuara ofruesve privatë dhe i blen ato. Zyra e Shtypshkronjës Federale është një shembull për këtë. Megjithatë, ajo u ble sërish prej aktivitetit privat pas disa vitesh, për motive sigurie.
- Partneritetet publike-private (PPP): zgjidhje kooperativë, përmes të cilave shteti dhe aktorët privatë punojnë së bashku.
- Privatizimi i plotë: shitje tërësore e pasurive publike, që shteti të ketë, si rrjedhojë, vetëm ndikim rregullator mbi zhvillimet e tregut.

Raporti midis administrimit shtetëror dhe lirisë ekonomike, midis sigurisë dhe novacionit duhet të rivlerësohet vazhdimisht. Me kalimin e kohës, kushtet e përgjithshme mund të ndryshojnë: privatizimi dhe liberalizimi i sektorit të telekomunikacionit vijon të shihet si një rast pozitiv privatizimi. Çmimet kanë rënë ndjeshëm si rrjedhojë e privatizimit, novacioni në sektor është rritur dhe të ardhurat nga

18 Klubi i Romës është një organizatë ndërkombëtare shkencëtarësh dhe studiuesish, që merren me çështjet sociale dhe ekonomike. Klubi i Romës u bë i njohur nga botimi i një studimi në vitin 1972, "Limitet e zhvillimit", në të cilin përfshiu rritjen e popullsisë, ndotjen mjedisore dhe varfërimin e rezervave të lëndës së parë. Ai pati ndikim vendimtar mbi lëvizjen mjedisore.

privatizimi i kanë siguruar para për “sëndukun” publik. Ky zhvillim kushtëzohej nga aftësia e ofruesve të ndryshëm për të ofruar shërbimet e tyre me anë të rrjetit telefonik ekzistues, që u bë e mundur teknikisht vetëm në fund të shekullit të njëzetë. Më parë, privatizimi nuk do të çonte në konkurrencë më të madhe, pasi një monopol shtetëror thjesht do të zëvendësohej nga një monopol privat.

Me kalimin e kohës, lavjerrësi kalon sa te shteti, te privati. Në shekujt e nëntëmbëdhjetë dhe të njëzetë, shtetet morën gjithnjë e më shumë përgjegjësi dhe gati kudo raporti i shpenzimeve publike u rrit ndjeshëm. Në të shkuarën, gjithçka, nga telekomunikacionet, prodhimi i energjisë, deri te degët e industrisë, si prodhimi i çelikut, prodhimi i makinave, ishin nën pronësi publike, ndërkohë që tashmë janë privatizuar pjesërisht dhe plotësisht. Në çerekshkullin e shkuar, peshorja ka anuar dukshëm nga ana e ekonomisë private.

Po cilët kanë qenë pararendësit e këtij zhvillimi? Në nivel ndërkombëtar, Banka Botërore dhe Fondi Ndërkombëtar Monetar (FMN), në kuadrin e të ashtuquajturit Konsensusi i Uashingtonit, luajtën një rol madhor. Udhëzimet e tyre për politikën ekonomike bënë thirrje për një sprapsje të shtetit dhe sollën valën globale të liberalizimit dhe privatizimit. Sipas fituesit të çmimit “Nobel” dhe ish-kryeekonomistit të Bankës Botërore, Joseph Stiglitz (Stiglitz 2002: 78–81), nëse gjatë viteve ‘80 dhe ‘90 dikush do t’i kishte mësuar një papagalli të thoshte fjalën “privatizim”, këshilla e Bankës Botërore dhe FMN-së do të kishte qenë se kjo është e panevojshme. Problemi me Konsensusin e Uashingtonit, sipas Stiglitz-it, ishte se e shihte privatizimin si qëllim në vetete, në vend që të shqyrtonte me hollësi se cilët sektorë ishin të përshtatshëm për të dhe në cilat rrethana, si dhe cilat grupe aktorësh do të ishin të nevojshëm për të arritur zhvillim më të qëndrueshëm e një shpërndarje e furnizim më të drejtë.

Efektet e privatizimit varen nga sektori ekonomik në të cilin zbatohet dhe kushtet mbizotëruese: për pasojë, privatizimi mund të ketë sukses në një vend, por të dështojë në tjetër në të njëjtin sektor.

Faktorët në vijim kanë rëndësi të veçantë për rezultatin e privatizimit:

- A është konkurrenca e mundshme në këtë sektor apo monopolin e shtetit thjesht do ta zëvendësonte ai privat? Sidomos në të ashtuquajturat industri të ndërlidhjes, kjo është vetëm pjesërisht e mundur: për shembull, në trafikun hekurudhor, në një linjë të caktuar, konkurrenca është mjaft e kufizuar.

Thjesht, ndërtimi i linjave hekurudhore krah për krah nuk sjell fitim dhe trenat si zor se mund të parakalojnë njëri-tjetrin në të njëjtët binarë. Të tjera industri të rrjetit përfshijnë ofruesit me bazë performance, si ata të ujit, gazit dhe energjisë elektrike. Nëse bëhet privatizimi, ofruesit duhet të rregullohen në mënyrë të tillë, që të mos kenë mundësi të abuzojnë me fuqinë e tyre në treg.

- A ka rrezik që disa konsumatorë të përjashtohen nga mallrat e shërbimet e rëndësishme? Për shembull, njerëzve që jetojnë në zona të largëta mund t'u mohohet shërbimi postar ose ata që e kanë të vështirë të përballojnë muajin me shpenzime mund të lihen jashtë rrjetit elektrik?
- A ka shteti një interes të posaçëm sigurie? Zyra e Shtypshkronjës Federale gjermane u kthye në pronësi publike pas privatizimit të saj të plotë, pasi dokumentet që prodhonte dhe të dhënat që administronte konsideroheshin mjaft delikate.

Rezultatet e privatizimit dhe shtetëzimit janë të përziera. Ato varen mjaft nga sektori i përfshirë dhe hartimi i politikave. Në raportin, "*Limitet e privatizimit*", studiohen e vlerësohen raste studimore të privatizimeve në Gjermani dhe në vende të tjera. Ka një spektër e gjerë rezultatesh pozitive dhe negative. Sa më poshtë, do të paraqesim së pari efektet e konsoliduara pozitive dhe, më pas, rreziqet e privatizimit, bazuar në analizën e Klubit të Romës.

Kur privatizimi bën që në një sektor të rritet konkurrenca, si rregull, kjo çon në orientim më të mirë të konsumatorit. Kompanitë private që janë në konkurrencë me njëra-tjetrën varen nga klientët e kënaqur dhe duhet të jenë novatore dhe efikase që të mbijetojnë në treg.

Telekomunikacionet janë shembulli i një sektori ku konkurrenca midis kompanive private ka sjellë novacion dhe zgjerim të tregut, që do të ishte e pakonceptueshme për një monopol shtetëror. Kompanitë shtetërore që nuk e gjejnë veten në situata konkurruese kanë prirjen të punojnë me kosto më të lartë dhe janë më pak të hapura ndaj novacionit. Megjithatë, ulja e kostos dhe një shërbim me cilësi më të lartë nuk janë të pashmangshme. Kompanitë private kanë prirjen t'i shpërfillin klientët nga të cilët nuk kanë fitime: me fjalë të tjera, ato anojnë nga "përzgjedhja". Shembuj për këtë janë njerëzit që jetojnë në zona të thella, ku shërbimi postar nuk ka kosto efektive.

Privatizimi zë vend kur shtetit i mungojnë burimet për investime dhe investuesit privatë (ndërkombëtarë) janë të gatshëm të vënë kapital në dispozicion. Kjo ndodh shpesh në vende më të varfra, ku shërbimet me interes të përgjithshëm, si furnizimi me ujë, u jepen ndonjëherë investuesve privatë. Megjithatë, furnizimi nis të përmirësohet vetëm për ata që janë në gjendje të paguajnë duke sjellë, kështu, thellimin e pabarazive.

Një nga problemet me privatizimin që haset shpesh janë rregullat e dobëta të investimit: nën tryshinë e rrethanave një shtet pa përvojë në privatizim mund të përfundojë me kushte shitjeje që janë në dëm të tij. Përballë kompanive ndërkombëtare me përvojë, ish-vendet komuniste, veçanërisht, u futën shpesh në situata me çmime dhe cilësi jorealiste. Kështu, për shembull, në shtetet në transformim të Evropës Qendrore dhe Lindore, shoqëritë e energjisë u shitën shumë poshtë vlerës së tyre.

I kemi përmendur tashmë problemet që mund të lindin kur mbizotëron konkurrenca e papërshtatshme dhe krijohen monopole private, për shembull, në rastin e industrive që përdorin rrjete – ujësjellësi, rrjeti i energjisë elektrike – ku nuk ka asnjë alternativë tjetër. Kjo nuk sjell as novacion, as leverdi në çmim. Monopolet private përgjithësisht kanë më shumë dizavantazhe sesa ato shtetërore.

Një tjetër rrezik është zhvendosja e rreziqeve dhe kostot e jashtme. Pas shitjes të një investuesi privat, mund të ndodhë që rreziqet e të ardhurave të transferohen te shteti. Kjo ndodh, për shembull, kur kostot e jashtme operacionale, siç janë pasojat mjedisore, i imponohen shtetit, ndërkohë që fitimet mbeten në duart e privatit. Një shembull i kësaj është kostoja operacionale e energjisë bërthamore.

Një problem tjetër i mundshëm me investuesit privatë është që ata e harrojnë elementin afatgjatë të cilësisë së qëndrueshme shpërfillja e së cilës, në disa raste, ka çuar në përkeqësimin e infrastrukturës e cila, më parë, mirëmbahej me mjete publike. Një shembull i njohur për këtë është sistemi hekurudhor britanik. Pas privatizimit, investuesit e lanë pas dore rrjetin hekurudhor, duke çuar në aksidente të rënda. U desh që rrjeti të shtetëzohej sërish.

Shpesh, privatizimi ndodh kryesisht për arsye fiskale: të ardhurat përdoren për të mbushur gropat e buxhetit. Kjo mund të sjellë efekte pozitive në fusha të

tjera. Për shembull, qyteti i Dresdenit shiti stokun e vet të strehimit të përbërë prej 100 000 banesash dhe, si rezultat, është i vetmi qytet gjerman që nuk ka borxhe. Kursimi vjetor prej 80 milionë eurosh, që më parë duhej të gjendeshin për të shlyer interesat, mund të investohet – minus diferencën e qirasë me kostot e mirëmbajtjes – në fusha të tjera, si arsimit.

Klubi i Romës ka hartuar një listë me pika që duhen mbajtur parasysh për privatizimin. Para së gjithash, arsyet e privatizimit duhen diskutuar publikisht, për t’u siguruar që privatizimi nuk është thjesht qëllim në vetvete.

- Duhet të ketë një kuadër të fortë rregullator me objektiva të qarta për investuesit.
- Privatizimi nuk duhet bërë mbi baza ideologjike për shërbime që edhe shteti mund t’i ofrojë shumë mirë.
- Duhet të ketë kontroll demokratik nga autoritetet mbikëqyrëse.
- Kur shteti nuk është më pronar, ai duhet të ushtrojë ndikimin e tij në treg si rregullator.
- Mallrat dhe shërbimet publike me interes të përgjithshëm duhet të kenë garanci të veçanta: privatizimi i këtyre mallrave duhet kryer me kujdes të veçantë.
- Duhet të ketë një kartë sociale për njerëzit në nevojë: shembull për këtë është qyteti i Dresdenit, i cili e lidhi shitjen e stokut të strehimit me të drejta të posaçme mbrojtëse për qiramarrësit.
- Thirrjet për privatizime duhet të jenë transparente e të ndershme.
- Duhet shqyrtuar nëse është e mundur një rrugë e tretë, midis publikes dhe private, në formën e partneriteteve publike-private ose kooperativave.

7.4. Puna e denjë dhe bashkëvendimmarrja:

Politika e punës së denjë

Wolfgang Schroeder

Çdo shoqëri e kupton punën sipas mënyrës së vet. Po ashtu ka pikëpamje të ndryshme rreth punës, përfshi atë që shihet si punë e denjë. Si organizohet sot puna? Si do të jetë ajo në të ardhmen? Çfarë vendi zë puna në jetët tona dhe në raport me kohezionin social? A është kalimtar polarizimi midis punësimit të

pasigurt¹⁹ me pagë të ulët dhe kushteve dëshpëruese të punës, nga njëra anë, dhe situatave të kënaqshme e të mirëpaguara të punës, nga ana tjetër? Mos ndoshta po bëhemi dëshmitarë të një zhvillimi negativ që po afron? Këto janë shqetësime të ngutshme. Nëse nuk trajtohen, nuk mund të hartojmë plane për të ardhmen e individëve dhe shoqërisë. Zërat e atyre që predikojnë doktrinën e “fundit të punës” po vijnë duke u zbehur. Sipas tyre, shoqëria moderne po e linte pas punësimin e qëndrueshëm dhe se puna me kohë të plotë nuk ishte më një alternativë. Kjo ide mund të hidhet poshtë duke u bazuar te shembulli i vendeve skandinave, të cilat kombinojnë shkallën e lartë të punësimin me standarde të larta shoqërore. Edhe në Gjermani, pas vitesh stanjacioni, është arritur që papunësia të ulet. Në të njëjtën kohë, sidoqoftë, janë përhapur shqetësimet lidhur me një “shoqëri super-punëtore të fleksibilizuar”. Edhe nëse fitimet nga produktiviteti nënkuptojnë se sot duhet më pak punë për të prodhuar një PKB shumë më të lartë, sesa, të themi, 40 vjet më parë, ky është vetëm një aspekt i debatit mbi transformimin e punës.

► Ndryshimet në organizimin e punës

Edhe nëse organizimi i punësimin të qëndrueshëm i nënshtrohet debatit publik vetëm gjatë fazave apo situatave të caktuara, ai përcakton rutinën e përditshme të punonjësve. Puna industriale ishte e ndërthurur ngushtë me punën në linjat e prodhimit apo punën në mëshirë të makinerive. Edhe pse i ashtuquajtur i organizim ‘teilorist’ i punës, që karakterizohej nga makineritë, kontrolli dhe standardet – me fjalë të tjera nga planifikimi ‘shkencor’ i punës – nuk i preku të gjithë, ai jo vetëm pati ndikim vendimtar në shoqëri në tërësi, por edhe në jetën pas pune. Po ashtu, historia e lëvizjes së punës, veçanërisht, e sindikatave, nuk mund të kuptohet pa marrë parasysh organizimin ‘teilorist’ të punës dhe shqetësimet e mëdha.

Nga vitet ‘80, ‘teilorizmit’ iu bashkua një model i dytë novator prodhimi, i njohur si ‘toiotizmi’²⁰. Ky model prodhimi që, asokohe, e mori emrin nga një formë e re e organizimit të punës mbështetur në praktikën e punës në ekip te prodhuesi i makinave, Toyota, synonte, mes të tjerash, të zgjidhte disa prej dizavantazheve që shoqëronin ndarjen e ngurtë të punës dhe të lehtësonte integrimin më të ngushtë të punonjësve me aftësi më të zgjeruara. Një prej aspekteve të këtij modeli, që përputhej me një prej objektivave kryesore të politikës së menaxhimit

19 “I pasigurt” vjen nga fjala latine “precarius”, që do të thotë “përfutur me anë të përgjërimit ose lutjes” (pra, në varësi të vullnetit të dikujt tjetër) ose “i/e pasigurt”

20 Emri është marrë nga modeli prodhues i firmës së prodhimit të automjeteve, Toyota, e cila u përpoq të bënte bashkë prodhimtarinë karakteristike të prodhimit në masë me cilësitë tipike të prodhimit në punishte.

të sindikatave, ishte humanizimi i punës: lidhur me këtë, u përmirësuan kushtet e punës duke rritur cilësinë e punës dhe jetesës, duke ruajtur shëndetin dhe nxitur pasurinë shoqërore.

Fabrikat e automjeteve ishin qendrat kryesore të novatorizmit në lidhje me organizimin e punës. Një nga impulset kryesore erdhi nga format e reja të punës në ekip në fabrikat suedeze të Volvos. Krijimi i

formave të reja autonome apo pjesërisht autonome të punës në ekip në fillimvitet '80 dhe idetë e reja mbi prodhimin qenë të lidhura ngushtë me këtë industri kryesore. Puna pjesërisht autonome në ekip solli shpresë për një situatë pune më të larmishme, më interesante e më kërkuese sa u takon aftësive të përdorura, ku punonjësit do të kishin më shumë fushëveprim për të krijuar kuotën e tyre të punës dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjen përkatëse. U duk se puna e skuadrës do të shndërrohej në simbol të botës së re të punës dhe se individit do të përfitonte një status të ri në grupet bashkëvepruese.

Kur puna e standardizuar e linjës së montimit – 'teilorizmi' – arriti limitet e tij, nisi një debat sesi mund të përmirësoheshin kushtet e punës. Në zhvillimin drejt punës pjesërisht autonome në ekip, ajo u kryqëzua me modelin e "punës së denjë". E krahasuar në nivel ndërkombëtar, ky proces ishte gjerësisht i përhapur në Gjermani, çka bëri që shumë të flisnin për një "kurs të veçantë" gjerman, përmasa cilësore e të cilit mbështetej në themelet e punës së kualifikuar dhe formimit të dyfishtë profesional të shndërruar në 'teilorizëm'. Në këtë mënyrë, u përftua një lloj harmonie midis humanizimit dhe racionalizimit, që nga ana tjetër përbën bazën prodhuese për projektin e specializimit fleksibël në industrinë e orientuara drejt eksportit.

Megjithatë, që nga mesi i viteve '90, e ardhmja e kësaj forme specifike të punës industriale është vënë në mëdyshje, pasi kufizimet ekonomike dhe financiare nga njëra anë dhe zhvillimet kontradiktore në punën në ekip nga ana tjetër, e kanë vënë në pikëpyetje efikasitetin dhe pranimin e saj.

Teilorizmi' e ka zanafillën nga Frederick Taylor (1856–1915). Objektivi i tij ishte të organizonte punën sa më me efikasitet të ishte e mundur. Sipas tij, punonjësit funksionojnë me të njëjtat parime si makineritë dhe u përpoq t'i strukturonte proceset e punës bazuar në prodhimin mekanik të linjës së montimit.

Ka mbërritur zhgënjimi. Puna në ekip është zgjeruar, por pritshmëritë që ndezi për shtrirjen e gjerë të humanizimit të botës së punës nuk janë realizuar. Përkundrazi, mundësitë që punonjësit të organizojnë punën e tyre janë tkurrur edhe njëherë në shumë fusha, në favor të standardizimit më të madh. Për pasojë, regjime të ndryshme pune po konkurrojnë me njëra-tjetrën sot në industri për të arritur produktivitetin më të lartë.

Me zbehjen e prodhimit industrial në shkallë të gjerë, një tjetër lloj pune po zë vend qendror gjithnjë e më shumë në debatin publik: puna fleksibël e orientuar drejt dijes në shërbime. Shpesh, mendohet se individët në këtë fushë kanë autonomi më të madhe. Është e vërtetë se ata nuk punojnë në mjedise të mëdha pune, por në këto vende të vogla kanë shumë më tepër përgjegjësi për rezultatet e punës së tyre. Megjithatë, kjo lloj pune shkon krah për krah me humbjen e praktikave të orarit të përcaktuar të punës dhe, në vend që orari i punës të shkurtohet, njerëzit flasin “për punë pa fund”. Për shembull, në epokën e postës elektronike dhe telefonave celularë, pretendohet që shumë punonjës të jenë vazhdimisht në dispozicion pas përfundimit të orarit të punës, edhe në shkelje të ligjit. Në debatin për rreziqet dhe mundësitë që janë karakteristike për këtë zhvillim, kualifikimet e punonjësve luajnë rol vendimtar kur iu vihet në diskutim pavarësia. Sa i takon riskut, vëmendja përqendrohet te format e reja të stresit, sindromës së ezaurimit (ezaurim mendor për shkak të punës), kërkesat e gjithëfarëllojshme të vendosura nga puna dhe kundërshtitë që lindin për rrjedhojë në raport me cilësinë e përmirësimit të jetesës.

Gjatë viteve të fundit, janë bërë shumë diskutime lidhur me faktin nëse ka lindur një lloj i ri punonjësi, i cili, si “punonjës sipërmarrës” (shih më poshtë) është gjithashtu përgjegjës për punësimin e tij. Kjo nxjerr në pah një proces zhvillimi që shkon nga paga proletare përmes punonjësit profesional te “punonjësi sipërmarrës”. Karakteristikat e këtyre “punonjësve sipërmarrës”, të cilët, të gjendur në kushte të ngjashme me të tregut, organizojnë deri diku punën e tyre në përputhje me nevojat specifike të kompanisë, përkufizohen duke pasur parasysh tri përmasa në veçanti: (i) kualifikime të personalizuara, (ii) vetëkontroll sistematik në raport me punën dhe (iii) rrezik vetëshfrytëzimi në kushte pasigurie sociale.

Duke qenë se “punonjësi sipërmarrës” është konstrukt shoqëror që përkon me një fazë të re në zhvillimin e ekonomisë së tregut, sociologët Voß dhe Pongratz, që krijuan këtë neologjizëm, përshkruan një grup të ri marrëdhëniesh push-

teti brenda kompanisë: “Kundërshtia midis kapitalit dhe punës në ndërmarrjet kapitaliste nuk zhduket te tipi i punonjësit sipërmarrës, por shndërrohet në një kontradiktë strukturore midis sipërmarrësve të llojeve të ndryshme” (Voß/ Pongratz 2003: 32). Edhe pse siç kanë kundërshtuar kritikët me të drejtë, ky lloj nuk është aspak mbizotërues në botën e punës, karakteristikat e identifikuar këtu janë tashmë të përhapura.

Sfida më e madhe e politikës së “punës së denjë” aktualisht është rritja e madhe e punonjësve në kushte të pasigurta. Veçanërisht problematik në këtë drejtim është fakti se po bëhet gjithnjë e më e vështirë për t’iu larguar kësaj mënyre punësimi. Puna e denjë për socialdemokratët është me rëndësi kryesisht në dy aspekte për individët e interesuar. Së pari, puna me cilësi të ulët duhet bërë sa më njerëzore. Së dyti, ata që punojnë në të tilla rrethana duhen ndihmuar për të dalë prej tyre sërish, për të zhvilluar veten.

➤ **Bashkëvendimmarrja: Aktorët dhe Procedurat**

Me rënien e rëndësisë së punës industriale, po dalin kërkesa të reja për ata që janë të përfshirë në nxitjen e politikës së punës së denjë. Përkrah organizatave të punëdhënësve, punëmarrësve dhe shtetit, aktorët në nivel ndërmarrjeje përbëjnë shtyllën e tretë të mënyrës gjermane të politikës së negociuar të punës së denjë. Në vitet ‘80, negociatat e tyre u përqendruan te çështjet kryesore që lidheshin me kushtet e punës në kuadër të standardeve të negociuara në mbarë industrinë ose të zbatuara nga shteti. Në këtë pikë, në Gjermani u formua sistemi social në nivel ndërmarrjeje, që shkonte drejt rregullimit në nivel industrie, por pa e ndjekur atë në mënyrë të verbër. Modeli gjerman lejon një gamë të gjerë praktikash dhe formash të ndryshme shkëmbimi në nivel ndërmarrjeje. Gjithsesi, për të qenë të sigurtë, ato i nënshtrohen një kuadri kushtesh specifike. Për shembull, drejtuesit duhet të mbajnë parasysh interesat e personelit dhe të këshillit të punës mbi çështjet e politikës së personelit, si dhe udhëzimet e organizmave të industrisë, si dispozitat e kontratave kolektive dhe rregullave të vendosura nga qeveria. Nga ana tjetër, këshilli i punës duhet të kombinojë veprimtaritë e tij si përfaqësues të interesave të punonjësve me përgjegjësinë për produktivitetin dhe rezultatet e kompanisë.

Modeli i bashkëvendimmarrjes dhe bashkëpunimit në ndërmarrje përcaktohet shkurtimisht në ligjin “Për themelimin e Këshillit të Punës”: “Punëdhënësi dhe këshilli i punës punojnë së bashku në frymën e besimit të ndërsjellë, duke respek-

tuar kontratat kolektive në fuqi dhe në bashkëpunim me sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve të përfaqësuar në institucion për të mirën e punonjësve dhe institucionit” (§2, pika 1, Ligji i themelimit të Këshillit të Punës).

Modeli i përfaqësimit të interesave në Gjermani bën një ndarje formale të këshillave të punës dhe sindikatave. Anëtarët e Këshillit të punës nuk duhet të jenë anëtarë të sindikatave dhe sindikatat nuk kanë ndikim automatik e të drejtpërdrejtë në këshillat e punës. Duke pasur parasysh këtë ndarje formale, një nga arritjet më të mëdha të modelit gjerman është se nuk ka lindur asnjë rivalitet i pakapërcyeshëm midis sindikatave dhe këshillave të punës, por, përkundrazi, një bashkëpunim i përditshëm. Për gjashtë dekada, më shumë se 70 për qind e të gjithë anëtarëve të këshillit të punës janë gjithashtu anëtarë të sindikatës dhe bëjnë punë të jashtëzakonshme vullnetare në sindikata. Ndërkohë që këshilli i punës vepron si institucion “në kufi” (Fürstenberg 2000 [1958]), midis fuqisë punëtore, drejtuesve të kompanive dhe sindikatës, drejtuesit e vendit të punës duhet të ruajnë ekuilibrin delikat midis fuqisë punëtore, këshillit të punës dhe interesave e kërkesave vendimtare që vijnë nga drejtuesit qendrorë të kompanisë dhe shoqatat e punëdhënësve. Përplasja e interesave midis këshillit të punës dhe drejtuesve të kompanive zgjidhet mbi bazën e procedurës së miratuar. Konflikti i hapur është i pazakontë. Kur lindin mosmarrëveshje organizative ose lidhur me shpërndarjen, shpesh janë të përfshirë aktorët e jashtëm. Këshilli i punës dhe drejtuesit e kompanive janë aktorët më të rëndësishëm të nivelit bazë në fushat e tyre. Ata kanë baza ligjore të ndryshme dhe burimet e tyre të ndikimit janë zakonisht të pabarabarta, ndaj marrëdhëniet industriale nuk karakterizohen në përgjithësi nga takime midis aktorëve me fuqi të barabartë. Aktorët e vendit të punës nuk kanë të drejta për veprim lidhur me bisedimet kolektive, që, në fakt, shtrihen në nivel industrie, me një model institucional që është zhvilluar me kalimin e kohës dhe që, deri më tani, ka nxitur një mënyrë bashkëpunimi, elementet më të rëndësishme të të cilit mund të kategorizohen së pari si politike dhe ekonomike.

➤ Sfidat e bashkëvendimmarrjes

Modeli i ndarjes së punës në bazë të bashkëvendimmarrjes në vendin e punës përmes këshillave të punës, përfshirjes së pjesshme në vendimmarrjen ekonomike përmes përfaqësuesve të punëmarrësve në vendin e punës, si dhe sindikalistët me kohë të plotë në bordet mbikëqyrëse po përballen aktualisht me sfida të reja.

1. Forcat që bëjnë bashkë aktorët e bashkëvendimmarrjes po shpërbëhen.

Pranimi i vendimmarrjes në nivel sektorial për çështjet e politikës së punës në nivelin e vendit të punës është i padiskutueshëm, por, më shumë, është shprehje e mënyrës me të cilën bëhen gjërat, që është zhvilluar me kalimin e kohës dhe ekuilibrit aktual të pushtetit politik. Fakti është se kur drejtuesit e kompanive shohin hapësirë për të vepruar në mënyrën e tyre në raport me bisedimet kolektive, pa rrezikuar paqen në vendin e punës apo produktivitetin, ata ndonjëherë provojnë ta bëjnë këtë. Gjatë viteve të fundit, kjo ka ndodhur gjithnjë e më shpesh. Është afërmendsh që për socialdemokratët nuk është çështja nëse pjesëmarrja e punonjësve është “e dobishme”: përkundrazi, kjo është një e drejtë themelore e sanksionuar me ligj, që nuk negociohet në asnjë rrethanë.

Është thelbësore për legjitimitetin dhe politikëbërjen në mbarë industrinë që aktorët e vendit të punës të shohin se mendimet dhe interesat e tyre po merren parasysh në nivel konfederate. Si rregull, organizatat përfaqësuese varen nga kjo për të arritur një shkallë të lartë besnikërie dhe për të qenë të afta të ndërmarrin e të zbatojnë angazhime në raport me anëtarët e tyre. Tradita ka qenë forcë e rëndësishme lidhëse që i ka dhënë formë dimensionit politik të marrëdhënieve industriale. Megjithatë, gjatë 20 viteve të shkuara, edhe kjo ka pësuar një bjerrje marramendëse. Për dekada të tëra, shumica e vendeve të punës në Gjermani kishin një ndarje të konsoliduar detyrash, që nuk ishte vënë asnjëherë seriozisht në diskutim e ishte përcjellë nga brezi në brez. Këto forca lidhëse kulturore e tradicionale midis aktorëve të konfederatave dhe vendit të punës duket se po e humbin ndikimin: që nga vitet '80, është konstatuar se fuqia e konfederatës për të vendosur norma është zbehur. Drejtuesit e kompanive dhe këshillat e punës po i ndajnë rrugët gjithnjë e më shumë, duke shprehur publikisht pakënaqësinë për vendimet e organizatave sektoriale dhe duke refuzuar t'i zbatojnë ato.

2. Këshilli i punëve është partneri i kontaktit dhe përfaqëson interesat të gjithë punonjësve.

Një sfidë tjetër e madhe është përfaqësimi i përbashkët i interesave të punonjësve kryesorë dhe periferikë. Këto vitet e fundit, strukturat e punësimit të biznesit kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme. Numri i punonjësve të përkohshëm, punonjësve me kohë të pjesshme dhe punonjësve të agjencive është rritur tej mase. Ky është një burim i mundshëm konflikti në vendin e punës, çka e përball bashkëvendimmarrjen në vendin e punës me probleme madhore që

lidhen me ndërmjetësimin dhe solidaritetin. Këshilli i punës përfaqëson një fuqi punëtore që është në ndryshim të përhershëm, që ndonjëherë sjell probleme të jashtëzakonshme, kur bëhet fjalë për përfaqësimin e interesave të grupeve të punonjësve që janë pak të mbrojtur, me të njëjtin sukses si fuqia punëtore normale.

3. Modeli i bashkëvendimmarrjes përballet me forma përgjegjësie biznesi që shkojnë në drejtime të ndryshme. Kur hyri në fuqi ligji “Për themelimin e Këshillit të Punës” (Betriebsverfassungsgesetz) vendimmarrësit në vendin e punës ishin përgjithësisht ata që merrnin përsipër riskun ekonomik. Bashkëvendimmarrja nga këshilli i punës për çështje që lidheshin me organizimin dhe personelin u kufizua në vendin e punës. Megjithatë, ishte po ashtu e mundur që vendimet ekonomike të diskutoheshin dhe, në disa raste, edhe të përmirësoheshin efektet e tyre. Si rezultat i ndërkombëtarizimit dhe ndarjes së pronësisë nga drejtimi i kompanisë, vendimmarrja ekonomike mund të bjerë ndesh jo vetëm me interesat e fuqisë punëtore, por edhe të vendit të punës, pa iu dhënë mundësi aktorëve të vendit të punës të ushtrojnë ndonjë ndikim kur merren këto vendime. Ndonjëherë ndodh që këshilli i punës të zbutë efektet e vendimmarrjes përmes bisedimeve, por zhvillimi dhe “kontrolli financiar i orientuar nga tregu” i kompanive i ka nxjerrë modelit të bashkëvendimmarrjes probleme të reja.

4. Ndërkombëtarizimi i kompanive kërkon ndërkombëtarizimin e bashkëvendimmarrjes. Një prej argumenteve kryesore që përdoren për të justifikuar uljen e standardit të kushteve të punës është konkurrenca midis vendndodhjeve të biznesit dhe, shumë shpesh, midis njësive të ndryshme të së njëjtës kompani. Për shembull, porosinë për modele të reja makinash mund të shpallen në të gjithë kompaninë dhe të nxitet konkurrenca midis vendeve të punës, për të ulur koston e pagave edhe kontributet shoqërore të punëdhënësit. Sidoqoftë, rastet e para të solidaritetit në këto rrethana janë shfaqur tashmë, për shembull, midis fabrikave të firmës General Motors në Evropë, kur drejtuesit qendrorë kërcënuan se do të mbyllnin fabrika individuale evropiane. Këshillat evropiane të punës përfaqësojnë institucionin e parë të rëndësishëm mbikombëtar dhe kompetencat e tyre janë vënë seriozisht në provë. Pavarësisht kësaj, duhen përmirësime të mëtejshme të të drejtave të punonjësve, për t’u dhënë mundësinë përfaqësuesve të tyre të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje njësoj si të tjerët. Një tjetër hapësirë për bashkëvendimmarrje e vënë në dispozicion përmes dispozitave ndërkombëtare është “Kompania evropiane” (SE - Societas Europaea). Po ashtu, në këtë drejtim duhen hartuar strategji e zhvilluar ide për të përfituar nga mundësitë e për të minimizuar risqet. Logjika është e thjeshtë. Për të garantuar të drejtat e bashkëven-

dimarrjes, duhet zgjeruar bashkëpunimi evropian, me përfshirjen e një game aktorësh dhe nivelesh. Sa më shumë të arrihet kjo, aq më të kënaqshme do të jenë rezultatet.

7.5. Debati mbi pagën minimale

*Claudia Weinkopf*²¹

A është rëndësia në rritje e pagave të ulëta një problem që kërkon veprim politik apo një aspekt i nevojshëm i një strategjie efektive për uljen e papunësisë? Kjo është një çështje e debatueshme në Gjermani. Edhe pse, gjatë viteve të fundit, një mori studimesh kanë rënë dakord se niveli i pagave të ulëta në Gjermani është tashmë i konsiderueshëm (shih, për shembull, Schäfer 2003; Rhein/Gartner/Krug 2005; Goebel/Krause/Schupp 2005; Eichhorst e të tjerët. 2005), vazhdon të ketë kërkesa për rritje të mëtejshme të punësimit me pagë të ulët dhe, madje, edhe thirrje sporadike për “futjen” e punëve me pagë të ulët.²²

Kohët e fundit, debati është zhvendosur duke vlerësuar pyetjen nëse është detyrë (ekskluzive) e shtetit që të plotësojë pagat e ulëta, për të siguruar që ato të garantojnë jetesën e familjeve ose nëse duhen caktuar kufij minimal në negociatat kolektive apo në përcaktimet statutore, për t’u siguruar që pagat të mos të ulen gjithnjë e më tepër. Në vijim, do të shqyrtojmë dhe komentojmë sesa të bazuara janë disa prej argumenteve të sjella pro dhe kundër pagës së ulët ose minimale nga pikëpamja gjinore.

21 Një variant thuajse identik i kësaj rubrike është botuar me titullin, “Die politische Debatte über Niedrig- und Mindestlöhne – aus der Gender-Perspektive kommentiert” (Debati politik mbi pagat e ulëta dhe minimale – me koment nga pikëpamja gjinore), si pjesë e artikullit, “Niedrig und Mindestlöhne. Eine Analyse aus der Gender-Perspektive” (Pagat e ulëta dhe minimale. Një analizë nga pikëpamja gjinore), në: Friederike Maier dhe Angela Fiedler (eds) (2008), *Verfestigte Schiefen. Ökonomische Analysen zum Geschlechterverhältnis (Probleme të rrënjosura. Analiza ekonomike të marrëdhënieve gjinore)*, Berlin. Dëshirojmë të falënderojmë botuesin, Edition Sigma dhe autorin që na dhanë leje ta paraqesim tekstin këtu.

22 Është e vështirë të gjesh referenca të dobishme lidhur me këtë. Në shumicën e botimeve përkatëse, kërkesat për më shumë punësim me pagë të ulët mbështeten në kualifikimet në nivel më të lartë ose më të ulët. Për shembull, flitet për nevojën e shpërndarjes më të madhe të pagave, për mundësinë e pagave më konkurruese për punën e pakualifikuar ose me kualifikim të ulët, për rivendosjen e të ashtuquajturit “Lohnabstandsgebot” (parimi se përfitimet e sigurimeve shoqërore duhet të jenë shumë më të ulëta se pagat) apo për mbylljen e “hendekut në ofrimin e shërbimeve”, krahasuar me ShBA-në. Për të dhënë një shembull, raporti vjetor 2006/2007 i Këshillit të Ekspertëve thotë: “Në sektorin e shërbimeve po hapen shumë mundësi punësimi, siç tregojnë edhe përvojat nga vendet e tjera, si ShBA-ja, për shembull. Megjithatë, në të shkuarën janë zhdukur shumë punë me pagë të ulët në sektorin e shërbimeve, si pasojë e kostove tejet të larta të pagave” (Sachverständigenrat 2006: 370).

Një nga argumentet që dëgjojmë shpesh rreth punëve me pagë të ulët është se ato mund të ofrojnë një trampolinë drejt punësimit me pagesë më të lartë. Megjithatë, rezultatet nga një numër studimesh të kryera së fundi mbi këtë temë janë kthjelltësuese: e ashtuquajtura “lëvizje lart” nga punët me pagë të ulët ka shënuar rënie domethënëse gjatë viteve të fundit në Gjermani (shih Rhein/Gartner/Krug 2005). Kjo konfirmohet nga një vlerësim i kryer nga Institut für Arbeit und Qualifikation (Instituti i Punës dhe i Kualifikimeve – shën. i përkthyesit) (IAQ) mbi të dhënat e Bundesagentur für Arbeit (Agjencia Federale e Punës – shën. i përkthyesit) (BA), ku shihet përqindja në të cilën punëmarrësit me kohë të plotë që, në vitin 1998, paguheshin nën kufirin e pagës së ulët, në vitin 2003, ia kishin dalë mbanë të kalonin në një punë me pagë më të lartë (mbi kufirin e pagës së ulët).

Mesatarisht, këtë kishin arritur ta bënin 34,4 për qind ose një e treta e atyre që kishin punësim të qëndrueshëm në vitin 2003. Numri i atyre që kishin mundur të gjenin një punë me pagë më të mirë ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme, sipas llojit të punëmarrësit: rezultatin më të mirë e kishin të rinjtë (nën 25 vjeç: 62,3 për qind), ata me kualifikime të mira (diplomë akademike: 53,6 për qind) dhe burrat (50,4 për qind). Megjithatë, te gratë, vetëm rreth një e katërta kishte arritur t’i shpëtonte sektorit me paga të ulëta (27,1 për qind) (Bosch/Kalina 2007: 45).

Çështja e pagave të ulëta është tejet e debatueshme edhe nga pikëpamja e politikës sociale. Ndërkohë që disa argumentojnë se të ardhurat nga puna me kohë të plotë duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar një jetesë të pavarur dhe se varfëria për dikë që punon me kohë të plotë është e papranueshme, të tjerë theksojnë se punësimi me pagë të ulët nuk çon domosdoshmërisht në varfëri. Një tjetër mendim është se punonjësit me pagë të ulët janë kryesisht në kërkim të të ardhurave shtesë (shih, për shembull, Brenke/ Eichhorst 2007). Të dyja pikëpamjet nënkuptojnë gjithashtu se pagat e ulëta për gratë nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe. Edhe te përkrahësit e pagave minimale, vëmendja kthehet nga mashkulli që sjell të ardhurat në shtëpi, i cili, edhe pse punon me kohë të plotë e, madje, edhe përtej orarit të punës, nuk fiton mjaftueshëm për të mbajtur familjen. Në këtë aspekt, situata duket se është më pak serioze për gratë: nëse kaq shumë gra punojnë me kohë të pjesshme ose marrin punë të vogla, sigurisht që punojnë kryesisht për “para xhepi” – së paku kjo është bindja e përhapur – e, kështu, pavarësisht pagave të ulëta, ato nuk preken nga varfëria, duke qenë se kanë një bashkëshort apo partner që fiton më shumë.

Këto mendime janë të sakta deri te fakti që, vërtet, jo të gjithë punonjësit me paga të ulëta preken nga varfëria, pasi mund të ndodhë që një familje mund të ketë disa burime të ardhurash, duke i renditur të ardhurat e përgjithshme mbi pragun e varfërisë. Në fakt, papunësia ose pasiviteti janë shkaqet kryesore të varfërisë, ndërkohë që pagat e ulëta luajnë vetëm rol të pjesshëm. Thënë kjo, numri i personave të varfër që punojnë në sektorin me paga të ulëta edhe deri në fund të viteve '90 ishte 41 për qind, krahasuar me mesataren e BE-së prej 37 për qindësh (Marlier/Ponthieux 2000). Më tej, insinuata se gratë me paga të ulëta përgjithësisht gëzojnë mbrojtjen e një familjeje me para është për t'u vënë në diskutim. Sipas një analize nga Becker (2006a) – edhe pse ka të bëjë vetëm me punëmarrësit me kohë të plotë – shifra prej 19 për qindësh e grave me paga të ulëta që jetojnë në familje nën pragun e varfërisë, është vetëm pak më e ulët sesa në rastin e burrave me pagë të ulët (22 për qind).

Duke e parë problemin vetëm nga aspekti i familjeve, lëmë jashtë faktin se edhe përfitimet e sigurimeve shoqërore, si pensionet, përfitimet e papunësisë janë të lidhura me nivelin e të ardhurave që fiton dikush. Po ashtu, është me rëndësi të thuhet se mbështetja e një partneri nuk është e garantuar përjetë. Papunësia, ndarja ose divorci mund ta ndryshojnë situatën sa hap e mbyll sytë e në mënyrë të pakthyeshme.

Dëgjojmë shpesh argumente kundër futjes së pagës minimale me ligj, me pretekstin se pagat e ulëta tregojnë produktivitet të ulët dhe, kështu, kufiri i pagës së ulët vendosur nga qeveria do të çojë në humbjen e vendeve të punës. Veçanërisht, mundësitë e punësimit për ata që kanë kualifikime të ulëta do të cenoheshin seriozisht. Megjithatë, pagat e ulëta në Gjermani nuk prekin kryesisht ata që kanë kualifikime të ulëta. Rreth tre të katërtat e punonjësve me pagë të ulët në Gjermani kanë ndjekur formimin profesional apo zotërojnë një diplomë akademike. Edhe efektet e pagës minimale në punësim janë mjaft të diskutueshme. Në Mbretërinë e Bashkuar, me futjen e pagës minimale në vitin 1999, disa prisnin humbje masive të vendeve të punës, por në këtë rast punësimi është rritur në mënyrë domethënëse gjatë viteve të fundit, pavarësisht rritjeve të konsiderueshme të pagës minimale (Bosch/Weinkopf 2006a). Në vitin 2006, në ShBA, më shumë se 650 ekonomistë (mes tyre edhe pesë fitues të çmimit "Nobel") bënë thirrje për rritje thelbësore të pagës minimale (Instituti i Politikave Ekonomike 2006).

Kjo larmi mendimesh nuk përfaqësohet realisht në komunitetin ekonomik gjerman. Shumica dërrmuese e profesorëve gjermanë të ekonomisë janë të mendimit se pagat minimale në vetvete do të kishin pasoja negative në punësim. Për shembull, më 12 prill 2005, Wolfgang Franz, president i Zentrum für Europäische Wirtschaftsforschung (Qendra për Studime Ekonomike Evropiane – shën. i përkthyesit) (ZEW), u shpreh në një deklaratë për shtyp se: “Nuk ka asnjë çështje tjetër për të cilën ekonomistët bien më shumë dakord sesa ajo për pasojat e dëmshme të pagave minimale” (cituar në Schulten 2005: 190).

Vereinigung der Bayerischen Wirtschaft (Shoqata Bavareze e Biznesit) (2006: 7), duke iu referuar përvojës me pagën minimale në vendet e tjera, solli argumente të ngjashme: “Nuk ka të dhëna mbi efektet pozitive në tregun e punës”.²³

Në fakt, literatura ende nuk i ka përcaktuar efektet e pagës minimale mbi punësimin dhe studimet e kryera dalin më së shumti me përfundime të ndryshme (shih Bosch/ Weinkopf 2006b). Për shembull, Komiteti i Këshilltarëve Ekonomikë i ShBA-së (homologu amerikan i Sachverständigenrat zur Begutachtung der gesamtwirtschaftlichen Entwicklung në Gjermani [Komiteti i Këshilltarëve Ekonomikë]) u shpreh në raportin e vet vjetor për presidentin, në vitin 1999, se: “Pesha e të dhënave tregon se rritjet e lehta të pagës minimale kanë pasur pak ose aspak efekt mbi punësimin” (cituar në Schulten 2005: 198).

Në raportin e Bofinger-it dhe autorëve të tjerë (2006) thuhet: “Duke qenë se hulumtimet empirike nuk na japin një panoramë të njëtrajtshme, nuk mund të hamendësojmë se pagat minimale janë përgjithësisht të dëmshme për punësimin. Të paktën, kjo vlen për aq kohë sa mbahen në një nivel të arsyeshëm”.

Sipas mendimit tonë, ka dy argumente të tjera të rëndësishme që flasin në favor të futjes së pagës së detyrueshme minimale në Gjermani: parandalimi i dampngut të pagave (ofrimi i pagave më të ulta se sa paga normale në një industri të caktuar), që po shtohet në vend dhe, lidhur ngushtë me këtë, rritja e subvencionimit të të ardhurave të ulëta në kuadrin e ndihmës sociale. Rritja e numrit të pagave të ulëta në Gjermani tregon se sistemi i negociatave kolektive, që për një kohë të gjatë ka

23 Është pretenduar (në mënyrë të gabuar) se pagat minimale në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë nuk zbatohen për ata “me kualifikime të ulëta” (Vereinigung der Bayerischen Wirtschaft 2006: 8). Në fakt, në Mbretërinë e Bashkuar, mund të paguhet një pagë minimale disi më e ulët (e ashtuquajtura “kuotë zhvillimore”) për periudhat fillestare deri në gjashtë muaj, kur ofrohet trajnim (shih Bosch/Weinkopf 2006b: 36f). Megjithatë, kjo nuk përbën në asnjë mënyrë një përjashtim të përgjithshëm për personat me kualifikim të ulët.

mbrojtur standardet minimale në nivel sektori, nuk ofron më mbrojtje efektive nga pagat e ulëta dhe shumë të ulëta. Fuqia detyruese e kontratave kolektive po humbet si në Gjermaninë lindore ashtu edhe atë perëndimore, por pagat për të cilat është rënë dakord, ndonjëherë, janë shumë të ulëta (shih Deutscher Bundestag 2004).

Në vitin 2006, sipas llogaritjeve tona, rreth 5,5 milionë punonjës fituan më pak se 7,50 euro bruto në orë, që është çka kërkuan asokohe sindikatat si pagë të detyrueshme minimale. Më pak se dy të tretat e tyre ishin gra, që përbëjnë 19,8 për qind të të gjitha grave punonjëse në Gjermani. Rreth 1,9 milionë punonjës fituan më pak se pesë euro (Kalina/Weinkopf 2008). Kjo përfaqëson rreth 33 për qind të pagës mesatare për orë pune në Gjermani. Punonjësit, për pasojë, fitojnë edhe më pak sesa është e lejueshme në ShBA, ku paga minimale kombëtare, e cila krahasimisht është thjesht simbolike, në çdo rast, vërtitet rreth këtij niveli (dhe, për më tepër, pritet që, së shpejti, të rritet në mënyrë të konsiderueshme).

Në BE, 20 nga 27 shtete anëtare kanë pagë minimale të parashikuar me ligj dhe vende të tjera kanë mekanizma që parashikojnë kontrata kolektive shumë më detyruese se në Gjermani.

Në vitin 2007, vende si Franca, Holanda, Mbretëria e Bashkuar, Belgjika, Luksemburgu kishin një pagë minimale që shkonte nga rreth 8 deri mbi 9 euro.

Edhe në kampin e punëdhënësve, të cilët, tradicionalisht, e kanë refuzuar ndërhyrjen e shtetit në caktimin e pagave - me përjashtim të industrisë së ndërtimit – ka kërkesa tashmë për vendosjen e standardeve minimale, për të shmangur dampingun në rritje. Posaçërisht aktive në këtë drejtim janë shoqatat e sektorëve të pastrimit të kompanive tregtare dhe punës së përkohshme – me fjalë të tjera, dy degë me raporte shumë të ndryshme të grave të punësuar. Sektori i pastrimit të kompanive tregtare u përfshi së fundi në Aktin e Punonjësve të Transferuar, çka nënkupton se kontratat kolektive janë përgjithësisht të detyrueshme dhe kanë fuqi edhe për ofruesit e huaj. Dy nga tri federatat kryesore të punëdhënësve në sektorin e punës së përkohshme po kërkojnë vendosjen e rregullave mbarësektoriale për pagën minimale, me qëllim tkurrjen e dampingut të pagës dhe për të siguruar që kompanitë e huaja, të cilat mund të hyjnë masivisht në tregun gjerman në të ardhmen, të detyrohen të zbatojnë standardet minimale duke iu nënshtuar Aktit të Punonjësve të Transferuar (për më shumë hollësi, shih Weinkopf 2006).

Një argument i mëtejshëm për pagë minimale statutorë lidhet edhe me financimin e shtetit të mirëqenies. Deri më tani, kompanitë në Gjermani kanë pasur mundësi të mbështeten te shteti për të përmbushur pjesën e tyre në raport me pagat e ulëta, për shembull, përmes përfitimeve plotësuese të së ashtuquajturës “pagesa bazë e punëkërkuësit” (Arbeits- losengeld II – ndihma ekonomike bazë për të papunët), nëse nevojat e familjes nuk arrijnë të përmbushen me të ardhurat e anëtarëve. Në tetor të vitit 2006, sipas Agjencisë Federale të Punësimit, 20,9 për qind e të gjithë personave në moshë pune që kanë nevojë për asistencë ishin punëmarrës që kishin të drejtë të merrnin përfitim shtesë (1,117 milionë nga 5,339 milionë). Shumica e atyre që kishin të drejtë të merrnin këto pagesa “plotësuese” ishin punëmarrës përgjegjës për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore (11.3 për qind e të gjithëve atyre që kanë nevojë për ndihmë ose 601 533 veta). Një numër prej 440 055 personash gjithsej (8,3 për qind e të gjithëve atyre që marrin përfitime sociale bazë) kishin qenë madje të punësuar me kohë të plotë. Nga përfituesit e punësuar të përfitimeve sociale bazë, gratë përfaqësojnë 48,4 për qind nga ata që kanë detyrimin të derdhen kontribute të sigurimeve shoqërore dhe 55,1 për qind e atyre në punësim marginal (punë të vogla). Sipas një studimi nga Becker (2006b), ka shumë më tepër njerëz që kualifikohen për të marrë përfitime shtesë, por nuk i kanë kërkuar ato, deri tani. Në çdo rast, futja e pagës së detyrueshme minimale nuk do ta bënte të panevojshëm subvencionimin e të ardhurave të ulëta nga shteti, pasi përveç pagës së ulët për orë, luan rol edhe puna afatshkurtër dhe madhësia e familjes, por ajo do të ulte padyshim koston financiare të këtij “kombinimi pagash” (*Kombilöhnen*) dhe do të parandalonin barrën që sjell shkurtimi i pagave duke iu faturuar shtetit.

Shpesh mendohet se marrësit e përfitimeve sociale bazë në punësimin marginal (punë të vogla) “përfitojnë” nga kombinimi i pagesave të transferuara dhe të ardhurave të fituara: me fjalë të tjera, ata sigurohen që ajo që fitojnë të mos shkojë sipër pragut të vendosur për kontributet shoqërore (“punë me marifet”, shih Grabowsky dhe autorë të tjerë 2006). Megjithatë, kjo nuk merr parasysh se rritja në numër e këtyre punëve të vogla vjen edhe si rrjedhojë e ndryshimit të strategjive të kompanive për personelin. Nuk mund të hamendësohet se punonjësit i marrin këto punë me dëshirë. Te pastrimi i kompanive tregtare, për shembull, punët me kohë të pjesshme dhe me kohë të plotë që janë subjekt i sigurimeve shoqërore i rezervohen kryesisht personelit mbikëqyrës (Hieming dhe të tjerët 2005; Jaehrling/ Weinkopf 2006). Në këtë pikë, është për t’u diskutuar nëse kjo mund të ndryshojë duke ndryshuar nivelin e të ardhurave të fituara që lejohen

në raport me përfitimet shoqërore bazë, për të favorizuar punë me paga më të larta, siç kanë propozuar, për shembull, Bofinger dhe autorë të tjerë (2006). Personat me të ardhura të ulëta shtesë (shih IMK-WSI- Arbeitskreis Kombilohn 2007) do të jenë shumë më keq dhe gratë do të preken shumë herë më tepër.

Në përgjithësi, ne mendojmë se ka shumë për të thënë për aspektin e standardeve të detyrueshme minimale të pagave. Nga variantet e ndryshme që, në parim, mund të miratohen, futja e një page minimale me ligj do të ishte zgjidhja më e mirë nga këndvështrimi i grave, pasi në këtë mënyrë do të caktohej një prag i ulët i detyrueshëm në të gjithë sektorët e punësimit. Pagat minimale të caktuara në kontrata kolektive nuk janë një alternativë e qëndrueshme, por, në rastin më të mirë, plotësuese, pasi kushtet e nevojshme për t'i deklaruar të detyrueshme në përgjithësi e për t'i përfshirë në Aktin e Punonjësve të Transferuar ekzistojnë vetëm në disa sektorë. Sektorët tipikë me paga të ulëta dhe numër të lartë grash nuk priren të mbulohen nga kontratat kolektive.

Nuk mund të mohohet se paga minimale e detyrueshme nuk do t'u japë grave automatikisht mundësinë të sigurojnë një jetesë të pavarur. Edhe paga prej 7,50 eurosh në orë apo edhe 8,50 euro në orë që është kërkuar së fundi nga sindikatat, shpesh nuk mjafton për këtë, sidomos duke qenë se një përqindje e konsiderueshme e grave në Gjermani punojnë në punë të vogla ose me kohë të pjesshme.

8. VAZHDO TË MENDOSH

Botimet e serive për demokracinë sociale ofrojnë një busull që ndihmon për të eksploruar pyetjet themelore të socialdemokracisë dhe pikat e referimit në një sërë fushash të politikave. Sidoqoftë, qëllimi i tyre nuk është të japin - as nuk munden - përgjigje të përfundimtare. Shtegu i demokracisë sociale, qoftë si ide apo aksion politik, duhet mbajtur nën vëzhgim të vazhdueshëm, të përshtatet e rivlerësohet, që të përshkohet me sukses.

Edhe kjo përmbledhje vjen në vazhdën e kësaj më sipër e, si e tillë, përbën së pari një ftesë për vazhduar e për të menduar rreth çështjeve të parashtruara: çfarë mund të bëjë një politikë e mirë socialdemokrate dhe cilat janë sfidat me të cilat përballet demokracia sociale në shekullin e njëzetënjëtë?

Aktualisht, sfida kryesore e politikës ekonomike socialdemokrate është si të gjejë një ekuilibër të ri midis shtetit dhe tregut. Programi i Hamburgut i Partisë Socialdemokrate gjermane jep një shtytë domethënëse në këtë aspekt:

“Për ne, tregu është një mjet i nevojshëm dhe ka epërsi ndaj formave të tjera të koordinimit ekonomik. Megjithatë, nëse e lë të vetërregullohet, tregu është i verbër si nga pikëpamja sociale, ashtu edhe ajo mjedisore. Ai nuk është i aftë të ofrojë vetvetiu të mira publike në sasi të mjaftueshme. Që tregu të mund të ushtrojë një ndikim pozitiv, ka nevojë të rregullohet nga një shtet që është në gjendje të zbatojë sanksione, ligje efektive dhe mënyra më të drejta për vendosjen e çmimeve”, (Programi i Hamburgut 2007: 17)

Demokracia sociale duhet të zhvillohet vazhdimisht përballë sfidave të reja. Nëse nuk harron atë që përfaqëson dhe ruan një pamje të qartë të realitetit, kjo nuk do të jetë problem.

Kjo vlen edhe për politikën ekonomike socialdemokrate. Qëllimi i këtij vëllimi është të tregojë se është e mundur që prej vlerave bazë të demokracisë sociale, të mishëruara në konventat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat themelore të njeriut, të mund të burojnë një qasje e qartë socialdemokrate e politikës ekonomike. Ajo përbën një pikë orientimi për një politikë ekonomike moderne orientuar nga vlerat, që ngrihet mbi parimet e rritjes, barazisë sociale dhe qëndrueshmërisë.

BIBLIOGRAFIA

Ackermann, Josef (2008), Finanzkrise: Ackermann fordert mehr Regulierung, in: manager-magazin online, 18 Mars 2008.

Amyx, Jennifer (2004), Japan's Financial Crisis: Institutional Rigidity and Reluctant Change, Princeton.

Aoki, Masahiko and Gary R. Saxonhouse (2000), Finance, Governance, and Competitiveness in Japan, Oxford.

Aoki, Masahiko, Gregory Jackson and Hideaki Miyajima (eds) (2007), Corporate Governance in Japan: Institutional Change and Organizational Diversity, Oxford.

Baier, Ernst et al. (2002), Lebens- und Arbeitsbedingungen des Industrieproletariats, Duisburg.

Becker, Irene (2006a), Mindestlöhne ein Instrument (auch) zur Förderung der Gender-Gerechtigkeit?, in: Gabriele Sterkel, Thorsten Schulten und Jörg Wiedemuth (eds), Mindestlöhne gegen Sozialdumping. Rahmenbedingungen – Erfahrungen – Strategien, Hamburg, pp. 61–79.

Becker, Irene (2006b), Armut in Deutschland: Bevölkerung unterhalb der ALG-II-Grenze. Johann Wolfgang-Goethe-Universität. »Soziale Gerechtigkeit« Project Working Paper No. 3, Frankfurt am Main.

Bofinger, Peter (2007), Grundzüge der Volkswirtschaftslehre, 2nd edition, München.

Bofinger, Peter, Martin Dietz, Sascha Genders and Ulrich Walwei (2006), Vorrang für das reguläre Arbeitsverhältnis: ein Konzept für die Existenzsichernde Beschäftigung im Niedriglohnbereich. Gutachten für das Sächsische Ministerium für Wirtschaft und Arbeit (SWMA).

Bosch, Gerhard and Thorsten Kalina (2007), Niedriglohnbeschäftigung in Deutschland, in: Gerhard Bosch and Claudia Weinkopf (eds), Arbeit für wenig Geld: Niedriglohnbeschäftigung in Deutschland, Frankfurt am Main, pp. 20–105.

Bosch, Gerhard and Claudia Weinkopf (2006a), Mindestlöhne in Großbritannien – ein geglücktes Realexperiment, in: WSI-Mitteilungen, 3, pp. 125–130.

Bosch, Gerhard and Claudia Weinkopf (with Thorsten Kalina) (2006b), Gesetzliche Mindestlöhne auch in Deutschland? Report commissioned by Friedrich-Ebert-Stiftung, Gesprächskreis Arbeit und Qualifizierung, Bonn.

Brenke, Karl and Werner Eichhorst (2007), Mindestlohn für Deutschland nicht sinnvoll, in: DIW-Wochenbericht, 9, pp. 121–131. Bundesagentur für Arbeit (2006), Beschäftigung von erwerbsfähigen Hilfebedürftigen, October 2006, Nürnberg.

Bündnis 90/Die Grünen (2002), Die Zukunft ist Grün (The Future Is Green), Programi i Partisë BÜNDNIS 90/DIE GRÜNEN, miratuar në konferencën federale të partisë, 15–17 Mars 2002 në Berlin.

Bury, Hans Martin and Thomas Schmidt (1996), Das Bankkartell: die Verflechtung von Geld, Macht und Politik, München.

CDU (2007), Freiheit und Sicherheit. Grundsätze für Deutschland (Freedom and Security. Principles for Germany), Programi i Partisë CDU, miratuar në konferencën e 21-të federale të partisë, 3–4 Dhjetor 2007 në Hannover.

Conert, Hansgeorg (2002), Vom Handelskapital zur Globalisierung. Entwicklung und Kritik der kapitalistischen Ökonomie, 2nd revised edition, Münster.

Daly, Herman (1996), Beyond Economic Growth: The Economics of Sustainable Development, Boston.

Daly, Herman, and John Cobb (1989), For the Common Good, Boston.

Darling, Alistair (2008), Darling invokes Keynes as he eases spending rules to fight recession in: The Guardian, 20 October 2008, p. 4.

Dauderstädt, Michael (2009), Krisenzeiten: Was Schulden vermögen und was Vermögen schulden, Friedrich-Ebert-Stiftung, Bonn.

Dauderstädt, Michael (2007), Aufschwung 2007: die Verantwortung der Lohnpolitik, WISO-direkt, Analysen zur Wirtschafts- und Sozialpolitik, Bonn.

Demes, Helmut (1998), Arbeitsmarkt und Beschäftigung, in: Deutsches Institut für Japanstudien (ed.), Die Wirtschaft Japans. Strukturen zwischen Kontinuität und Wandel, Berlin, pp. 135–164.

Deutscher Bundestag (Parlamenti Gjerman) (1998), Abschlussbericht der Enquete-Kommission "Schutz des Menschen und der Umwelt – Ziele und Rahmenbedingungen einer nachhaltig zukunftsverträglichen Entwicklung", Deutscher Bundestag: Drucksache 13/11200, 26 Qershor 1998, Berlin.

Deutscher Bundestag (Parlamenti Gjerman) (2004), Wandel der Arbeitswelt und Modernisierung des Arbeitsrechts, Deutscher Bundestag: Drucksache 15/2932, Berlin.

Die Linke (2007), Programmatische Eckpunkte (Programmatic Points). Dokumenti themeltar i programit të partisë Die Linke, miratuar në konferencën e partiake të WASG dhe Linkspartei.PDS, 24–25 Maj 2007 në Dortmund.

Dirks, Daniel and Silke-Susann Otto (1998), Das "japanische Unternehmen", in: Deutsches Institut für Japanstudien (ed.), Die Wirtschaft Japans. Strukturen zwischen Kontinuität und Wandel, Berlin, pp. 211–244.

Dore, Ronald (2000), Stock Market Capitalism: Welfare Capitalism: Japan and Germany versus the Anglo-Saxons, Oxford.

Dore, Ronald, William Lazonick and Mary O'Sullivan (1999), Varieties of Capitalism in the Twentieth Century, in: Oxford Review of Economic Policy, vol. 15, pp. 102–120.

Economic Policy Institute (2006), EPI on the Minimum Wage, EPI News, 27 October 2006, Washington, DC.

Egle, Christoph (2006), Deutschland: der blockierte Musterknabe, in: Thomas Meyer (ed.), Praxis der Sozialen Demokratie, Wiesbaden, pp. 273–326.

Eichhorst, Werner, Hermann Gartner, Gerhard Krug, Thomas Rhein and Eberhard Wiedemann (2005), Niedriglohnbeschäftigung in Deutschland und im internationalen Ver-

Lexime të mëtejshme:

Faqja e internetit e Akademie für Soziale Demokratie ofron lexime të tjera të përzgjedhura (me komente): www.fes-soziale-demokratie.de/materialien

Studimet dhe analizat aktuale të politikës ekonomike gjenden në botimet e Departamentit të Politikave Ekonomike e Sociale të Friedrich-Ebert-Stiftung: www.fes.de/wiso

Lexime të mëtejshme:



*Më shumë kontekst,
tekste dhe materi-
ale rreth vlerave dhe
rrënjëve të demokra-
cisë sociale ofronen
në modulën, "Demo-
kracia sociale", në
Friedrich- Ebert-Stif-
tung der Online-Aka-
demie*

*Një hyrje në të gjitha
çështjet e rëndë-
sishme që lidhen me
ekonominë dhe të
rejat ekonomike e
gjeni në: "Das Wirt-
schaftslexikon.
Begriffe. Zahlen.
Zusammenhänge"
nga Volker Happe,
Gustav Horn dhe
Kim Otto (shih f. 20)*

gleich, in: Jutta Allmendinger, Werner Eichhorst and Ulrich Walwei (eds), IAB Handbuch Arbeitsmarkt. Analysen, Daten, Fakten, Nürnberg, pp. 107–142.

Engels, Friedrich (1988), Herrn Eugen Dührings Umwälzung der Wissenschaft (Anti-Dühring), Karl Marx und Friedrich Engels Gesamtausgabe (MEGA), Vol. 27, Berlin.

Eurostat, Statistical Database of the European Commission: http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/search_database.

FDP (1997), Wiesbadener Grundsätze. Für die liberale Bürgergesellschaft (Wiesbaden Principles. For a Liberal Civil Society), miratuar në konferencën federale të partisë FDP, 24 Maj 1997 në Wiesbaden.

Friedman, Milton (1973), Capitalism and Freedom, Chicago.

Friedman, Thomas L. (2005), The World Is Flat: A Brief History of the Twenty-First Century, New York.

Fürstenberg, Friedrich (2000 [1958]), Der Betriebsrat als Grenzinstitution, in: Friedrich Fürstenberg (ed.), Arbeitsbeziehungen im gesellschaftlichen Wandel, München/Mering.

Gabriel, Sigmar (2008), Links neu denken. Politik für die Mehrheit, München.

Galston, William A. (2008), How Big Government Got Its Groove Back, in: American Prospect, vol. 19, no. 6, Washington, DC, pp. 23–26.

Gerstenberger, Heide (2006), Die subjektlose Gewalt. Theorie der Entstehung bürgerlicher Staatsgewalt, 2nd edition, Münster.

Gilpin, Robert (2001), Global Political Economy: Understanding the International Economic Order, Princeton/Oxford.

Goebel, Jan, Peter Krause and Jürgen Schupp (2005), Mehr Armut durch steigende Arbeitslosigkeit, in: DIW-Wochenbericht, 10, pp. 725–730.

Grabowsky, Fabian, Alexander Neubacher and Michael Sauga (2006), Die große Flut. Dank Hartz-Reformen haben Hunderttausende Niedrigverdienender Anspruch auf staatliche Hilfe – darunter auch viele Selbstständige, in: Der Spiegel, 19, pp. 66–68.

Haak, René (ed.) (2006), The Changing Structure of Labour in Japan, London.

Hall, Peter A. and David Soskice (eds) (2001), Varieties of Capitalism. The Institutional Foundations of Comparative Advantage, New York/Oxford.

Hamburger Programm (2007), Party programme of the SPD, Germany, adopted at the Hamburg party conference of the SPD, 28 October 2007.

Happe, Volker, Gustav Horn and Kim Otto (2009), Das Wirtschaftslexikon. Begriffe. Zahlen. Zusammenhänge, Verlag J.H.W. Dietz Nachf., Bonn.

Hassel, Anke (2006), Die Schwächen des deutschen Kapitalismus, in: Volker Berghahn and Sigurt Vitols (eds), Gibt es einen deutschen Kapitalismus? Die soziale Marktwirtschaft im Weltsystem, Frankfurt am Main, pp. 200–214.

Hauff, Volker (ed.) (1987), Unsere gemeinsame Zukunft: der Brundtland-Bericht der Weltkommission für Umwelt und Entwicklung, Greven.

Heinemann, Gustav W. (1972), Grußwort auf dem IG-Metall-Kongress "Qualität des Lebens" am 11. April 1972 in Oberhausen, in: IG Metall (ed.), Aufgabe Zukunft, Band 1: Qualität des Lebens. Contributions to the fourth international conference of Industriegewerkschaft Metall für die Bundesrepublik Deutschland (IG Metall), 11–14 April 1972 in Oberhausen, Frankfurt am Main, pp. 14–17.

Heinrich, Michael (2004), Kritik der politischen Ökonomie. Eine Einführung, 1st edition, Stuttgart.

Hieming, Bettina, Karen Jaehrling, Thorsten Kalina, Achim Vanselow and Claudia Weinkopf (2005), Stellenbesetzung im Bereich "einfacher" Dienstleistungen. Abschlussbericht einer Studie im Auftrag des Bundesministeriums für Wirtschaft und Arbeit, No. 550, Berlin.

Hinchmann, Lew (2006), USA: Residual Welfare Society and Libertarian Democracy, in: Thomas Meyer (ed.), Praxis der Sozialen Demokratie, Wiesbaden, pp. 327–373.

Horn, Gustav (2005), Die deutsche Krankheit: Sparwut und Sozialabbau, München.

IMK-WSI-Arbeitskreis Kombilohn (2007), Was tun im Niedriglohnbereich? Eine kritische Auseinandersetzung mit einem neuem Kombilohnkonzept, IMK-Report, No. 18, Düsseldorf.

Kalina, Thorsten and Claudia Weinkopf (2008), Neue Berechnung des IAQ zu Niedriglöhnen in Deutschland. 2006 arbeiteten 5,5 Millionen Beschäftigte für Bruttostundenlöhne unter 7,50 €, Manuscript, Gelsenkirchen.

Kevenhörster, Paul, Werner Pascha and Karen Shire (2003), Japan: Wirtschaft – Gesellschaft – Politik, Wiesbaden.

Keynes, John Maynard (1966), Allgemeine Theorie der Beschäftigung, des Zinses und des Geldes (General Theory of Employment, Interest and Money), München/Leipzig.

Keynes, John Maynard (1926), The End of Laissez-Faire: The Consequences of the Peace (New edition 2009), New York.

Lawn, Philip (2003), A Theoretical Foundation to Support the Index of Sustainable Economic Welfare (ISEW), Genuine Progress Indicator (GPI), and other related indexes, in: Ecological Economics 44, pp. 105–118.

Lincoln, James R. and Michael L. Gerlach (2004), Japan's Network Economy: Structure, Persistence, and Change, Cambridge.

Marlier, Eric and Sophie Ponthieux (2000), Low-Wage Employees in EU Countries, European Commission, Statistical Office: Statistics in Focus/Population and Social Conditions, 11/2000, Luxembourg.

Marx, Karl (1991), Kritik der politischen Ökonomie, Karl Marx und Friedrich Engels Gesamtausgabe (MEGA), Vol. 10, Berlin.

Marx, Karl and Friedrich Engels (1987), Manifest der Kommunistischen Partei (Communist Manifesto), Berlin (West).

Meadows, Donella et al. (1972), Die Grenzen des Wachstums – Berichte des Club of Rome zur Lage der Menschheit, München.

Merkel, Wolfgang et al. (2003), Defekte Demokratie, Band 1: Theorie, Opladen.

- Meyer, Thomas (2006), *Praxis der Sozialen Demokratie*, 1st edition, Wiesbaden.
- Meyer, Thomas (2005a), *Theorie der Sozialen Demokratie*, 1st edition, Wiesbaden.
- Meyer, Thomas with Nicole Breyer (2005b), *Die Zukunft der Sozialen Demokratie*, Bonn.
- Minsky, Hyman P. (1986), *Stabilizing an Unstable Economy*, New Haven.
- Müller-Armack, Alfred (1947), *Wirtschaftslenkung und Marktwirtschaft*, Hamburg.
- Münch, Joachim and Mikiko Eswein (1998), *Bildung, Öffentlichkeit und Arbeit in Japan. Mythos und Wirklichkeit*, Berlin.
- Pascha, Werner (ed.) (2004), *Systemic Change in the Japanese and German Economies. Convergence and Differentiation as a Dual Challenge*, London/New York.
- Platzek, Matthias, Peer Steinbrück and Frank-Walter Steinmeier (2007), *Auf der Höhe der Zeit*, Berlin.
- OECD (various years), *Statistical Extracts*, <http://stats.oecd.org>.
- Pongratz, Hans J. and G. Günther Voss (2003), *Arbeitskraftunternehmer: Erwerbsorientierung in entgrenzten Arbeitsformen*, Berlin.
- Reich, Robert (2008), *Supercapitalism. The Battle for Democracy in an Age of Big Business*, New York.
- Rhein, Thomas, Hermann Gartner and Gerhard Krug (2005), *Niedriglohnssektor: Aufstiegschancen für Geringverdiener verschlechtert*. IAB-Kurzbericht, 10 Mars 2005, Nürnberg.
- Rössel, Jörg (2005), *The Semantics of Social Structure: An International Comparison*, Köln.
- Rodrik, Dani (1997), *Has Globalization Gone Too Far?*, Washington, DC.
- Sachverständigenrat (Council of Experts) (2005), *Die Chance nutzen – Reformen mutig voranbringen*, Sachverständigenrat zur Begutachtung der gesamtwirtschaftlichen Entwicklung, Jahresgutachten 2005/06, Wiesbaden.
- Sachverständigenrat (Council of Experts) (2006), *Widerstrebende Interessen, ungenutzte Chancen*, Sachverständigenrat zur Begutachtung der gesamtwirtschaftlichen Entwicklung, Jahresgutachten 2006/07, Wiesbaden.
- Schäfer, Claus (2003), *Effektiv gezahlte Niedriglöhne in Deutschland*, in: *WSI-Mitteilungen*, 56, pp. 420–428.
- Scharpf, Fritz W. (1987), *Sozialdemokratische Krisenpolitik in Europa*, Frankfurt am Main/New York.
- Schmidt, Manfred G. (2000), *Immer noch auf dem mittleren Weg? Deutschlands politische Ökonomie am Ende des 20. Jahrhunderts*, in: Roland Czada and Helmut Wollmann (eds), *Von der Bonner zur Berliner Republik*, Wiesbaden, pp. 491–513.
- Schulten, Thomas (2005), *Gesetzliche Mindestlöhne in Europa. Institutionelle Regelungen und ökonomische Konsequenzen*, in: Eckhard Hein (ed.), *Löhne, Beschäftigung, Verteilung und Wachstum*, Marburg, pp. 185–208.
- Schumpeter, Joseph A. (1950), *Kapitalismus, Sozialismus und Demokratie*, München.
- Sen, Amartya (1999), *Development as Freedom*, New York.
- Sinn, Hans-Werner (1986), *Risiko als Produktionsfaktor*, in: *Jahrbücher für Nationalökonomie und Statistik*, München, pp. 557–571.
- Smith, Adam (1974), *Der Wohlstand der Nationen. Eine Untersuchung seiner Natur und seiner Ursachen (The Wealth of Nations)*, München.
- Solow, Robert and Charles Wyplosz (2007), in: Ronald Schettkat and Jochem Langkau (eds), *Aufschwung für Deutschland. Plädoyer international renommierter Ökonomen für eine neue Wirtschaftspolitik*, Bonn, pp. 35–47.
- Stiglitz, Joseph E. (2002), *Globalisation and Its Discontents*, New York.
- Streeck, Wolfgang (1995), *German Capitalism. Does It Exist? Can It Survive?*, Köln.
- Streeck, Wolfgang and Kozi Yamamura (eds) (2003), *The End of Diversity? Prospects for German and Japanese Capitalism*, Ithaca, New York.
- Vaut, Simon (2007), *Hoffnung wagen*, Berliner Republik 3/2007, Berlin, pp. 78–83.
- Vaut, Simon (2008), *Amerikas Hoffnung*, Berliner Republik 1/2008, Berlin, pp. 79–81.
- Vereinigung der Bayerischen Wirtschaft (2006), *Mindestlöhne – Gefahr für den Arbeitsmarkt. Argumentation. Die Stimme der Wirtschaft*, 14 March 2006, München.
- Wagner, Gert G. and Wolfgang Wiegard (2002), *Volkswirtschaftliche Forschung und Politikberatung*, in: Irene Becker et al. (eds), *Soziale Sicherung in einer dynamischen Gesellschaft*, Frankfurt am Main, pp. 770–788.
- Weinert, Klaus Peter (2008), *Auf lange Sicht sind wir alle tot. Die Wirtschaftsprognosen des John Maynard Keynes*, Deutschlandradio Kultur, Radiofeuilleton Kalenderblatt, *transmetim* i 5 Qershorit 2008, URL: ([dëguar për herë të fundit në 8 Janar 2009](http://deguar.për.herë.të.fundit.në.8.Janar.2009)).
- Weinkopf, Claudia (2006), *Mindestbedingungen für die Zeitarbeitsbranche? Expertise im Auftrag des Interessenverbandes Deutscher Zeitarbeitsunternehmen (IGZ)*. Institut Arbeit und Technik, Gelsenkirchen.
- Weizsäcker, Ernst Ulrich von (2006), *Grenzen der Privatisierung*, Stuttgart.
- Wood, Steward (2001), *Business, Government, and Patterns of Labour Market Policy in Britain and the Federal Republic of Germany*, in: Peter A. Hall and David Soskice (eds), *Varieties of Capitalism. The Institutional Foundations of Comparative Advantage*, New York/Oxford, pp. 247–274.

Dymbëdhjetë termat kyçe

1. *Barazia*
(S. 80, S. 149 ff.)

2. *Globalizmi*
(S. 53 ff., 106 ff.)

3. *Të drejtat
themelore*
(S. 60 ff.)

4. *Vlerat bazë*
(S. 57 ff.)

5. *Puna e denjë*
(S. 15, S. 140 ff.)

6. *Kapitalizëm*
(S. 21 ff., 27 ff., S. 32
ff., S. 43 ff., S. 48 ff.)

7. *Ekonomi tregu*
(S. 43 ff., S. 48 ff.,
S. 51 ff.)

8. *Paga minimale*
(S. 148 ff.)

9. *Bashkëvendim-
marrja* (S. 40 ff., S.
81, S. 140 ff.)

10. *Qëndrueshmëri*
(S. 72 ff.)

11. *Barazia sociale*
(S. 69 ff.)

12. *Rritja* (S. 67 ff.)

REAGIME NDAJ PUBLIKIMIT TË PARË NË GJERMANISHT

“Një libër informativ, Botimi 2 ia vlen të lexohet. Edhe pse nuk ka shprehimisht këtë qëllim, ai është ajo çka na duhet në këtë epokë të kapitalizmit financiar të shfrenuar. Politika ekonomike e orientuar drejt vlerave është tema e këtij libri dhe ajo për çfarë bën thirrje. Ai flet për një politikë, të demokracisë sociale, ku në qendër të vëmendjes janë njerëzit. Një politikë qëllimi i së cilës është mirëqenia për të gjithë në nivel të lartë dhe që e bën të arritshme dhe të përhershme po ashtu – të suksesshme ekonomikisht, të arsyeshme nga ana mjedisore, të qëndrueshme dhe të drejtë në pikëpamjen sociale. Një busull drejt së ardhmes”.

Franz Müntefering, Kryetar i SPD-së deri në vitin 2009

“Botimet për demokracinë sociale trajtojnë çështje të ndërlikuara në mënyrë të kuptueshme dhe koncize. Kush, çfarë, si dhe, veçanërisht, për çfarë arsye: një vështrim i përmbledhur që, në mjedisin e egër të politikës së përditshme, vlen më shumë se ari”.

Dianne Köster, sekretare e sindikatës

“Botimi ‘Ekonomia dhe demokracia sociale’ ofron një panoramë interesante dhe të hollësishme të lidhjeve midis proceseve ekonomike dhe socialdemokracisë. Veçanërisht në kontekstin e krizës financiare, është thelbësore të njohim sistemet dhe rendet e ndryshme ekonomike dhe, mbi të gjitha, parimet dhe programet ekonomike të partive politike”.

Thorsten Schäfer-Gümbel, kryetar i SPD-së në Hese dhe kryetar i grupit të SPD-së në parlamentin e landit të Hesent

“Botimi ‘Ekonomia dhe demokracia sociale’ është një ndihmë e madhe për njerëzit që janë të shqetësuar nëse ajo që përjetojnë në ‘jetën ekonomike’, në punën e tyre apo si konsumatorë është realisht në përputhje me atë që Kushtetuta nënkupton me ‘shtet social’”.

Josef Vogt, anëtar i përhershëm i SPD-së, IG-Metall dhe AWO (Arbeiterwohlfahrt – Shoqata për Mirëqenien e Punëtorëve)

“Veçanërisht gjatë kësaj periudhe krize financiare, vëllimi i FES-it, ‘Ekonomia dhe demokracia sociale’, është i domosdoshëm. Autorët analizojnë në mënyrë të qartë e të kuptueshme teorinë kryesore ekonomike, trajtojnë shembuj praktikë dhe ngrenë pyetjen se

ç'pamje mund të ketë politika ekonomike socialdemokrate moderne. Si rezultat, libri është një instrument i dobishëm për edukimin politik: të formësosh e të thuash fjalën tënde në politikbërje është motori i demokracisë sociale».

Dr. Peter Struck, kryetar i grupit parlamentar të SPD-së në Bundestag deri në vitin 2009

“Në kohë krizash të mëdha, gjithçka ndryshon, Teoritë dhe instrumentet për të drejtuar e koordinuar kapitalizmin nisin e ringjallen. Demokracia sociale ngrihet mbi një model ideal, i cili i jep formë edhe orientimit të politikës së saj ekonomike. Vlerat bazë dhe të drejtat themelore marrin përparësi në aksionin ekonomik dhe politik. Të gjithë ata që duan të kuptojnë e të ndihmojnë për t’u dhënë formë këtyre proceseve ndryshimi, do ta konsiderojnë të paçmuar leximin e botimit ‘Ekonomia dhe demokracia sociale’. Ai ofron shembuj praktikë dhe bazat teorike të nevojshme për këdo që kërkon të formojë qëndrimin e vet. Libri shtyn për reflektim dhe angazhim të mëtejshëm. Ekonomia nuk mbështetet në ligjin natyror, por mund të ndikohet nga politika dhe nga njerëzit”.

Ulla Schmidt , deputete, ish-ministre e Shëndetësisë

Dëshirojmë t’ju ftojme të merrni pjesë në debatin mbi demokracinë sociale. Akademia për Demokracinë Sociale e fondacionit “Friedrich Ebert” ofron hapësirë për këtë qëllim. Një seminar me tetë module trajton vlerat bazë dhe zbatimin në praktikë të demokracisë sociale:

Themelet e demokracisë sociale

Ekonomia dhe demokracia sociale

Shteti i mirëqenies dhe demokracia sociale

Globalizimi dhe demokracia sociale

Evropa dhe demokracia sociale

Imigracioni, integrimi dhe demokracia sociale

Shteti, Shoqëria Civile dhe Demokracia Sociale

Paqja dhe Demokracia Sociale

RRETH AUTORËVE

Jochen Dahm (*1981) është nëpunës i Akademisë Politike të fondacionit “Friedrich-Ebert”. Ai ka studiuar shkencë politike, shkencë komunikimi dhe të drejtë publike në Mynster dhe Málaga.

Dr. Michael Dauderstädt (*1947) ka punuar për fondacionin “Friedrich-Ebert” që prej vitit 1980. Që prej vitit 2006, ai drejton Departamentin e Ekonomisë dhe Politikave Sociale dhe përpara kësaj edhe atë të Analizës Politike Ndërkombëtare. Ai ka studiuar për matematikë, ekonomik dhe politika zhvillimi në Ahen, Paris dhe Berlin.

Peter Franz (*1953) ka punuar në Ministrinë gjermane të Mjedisit, Ruajtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore që nga vitit 1988. Prej vitit 1999, ka drejtuar Departamentin e Mjedisit dhe Ekonomisë, Novacionit dhe Punësimit, Kontrollit Mjedisor. Ai ka studiuar për ekonomi politike dhe shkencë administrative.

Tobias Gombert (*1975) organizon seminare për këshillat e punës. Po ashtu, ai është instruktor në seminarët dhe takimet e punës për komunikimin. Nga viti 2003 deri në vitin 2005, ai ishte zëvendëskryetar i Socialistëve të Rinj në SPD (Juso) dhe anëtar i këshillit kombëtar nga viti 2005 to 2007. Gjatë kësaj kohe, ai mori pjesë në ngritjen e Akademisë së Socialistëve të Rinj. Që prej vitit 2007, është instruktor në Akademinë e Demokracisë Sociale. Ai është autori kryesor i vëllimit ‘Bazat e Demokracisë Sociale’. Puna e tij akademike është përqendruar te Zhan-Zhak Ruso, te teoritë dhe filozofia morale Marxiste.

Dr. Erik Gurgsdies (*1944) punoi si drejtor i zyrës rajonale të Mecklenburg-Vorpommern të fondacionit, “Friedrich Ebert” nga viti 1993 në vitin 2009. Ai kreu studimet për ekonomik dhe sociologji, përpara sesa të punonte si lektor i ekonomisë në institutet arsimore për të rritur (Heimvolkshochschule) në Bergneustadt dhe Ahrensburg, si dhe në Shkollën Ekonomike dhe Politike të Hamburgut.

Dr. Christian Krell (*1977) është anëtar i fondacionit “Friedrich Ebert”, përgjegjës për Akademinë për Demokraci Sociale. Ai studioi për shkencë politike, histori dhe sociologji në Universitetin e Zigenit dhe Universitetin e Jorkut. Në vitin 2007, ai përfundoi doktoraturën për shkencë politikë mbi politikën evropiane të SPD-së, Partisë së Punës dhe Partisë Socialiste.

Dr. Florian Mayer (*1975) është punonjës i Ministrisë gjermane të Mjedisit, Ruajtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore, në Departamentin e Mjedisit dhe Ekonomisë, Novacionit dhe Punësimit, Kontrollit Mjedisor dhe jep mësim në Universitetin e Heidelbergut. Ai ka studiuar ekonomik dhe shkencë sociale.

Prof. Dr. Werner Pascha (*1957) është profesor i studimeve ekonomike të Azisë Lindore/Japonisë dhe Koresë në Universitetin Duisburg-Essen. Ai studioi ekonomi politike në Londër (LSE), Nagoya/Japoni dhe, veçanërisht, në Freiburg im Breisgau, ku edhe kreu doktoraturën dhe studimet për marrjen e titullit “profesor”.

Prof. Dr. Wolfgang Schroeder (*1960) është Sekretar i Shtetit në Ministrinë për Punë, Siguri Shoqërore, Gratë dhe Familjen në landin e Brandenburgut që nga viti 2009, dhe që nga viti 2006, profesor i lëndës, ‘Sistemi politik i Republikës së Gjermanisë /Transformimet e shtetit në Kasel’. Përpara kësaj, mes të tjerash ai ka mbajtur një sërë pozicionesh ekzekutive në IG Metall dhe ka dhënë mësimë e ka kryer studime në universitetet Frankfurt am Main, Darmstadt dhe Harvard. Ai studioi shkencë politike në Marburg, Vjenë, Tübingen dhe Frankfurt am Main dhe kreu doktoraturën në Gisen.

Stefan Tidow punon në Departamentin e Mjedisit, Ekonomisë, Novacionit dhe Punësimit, Kontrollit Mjedisor në Ministrinë gjermane të Mjedisit, Ruajtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore. Aktualisht, ai ka marrë një vit pushim dhe është punësuar nga grupi parlamentar Bündnis 90/Die Grünen.

Simon Vaut (*1977) punon në Ministrinë e Punës, Mirëqenies, Familjes dhe Grave në landin e Brandenburgut në Gjermani. Si instruktor i Akademisë për Demokraci Sociale, ai ka zhvilluar seminare mbi ekonominë dhe globalizimin. Ai ka punuar po ashtu për Institut für Sozialforschung und Sozialwirtschaft, shkollën e qeverisjes “Hertie” dhe OECD-në.

Dr. Claudia Weinkopf (*1963) është zëvendës drejtore e departamentit kërkimor, “Fleksibilitet dhe siguri” (FLEX) në Institutin për Punë, Aftësi dhe Trajnim (IAQ), Universiteti i Duisburg-Essen-it. Ajo studioi ekonomi politike në Dortmund me diplomë dytësore në sociologji. Po ashtu, atje ajo kreu edhe doktoraturën.

Politikës i duhet një drejtim i qartë. Vetëm ata që mund të identifikojnë objektivat e tyre në mënyrë të kthjellët do t'i arrijnë ato e do të frymëzojnë edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Për këtë qëllim, botimi “Ekonomia dhe demokracia sociale” shtron pyetjen: Si mund të jetë e suksesshme një politikë ekonomike socialdemokrate moderne dhe e orientuar drejt vlerave? Mbi ç’parime mbështetet ajo? Si mund të zbatohet në praktikë?

Çështjet që trajtohen në botimet për demokracinë sociale janë të orientuara drejt seminareve të Akademisë për Demokraci Sociale. Akademia për Demokracinë Sociale është një burim këshillimor dhe edukues i Friedrich-Ebert-Stiftung për njerëzit e interesuar dhe të angazhuar në politikë.

Për informacion të mëtejshëm rreth Akademisë: www.fes-soziale-demokratie.de

“Një libër informues. Botimi 2 ia vlen të lexohet”.

Franz Müntefering, Kryetar i SPD-së deri në 2009

“Kush, çfarë, si dhe, veçanërisht, për ç’arsye: një vështrim i përmbledhur që në mjedisin e egër të politikës së ditës, vlen më shumë se ari” Dianne Köster, sekretare e sindikatës

“Veçanërisht gjatë kësaj periudhe të krizës financiare, vëllimi i FES-it, ‘Ekonomia dhe demokracia sociale’ është i domosdoshëm”

Dr. Peter Struck, kryetar i grupit parlamentar të SPD-së në Bundestag deri në vitin 2009